

HASAN SHALA - DELUSHE HALIMI

UDHËZUESI PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE



UDHËZUESI PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Përgatitur nga:

Hasan Shala - Kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe
Delushe Halimi - Gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Kosovës

Prishtinë, 2019

I publikuar nga

Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Autorët:

Hasan Shala, Delushe Halimi

© 2019 Hasan Shala, Delushe Halimi dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Të gjitha të drejtat rezervohen. Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk pranojnë kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk janë përgjegjës për aktualitetet, korrektësinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

Informacion

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi / shumëzimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj. në publikimet e tjera pa pëlqimin shprehimor nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe autorët.

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i kësaj Përmbledhje është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës

PARATHËNIE

Një qasje gjithëpërfshirëse për të mbështetur institucionet dhe proceset demokratike dukshëm, drejtohet vëmendja tek administrata publike dhe veprimtaria e saj në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Transparenca dhe llogaridhënia në administratën publike janë konsideruar nga të gjithë si pjesë dhe paketë e qeverisjes demokratike. Nxitja e këtyre standardeve dhe zbatimi i tyre në praktikë nuk është i mundur pa një sistem funksional të drejtësisë administrative, i cili jo vetëm ofron mundësinë që personat privatë të ankohen ndaj veprimeve apo vendimeve administrative, por edhe i bën përgjegjëse autoritetet publike për shkelje të legjislacionit apo të drejtave të njeriut. Në të kundërt, mungesa e këtyre sistemeve rezultojnë në një pasiguri ligjore dhe tensione e konflikte të mundshme shoqërore, sidomos kur autoritetet publike nuk perceptohen si të përgjegjshme apo si të bindura ndaj ligjit.

Sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me çështjet e procedurës administrative, zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 05/L-031, Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përgjithësi, rregullat e veçanta (për disa materie të administratës), dhe rregullat e përgjithshme të përcaktuara dhe të garantuara me Kushtetutë.

Në teorinë juridike administrative, por edhe në legjislacionin pozitiv të shumë sistemeve juridike, procedura administrative definohet para së gjithash, si tërësi e normave juridike me të cilat rregullohen mënyrat e sjelljes së organeve dhe agjencioneve të administratës, kur këto institucione të pushtetit, duke aplikuar normat e së drejtës materiale, duke menaxhuar çështje juridike administrative, nxjerrin akte juridike administrative, me të cilat vendosin për të drejtat, obligimet ose interesat e subjekteve përkatëse (personat fizik dhe juridik).

Sistemi juridik në Kosovë ka nxjerrë dhe ndryshuar më tepër se një Ligj në periudhën e pas luftës, andaj praktika administrative ka vështirësi të mëdha në implementimin e saj. Kjo vlen edhe për Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Ligjeve tjera në çështjet administrative me të cilat rregullohet një materie e caktuar. Andaj, literatura profesionale në formë të udhëzimeve juridike dhe komentimi i tyre krahas edhe me nxjerrjen apo ndryshimin e Ligjeve në fuqi, paraqet nevojë si për zyrtarët administrativ në institucione të administratës publike ashtu edhe për pjesën tjetër të shoqërisë civile dhe qytetarëve në përgjithësi për të pasur më lehtë qasjen në administratë publike.

Udhëzuesi për procedurën administrative do të jetë një praktikë e mirë jo vetëm për nevojat e zyrtarëve në institucionet e administratës publike por edhe për juristët të cilët janë të interesuar dhe ofrojnë ndihmë juridike në këto çështje si dhe paraqet një mbështetje dhe mbrojtje më efikase të lirive dhe të drejtave të njeriut në rastet kur paraqiten si palë në procesin administrativ për të realizuar të drejtën e tyre. Gjithashtu i

njëjti mund të përdoret edhe për trajnimin e dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative në institucionet e administratës publike.

Ky udhëzues qëllim kryesor e ka të lehtësojë punën e organeve të administratës ku në procedurë administrative vendosin për të drejtat dhe detyrimet e palëve, po ashtu edhe të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, por i njëjti mund të jetë i nevojshëm edhe për shërbimet e tjera juridike si dhe për aftësimin profesional të zyrtarëve të administratës publike të cilët aktualisht janë të punësuar dhe pritet të punësohen në vazhdimësi në organet administrative. Gjithashtu ky udhëzues mund të kontribuojë organeve të administratës shtetërore në lehtësimin e zbatimit e rregullave-dispozitive të Ligjit të Procedurës Administrative, si atyre që në praktikën e tyre hasin në vështirësi gjatë punës së tyre në rastin kur vendosin për një të drejtë apo detyrim të palës në procedurë administrative, e në veçanti për palët të drejtat dhe detyrimet e të cilëve vendoset në procesin administrativ.

Ky udhëzues përveç shtjellimit të materies për procedurën administrative në përgjithësi do të përmbajë formularë me shembuj të ndryshëm të akteve të organeve administrative të cilat mirren gjatë zhvillimit të procedurës administrative, në rastet kur ndërmarrin disa veprime dhe kur vendosin për një të drejtë apo detyrim të palës (qytetarit) të personave fizik dhe juridik.

Duke ju vënë në dispozicion këtë material të gjitha institucioneve, organeve administrative dhe personave të interesuar, inkurajojmë angazhimin e mëtejshëm të punonjësve të praktikës dhe autoriteteve për të përmirësuar kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë administrative në vend.

Andaj konsiderojmë se GIZ me botimin e këtij Udhëzuesi po bënë një kontribut jashtëzakonisht të rëndësishëm për plotësimin e punës praktike lidhur me vendimmarrjen, hartimin dhe arsyetimin e akteve të ndryshme administrative lidhur me një të drejtë apo detyrim të palës (qytetarit), e cila ka shumë vështirësi në implementimin e praktikës në bazë të legjisllacionit i cili është aktualisht në fuqi.

Përmbajtja

Hyrje	7
Burimet	8
Pjesa -I-	9
Nocioni i të drejtës së procedurës administrative	9
Parimet Themelore të Ligjit për Procedurën Administrative	10
Kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës administrative.....	13
Procedura për garantimin e paanshmërisë së Administratës Publike	18
Fillimi i procedimit administrativ	20
Subjektet e Procedurës.....	22
Dorëzimi i kërkesave	25
Procedimi administrativ deri në nxjerrjen e aktit administrativ.....	29
Braktisja e procedurës Administrative.....	42
Pamundësia e përfundimit të procedurës administrative	42
Përjashtimi nga Procedura Administrative	43
Bashkëpunimi administrativ	45
Ndihma ndërmjet organeve publike (ndihma administrative)	47
Akti Administrativ	50
Revokimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ.....	54
Kontratat Administrative	63
Mjetet Juridike në Procedurën Administrative	67
Rregullat e përgjithshme dhe kushtet e pranueshmërisë së ankesës	70
Format Praktike	78
Pjesa -II-	87
Konkluzion	314

HYRJE

Më 25 maj 2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës, miratoi Ligjin nr. 05/L-031, i publikuar në gazetën zyrtare më 21 qershor 2016, i cili ka hyrë në fuqi një vit pas ditës së miratimit e me të cilin është rregulluar procedura e përgjithshme administrative në vend.

Me qenë se ligjet zakonisht kanë vështirësinë e tyre në aplikimin e dispozitave ligjore gjatë punës së përditshme të organeve administrative, dhe nga vet fakti se palët (personat juridik dhe fizik) në procesin administrativ, kanë qasje të vazhdueshme dhe kërkesa për një të drejtë ose detyrim, të një organ i caktuar publik janë të përditshme, lind nevoja e përgjigjes në këto lloj kërkesa dhe marrja e një numri të madh të akteve administrative, varësisht nga çështja e cila është në kërkesë ose në aktin e detyrueshëm.

Duke e pasur parasysh se në kohën në të cilën jemi duke vepruar kur kemi përball një ligj pothuajse të ri në zbatim, është më se e nevojshme për qartësimin dhe modifikimin e një Udhëzuesi i llojit të tillë, në mënyrë që funksionimi i administratës publike të bëhet më i lehtë për zyrtarët të cilët punojnë si dhe për qytetarët (personave fizik dhe juridik) palë në procedurë administrative, për të pasur në dispozicion një udhëzues për të realizuar sa më lehtë dhe më shpejtë të drejtën e tyre të kërkuar ose për të kundërshtuar një detyrim të caktuar nga organi administrativ.

Në këtë udhëzues përdoren metodat e shpjegimit, duke u bazuar në raste dhe duke përdorur shembuj konkret. Materiali i këtij udhëzuesi do t'iu shpërndahej gjitha organeve administrative e veçanërisht atyre që do ta zbatojnë drejtë për drejtë për punën e tyre, i cili material do të përmban komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Procedurën Administrative.

Burimet

Për përgatitjen e këtij Udhëzuesi janë shfrytëzuar këto materiale:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Procedurën Administrative;
- E Drejta e Procedurës Administrative - Mr.Sc. Agur Sokoli;
- E Drejta administrative - Dr. Esat Stavileci, Agur Sokoli, Mirlinda Batalli.

PJESA - I -

Nocioni i të drejtës së procedurës administrative

Me të drejtën e procedurës administrative kuptojmë sistemin e dispozitave juridike të cilat caktojnë të drejtat dhe detyrimet e organit shtetëror në zbatimin e normave juridike materiale, në raste konkrete si dhe të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

E drejta e procedurës administrative paraqet tërësi dispozitash me të cilat rregullohet veprimtaria e organeve administrative, organeve tjera shtetërore dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike, kur në çështje administrative drejtpërdrejtë duke i zbatuar dispozitat, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e individëve apo të personave juridik dhe palëve tjera. Nga kjo rezulton se këto dispozita rregullojnë formën e veprimtarisë së organeve administrative lidhur me nxjerrjen e akteve administrative.

Roli i administratës në kushte të reja të zhvillimit të shoqërisë kosovare është ndër temat aktuale. Sa do që ushtrimi i pushtetit nëpërmes administratës është në kundërshtim me çfarëdo forme të demokracisë, organet administrative pa pushtet nuk mund të funksionojnë. Roli i administratës publike sot shprehet në dy drejtime: në njërën anë ajo ka rëndësi të veçantë për qytetarët të cilët paraqiten si palë në raport të drejtpërdrejte me organet administrative, në anën tjetër ajo ka rëndësi të posaçme për organet administrative të pushtetit të cilat iu nënshtrohen proceseve të reja të zhvillimit të shoqërisë.

Kërkesa për njohjen dhe zgjerimin e njohurive për administratën është e domosdoshme sidomos pas reformave në gjykata, ku nga 1 janari i vitit 2013, themelohet Departamenti i veçantë (special) për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës, si dhe Departamenti për Çështje administrative në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës Ligji Nr. 05/L -031, i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 20/21 ne Qershor 2016, në Prishtinë, ka për qëllim që të garantoj në raport me palët nxjerrjen e vendimeve të ligjshme dhe të drejta, gjegjësisht që të vërtetohet gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Ligji për Procedurën Administrative, përmban dispozita me të cilat rregullohet mënyra e ushtrimit të administratës në situatat individuale, e veçmas mënyra e nxjerrjes së akteve konkrete administrative. Ky ligj përmban jo vetëm parimet themelore por edhe institutet juridike dhe rregulla juridike procedurale të cilat sigurojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e punës dhe të vendosjes, mbrojtjen e të drejtave subjektive të palëve si dhe inspiron racionalizimin dhe ekonomizimin e procedurës dhe njëherit pengojnë arbitraritetin e organit administrativ që zhvillon këtë procedurë.

Ligji për Procedurën Administrative, përcakton dispozita të cilat rregullojnë çështjet e procedurës siç janë:

- Dispozita mbi kompetencën e organit që vendos në çështjet administrative;
- Mbi rendin e veprimeve dhe formën e veprimeve;
- Mbi formën e akteve administrative;
- Dispozita lidhur me pjesëmarrësit në procedurë (palët dhe pjesëmarrësit e tjerë);
- Dispozita mbi afatet;
- Dispozita mbi komunikimin e organit dhe të palëve;
- Dispozita mbi shpenzimet e veprimeve të veçanta procedurale;
- Dispozita mbi procedurën e shkallës së parë dhe të dytë;
- Dispozita mbi anulimin dhe prishjen e vendimeve të paligjshme;
- Dispozita mbi mjetet juridike;
- Dispozita mbi ekzekutimin e vendimeve në procedurën administrative.

Ligjin për Procedurën Administrative e zbatojnë të gjitha organet e administratës publike, si dhe organizatat të cilat ushtrojnë autorizime publike, të cilat Organe të administratës publike janë:

- Organet e administratës publike qendrore dhe organet tjera në varësi të tyre;
- Organet e administratës publike lokale dhe organet e tjera në varësi të tyre.

Parimet Themelore të Ligjit për Procedurën Administrative

Sipas Ligjit për Procedurën Administrative përcaktohen parimet themelore, mbi të cilat bazohet dhe zhvillohet procedura administrative. Këto parime përcaktohen në bazë të këtij ligji me qëllim që të sigurohen të drejtat dhe interesat e palëve me rastin kur vihen në marrëdhënie me organet e administratës publike. Nga kjo rezulton se këto parime themelore janë parashikuar me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave juridike të qytetarëve nga veprimtaria e parregullt e administratës publike. Prandaj mund të themi se parimet themelore të procedurës administrative janë udhërrëfyes për vendosjen e drejtë të çështjes administrative, sepse organi duke respektuar këto parime gjen orientimin për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Parimet Themelore të procedurës administrative janë:

- Parimi i ligjshmërisë;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme;
- Parimi i administratës së hapur;
- Parimi i joformalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative;
- Parimi i informimit dhe ndihmës aktive;
- Parimi i mospagimit të procedurës;

- Parimi i të drejtës në mjete juridike.

Parimi i ligjshmërisë - në procedurën administrative përcakton jo vetëm parimin themelor të procedurës administrative por edhe njërin nga parimet themelore kushtetuese, i cili është proklamuar në të gjitha sistemet juridike. Ky parim përcakton idenë mbi sundimin e ligjit në shoqëri, që do të thotë se të gjithë qytetarët, organet dhe organizatat normative juridike nënshtrohen para ligjit. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Pra sipas këtij parimi organet e administratës publike të cilat zhvillojnë procedurën administrative, kur vendosin në çështje administrative, mbi të drejtat, detyrimet ose interesat juridike të individëve, të personave juridik dhe palëve tjera duhet t'i përmbahen Ligjit për Procedurën Administrative, dhe të zbatojnë drejt dispozitat materiale juridike, në bazë të të cilave vendoset mbi të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve, të personave juridik ose të palëve tjera. Ligdhënësi me qëllim të respektimit të parimit të ligjshmërisë, ka parashikuar që me rastin e moszbatimit të parimit të ligjshmërisë palët kanë të drejtë të ushtrimit të mjeteve juridike siç është përdorimi i ankesës si mjet i rregullt juridik dhe mjetet e jashtëzakonshme në procedurën administrative dhe padisë në konfliktin administrativ.

Parimi i proporcionalitetit - në bazë të këtij parimi organet e administratës publike gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore në zbatim të interesit publik do të përdorin mjetet që janë në proporcion me qëllimet që synohen të arrihen. Të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizik apo juridik mund të kufizohen në pajtim me ligjin dhe në masën që është e domosdoshme për të realizuar një interes publik të rëndësishëm. Në çdo rast organet e administratës publike do të vlerësojnë nëse qëllimi i kërkuar mund të realizohet me masa sa më pak represive pa komprometuar efektivitetin e tyre.

Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit - përcakton detyrimin e çdo organi të administratës publike, trajtim në mënyrë të barabartë të të gjitha çështjeve në shqyrtim para tyre për aq sa këto çështje janë të njëjta. Dallimet në trajtimin e çështjeve lejohen vetëm në masën që ato përputhen me ndryshimet objektive mes çështjeve. Organet e administratës publike janë të obliguar që t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe pa dallime në mes të personave fizik dhe juridik siç është: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, opinionin politik, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër.

Parimi i objektivitetit dhe i paanshmërisë - në bazë të këtij parimi organet e administratës publike gjatë veprimtarisë se tyre marrin në konsideratë dhe u japin peshën që u takon të gjithë faktorëve që lidhen me një akt të caktuar administrativ. Gjithashtu organet e administratës publike nuk janë të influencuara nga interesat private ose personale ose paragjykimet të nëpunësve që ushtrojnë këtë veprimtari.

Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme - ky parim përcakton faktin se organet e administratës publike duhet të jenë të qëndrueshme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre administrative me qëllim të respektimit të pritjeve legjitime të personave fizik dhe juridik.

Parimi i administratës së hapur - në procedurën administrative është parim kushtetues dhe parim që zbatohet në çdo procedurë ligjore. Parimi i administratës së hapur apo publicitetit në procedurën administrative përcakton hapjen e kësaj procedure parimisht ndaj të gjithëve, që do të thotë se gjatë zhvillimit të procedurës administrative mund të asistojnë edhe personat e tjerë që nuk marrin pjesë në procedurën administrative. Ky parim pranë organeve administrative publike vjen në shprehje në seancën verbale. Publiku mund të përjashtohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj mbi përjashtimin e publikut, nxirret përfundimi i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe i shpallur publikisht. Ky përjashtim nuk vlen me palët, përfaqësuesit e tyre, ndihmësit profesional të tyre.

Parimi jo formal dhe i efikasitetit të procedurës administrative - Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative është kujdesur që të përcaktojë se procedura administrative duhet të zhvillohet në mënyrë të shpejtë me shpenzime sa më të vogla duke mos humbur kohë as për organin e as për palën dhe për personat e tjerë që marrin pjesë në procedurë, mirëpo gjithmonë të kontribuohet në vendosjen në mënyrë të drejtë pa e cenuar interesin publik e as të palës. Ky parim nuk duhet të aplikohet në dëm të parimit të vërtetësisë për realizimin e qëllimit të procedurës. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa më shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar asgjë që është e nevojshme për të marrë vendim të drejtë, duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji.

Parimi i informimit dhe ndihmës aktive - ky parim siguron që organi publik i cili e zhvillon procedurën administrative të ketë kujdes që mosdija e palës në procedurë të mos e përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik sipas këtij parimi duhet të ndihmon palën që të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridike të personave tjerë.

Parimi i mospagimit të procedurës - sipas këtij parimi procedura administrative për palën është pa pagesë, përveç në rastet kur parashihet ndryshe me ligj. Mirëpo ky parim kujdeset që edhe në rastet kur pagesa është e rregulluar me ligj e njëjta nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës administrative. Sipas këtij parimi organi publik nxjerr akt të veçantë administrativ me të cilin e rregullon çështjen e pagesës dhe lirim nga e njëjtat për kategoritë e përcaktuara me ligj për përjashtim nga pagesa e taksës administrative lidhur me zhvillimin e procedurës administrative.

Parimi i të drejtës në mjete juridike - secili person ka të drejtë të ushtrojë mjete juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik, përveç kur kjo përjashtohet shprehimisht me ligj.

Kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës administrative

Kompetenca në procedurën administrative përcakton të drejtën dhe detyrimin e organit shtetëror ose organizatës së autorizuar për ushtrimin e autorizimeve publike, për të nxjerrë vendimin në ndonjë çështje administrative, që do të thotë se kompetenca është e drejtë dhe detyrim i organit të caktuar administrativ që të vendos në çështje të caktuara dhe në territorin e caktuar. Rëndësia e caktimit të kompetencës në procedurën administrative është e shumëfishtë. Caktimi i kompetencës është veçmas me rëndësi për individët dhe organizatat, mbi të drejtat dhe interesat juridike të të cilëve vendoset në procedurë administrative, sepse ato e përcaktojnë se cilit organ duhet t'i drejtohen palët në rastin konkret. Sepse mos respektimi i kompetencës do të krijojë pasiguri përveç për organet shtetërore por edhe pakënaqësi për palët të cilat kërkojnë të drejta pranë këtyre organeve.

Llojet e kompetencës në procedurën administrative; kemi dy lloje kompetencash:

- Kompetenca lëndore;
- Kompetenca territoriale (tokësore).

Kuptimi i kompetencës lëndore - kompetenca lëndore është e drejtë dhe detyrë e një organi shtetëror që të vendos në çështjet e veçanta administrative nga lëmia ose materia e caktuar administrative. Me anë të kompetencës lëndore Ligji për Procedurën Administrative, përcakton llojin e organit shtetëror i cili do ta zhvillojë procedurën administrative në çështjen e caktuar administrative. Me kompetencë lëndore përcaktohet natyra e materies, grupi i punëve apo grupi i veprimeve të cilat i përkasin një organi në procedurën administrative, p.sh. për dhënien e lejes së ndërtimit është organi kompetent për ndërtimtari dhe urbanizëm. Gjithashtu në kompetencë lëndore nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj, për të vendosur në çështje administrative në shkallë të parë janë përcaktuar organet komunale të administratës.

Kuptimi i kompetencës territoriale (tokësore) - Ligji për Procedurën Administrative, e përcakton dhe e autorizon organin shtetëror për kompetencë territoriale që t'i kryej kompetencat e veta lëndore në territor të caktuar. Kompetenca territoriale përcakton territorin e juridiksionit të organit, që do të thotë se me kompetencë territoriale thelbësore është territori i caktuar e jo lloji i punës siç është rasti me kompetencën lëndore. Kompetenca territoriale caktohet sipas dispozitave mbi ndarjen politiko-territoriale dhe sipas dispozitave mbi organizimin e organeve të veçanta të administratës.

Kompetenca territoriale caktohet:

- Në çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë e paluajtshme në vendin ku ndodhet ajo;
- Për çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e një organizate afariste ose afarizmi individual, vendi i selisë së tyre;
- Për çështjet tjera vendbanimi i palës ose selia e personit juridik.

Në qoftë se kompetenca territoriale nuk mund të përcaktohet atëherë kompetenca territoriale caktohet sipas vendit ku ka ndodhur ngjarja. Në qoftë se sipas dispozitave do të ishin dy ose me tepër organe për vendosje sipas kompetencës territoriale, kompetent është organi që ka filluar i pari lidhur me procedimin e çështjes. Kompetenca lëndore dhe territoriale nuk mund të ndryshohen me marrëveshjen e palëve ose marrëveshjen e organit dhe palës, përveç se nëse kjo parashihet ndryshe me ligj.

Delegimi i kompetencës - organit të shkallës së parë mund t'i delegohet kompetenca nga organi i shkallës më të lartë, që punët e caktuara nga kompetenca e vet lëndore, t'ia bart organit të administratës së shkallës më të ultë, por vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Instrumenti ligjor përmes të cilit bëhet delegimi i kompetencave është vendim i organit delegues në ato raste kur organi i deleguar është në varësi të organit të parë dhe memorandum mirëkuptimi në ato raste kur organi i deleguar nuk është në varësi të organit delegues. Organi të cilit i është deleguar kompetenca nuk mund që ta nën delegoi të një organ i tretë kompetencën e përfutur përmes delegimit. Çdo veprim apo vendim i organit delegues që ka për qëllim autorizimin e organit të deleguar për të nën deleguar kompetencat e deleguara, është i pavlefshëm. Në çdo rast kur organi më i lartë bën nën delegimin e kompetencave, organi delegues saktë duhet të përcaktoj kompetencat konkrete që delegohen si dhe procedurën që duhet ndjekur për ekzekutimin e tyre nga organi i deleguar. Instrumenti ligjor përmes të cilit bëhet delegimi i kompetencave botohet në Gazetën Zyrtare. Organi të cilit i është deleguar kompetenca fillon zbatimin e kompetencave të deleguara në ditën e punës menjëherë pas botimit të instrumentit në gazetën zyrtare.

Organi i cili ka deleguar kompetencën mund të nxjerrë udhëzime, të cilat janë të detyrueshme për organin të cilit i është deleguar kompetenca, në lidhje me zbatimin e kompetencave të deleguara. Organi i cili e ka deleguar kompetencën mund t'ia tërheq kompetencat e deleguara si dhe të revokoj çdo akt apo veprim administrativ të ndërmarrë nga organi i deleguar në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë vlefshmërinë e aktit administrativ.

Delegimi i kompetencave përfundon me këto veprime:

- Me revokimin nga organi delegues të instrumentit të delegimit;
- Me përfundimin e detyrave të parashikuara në aktin e delegimit dhe
- Me shuarjen e organit delegues ose atij të deleguar.

Konflikti për kompetencë në procedurën administrative - me konflikt kompetence në procedurën administrative nënkuptojmë atëherë kur dy ose me shumë organe shpallen kompetente ose jo kompetente për vendosjen për një çështje konkrete administrative.

Me rastin e paraqitjes së konfliktit të kompetencave ketë konflikt e zgjidh:

- Gjykata kompetente për konfliktet e lindura mes organeve të ndryshme të administratës publike;
- Kryeministri për ministrinë e ndryshme dhe
- Ministri ose udhëheqësi i institucionit qendror për institucionet në varësi të tyre.

Procedura për iniciimin dhe zgjidhjen e konfliktit të kompetencave -mund të zhvillohet me propozim për zgjidhjen e konfliktit për kompetencë, të cilën mund ta ushtrojë organi i cili i fundit ka vendosur për kompetencën e vet, mirëpo propozimin mund ta parashtroj edhe pala. Vazhdimin e procedurës do ta bën organi i cili është caktuar me aktvendim me të cilin është zgjidhur konflikti administrativ. Kundër aktvendimit me të cilin është zgjidhur konflikti administrativ mbi kompetencën, palët nuk mund të ushtrojnë ankesë dhe as të zhvillojnë konflikt administrativ.

Kompetencën në Procedurën Administrative në praktikë e ka rregulluar neni 21 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet se:

- Kompetenca lëndore e organit publik përcaktohet me ligj.
- Nëse kompetenca lëndore për një çështje të caktuar nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo është e pamundur të përcaktohet sipas natyrës të çështjes, organi publik i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës material, do të ketë kompetencën lëndore mbi atë çështje.

Ndërsa me (nenin 22) kompetenca territoriale (tokësore) përcaktohet:

1. Nëse kompetenca territoriale nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo akti nënligjor, ajo përcaktohet si vijon:
 - 1.1. në një çështje që ka të bëjë me një pronë të paluajtshme apo me një të drejtë reale apo marrëdhënie tjetër juridike lidhur me një pronë të paluajtshme - sipas vendndodhjes së pronës;
 - 1.2. në një çështje të lidhur me një veprimtari afariste apo profesionale të palës - sipas vendit ku ndodhet selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së palës;
 - 1.3. në çështje të tjera - sipas vendbanimit të palës. Nëse pala nuk ka vendbanim në territorin e Republikës së Kosovës, kompetenca territoriale përcaktohet sipas vendqëndrimit të përkohshëm të palës. Nëse pala nuk ka vendqëndrim të përkohshëm në territorin e Republikës të Kosovës, kompetenca territoriale do të përcaktohet në bazë të vendbanimit apo vendqëndrimit të fundit që pala ka pasur.

2. Në çështjet ku kompetenca territoriale nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, ajo përcaktohet sipas vendit ku ka lindur apo është shfaqur arsyeja për fillimin e procedurës administrative.

Përcaktimi dhe Natyra detyruese e kompetencës (neni 23) - kompetenca përcaktohet në çastin kur fillon procedura administrative dhe çdo ndryshim faktik apo ligjor i mëvonshëm nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi në të cilin procedura është në vazhdim:

- Pushon së ekzistuari
- Pushon së pasuri kompetencën

Po që se një organ që ka filluar procedurën pa pasur kompetencën e nevojshme dhe më vonë i është dhënë kjo kompetencë sipas ligjit, ai do të vlerësohet kompetent që nga fillimi.

Ushtrimi i kompetencës sipas këtij ligji është i detyrueshëm, përveç kur parashihet ndryshe me ligj.

Kompetenca në raste urgjente është parashikuar me (nenin 24) - nëse një organ publik nuk mund të veprojë, apo të veprojë pa vonesë, për shmangien e një dëmi të menjëhershëm të rëndë dhe të pariparueshëm që mund ti shkaktohet interesit publik apo të drejtave dhe interesave juridike të personave, çdo organ tjetër publik sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, është kompetent të ndërmarrë veprime të domosdoshme për shmangien apo kufizimin aty për aty të dëmit.

Verifikimi dhe Konflikti për kompetencë në procedurën administrative me (nenin 25)

Organi publik verifikon kompetencën sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të palës.

Sipas këtij ligji përveç në rastet kur parashihet ndryshe me ligj, konflikti i kompetencës ndërmjet dy apo më tepër organeve zgjidhet me marrëveshje unanime mes tyre.

Në rastet kur organet publike në konflikt nuk arrijnë një marrëveshje, konflikti i kompetencës zgjidhet nga organi i përbashkët epror, që vjen menjëherë më sipër sipas hierarkisë dhe që ka kompetenca kontrolli apo mbikëqyrje mbi organet në konflikt.

Organi publik epror i përbashkët për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës ndërmjet dy ministrive të ndryshme apo ndërmjet një ministrie dhe një organi publik qendror në vartësi të kryeministrit, është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, në rastet kur organet në konflikt kompetence nuk kanë një organ të përbashkët mbikëqyrës epror, konflikti i kompetencës zgjidhet nga gjykata kompetente për çështje administrative.

Procedura për iniciimin dhe zgjidhjen e konfliktit të kompetencave mund të zhvillohet me propozim për zgjidhjen e konfliktit për kompetencë, të cilën mund ta ushtroj organi i cili i fundit ka vendosur për kompetencën e vet, mirëpo propozimin mund ta parashtrij edhe pala. Vazhdimin e procedurës do ta bën organi i cili është caktuar me aktvendim me të cilin është zgjidhur konflikti administrativ. Kundër aktvendimit me të cilin është zgjidhur konflikti administrativ mbi kompetencën, palët nuk mund të ushtrojnë ankesë dhe as të zhvillojnë konflikt administrativ. Zgjidhja e kompetencës sipas këtij ligji bëhet brenda 10 ditëve.

Zyrtari përgjegjës në procedurën administrative është parashikuar me (nenin 26)

Parimet Themelore të Ligjit për Procedurën Administrative, garantojnë detyrimin e organeve të administratës publike që të vendosin në çështjet administrative me kujdes ndaj parimeve të objektivitetit dhe paanshmërisë me që rëndësia juridike e këtyre parimeve shprehet në të gjitha dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative. Parimet Themelore të procedurës administrative kanë për qëllim që palës t'i mundësohet që në procedurë të jetë pjesëmarrës aktiv për të realizuar mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe interesave të veta juridike.

Organi publik kompetent, në një procedurë administrative vepron nëpërmjet zyrtarit përgjegjës.

Nëse nuk është e përcaktuar ndryshe me ligj, organi publik me akt nënligjor apo me rregullat e brendshme administrative të organizimit, titullari i organit publik, cakton paraprakisht, në përputhje me rregullat e organizimit të brendshëm, një njësi përgjegjëse për çdo lloj të procedurës administrative në kompetencë të organit. Vendimi lidhur me këtë çështje është publik.

Me LPPA-është e rregulluar edhe delegimi i kompetencës një nëpunësi tjetër ose organi tjetër për vendim-marrje gjithnjë nëse nuk parashihet ndryshe me ligj.

Përgjegjësia për procedurën dhe vendimmarrjen parashikohet në (nenin 27)

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës.
2. Nëse, në dispozitat ligjore, parashikohet se vendimi përfundimtar merret dhe nënshkruhet nga një zyrtar tjetër i organit publik, i ndryshëm nga zyrtari

përgjegjës, ky i fundit zhvillon procedurën administrative, përgatit një raport me shkrim, në të cilin paraqet një përmbledhje të procedurës së kryer si dhe formulon projekt-aktin apo kontratën administrative dhe ia paraqet atë për miratim dhe nënshkrim zyrtarit tjetër të përcaktuar nga ligji apo akti nënligjor.

3. Nëse zyrtari tjetër nuk është dakord me projekt-aktin/kontratën e propozuar, ai është përgjegjës për hartimin apo zëvendësimin e projekt-aktit/kontratës administrative dhe nënshkrimin tij/saj. Raporti dhe projekt-akti/kontrata e propozuar nga zyrtari përgjegjës bëhet gjithashtu pjesë e dosjes së çështjes.

Ndalimi i nën delegimit dhe autoriteti i deleguesve është paraparë me (nenin 28)

Zyrtari tjetër i caktuar në bazë të delegimit nga zyrtari përgjegjës apo organi tjetër i caktuar në bazë të delegimit nga organi përgjegjës sipas këtij ligji, nuk mund të delegojnë kompetencën më tutje.

Caktimi i njësisë përgjegjëse dhe delegimi do të përfundojnë me shfuqizimin e aktit mbi caktimin e delegimit në të njëjtën mënyrë sikurse është bërë caktimi apo delegimi.

Lidhur me kompetencat e deleguar mund të nxirren udhëzime nga titullari i organit apo drejtuesi i njësisë përgjegjëse të cilat janë të detyrueshme për zyrtarin përgjegjës lidhur me zbatimin e kompetencave të deleguara.

Procedura për garantimin e paanshmërisë së Administratës Publike

Parimet Themelore të Ligjit për Procedurën Administrative garantojnë detyrimin e organeve të administratës publike që të vendosin në çështjet administrative me kujdes ndaj parimeve të objektivitetit dhe paanshmërisë me që rëndësia juridike e këtyre parimeve shprehet në të gjitha dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithëshme Administrative. Parimet Themelore të procedurës administrative, kanë për qëllim që palës t'i mundësohet që në procedurë të jetë pjesëmarrës aktiv për të realizuar mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe interesave të veta juridike. Organi gjegjësisht personi zyrtar i cili zhvillon procedurën administrative, duke pasur kujdes ndaj këtyre dy parimeve, do të jetë i sigurt se në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë do ta vendos çështjen konkrete administrative. Pengesat ligjore që e bëjnë nëpunësin administrativ që mos ta ushtrojë detyrën e nëpunësit publik apo përjashtimin e tij nga ndërmarra e veprimeve në procedurë janë:

- Nëpunësi publik ka një interes personal, të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendim marrje në shqyrtim;
- Bashkëshorti i tij ose partneri bashkëjetues ose të afërmit e tij deri në shkallën e dytë kanë interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendim marrje në shqyrtim;

- Nëpunësi publik ose personat e përcaktuar në pikën e më lartë të këtij neni kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim;
- Nëpunësi publik ka marr pjesë si ekspert, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;
- Personat e përcaktuar në pikën e dytë të kishin marrë pjesë si ekspert, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;
- Ndaj nëpunësit publik ose personave të përcaktuar në pikën e dytë ka nisur një proces gjyqësor nga palët e interesuara në procedimin administrativ në shqyrtim;
- Çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marr nga nëpunësi publik ose nga personi i përcaktuar në pikën e dytë;
- Nëpunësi publik ose personat e përcaktuar në pikën e dytë janë debitor ose kreditor të palëve të interesuara në procedimin administrativ në shqyrtim;
- Nëpunësi publik ose personat e përcaktuar në pikën e dytë kanë marrë dhurata nga palët e interesuara përpara ose pas fillimit të procedurës administrative në shqyrtim;
- Nëpunësi publik ose personat e përcaktuar në pikën e dytë kanë miqësi ose armiqësi me palët e interesuara në procedurën administrative në shqyrtim.

Mos deklarimi nga nëpunësi publik me kohë për ekzistimin e pengesave ligjore sipas këtij ligji paraqet shkelje të rëndë të dispozitave ligjore.

Me qëllim që të sigurohet objektiviteti në vendosjen e çështjes administrative me Ligjin e Procedurës së Përgjithëshme Administrative, nuk lejohet ta zhvilloj personi zyrtar që objektiviteti i të cilit dyshohet qoftë për shkak të ekzistimit të rrethanave të caktuara me lartë.

Andaj nëse përmbushen këto rrethana të cekura me lartë, personi zyrtar duhet të përjashtohet nga ajo çështje administrative ngase edhe vet qëllimi i përjashtimit të personit zyrtar është që të sigurohet objektiviteti në vendosje në procedurën administrative.

Përjashtimin e personit zyrtar - nga procedura administrative palët mund ta kërkojnë me kërkesë për shkak të rrethanave dhe arsyeve të cilat e vejnë në dyshim objektivitetin e personit zyrtar, personi zyrtar nuk mund të ushtroj asnjë veprim në procedurë deri në marrjen e vendimit mbi këtë kërkesë, përveç atyre veprimeve që sipas natyrës së çështjes nuk e lejojnë shtyrjen.

Vendosja lidhur me kërkesën për përjashtim të personit zyrtar - vendimi për përjashtim të personit zyrtar, merret brenda një afati prej pesë ditëve të punës nga dita në të cilën palët e interesuara kanë paraqitur kërkesën për përjashtim ose nëpunësi ka deklaruar pengesën. Vendimin e merr udhëheqësi ose drejtori i administratës publike.

Në rastet kur pengesat e parashikuara kanë të bëjnë me drejtorin e organit kolektiv të administratës publike, vendimi për përjashtim ose konfirmimin e tij nga procesi vendim marrës do të merret nga mbledhja plenare e organit kolektiv pa praninë e drejtorit. Me përfundim mbi përjashtimin e personit zyrtar do të caktohet personi tjetër zyrtar që do të vendos lidhur me çështjen për të cilën është përjashtuar personi zyrtar nga procedura administrative. Kundër përfundimit mbi përjashtimin e personit zyrtar nga procedura administrative nuk lejohet ankesë.

Fillimi i procedimit administrativ

Sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, për fillimin e procedurës administrative vlen parimi i oficialitetit, ngase përherë hapet nga organi shtetëror kompetent, pa marrë parasysh se kush është iniciator për fillimin e procedurës administrative. Të gjithë personat fizik dhe juridik të interesuar kanë të drejtë të fillojnë procedurën administrative. Aftësia për të iniciuar një procedurë administrative ose për të marrë pjesë në të, si dhe rregullat që bëjnë të mundur përfaqësimin përcaktohen në përputhje me dispozitat e se drejtës civile mbi aftësinë juridike të personave fizik dhe juridik. Në rastin kur mbrohen interesat publike të cilat mund të preken nga një procedim administrativ, e drejta për të filluar një procedim administrativ ose për të marrë pjesë në të, u njihet personave të cilëve procedimi administrativ iu shkakton një dëm në të drejtat e tyre të përbashkëta siç janë: shëndeti publik, arsimimi, trashëgimia kulturore, ambienti dhe cilësia e jetës si dhe personave të cilët jetojnë në brendësi apo afërsi të një prone publike, e cila mund të dëmtohet nga procedimi administrativ.

Ombudspersoni por edhe shoqatat dhe organizatat e tjera të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike kanë gjithashtu të drejtë të fillojnë një procedim administrativ ose të marrin pjesë në një procedim administrativ.

Organi shtetëror e fillon procedurën administrative:

- Nga organi i administratës publike;
- Me kërkesën e palës dhe
- Me kërkesën e publikut.

1. Fillimi i procedimit nga organi i administratës publike - është mënyrë oficiale e organit kompetent që të zhvillojë procedurën administrative kryesisht pa marrë parasysh se iniciativën për hapjen e procedurës e ka dhënë vet organi, ose e ka bërë pala me kërkesën e vet. Kjo procedurë konsiderohet se ka filluar kur organi i administratës publike, palëve të interesuara u dërgon lajmërimin se ka filluar veprimet procedurale nga ai organ administrativ. Lajmërimi për fillimin e veprimeve bëhet me shkrim, nënshkruhet nga drejtuesi i organit të administratës publike dhe përmban informacione si:

- emrat dhe adresat postare të të gjithë personave të interesuar të cilëve iu dërgohet lajmërimi;

- emrin dhe adresën postare të organit të administratës publike që ka filluar procedimin si dhe emrin e nëpunësit përgjegjës të administratës publike;
- emrin e procedimit në qoftë se ka të tillë;
- afatin kohor, që fillon që nga data e nisjes së lajmërimit për fillimin e veprimeve, brenda të cilit palët e interesuara mund të bëjnë ndonjë ndërhyrje me shkrim;
- në qoftë se ligji kërkon zhvillimin e një seance dëgjimore, një njoftim për kohën dhe vendin se ku do të zhvillohet seanca dëgjimore, një njoftim për qëllimin për të cilin zhvillohet seanca dëgjimore si dhe një kujtesë se pala që nuk merr pjesë në seancën dëgjimore mund të konsiderohet me faj;
- në qoftë se ligji e lejon zhvillimin e një seance dëgjimore, një informacion që t'i kujtojë palët se ato mund të kërkojnë zhvillimin e seancës dëgjimore brenda afateve kohore të parashikuara nga ligji ose rregullat e brendshme të organit procedues;
- informacion në lidhje me autoritetin ligjor të organit procedues për të zhvilluar procedimin në fjalë dhe
- informacion në lidhje me qëllimin e procedimit dhe, për aq sa është e mundur, çështjet në lidhje me të cilat duhen marrë vendime.

Organi i administratës publike nuk komunikon me palët e interesuara në përputhje me kërkesat e paragrafit 2 të këtij neni në ato raste kur çështja e trajtuar nga organi është sekrete ose konfidenciale sipas klasifikimeve që iu bëhen këtyre koncepteve me ligj, ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, komunikimi mund të cenojë efikasitetin e procedimit administrativ.

2. Fillimi i procedimit nga pala e interesuar - bëhet atëherë kur organi administrativ fillon procedimin administrativ me kërkesën e palës në çështjet të cilat sipas Ligjit për Procedurën administrative për fillimin dhe zhvillimin e procedurës administrative, nevojitet ushtrimi i kërkesës se palës pranë organit administrativ, që do të thotë se kusht qenësor për nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm nga ana e organit administrativ është ushtrimi i kërkesës pranë organit administrativ. Procedura administrative konsiderohet e hapur menjëherë pasi që organi kompetent administrativ të ketë kryer cilindo veprim, me qëllim të zhvillimit të procedurës administrative për vendosje në atë çështje siç është: thirrja e palëve, dëshmitarëve apo ekspertëve.

Ligji ka përcaktuar kur lejohet fillimi i procedimit administrativ nga pala e interesuar, kërkesa e palës të interesuar për fillimin e veprimeve nga administrata bëhet me shkrim, nënshkruhet dhe datohet nga personi që kërkon veprimin e administratës ose nga përfaqësuesi ligjor i palës se interesuar dhe duhet të përfshij:

- Emërtimin e organit të administratës publike, veprimi i të cilit kërkohet;
- datën në të cilën kërkesa për veprim nga ana e administratës publike është postuar;

- një indikacion në lidhje me kompetencat e organit administrativ, në kuadrin e të cilave kërkohet veprimi i organit;
- veprimin konkret që kërkohet nga organi i administratës publike dhe
- numërimin e fakteve dhe të shkaqeve që qëndrojnë në themel të kërkesës për veprim nga organi administrativ.

Pala e cila e ka iniciuar procedurën dhe të njëjtën kohë kërkon veprimin e organit të administratës publike, ia dorëzon kërkesën organit kompetent si dhe një kopje ia dërgon të kësaj kërkesë ia dërgon të gjithë personave të cilët kanë interes direkt apo indirekt për veprimin e kërkuar administrativ. Drejtuesi i organit të administratës publike shqyrton kërkesat për veprim drejtuar organit nga pala e interesuar dhe kryen veprimet siç janë:

- njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar dhe se procedimi administrativ ka filluar,
- njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa nuk është pranuar dhe se pala mund të ankohet kundër këtij vendimi konform dispozitave të Ligjit, dhe
- njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative përpara se organi t'i përgjigjet kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme.

Organi administrativ fillimisht shqyrton kërkesën formale juridike të palës dhe nëse gjen ndonjë parregullsi atëherë kërkon me shkrim nga pala që ka ushtruar kërkesë që ta bëjë korrigjimin e pasaktësive të kërkesës.

Subjektet e Procedurës

Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, ka parashikuar në mënyrë të veçantë se kush mund të jetë palë në procedurë administrative dhe si mund të përfaqësohet e njëjta ku me **(nenin 14) janë përcaktuar se:** sipas ligjit palë në procedurë administrative mund të jetë çdo person fizik, juridik apo grup personash me një interes të përbashkët:

- me kërkesën e të cilit organi publik e ka filluar procedurën administrative,
- ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund ti cenojë të drejtat apo interesat juridike.

Palë në procedurë sipas këtij ligji janë edhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo interesave të gjëra të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.

Zotësia dhe përfaqësimi ligjorë është paraparë me (nenin 15)

Edhe çështja e zotësisë dhe përfaqësimit është rregulluar me LPPA, ku përcaktohet se përveç kur parashihet ndryshe me ligj, zotësia për të vepruar e një personi fizik apo juridik në procedurën administrative përcaktohet me dispozitat përkatëse të legjislacionit civil.

Sipas këtij ligji një grup i personave me një interes të përbashkët, që nuk e kanë statusin e personit juridik vepron në procedurë administrative nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar.

Gjithashtu organi publik, palë në procedurë administrative, vepron nëpërmjet titullarit të tij, përfaqësuesit ligjor apo të autorizuar të caktuar me ligj.

Përfaqësuesi i caktuar sipas detyrës zyrtare është paraparë me (nenin 16)

1. LPPA-ja, ka përcaktuar edhe mundësinë e caktimit të përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare në procedurë administrative, në rastet kur në një procedurë administrative palës që nuk ka zotësi të plotë veprimi apo atë e ka të kufizuar, nuk i është caktuar përfaqësuesi ligjor apo ai ka konflikt interesi me të përfaqësuarin apo kur përfaqësuesi ligjor nuk tregon dukshëm kujdesin e duhur, atëherë organi publik e pezullon procedurën dhe i kërkon autoritetit kompetent sipas ligjit caktimin e përfaqësuesit ligjor apo zëvendësimin e tij.
2. Organi publik përveç kësaj mund ti caktojë palës përfaqësuesin sipas detyrës zyrtare edhe në rastet kur:
 - 2.1. komunikimi me palën është i pamundur,
 - 2.2. pala është në pamundësi objektive për të mbrojtur interesat e veta dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësues dhe
 - 2.3. kur palës nuk i dihet vendqëndrimi ose vendbanimi dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësuese brenda afatit të dhënë nga organi publik.
3. Organi publik njofton, pa vonesë, palën për caktimin e përfaqësuesit. Në rastin e parashikuar në nënparagrafin 3.1 dhe 3.3 të këtij neni, pala njoftohet nëpërmjet shpalljes publike sipas nenit 122 të këtij Ligji.
4. Përfaqësuesi i caktuar sipas detyrës zyrtare në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, merr pjesë dhe e përfaqëson palën vetëm në veprimin procedural për të cilin është caktuar shprehimisht apo deri në caktimin apo zëvendësimin e përfaqësuesit ligjor. Në rastin e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, përfaqësuesi i caktuar sipas detyrës zyrtare, merr pjesë në procedurë deri në paraqitjen e palës apo të përfaqësuesit të autorizuar prej saj.

5. Përfaqësuesi i caktuar sipas detyrës zyrtare në përputhje më paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, kryen përfaqësimin mbi baza vullnetare. Përfaqësuesi mund të kërkojë nga organi publik pagesën e shpenzimeve të pashmangshme të nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për të cilat është ngarkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar është paraparë me (nenin 17)

1. Pala mund të autorizojë një përfaqësues, që të veprojë në emër dhe për llogari të saj, për të gjithë procedurën administrative apo vetëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, përveç rastit kur me ligj kërkohet që vetë pala personalisht të kryejë një veprim të caktuar procedural.
2. Autorizimi për përfaqësim mund të jepet me afat të caktuar.
3. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, autorizimi i përfaqësuesit është i vlefshëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga pala, apo deklarohet në mënyrë verbale dhe regjistrohet nga organi publik në procesverbal.
4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Ligj, dispozitat përkatëse të legjislacionit civil mbi përfaqësimin, zbatohen, përshtatshmërisht në procedurën administrative.

Përfaqësuesi i Përbashkët është paraparë me (neni 18)

1. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, dy apo më shumë palë, me interesa të njëjta mund të paraqiten së bashku në të njëjtën procedurë administrative. Në këtë rast, palët mund ta caktojnë njërin prej tyre si përfaqësues të përbashkët, apo mund të autorizojnë një përfaqësues tjetër të përbashkët, sipas nenit 17 të këtij Ligji.
2. Edhe kur caktojnë njërin prej tyre si përfaqësues të përbashkët, secila nga palët mund të marrë pjesë në procedurën administrative personalisht, mund të paraqesë deklarata dhe të ushtrojë mjetet juridike administrative në mënyrë të pavarur.

Zotësia për të qenë Përfaqësues është parashikuar me (nenin 19)

1. Çdo person fizik, që ka zotësi të plotë për të vepruar sipas ligjit civil, mund të jetë përfaqësues, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.
2. Përveçse, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, në rastin e caktimit të një përfaqësuesi, sipas detyrës zyrtare, në përputhje më paragrafin 2 dhe 3 të nenit 16 të këtij Ligji, organi publik kujdeset të zgjedhë një person që ka aftësitë e nevojshme të sigurojë që të drejtat dhe interesat juridike të personit të përfaqësuar të mbrohen në mënyrë të përshtatshme.

Kryerja e veprimeve procedurale është paraparë me (nenin 20)

1. Në rastin kur pala vepron e përfaqësuar, organi publik i kryen veprimet procedurale dhe komunikon me përfaqësuesin.
2. Organi publik, mund të kërkojë drepëdrejt nga pala kryerjen e një apo disa veprimeve të caktuara procedurale në rastet kur parashikohet shprehimisht me ligj. Në këtë rast, përfaqësuesi i palës duhet të informohet.
3. Pala, edhe nëse ka autorizuar një përfaqësues, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kryejë personalisht veprime procedurale, të japë deklarata apo të ndërmarrë veprime tjera në procedurën administrative.
4. Kur përfaqësuesi i autorizuar jep një deklaratë me gojë, pala e pranishme, mund ta zhvlerësojë apo tërheqë atë, aty për aty.

Dorëzimi i kërkesave

Pala mund të ushtrojë kërkesë dhe të njëjtën ta dorëzojë drejtpërdrejtë në zyrën e organit kompetent administrativ. Kërkesën pala mund ta ushtrojë edhe nëpërmjet poste të regjistruar por edhe në formë elektronike. Organi i administratës pavarësisht mënyrës se dorëzimit të kërkesës se personave te interesuar për fillimin e procedimit administrativ, organi që i merr kërkesat i regjistron ato në një regjistër të posaçëm në pajtim me dispozitat pozitive. Regjistri i kërkesave për fillimin e procedimit administrativ përmban informacionin:

- Numrin e kërkesës;
- Datën e dorëzimit;
- Objektivin e kërkesës;
- Numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkangjiten kërkesës;
- Emrin e kërkuesit.

Kërkesat e ushtruara nga personat e interesuar për fillimin e një procedimi administrativ regjistrohen sipas radhës se dorëzimit. Ato kërkesa që vijnë në të njëjtën dërgesë postare konsiderohen si të dorëzuara në të njëjtën kohë. Organi i administratës publike është i obliguar që tu jep një dëshmi personave të interesuar që ushtrojnë kërkesë me anën e së cilës vërteton dorëzimin dhe marrjen e kërkesës. Kjo dëshmi tregon faktin e dorëzimit të kërkesës dhe marrja nga nëpunësi përgjegjës i organit të administratës publike. Menjëherë pas pranimit të kërkesës organi i administratës publike e verifikon kompetencën përveç verifikimit të kompetencës organi administrativ verifikon edhe këtë:

- nëse të drejtat apo interesat e kërkuesit nga personat e interesuar janë parashkruar;

- legjitimimi i personit fizik dhe juridik që ka dorëzuar kërkesën për fillimin e procedimit administrativ;
- nëse afatet e parashikuara nga ligji për dorëzimin e kërkesës janë respektuar;
- nëse kërkesa e një personi fizik dhe juridik për fillimin e procedimit administrativ mund të shqyrtohet së bashku me kërkesat e personave të tjerë fizikë dhe juridikë sipas Ligjit për Procedurën Administrative.

1. Fillimi i procedimit me iniciativën e publikut - këtë procedurë sipas Ligjit për Procedurën Administrative mund ta iniciojë edhe publiku por edhe ombudspersoni. Në këto raste organi administrativ është i obliguar që t'i ndërmerr të gjitha masat që janë të nevojshme për përgatitjen e çështjes konkrete të parashtruar në kërkesë bile duke përfshirë edhe probleme që nuk përfshihen në kërkesën e dorëzuar në qoftë se gjykon se kjo është në interes të publikut.

Kërkesa verbale për fillimin e procedimit administrativ - palët e interesuara përveç ushtrimit të kërkesës me shkrim ato mund ta fillojnë procedimin administrativ edhe me kërkesë verbale. Për këtë nëpunësi i organit të administratës publike detyrohet që ta bëjë një shënim zyrtar të krijoj lëndën që përfshin të dhënat siç janë:

- emrin e organit të administratës publike, veprimi i të cilit kërkohet;
- emrin e kërkuesit;
- datën e bërjes së kërkesës;
- veprimin konkret që kërkohet nga organi i administratës publike.

Shqyrtimi i përnjëhershëm i disa kërkesave për fillimin e procedimit administrativ - organi administrativ që është kompetent mund të bëjë bashkimin e çështjeve (lëndëve) në një procedim, atëherë kur të drejtat dhe detyrimet e palëve bazohen në të njëjtën gjendje faktike, kur të drejtat dhe detyrimet bazohen në të njëjtën bazë juridike dhe kur organi administrativ i cili zhvillon procedimin ka kompetencë lëndore për të gjitha lëndët. Kur organi administrativ vlerëson këtë do të nxjerr vendim të veçantë mbi bashkimin e lëndëve. Ky vendim mund të atakohet me ankesë të veçantë.

Tërheqja e kërkesës për fillimin e procedimit administrativ - palët të cilat kanë ushtruar kërkesë pranë organit administrativ, me anë të një deklaratë me shkrim mund ta tërheqin kërkesën në tërësi apo pjesërisht si dhe të heqin dorë nga të drejtat dhe interesat e tyre ligjore, me përjashtim të rasteve kur ligji e ndalon një gjë të tillë. Pas tërheqjes së kërkesës nga ana e personit i cili ka ushtruar kërkesë, organi kompetent i organizatës publike merr vendim për përfundimin e procedimit administrativ. Pala kundërshtarë në procedimin administrativ njoftohet nga organi për përfundimin e procedimit. Vendimi i organit kompetent të organizatës publike për tërheqjen e kërkesës mund të kundërshtohet nga çdo palë tjetër e interesuar. Tërheqja e njëres prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i administrimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim. Pala që e tërheq

kërkesën e ushtruar për fillimin e procedimit administrativ do t'i bart të gjitha shpenzimet gjer në momentin e ndërprerjes së procedimit administrativ me përjashtim të rasteve kur ligji parasheh ndryshe.

Aktpajtimi - me rastin e zhvillimit të procedurës administrative me palë kundërshtare nëpunësi përgjegjës i organit të administratës publike duhet të përpiqet t'i pajtoj palët në procedurë. Aktpajtimi është marrëveshje e lidhur midis palëve para personit zyrtar të organit të administratës publike që e zhvillon procedurën administrative. Aktpajtimi në mes dy ose me shumë palëve në një procedim administrativ bëhet në formë të shkruar dhe pasi të lexohet dhe të nënshkruhet nga palët bëhet i plotfuqishëm. Aktpajtimi në mes dy ose me shumë palëve në një procedim administrativ ka efekt të njëjtë me atë të aktit administrativ. Organi i administratës publike nuk do të pranojë aktpajtimit në mes të palëve në procedim në qoftë se aktpajtimi është në kundërshtim apo në dëm të interesit publik ose në dëm të interesave ligjore të personave tjerë fizik dhe juridik. Aktpajtimi mund të lidhet si në procedurën e shkallës së parë ashtu edhe në atë të shkallës së dytë. Organi para të cilit është lidhur aktpajtimi do të nxjerr përfundim me të cilin pezullohet procedura administrative pjesërisht apo tërësisht në vështrim të aktpajtimit të lidhur.

Fillimi i një procedure administrative është paraparë me (nenin 83) ku përcaktohet se:

1. Procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik.
2. Në çështjet në të cilat, sipas ligjit apo natyrës së çështjes, kërkohet kërkesa e palës, organi publik mund të veprojë vetëm në bazë të një kërkesë të tillë.
3. Fillimi i një procedure administrative sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e ligjshëm të organit publik, përpos në rastet kur:
 - 3.1. Ligji parasheh shprehimisht detyrimin për të filluar një procedurë;
 - 3.2. organi publik vihet në dijeni të fakteve që kërkojnë fillimin e procedurës në mënyrë që të mbrohet interesi publik.
4. Procedura administrative vlerësohet të ketë filluar me kryerjen e çfarëdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e një procedure të filluar sipas detyrës zyrtare apo me parashtrimin e kërkesës nga pala, në rastin e një procedure të filluar sipas kërkesës.

LPPA ka paraparë bashkimin e çështjeve administrative në një procedure në (nenin 84) ku përcaktohet se:

1. Organi publik kompetent mund të bashkojë disa procedura administrative në një të vetme, nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjashme.
2. Bashkimi i procedurave nuk kufizon të drejtën e palëve për të paraqitur kërkesa apo pretendime të ndryshme.

Ndërsa çështjet paraprake janë përcaktuar me (neni 85) ashtu që:

1. Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit.
2. Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, vendimi për pezullimin e procedurës duhet të informojë palën për nevojën e kësaj kërkesë.
3. Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillohet vetëm sipas detyrës zyrtare nga organi tjetër, organi për zgjidhjen e çështjes do të kërkojë nga organi tjetër fillimin e procedurës për zgjidhjen e çështjes paraprake.

Shqyrtimi administrativ sipas detyrës zyrtare është paraparë me (nenin 86) ku përcaktohet se:

1. Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.
2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.
3. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre.

LPPA ka paraparë bashkëpunimin e palës në nenin (Neni 87) në rastet kur:

1. Pala bashkëpunon në mirëbesim me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes përkatëse (në vijim: "detyrim i bashkëpunimit të përgjithshëm").
2. Pala detyrohet që të sjellë prova, informata, të japë një deklaratë me shkrim apo të paraqitet personalisht për të dhënë një deklaratë para një organi publik, vetëm në ato raste kur parashihet shprehimisht me ligj (në vijim: "detyrimi i bashkëpunimit të posaçëm").
3. Si rregull, pala mund të jep deklarata qoftë në formë verbale apo të shkruar. Në çështje të ndërlikuara, organi publik mund të kërkojë nga pala që të parashtrijë një deklaratë me shkrim. Pala nuk do të thirret që të paraqitet personalisht para organit publik, nëse deklarata mund të parashtrijet në mënyra tjera më të përshtatshme.
4. Mosrespektimi i detyrimit të bashkëpunimit të përgjithshëm apo të posaçëm sipas këtij neni, vlerësohet, nga organi publik, së bashku me të gjitha rrethanat përkatëse të çështjes dhe nuk përjashton organin publik nga detyrimi për shqyrtimin e fakteve dhe marrjen e një vendimi përfundimtar.

Procedimi administrativ deri në nxjerrjen e aktit administrativ

Kuptimi i procedurës së shqyrtimit, gjatë zhvillimit të procedurës administrative, nëpunësi që e drejton procedurën administrative do t'i merr në konsideratë të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen administrative dhe i jep secilit faktorë vlerësimin adekuat. Procedura e shqyrtimit të një çështje administrative, procedura hetimore dhe procesi i ekzaminimit është fazë e procedurës administrative e cila pason pas fillimit të procedurës dhe i paraprin nxjerrjes së vendimit, që do të thotë se gjitha këto veprime përfshihen prej fillimit të procedurës gjër të nxjerrja e aktit administrativ (vendimit). Me procedurën e shqyrtimit nënkuptohet faza e procedurës administrative me të cilën duhet të vërtetohen faktet dhe rrethanat relevante të cilat do të shërbejnë si bazë për zbatimin e dispozitave materiale juridike në një çështje konkrete administrative. Qëllimi i procedurës së shqyrtimit është që të vërtetohen të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë rëndësi për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm dhe njëherit palëve tu bëhet i mundur realizimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të tyre juridike.

Procedura hetimore - zhvillohet nga organi administrativ në kompetencën e të cilit është marrja e vendimit përfundimtar. Procedura hetimore është procedurë e të provuarit nga ana e organit administrativ. Procedura hetimore gjër të nxjerrja e vendimit zhvillohet në dy forma:

- procedurë e shkurtër e shqyrtimit;
- procedurë e veçantë e shqyrtimit.

Procedura e shkurtër e shqyrtimit - zbatohet në rastet e veçanta kur nuk nevojitet të kryhen veprime procedurale si, seanca verbale, dëgjimi i dëshmitarëve, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike që është me rëndësi për vendosjen e një çështje administrative. Që do të thotë se për çështjen, organi administrativ vendos drejtpërdrejtë qoftë në bazë të fakteve dhe provave të cilat i disponon organi administrativ, apo në bazë të provave që i ka paraqitur pala me kërkesën me të cilën ka iniciuar procedurën administrative. Organi administrativ mund të vendos në procedurë të shkurtuar vetëm në ato raste kur është paraparë me Ligjin për Procedurën Administrative, e këto raste janë:

1. Në qoftë se pala se bashku me kërkesë i ka bashkangjitur prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet gjendja faktike ose kjo gjendje faktike vërtetohet në bazë të fakteve notore.
2. Në qoftë se gjendja faktike për çështje administrative vërtetohet në bazë të provave dhe fakteve që disponon organi administrativ.
3. Në rastet kur me Ligjin për Procedurën Administrative është paraparë se një çështje administrative mund të vendoset mbi bazën e fakteve ose të provave që nuk janë plotësisht të provuara, ashtu që këto fakte dhe prova janë bërë të besueshme.
4. Në rast se për një çështje është e nevojshme ndërmarrja e masave urgjente që kanë interes publik, të cilat nuk mund të shtyhen, gjersa faktet dhe provat në të cilat vendimi do të bazohet, janë vërtetuar ose janë bërë të besueshme.

Procedura e veçantë e shqyrtimit - nëse organi administrativ nuk ka kushte për zbatimin e procedurës së shkurtuar të shqyrtimit atëherë ky organ zbaton procedurën e veçantë të shqyrtimit. Procedura e veçantë e shqyrtimit përbëhet nga të provuarit, nga veprimet e veçanta procedurale që i ndërmerri organi administrativ për vërtetimin e gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë për një çështje. Procedura e veçantë e shqyrtimit është procedurë në të cilën kryhen disa veprime të veçanta procedurale, siç është seanca verbale, këqyrja e vendit të ngjarjes, dëgjimi i palëve dhe ekspertimi, për vërtetimin e gjendjes faktike që janë me rëndësi për nxjerrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm. Personi zyrtar i organit administrativ vet i përcakton rrjedhën e procedurës së veçantë, cakton rendin sipas të cilit do të zhvillohet procedura dhe veprimet e veçanta. Personi zyrtar i organit administrativ vendos se cilat prova do të administrohen dhe me cilat mjete provuese do të bëhet administrimi i provave.

Seanca verbale - Seanca verbale përfaqëson një nga veprimet e procedurës së veçantë të shqyrtimit me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike duke u bazuar në fakte dhe prova relevante, në mënyrë që të ju mundësohet pjesëmarrja aktive e palëve në procedurën administrative duke i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre juridike. Seanca verbale caktohet nga organi administrativ në çdo rast kur është e domosdoshme

që të vërtetohet gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë në një çështje të ndërlikuar administrative. Caktimi i seancës verbale mund të jetë:

- Fakultativ, dhe
 - I detyrueshëm.
- **Caktimi fakultativ i seancës verbale** - i mbetet personit zyrtar të organit administrativ varësisht nga rrethanat e çdo rasti të veçantë, të vendos se nëse është e nevojshme të caktohet seanca verbale apo jo.
 - **Caktimi i detyrueshëm i seancës verbale** - në çështjen administrative në të cilat marrin pjesë dy ose me shumë palë me interesa të kundërta dhe kur duhet të bëhet këqyrja e vendit të ngjarjes ose dëgjimi i dëshmitarëve apo i ekspertëve. Seanca verbale është e hapur dhe publike, ku mund të marrin pjesë publiku. Mirëpo personi zyrtar i organit administrativ mund ta përjashtoj publikun gjatë seancës verbale ose gjatë një pjese të saj, dhe se këto raste janë të përcaktuara me ligj:
 1. Në qoftë se këtë e kërkojnë shkaqet e moralit apo të sigurisë publike;
 2. Në qoftë se ekziston rreziku serioz dhe i drejtpërdrejtë i pengimit të seancës verbale;
 3. Në qoftë se shqyrtohen raportet dhe marrëdhëniet në një familje;
 4. Në qoftë se vlerësohen faktet dhe rrethanat që përbëjnë sekret zyrtar, profesional, shkencor ose artistik.

Kur personi zyrtar i organit administrativ përjashton publikun gjatë seancës verbale, këtë duhet ta bëjë me përfundim të veçantë, i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe i shpallur publikisht. Përjashtimi i publikut nuk ka të bëjë me palët, me përfaqësuesit e tyre, me të autorizuarit e palëve. Gjersa në seancën verbale mund të lejohen personat e veçantë zyrtar.

Seanca verbale zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Personi zyrtar i organit administrativ duhet të ndërmarr të gjitha veprimet që seanca verbale të zhvillohet pa zvarritje. Palët duhet të ftohen në seancën verbale me thirrje të posaçme dhe atë 8 ditë para mbajtjes se seancës verbale, në mënyrë që palët të kenë mundësi dhe kohë për tu përgatitur për shqyrtim.

Të provuarit në procedurën administrative - personi zyrtar i organit administrativ kërkon të njihet me të gjitha faktet të cilat janë te nevojshme për vërtetimin e gjendjes faktike në mënyrë që pastaj të nxjerr vendimin përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara me ligj. Prandaj organi që e zhvillon procedurën para vendosjes se çështjes konkrete administrative, duhet të vërtetojë

gjendjen faktike që është objekt shqyrtimi dhe te vërtetën materiale. Për këtë arsye duhet të vërtetohen të gjitha faktet dhe rrethanat që janë relevante për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë. Të provuarit në procedurën administrative janë tërësia e veprimeve për vërtetimin e gjendjes faktike, si bazë për nxjerrjen e vendimit mbi një çështje administrative. Faktet dhe rrethanat juridikisht të rëndësishme vërtetohen me prova. Faktet relevante janë ato fakte që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për vendosjen e një çështjeje administrative konkrete.

Barra e provës - barra e të provuarit nënkupton caktimin e subjektit në procedurë i cili duhet të provoj ndonjë fakt me rëndësi për konstatimin dhe vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike. Sipas Ligjit për Procedurën Administrative, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi palët e interesuara në procedimin administrativ, pavarësisht nga detyrimi i administratës për të vënë në dispozicion të palëve provat e administruara prej saj. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre palët e interesuara mund të ju bashkëngjisin kërkesave për fillimin e procedimit administrativ dokumente ose fakte të ndryshme. Palët e interesuara mundën gjithashtu ti kërkojnë organit kompetent të organizatës publike që të ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij në procedurën administrative. Personi zyrtar i organit administrativ që zhvillon procedurën hetimore mund të ju kërkoj palëve të interesuara paraqitjen e informacioneve, dokumenteve apo objekteve të cilat i nënshtrohen inspektimit si dhe çdo formë tjetër hetimi për të provuar pretendimet. Palët e interesuara mund të refuzojnë bashkëpunimin e paraparë në rast se kemi të bëjmë me shkeljen e sekretit profesional, për hapjen e të dhënave njohja me të cilat është ndaluar me ligj, njohja me të dhëna komprometuese që lidhen me vet palën e interesuar apo me bashkëshortin, prindin, fëmijën, vëllain e motrën. Nga e gjithë kjo rezulton se pala mund të paraqes dhe të ofroj të gjitha provat për të cilat konsideron se janë të nevojshme për konstatimin e të vërtetës materiale.

Metodat për paraqitjen e informacionit dhe te provave - në rastet kur nevojitet paraqitja e informacionit ose e provave nga pala e interesuar, organi kompetent i administratës publike e njofton palën me shkrim ose gojarisht, brenda afateve të parapara të Ligjit për Procedurën Administrative. Palët e interesuara mund të paraqesin informacione dhe prova shpresore ose në mënyrë verbale në çdo kohë gjatë zhvillimit të procedurës administrative. Kur pala e interesuar nuk banon në vendin ku ndodhet selia e organit administrativ që zhvillon procedurën hetimore dhe nuk dëshiron që të paraqitet përpara organit kompetent, me vendim të këtij organi, njoftimi me gojë mund të bëhet me ndërmjetësimin e një organi tjetër i cili ndodhet në vendbanimin e palës. Kur pala e interesuar nuk i përgjigjet njoftimit, organi administrativ mund të bëjë një njoftim të ri ose të ndërpres procedimin, kur një gjë e tillë nuk komprometon ndonjë interes publik ose ndonjë interes ligjor privat. Kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vet palët, procedimi pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe pala e interesuar njoftohet për këtë. Personi zyrtar i organit të administratës publike gjatë zhvillimit të

procedurës hetimore mund të ju kërkoj organeve të tjera të administratës publike marrjen e masave për sigurimin e provave në rastet kur nuk mund ta bëj vet një gjë të tillë brenda një afati për të cilin bien dakord te dyja palët por jo me gjatë se 30 ditë. Të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë një procedure administrative të zhvilluar pranë organit të administratës publike mbulohen nga pala e cila ka ushtruar kërkesën për zhvillimin e procedurës administrative.

Mjetet provuese dhe llojet e tyre - me mjete provuese kuptojmë personat ose objektet nga të cilat organi administrativ merr dijëni duke fituar njohuri lidhur me vërtetësinë apo pa vërtetësinë e ndonjë fakti kontestues relevant juridik. Si mjet provues mund të përdoret çdo gjë që është e përshtatshme për të vërtetuar gjendjen e drejtë të çështjes dhe që i përgjigjet rastit konkret. Si mjete themelore provuese në procedurën administrative konsiderohen:

- dokumentet,
- dëshmitarët,
- ekspertizat,
- deklaratat e palës,
- këqyrja në vendin e ngjarjes.

Me dokument - kuptojmë çdo objekt i cili përmban shenjë të dukshme me të cilën mund të dëshmohet mbi ndonjë ngjarje, rrethanë ose fakt. Varësisht se kush i nxjerr dokumentet ato ndahen në:

- dokumente publike dhe
- dokumente private.

Dokument publik - është shkresa, të cilën e ka lëshuar organi shtetëror, në kuadrin e kompetencës së vet ose organizmat në punët që ushtron në bazë të autorizimeve publike me të cilën provohet ajo që zyrtarisht konfirmohet ose caktohet me të, p.sh. pasaportat, letërnjoftimet, diplomat etj. Dokumente publike konsiderohen ato dokumente në të cilat thënie në to konsiderohen si të vërteta deri sa mos të provohet e kundërta.

Dokument privat - nënkuptohet shkresa të cilën e ka nxjerr personi fizik ose juridik, me të cilën provohet se deklarata e inkorporuar në të rrjedh nga dhënësi i saj. Nga kjo rezulton se me dokumentin privat provohet vetëm ajo se dhënësi i këtij dokumenti ka dhënë deklaratën e cila përfshihet në dokument. Në dokumentet private bëjnë pjesë: testamenti, kambiali, kontrata.

Dëshmitarët si mjet provues - kuptimi i dëshmisë dhe dëshmitarëve në procedurën administrative. Me dëshmitar kuptojmë personat fizik që japin deklaratë për faktet dhe rrethanat që janë objekt shqyrtimi dhe i të provuarit para organit që zhvillon procedurën administrative. Dëshmitarë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik i cili është i aftë të vërejtë faktin për të cilin do të dëshmojë dhe njëherit

është në gjendje që vrojtimet e veta t'ia komunikoj organit që zhvillon procedurën administrative. Çdo person që thirret si dëshmitar ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes dhe të dëshmoj ngase dëshmia është detyrim i përgjithshëm qytetar. Dëshmitari ka për detyrim që t'i përgjigjet thirrjes, të dëshmoj dhe të flas të vërtetën. Dëshmitari që është thirrur në mënyrë të rregullt nuk vjen tek organi administrativ gjersa mungesën e vet nuk e arsyeton, organi që e zhvillon procedurën mund të urdhëroj që ai të sillet me dhunë. Në qoftë se dëshmitari vjen të dëshmoj para organit administrativ por pa ndonjë arsye refuzon të dëshmoj edhe pse i është tërhequr të njëjtit vërejtja për pasojat e refuzimit të dëshmisë, dëshmitari mund të dënohet me gjobë. Përfundimin mbi caktimin e dënimit me gjobë e bien personi zyrtar që zhvillon procedurën administrative. Dëshmitari mund të lirohet nga dëshmia në ato raste kur e parasheh Ligji për Procedurën Administrative.

Ekspertet si mjet provues - ekspertët janë persona të tretë në procedurën administrative të cilët, kanë aftësi të caktuar profesionale për vërtetimin e fakteve kontestuese juridike relevante. Ekspertët janë persona me aftësi profesionale për ekzaminimin e fakteve të caktuara dhe për to paraqesin mendimin dhe konstatimin e vet profesional. Gjatë procedurës administrative ekspertizat, raportet, vlerësimet dhe masat e tjera të ngjashme kryhen vetëm nga ekspert të specializuar apo nga organet e specializuara të administratës. Mënyra e zgjedhjes së ekspertëve është e rregulluar me Ligjin për Procedurën Administrative. Eksperti caktohet nga personi që e udhëheq procedurën administrative ngase si ekspert do të caktohen vetëm personat që janë profesionist dhe që kanë autorizim të veçantë për dhënien e mendimit rreth çështjeve të lëmisë përkatëse. Objekti i ekspertizës është vërtetimi i fakteve të kontestueshme relevante për të cilat kërkohet mendimi profesional dhe konstatimi i ekspertit ose vlerësimi i fakteve tashmë të kontestuara. Gjatë zhvillimit të procedurës administrative organi administrativ cakton ekspert, mirëpo edhe pala e interesuar mund të caktoj ekspertët e saj në një numër të njëjtë me ata të administratës

Deklarata e palës si mjet provues - mund të përdoret si mjet provues në qoftë se për vërtetimin e faktit të caktuar nuk ekziston prova direkt, ose nëse fakti i tillë nuk mund të vërtetohet në bazë të mjeteve të tjera provuese. Që do të thotë se pas përfundimit të procedurës hetimore palët e interesuara kanë të drejtë të deklarojnë para marrjes së vendimit përfundimtar. Organi që e zhvillon procedurën hetimore vendos për çdo rast nëse palët e interesuara do të deklarojnë me shkrim apo me gojë. Nëse organi që e zhvillon procedurën hetimore vendos të ju kërkoj palëve të interesuara të deklarojnë me shkrim palët njoftohen për të paraqitur deklaratën me shkrim jo më vonë se 10 ditë nga dita e pranimit të njoftimit. Njoftimi duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për palët dhe arsyet pse kërkohet deklarata me shkrim. Kur organi që e zhvillon procedurën hetimore vendos tu kërkoj palëve të interesuara të deklarojnë me gojë, ai cakton një datë për takim me palët jo më herët se 8 ditë nga njoftimi. Në seancat ku palët deklarojnë me gojë mund të diskutohen të gjitha çështjet ligjore që janë me rëndësi për marrjen e vendimit. Mosparaqitja e palëve të interesuara nuk e arsyeton shtyrjen e

seancës, me përjashtim kur palët e arsyetojnë mungesën para fillimit të seancës. Palës se interesuar mund t'i mohohet e drejta për tu deklaruar gjatë procedurës administrative, në rastet:

- kur marrja e vendimit është urgjente;
- kur është e qartë se një masë e tillë do të vështirësonte ekzekutimin e vendimit;
- kundër vendimit të organit kompetent të organizatës publike për të mos dëgjuar palët, mund të paraqitet ankesë nga palët e interesuara, e cila ankesë nuk e ndalon procedimin administrativ. Mirëpo organi administrativ që e zhvillon procedurën hetimore mund t'i mohojë të drejtën për tu deklaruar palës se interesuar edhe në këto raste:
- në qoftë se palët e interesuara kanë pasur rast të deklarohen për çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit gjatë zhvillimit të procedimit dhe mbi bazën e provave ekzistuese;
- në qoftë se informacioni i paraqitur gjatë procedimit shpie drejt një vendimi në favor të palës se interesuar.

Këqyrja në vendin e ngjarjes - është një nga format procedurale të të provuarit me të cilën personi zyrtar që zhvillon procedurën vërteton fakte të rëndësishme me vrojtimin e drejtpërdrejtë, me qëllim që personalisht dhe drejtpërdrejtë të bindet për vërtetësinë përkatësisht për pavërtetësinë e ndonjë fakti juridik. Kur personi zyrtar i cili udhëheq procedurën administrative vendos të bëjë këqyrjen në vend ai duhet njëkohësisht të caktoj seancën verbale. Gjatë këqyrjes në vend të ngjarjes mbahet procesverbali. Gjithashtu këqyrja në vend mund të bëhet edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve.

Ndërhyrja - çdo person fizik dhe juridik, që nuk është palë në një procedurë administrative mund të ushtroj kërkesë me shkrim për ndërhyrje në procedurë administrative. Personi që ka interes juridik që të ndërhyj në ndonjë procedim administrativ duhet të ushtroj kërkesë pranë organit kompetent të administratës publike, gjithashtu nga një kopje të kësaj kërkesë tua dorëzohet edhe palëve në procedurë. Kërkesa të cilën pala e ushtron në cilësi të ndërhyrësit në procedurë administrative duhet ti përmbaj këto elemente:

- emrin e organit të administratës publike që është duke e zhvilluar procedurën administrative;
- emrin e procedimit;
- një përmbledhje të fakteve që tregojnë që të drejtat dhe interesat ligjore të ushtruesit të kërkesës preken nga procedimi administrativ në zhvillim;
- tregimin e veprimit që kërkuesi kërkon nga organi i administratës publike.

Personi që e udhëheq procedurën administrative, do ta pranon kërkesën për ndërhyrje mirëpo fillimisht do të vlerësoj se kërkesa e ushtruar nga ndërhyrësi a i plotëson kushtet siç janë:

- të drejtat, liritë ose interesat ligjore të ushtruesit të kërkesës mund të preken nga procedimi administrativ që është në zhvillim;

- zhvillimi i shpejtë dhe i rregullt i procedimit administrativ nuk vështirësohet për shkak të ndërhyrjes;
- interesat e publikut përfitojnë nga ndërhyrja.

Personi që udhëheq procedurën e organit administrativ pas vlerësimit të këtyre kritereve nxjerr vendim me shkrim se a do të pranoj në cilësi të ndërhyrësit ushtruesin e kërkesës ose do ta refuzoj, dhe se për këtë vendim do t'i njoftoj palët në procedurë. Me vendimin që lejon ndërhyrjen personi që udhëheq procedurën administrative mund të vendos disa kushte për ndërhyrësin me qëllim që ndërhyrja të mos vështirësoj zhvillimin e shpejtë dhe të rregullt të procedimit në vijim, gjithashtu udhëheqësi që zhvillon procedimin mund të i vendos kushtet për ndërhyrësin në çdo kohë pas pranimit të ndërhyrjes.

Vendimet e ndërmjetme - rastet kur mund të jepen vendime të ndërmjetme nga organi administrativ që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar në një procedim administrativ, mund të marr edhe vendime të ndërmjetme kur gjykon se mos marrja e disa masave mund të ju shkaktoj një dëm të rëndë dhe të pa riparueshëm interesave të publikut dhe palëve të interesuara. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me vet iniciativën e organit administrativ ose me kërkesën e palëve të interesuara. Vendimi i ndërmjetëm duhet të jetë i justifikuar dhe me afat kohor të përcaktuar. Organi administrativ mund ta revokoj vendimin për marrjen e masave të ndërmjetme mirëpo, i njëjti duhet të jetë i justifikuar.

Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme të nxjerra nga organi kompetent i organizatës publike mbarojnë në këto raste:

- pasi jepet vendimi përfundimtar;
- kur afati kohor i vendimeve të ndërmjetme mbaron;
- kur në mungesë të afateve të parashikuara nga ligji ose vendimi i organit administrativ, që zhvillon procedimin për marrjen e masave të ndërmjetme kalojnë 6 muaj, nga data e fillimit të procedimit.

Përfundimi i procedimit administrativ - bëhet me marrjen e vendimit përfundimtar ose për shkak të fakteve tjera që parashikohen me Ligjin për Procedurën Administrative. Me vendimin përfundimtar, organi administrativ vendos për të gjitha çështjet e ngritura gjatë zhvillimit të procedimit.

Braktisja - konsiderohet atëherë kur pala e interesuar, e cila ka ushtruar kërkesë pranë organit administrativ për fajin e saj ka qenë jo aktive mbi 3 muaj, me përjashtim kur ka interes publik për marrjen e një vendimi përfundimtar. Braktisja e procedurës administrative nuk e shuan të drejtën, të cilën pala e kishte kërkuar të zbatohet.

Pamundësia - procedimi administrativ përfundon edhe atëherë kur organi administrativ për marrjen e vendimit përfundimtar konstaton se objekti për të cilin

kishte filluar procedimin ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. Deklarimi i përfundimit të përmendur duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar dhe se kundër një këtij vendimi mund të ushtrohet ankesa tek organi administrativ ose në gjykatë.

Mos pagesa e tarifave ose detyrimeve tjera - janë shkas që procedimi të përfundon si pasojë e mos pagimit brenda afatit kohor të tarifave ose të detyrimeve të tjera, pagimi i të cilave, sipas ligjit është kusht për zbatimin e akteve procedurale. Mirëpo, palët e interesuara mund të parandalojnë përfundimin e procedurës në qoftë se ato paguajnë dyfishin e shumës fillestare, brenda 10 ditëve, pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar.

Me LPPA janë paraparë mjetet e provës në (nenin 88) ku përcaktohet se:

1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore.
2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen.

Vlerësimi i provave është paraparë me (nenin 89)

Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ.

Sigurimi i provave me (nenin 90)

1. Nëse marrja e një prove të nevojshme, mund të bëhet e pamundur ose e vështirë, organi publik, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së arsyetuar të palës, mund të vendosë për sigurimin e provës.
2. Sigurimi i provave mund të bëhet në cilëndo fazë të procedurës, qoftë edhe para fillimit të saj. Përgjegjësia për të siguruar provat bie në kompetencën e organit publik që udhëheq procedurën administrative.

Paraqitja e provave pranë organeve të tjera në (nenin 91)

1. Nëse paraqitja apo marrja e provave të nevojshme nga vetë organi publik është i vështirë, kërkon kohë apo ka kosto më të lartë, ai mund të vendosë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së palës, që paraqitja apo marrja e provave apo e pjesëve të tyre të bëhet nëpërmjet një organ tjetër publik.

2. Në këtë rast zbatohen, përshtatshëm, dispozitat e këtij Ligji për ndihmën administrative ndërmjet organeve publike.

E drejta e njohjes me dosjen dhe marrjes së informacionit me (neni 92)

1. Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës administrative dhe të marrë kopje të dokumenteve që gjenden në të.
2. Organi publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës, duhet të sigurojë në mjediset e tij të punës kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për palën, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjediset e një organi tjetër publik, apo në përfaqësitë konsullore e diplomatike të Republikës së Kosovës.
3. Kur dokumentacioni administrohet në mënyrë elektronike, organi publik i siguron palës mjetet e nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të qasshme nëpërmjet internetit, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit.
4. Pala ka gjithashtu të drejtën të kërkojë dhe marrë informacion mbi statusin, progresin e procedurës administrative, si dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë nga organi publik gjatë procedurës. Organi publik, për zhvillimin e procedurës, duhet të sigurojë informacion për palën pa vonesë dhe me çdo mjet të përshtatshëm.
5. E drejta e njohjes së dosjes, e marrjes së kopjeve të dokumenteve dhe informacionit sipas këtij neni, kufizohet vetëm nëse dhe për aq sa dokumenti apo informacioni është mbrojtur sipas legjislacionit për klasifikimin e informatave, përmban të dhëna personale, përmban të dhëna afariste, apo të dhëna profesionale të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi.

E drejta e ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës është parashikuar me (nenin 93)

Pala mund të ndryshojë kërkesën e paraqitur, nëse qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike me kërkesën fillestare, apo edhe ta tërheqë plotësisht atë, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi publik. Nëse ka palë të tjera në procedurë, ato njoftohen.

E drejta për të paraqitur mendime, shpjegime dhe prova në (nenin 94)

Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së

bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes.

E drejta e dëgjimit është parashikuar me (nenin 95)

1. Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t'u dëgjuar.
2. Njoftimi, i paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, do të përshijë informacionin mbi rezultatet e shqyrtimit administrativ, rezultatin e mundshëm të procedurës si dhe informacionin mbi mënyrën e ushtrimit të së drejtës së dëgjimit.
3. E drejta për t'u dëgjuar mund të ushtrohet me shkrim apo gojarisht dhe regjistrohet në procesverbal nga organi publik.
4. Kur dëgjimi ndaras i secilës prej palëve të përfshira, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, është jopraktik për shkak të numrit të madh të palëve, dëgjimi do të zhvillohet në çfarëdo mënyre të përshtatshme të dëgjimit të përbashkët.

Përfundimi nga e drejta e të dëgjuarit parashihet në (nenin 96)

1. Vendimi mund të merret pa u dëgjuar pala në rast se:
 - 1.1. rezulton qartë se vendimi përfundimtar do të jetë në favor të palës apo do të përbëjë miratimin e plotë të kërkesës së saj;
 - 1.2. marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të një interesi publik, që mund t'i shkaktohet një dëm nga vonesa;
 - 1.3. pala tashmë i ka shprehur plotësisht, gjatë procedurës, mendimet e veta rreth rezultatit të shqyrtimit administrativ dhe rezultatit të mundshëm të procedurës, apo
 - 1.4. dëgjimi i palës përjashtohet shprehimisht me ligj.

Parimi i përfundimit të procedurës administrative është paraparë me (nenin 97)

Përfundimi i procedurës administrative

1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative.
2. Përfundimi i një procedure administrative të nisur sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e organit publik, përpos kur parashihet ndryshe me ligj dhe bëhet me akt administrativ.

3. Një procedurë administrative përfundon, gjithashtu, në praninë e një prej rasteve të parapara në nenet 101 - 104 të këtij Ligji. Në këte rast përfundimi i procedurës administrative bëhet me një akt administrativ që nuk shprehet mbi thelbin e çështjes administrative.

Afati për përfundimin e procedurës administrative është paraparë me (nenin 98)

1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.
2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.
3. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës.

Shtyrja e afatit të përfundimit të procedurës administrative me (nenin 99)

1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji.
2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjestim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar.
3. Vendimi procedural i shtyrjes të afatit fillestar dhe data e re e mbarimit të tij, i njoftohet palës, brenda afatit fillestar dhe duhet të jetë e arsyetuar.

Akti administrativ i miratuar në heshtje është parashikuar me (nenin 100)

1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe

akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: "akti administrativ i miratuar në heshtje").

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet kur parashihet ndryshe me ligj.
3. Në rast të një akti administrativ të miratuar në heshtje, pala ka të drejtë të marrë nga organi kompetent një vërtetim me shkrim për përmbajtjen e tij, siç është paraparë në paragrafin 3 të nenit 46 të këtij Ligji.
4. Dispozitat e këtij Ligji për pasojat juridike, ligjshmërinë, shfuqizimin dhe anulimin e akteve administrative, si dhe për mjetet juridike, zbatohen gjithashtu, përshtatshëmrisht edhe për aktin administrativ të miratuar në heshtje.

Përfundimi i procedurës administrative në raste të posaçme - Ligji ka parashikuar edhe rastet e veçanta kur procedura administrative mund të konsiderohet se ka përfunduar e ato janë rastet:

Kërkesa e përsëritur e paraparë me (nenin 101)

1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se:
 - 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, ose
 - 1.2. një procedurë administrative tjetër, nisur sipas një kërkesë tjetër të paraqitur nga e njëjta palë me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, është ende në proces shqyrtimi dhe e papërfunduar.
2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet në rastin kur procedura administrative ka përfunduar në rastet e parashikuara në nenin 103 të këtij ligji.

Vdekja e një pale dhe shuarja e një personi juridik është parashikuar me (nenin 102)

1. Nëse një person fizik vdes gjatë procedurës administrative të nisur për një çështje kryekëput personale (intuitu personae), organi publik do të mbyllë dosjen dhe do përfundojë procedurën administrative.
2. Në çfarëdo rasti tjetër, përpos atij që është paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, kur një person fizik vdes gjatë zhvillimit të një procedure administrative, nëse organi publik e konsideron pjesëmarrjen e palës si të domosdoshme, atëherë do të pezullojë përkohësisht procedurën administrative deri sa të përcaktohet trashëgimtari i saj.

3. Përveç kur parashihet ndryshe me ligj, në rast të shuarjes së një personi juridik, kur një person tjetër juridik i merr përsipër, në pajtim me ligjin, të drejtat dhe detyrimet e personi të shuar, organi publik do të vazhdojë procedurën administrative me këtë të fundit. Në çdo rast tjetër, organi publik do të mbyllë dosjen dhe përfundojë procedurën administrative.

Braktisja e procedurës Administrative

Konsiderohet atëherë kur pala e interesuar, e cila ka ushtruar kërkesë pranë organit administrativ për fajin e saj ka qenë jo aktive mbi 3 (tre) muaj, me përjashtim kur ka interes publik për marrjen e një vendimi përfundimtar. Braktisja e procedurës administrative nuk e shuan të drejtën, të cilën pala e kishte kërkuar të zbatohet.

Tërheqja dhe braktisja e kërkesës është paraparë me (nenin 103)

1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë.
2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë.
3. Tërheqja apo braktisja nuk ndikon në përfundimin e procedurës administrative, nëse organi publik konsideron se vazhdimi i saj është në interes të publikut, përveç kur ajo procedurë mund të themelohet vetëm në bazë të kërkesës.

Pamundësia e përfundimit të procedurës administrative

Procedimi administrativ përfundon edhe atëherë kur organi administrativ për marrjen e vendimit përfundimtar konstaton se objekti për të cilin kishte filluar procedimin ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. Deklarimi i përfundimit të përmendur duhet të jetë gjithmonë i arsyetuar dhe se kundër një këtij vendimi mund të ushtrohet ankesa tek organi administrativ ose në gjykatë.

Pamundësia është parashikuar me (nenin 104)

Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.

Përfashtimi nga Procedura Administrative

Është institut i njohur dhe shumë i rëndësishëm në rastet e zhvillimit të një procedure administrative pavarësisht se si ka filluar e njëjta, me kërkesën e palës apo sipas detyrës zyrtare, me këtë garantohet e drejta dhe detyrimi i institucionit me rastin e vendosjes për një çështje të caktuar me interes të ndonjërit nga palët në procedurë por edhe garantohet një procedurë e drejtë dhe një vendimmarrje e paanshme dhe subjektive.

Rastet e përjashtimit nga procedura janë përcaktuar me (nenin 29) të LPPA-së, ku taksativisht janë të numruara rastet se kur mund të ndodh një përjashtim gjat fillimit apo zhvillimit të një procedure administrative:

1. Një nëpunës nuk duhet të përfshihet në një procedurë administrative, nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë, në mënyrë të veçantë kur ndodhet në njërin nga këto situata:
 - 1.1. Kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo në gjini të krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;
 - 1.2. kur bashkëshorti apo partneri bashkëjetues, apo të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;
 - 1.3. kur është vetë palë, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i palës, apo me palën është kreditor apo bashkëkreditor, debitor apo bashkëdebor, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjues si dëshmitar apo si ekspert, apo ka marrë pjesë në procedurë si këshilltar apo avokat i palës;
 - 1.4. nëpunësi apo personat e parashikuar nga nënparagrafi 1.2. i këtij neni, kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë;
 - 1.5. personat e përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë, dëshmitarë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë;
 - 1.6. ndërmjet nëpunësit apo personave të përmendur në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, ka një proces gjyqësor me palët;
 - 1.7. nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vetë atij, ose nga personat e përmendur në nënparagrafin 1.2 të këtij neni;
 - 1.8. nëpunësi ose personat e përmendur në nënparagrafin 1.2 të këtij neni, kanë përfituar dhurata apo shërbime me një çmim dukshëm me të ulët se vlera e tregut, nga palët në procedurën administrative, përpara ose pas fillimit të procedurës;
 - 1.9. me palën, përfaqësuesin apo të autorizuarin e palës, është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit apo të ushqyesit;
 - 1.10. në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij.

Më hollësisht në ligj sqarohet deklarimi dhe kërkesa për përjashtim në (nenin 30) ku thuhet se:

Personi përgjegjës kur gjendet apo dyshon se është në një situatë nga të cilat mund të kërkohet përjashtimi menjëherë tërhiqet nga pjesëmarrja në procedurën administrative dhe njofton eprorin e vet gjegjësisht organin kolegjial. Çdo nëpunës që ka dijeni për gjendjen e një nëpunësi tjetër në konflikt interesi sipas këtij ligji ka për detyrim të njoftojë organin lidhur me këtë gjë.

Pala gjithashtu mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo një anëtari të organit kolegjial nga një procedurë administrative, deri në çastin e marrjes së vendimit duke i paraqitur arsyet për të cilat mund të kërkohet përjashtimi.

Me këtë nen të këtij Ligji taksativisht përcaktohet se:

1. Kur gjendet apo dyshon se është në një situatë sipas nenit 29 të këtij Ligji, nëpunësi apo anëtari i organit kolegjial, menjëherë me njohjen e shkakut, tërhiqet nga pjesëmarrja në procedurën administrative dhe njofton eprorin e vet gjegjësisht organin kolegjial.
2. Çdo nëpunës që ka dijeni për gjendjen e një nëpunësi tjetër në konflikt interesi sipas nenit 29 të këtij ligji, ka detyrimin të njoftojë organin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Pala, gjithashtu, mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtari të organit kolegjial nga një procedurë administrative, deri në çastin e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi.

Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit janë paraparë me (nenin 31) ku përcaktohet se:

1. Eprori apo organi kolegjial, që ka marrë dijeni për një rast të përjashtimit sipas këtij Ligji, vendosin brenda pesë (5) ditëve nga marrja në dijeni të rastit, gjegjësisht nga parashtrimi i kërkesës nga pala.
2. Në rast të vendimit për përjashtimin, nëpunësi apo anëtari i organit kolegjial zëvendësohet nga një nëpunës apo anëtar tjetër, apo nga vetë eprori, kur ai vendos kështu.
3. Në rastin e përjashtimit të titullarit të organit publik, eprori i tij direkt cakton një nëpunës të të njëjtit organ publik për të vazhduar procedurën dhe merr masa për shmangien e çdo konflikti të mëtejshëm.

4. Në rastet e përjashtimit të një anëtarit të organit kolegjial, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar. Kuorumi dhe vendimmarrja llogaritet pa marrë në konsideratë vendin apo votën e anëtarit të përjashtuar.

Bashkëpunimi administrativ

Bashkëpunimi administrativ ka një rëndësi të veçant në procedurën administrative sepse nga ky bashkëpunim varet edhe fillimi zhvillimi dhe përfundimi i një procedure administrative, e cila nëse hasë në bashkëpunim të miëe ndërmjet organeve administrative, mund të kontribuojë në mos vonesës e përfundimit të çështjes në vendosje efikasitetin dhe punën më të lehtë në procedimin e çështjeve në kompetencën e organeve publike.

Për rëndësinë që ka bashkëpunimi administrative në çështjet e procedurës administrative e ka hasur edhe ligjvënësi ku e ka paraparë edhe me **(nenin 22)** të Ligjit - Vendimmarrjen e përbashkët të organeve publike, ku përcakton saktë se kur mundet me ndodh e njëjta:

1. Në rastet kur, dy apo më shumë organe publike vendosin në një procedurë të vetme apo në disa procedura që lidhen me një veprimtari apo rezultat të vetëm, ato përcaktojnë me marrëveshje organin publik që do të nxjerrë aktin administrativ të përbashkët, i cili përfshin edhe vendimin e organit tjetër publik.
2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, secili prej organeve të përfshira, vendos vetëm brenda kompetencës përkatëse.
3. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, mosmarrëveshjet ndërmjet dy organeve publike lidhur me paragrafin 1 të këtij neni, zgjidhen sipas nenit 25 të këtij Ligji.
4. Nëse me ligj është përcaktuar se, një organ publik vendos pas marrjes më parë të pëlqimit të mendimit apo miratimit të një organi tjetër publik, ky i fundit duhet ta japë mendimin, pëlqimin apo miratimin në një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, prej parashtrimit të kërkesës, përveç kur me dispozita të veçanta parashikohet një afat tjetër.
5. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, kur organi publik, mendimi, pëlqimi apo miratimi i të cilit kërkohet nuk vepron brenda afatit të caktuar, konsiderohet se mendimi, pëlqimi apo miratimi është dhënë dhe është në favor të palës. Në këtë rast, organi publik që nuk ka vepruar brenda afatit dhe organi i tij epror do të njoftohen për vazhdimin e procedurës në bazë të prezumimit të dhënies së mendimit, pëlqimit apo miratimit në favor të palës.

6. Organi publik i cili nxjerrë vendim, është i detyruar që në vendimin e tij ta cekë aktin me të cilin organi tjetër publik ka dhënë apo ka refuzuar mendimin, pëlqimin apo miratimin, përkatësisht të cekë se në afatin e përcaktuar organi tjetër publik e ka dhënë atë ose jo.

Pikat e vetme të kontaktit janë parashikuar në (nenin 33)

1. Kur sipas ligjit dy apo më shumë organe publike janë të përfshira në një procedurë të vetme administrative, të gjithë hapat proceduralë dhe formalitetet e nevojshme duhet të trajtohen nëpërmjet një pike të vetme kontakti.
2. Ekzistenca e një pike të vetme kontakti nuk cenon kompetencën e secilit prej organeve publike si dhe të drejtën e palëve t'i drejtohen dhe komunikojnë drejtpërdrejt me organin publik kompetent.
3. Pika e vetme e kontaktit ka këto detyra:
 - 3.1. të këshillojë aplikantin, njësoj siç detyrohet të bëjë organi publik kompetent dhe, t'i sigurojë atij informimin dhe ndihmën aktive sipas nenit 11 të këtij Ligji. Kjo përfshinë edhe informatat për mjetet dhe kushtet për qasjen në regjistrat publikë dhe në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe për mjetet juridike.
 - 3.2. të pranojë kërkesën për nxjerrjen e një akti administrativ apo kryerjen e një akti real, si dhe çdo parashtrësë tjetër sipas nenit 77 të këtij Ligji dhe t'ia transferojë ato organit publik kompetent;
 - 3.3. të komunikojë me palën, gjatë procedurës për të gjitha kërkesat procedurale, dhe
 - 3.4. t'ia bëjë të njohur palës çdo akt apo veprim administrativ, të nxjerrë/kryer nga organi publik kompetent, përfshirë aktet apo veprimet procedurale.
4. Shërbimet e përcaktuara me anë të këtij ligji kryhen me kërkesë të palës, drejtpërdrejt në ambientet e pikës së vetme të kontaktit, si dhe nëpërmjet postës apo në mënyrë elektronike. Kjo nuk zbatohet për inspektimet në vend apo inspektimet e tjera fizike apo personale, të parashikuara nga ligji.
5. Kërkesa e palës do të vlerësohet e parashtruar në kohë, nëse është parashtruar sipas këtij Ligji, në pikën e vetme të kontaktit apo në organin publik kompetent. Ndërsa afatet që ecin kundrejt organit publik, fillojnë të llogariten me parashtrimin e kërkesës së plotë, sipas këtij Ligji, në pikën e vetme të kontaktit, pavarësisht nga koha e nevojshme për transferimin e tyre te organi publik kompetent.
6. Si rregull, ndërmjet organeve publike kompetente të përfshira në procedurën administrative pika e vetme e kontaktit do të jetë organi përgjegjës për vendimmarrjen më të rëndësishme. Caktimi apo krijimi i pikës së vetme të

kontaktit, bëhet me marrëveshje të organeve publike kompetente të përfshira, apo me vendim të Qeverisë të Kosovës.

7. Marrëveshja apo vendimi, sipas këtij ligji, përcakton gjithashtu, procedurat e brendshme të komunikimit ndërmjet pikës së vetme të kontaktit dhe organeve të tjera publike të përfshira.
8. Si rregull, të gjitha procedurat dhe formalitetet administrative, në kompetencën e organeve të ndryshme publike, të nevojshme për fillimin dhe ushtrimin e një veprimtarie të caktuar shërbimi, do të trajtohen nëpërmjet një pike të vetme kontakti. Dispozitat e paragrafit 1 deri 7 të nenit 33 të këtij ligji zbatohen përshtatshëm edhe në këtë rast. Qeveria e Kosovës përcakton veprimtaritë e shërbimit si dhe procedurat administrative dhe formalitetet e tjera, lidhur me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit, të cilat kryhen nëpërmjet pikave të vetme të kontaktit.

Ndihma ndërmjet organeve publike (ndihma administrative)

Ndihma administrative është parapar me **(nenin 34)**, ku përcaktohet se:

1. Organi publik mund t'i kërkojë ndihmë një organi tjetër publik, për kryerjen e një a disa veprimeve të nevojshme procedurale, në kuadër të një procedure administrative.
2. Ndihma administrative kërkohet:
 - 2.1. nëse për arsye të justifikuar, organi kërkues, nuk mund t'i kryejë vetë këto veprime;
 - 2.2. nëse kryerja e veprimeve nga organi kërkues nuk është efektive apo kostot për kryerjen e tyre janë shumë më të larta në krahasim me koston e kryerjes së tyre nga organi tjetër;
 - 2.3. për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjetër.
3. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, organi publik mund ta zgjedhë organin, të cilit i kërkon ndihmë, në përputhje me parimin e kosto-efektivitetit.

Detyrimi për dhënie të ndihmës administrative është paraparë me (nenin 35)

1. Organi të cilit i kërkohet ndihma administrative, nuk mund ta refuzojë atë, me përjashtim të rasteve të pamundësisë objektive për kryerjen e veprimeve të kërkuara. Në këtë rast organi kërkues njoftohet pa vonesë.

2. Mosmarrëveshja ndërmjet dy organeve zgjidhet nga organi më i lartë, të atij që i kërkohet ndihmë.

Procedura e ndihmës administrative përcaktohet me (nenin 36)

1. Organi, të cilit i kërkohet ndihmë administrative gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për të cilat është kërkuar ndihma, u nënshtrohet procedurave dhe detyrimeve ligjore të parashikuara për organin që ka kërkuar ndihmën administrative dhe kryen veprimet e kërkuara sa më shpejt të jetë e mundur.
2. Organi kërkues, në kërkesën për ndihmë, informon organin tjetër për procedurat dhe detyrimet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Organi kolegjal - nocioni me (nenin 37)

1. Organi publik kolegjal është një grup personash, të caktuar sipas ligjit, që përfshihen në një procedurë administrative me kompetenca vendimmarrëse apo këshillimore.
2. Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen për organet kolegjiale, përveç se dhe për atë që nuk parashikohet shprehimisht ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

Kryetari i organit kolegjal me (nenin 38)

1. Përveç kur është paraparë ndryshe me ligj, organi kolegjal ka një kryetar dhe një nënkryetar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi. Nënkryetari zëvendëson kryetarin nëse ky i fundit ndodhet në pamundësi për të ushtruar funksionet e tij.
2. Kryetari i organit kolegjal hap, drejton dhe mbyll mbledhjet dhe është përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të mbledhjeve.
3. Kryetari thërret mbledhjet, përcakton kohën dhe vendin e mbledhjes dhe përgatit rendin e ditës të mbledhjes. Anëtarët e organit kolegjal njoftohen, në kohë të përshtatshme, por së paku 48 orë përpara mbledhjes, për zhvillimin e mbledhjes së radhës dhe rendin e ditës.
4. Kryetari detyrohet të thërrasë një mbledhje, nëse është vendosur nga organi kolegjal apo kërkohet me shkrim nga të paktën një e treta (1/3) e anëtarëve. Kërkesa e një të tretës (1/3) të anëtarëve duhet të përcaktojë çështjet që kërkohen të diskutohen.

Mbledhjet e organit kolegjal janë të përcaktuara me (nenin 39)

1. Si rregull, mbledhja e organit kolegjal mbahet me prezencën fizike të anëtarëve. Me pëlqimin e shumicës së të gjithë anëtarëve, mbledhja mund të mbahet dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve nëpërmjet videokonferencës apo me mjete të tjera të përshtatshme të komunikimit simultan në distancë.
2. Mbledhjet e organit kolegjal janë të mbyllura, përveç kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.
3. Në rastin e mbledhjeve të hapura për publikun, data, ora dhe vendi i zhvillimit të mbledhjes njoftohen me mjete të përshtatshme për të mundësuar pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

Kuorumi parashihet me (nenin 40)

1. Mbledhja e organit kolegjal është e vlefshme nëse të gjithë anëtarët janë njoftuar sipas ligjit dhe në mbledhje janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk realizohet kuorumi i nevojshëm, një mbledhje e dytë me të njëjtin rend dite thirret në një ditë tjetër, sipas paragrafit 3 të nenit 38 të këtij Ligji. Në këtë rast, mbledhja e dytë është e vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm më shumë se një e treta (1/3) e anëtarëve të tij, me kushtin që njoftimet të jenë bërë sipas ligjit dhe në njoftim të jetë përfshirë njoftimi që mbledhja e dytë do të jetë e vlefshme me këtë kuorum.

Forma e votimit rregullohet me (nenin 41)

1. Vendimet e organit kolegjal merren me votim të hapur që realizohet me zë, me shenja apo çdo formë tjetër të përshtatshme. Vendimet e organit kolegjal mund të miratohen edhe me një procedurë qarkulluese, në rast se asnjë anëtar nuk shpreh kundërshti.
2. Vendimet që lidhen me zgjedhjen e një individi, merren me votim të fshehtë.
3. Procedura qarkulluese, është procedura e votimit, në të cilën anëtarët votojnë individualisht, me shkrim, pa qenë e nevojshme mbledhja e organit kolegjal.

Vendim-marrja përcaktohet me (nenin 42)

1. Vendimet e organit kolegjal merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Vendimet me procedurë qarkulluese merren me shumicën e votave të anëtarëve të organit kolegjal.
2. Abstenimi apo votat e paplotësuara do të llogariten si vota kundër.
3. Në rast barazie të votave, vota e kryetarit është vendimtare, përveçse kur ai ka një pengesë ligjore për të votuar sipas ligjit. Barazia e votave do të vlerësohet si rrëzim i propozimit.
4. Në rastin e zgjedhjes së individëve, paraparë në paragrafin 2 të nenit 41 të këtij Ligji, individi që merr më shumë vota do të konsiderohet i zgjedhur. Në rast të barazisë së votave, individi fitues, nga individët që kanë marrë të njëjtin numër votash, do të përcaktohet me short.

Procesverbali i mbledhjes parashikohet me (nenin 43)

1. Në secilën mbledhje mbahet një procesverbal, në të cilin përfshihen:
 - 1.1. data dhe vendi i mbledhjes;
 - 1.2. anëtarët që morën pjesë;
 - 1.3. çështjet që u diskutuan dhe pretendimet e anëtarëve;
 - 1.4. vendimet që u morën, si dhe
 - 1.5. forma dhe rezultati i votimeve.
2. Anëtarët e organit kolegjal mund të kërkojnë që vota kundër e tyre dhe arsyetimi përkatës të përfshihet në procesverbal.
3. Procesverbali paraqitet për miratim në fund të mbledhjes përkatëse ose në fillim të mbledhjes paraardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe personi që ka mbajtur procesverbalin.

Akti Administrativ

Nxjerrja e aktit administrativ është faza më e rëndësishme e procedurës administrative. Procedura administrative përbëhet nga një sërë veprimesh që ndërmerren për vendosjen përfundimtare të çështjes administrative. Pra vendimi është akt administrativ me të cilin organi kompetent vendos mbi çështjen administrative e cila paraqet objekt të procedurës administrative. Vendimi është rezultat i aplikimit të dispozitave juridike materiale, në rastin konkret në gjendjen e vërtetuar faktike.

Llojet e akteve administrative - në procedurën administrative nxirren dy lloj aktesh administrative:

- Vendimi (aktvendimi);
- Përfundimet (konkluzionet).

Vendimi - paraqet aktin administrativ me të cilin vendoset çështja administrative dhe me të cilin krijohen pasoja juridike. Vendimi përkufizohet si akt administrativ me të cilin organi kompetent vendos mbi objektin, çështjen konkrete administrative, mbi ndonjë të drejtë, detyrim ose interes juridik, duke aplikuar drejtpërdrejtë dispozitat juridike materiale.

Përfundimi - është akt administrativ me të cilin vendoset mbi çështjet që i përkasin procedurës, ose paraqiten si sekondare lidhur me zhvillimin e procedurës, e të cilat nuk vendosen me vendim.

Forma e aktit administrativ - akti administrativ paraqet akt formal i përcaktuar me ligj, që do të thotë se akti administrativ ka formën e shkruar, përjashtimisht të rasteve kur me ligj kërkohet një formë tjetër apo kur një gjë të tillë e imponojnë rrethanat tjera. Aktin administrativ si rregull e nxjerr organi kompetent në formë të shkruar. Dhe se në çdo rast aktet administrative duhet të tregojnë qëllimin e tyre. Akti administrativ duhet patjetër të përmbajë informacionet siç janë:

- a) emrin e organit të administratës publike që nxjerr aktin, numrin, datën e nxjerrjes së aktit si dhe çdo delegim kompetencash, në bazë të të cilit është nxjerrë akti;
- b) identitetin e palëve të cilave iu drejtohet akti;
- c) një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar vetëm në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata;
- d) një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti;
- e) një shpjegim të pasojave praktike të aktit për palët në procedimin administrativ;
- f) një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të kërkojnë rishqyrtimin e çështjes;
- g) një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të apelojnë kundër vendimit në rrugë administrative ose gjyqësore;
- h) një kujtesë për afatet kohore që palët duhet t'i kenë parasysh për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ose të ankimit administrativ apo gjyqësor;
- i) datën kur akti hyn në fuqi;
- j) nënshkrimin e udhëheqësit të organit të administratës publike që nxjerr aktin ose të drejtuesit të organit kolektiv.

Akti administrativ - duhet të përmbajë arsyet e nxjerrjes së aktit, vetëm në ato raste kur shprehimisht parasheh ligji. Përveç rasteve kur ligji vet parasheh dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht:

- a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime;
- b) përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet;
- c) përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar;
- d) përbëjnë devijim nga praktika e ndjekur për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme;
- e) shkaktojnë revokimin, shfuqizimin, modifikimin ose pezullimin e një akti të mëparshëm.

Arsyetimi i aktit administrativ është pjesë e aktit shkresor me të cilin sqarohet akti administrativ. Arsyetimi përfshin shpjegimin e bazës ligjore dhe faktet e aktit administrativ. Domethënë në arsyetim duhet të shënohet qartë se përse është vendosur ashtu siç është shënuar në aktin administrativ. Arsyetimi duhet të formulohet qartë ngase arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit. Në rastet kur kemi të bëjmë me çështje analoge arsyetimet e bëra mund të përdoren në çështjet e mëparshme me kusht që të mos rëndohet pozita e palëve të interesuara.

Hyrja në fuqi e aktit administrativ - akti administrativ hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij, me përjashtim të rasteve kur ligji ose vet akti i jep fuqi prapaveprues ose të vonuar.

Fuqia prapavepruese e aktit administrativ - është si në rastet e mëposhtme:

- kur akti interpreton një akt të mëparshëm;
- kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili nga ana e tij ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;
- kur vet ligji i jep aktit fuqi prapavepruese.

Përveç këtyre rasteve të përmendura organi kompetent mund t'i jap fuqi prapavepruese aktit edhe në rastet:

- kur fuqia prapavepruese është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë;
- kur është fjala për një akt i cili shfuqizon një akt të mëparshëm se bashku me aktet e tjera;
- kur një gjë e tillë lejohet nga ligji.

Efekt i vonuar i aktit administrativ - akti administrativ ka efekt të vonuar në këto raste:

- kur hyrja në fuqi e aktit kushtëzohet nga miratimi apo kundërfirmimi;
- kur efektet e aktit bëhen të pamundura për shkak të ndonjë pezullimi apo afati;
- kur hyrja në fuqi e aktit varet nga vërtetimi i disa kushteve ose rrethanave.

Shpallja e akteve - bëhet atëherë kur aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh. Aktet administrative shpallen vetëm kur ligji e kërkon shprehimisht një gjë të tillë dhe se mos shpallja e aktit administrativ kur kjo kërkohet me ligj, shkakton mos hyrjen në fuqi të aktit administrativ. Në rastet kur shpallja e aktit administrativ është e detyrueshme, shpallja bëhet (Në Gazetën Zyrtare) brenda 30 ditësh nga miratimi i aktit.

Pavlefshmëria e aktit administrativ - shfaqet në dy forma:

- Akt absolutisht i pavlefshëm dhe
- Akt relativisht i pavlefshëm.

Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm - është në rastet:

- Kur akti është nxjerrë nga organi administrativ i paidentifikuar;
- Kur akti është nxjerrë nga organi administrativ jo kompetent;
- Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga ky ligj ose ndonjë ligj tjetër,
- Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga ky ligj ose ndonjë ligj tjetër.

Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike ngase në çdo kohë mund të shpallet nule, dhe anulohen edhe pasojat juridike që i ka prodhuar akti absolutisht i pavlefshëm prej momentit të nxjerrjes se tij. Të gjitha organet e administratës publike ose persona fizik dhe juridik të cilëve iu drejtohet akti administrativ absolutisht i pavlefshëm duhet ta injorojnë urdhrin e tij për të vepruar. Palët e interesuara mund t'i drejtohen në çdo kohë organit të administratës publike me kërkesë për shpalljen e një akti të caktuar si absolutisht të pavlefshëm. Organi administrativ që është kompetent për të vendosur në lidhje me kërkesën për rishqyrtim ose ankesën kundër aktit administrativ me iniciativën e vet ose të palës së interesuar, mund të shpall në çdo kohë një akt administrativ si absolutisht të pavlefshëm.

Akti administrativ relativisht i pavlefshëm - është akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin në rastet kur:

- Autorizon kryerjen e veprimeve ose njeh të drejta e privilegje të cilat nuk parashikohen me ligj;
- Ndalon kryerjen e veprimeve ose refuzon të drejta e privilegje të parashikuara me ligj;
- Nxirret në bazë të një akti të kundërligjshëm të një organi me të lartë;
- Nxirret nën ndikimin e kanosjes, dhunës ose paqëndrueshmërisë së përkohshme mendore.

Palët e interesuara mund të ushtrojnë kërkesë për rishqyrtim ose ankesë kundër aktit administrativ relativisht të pavlefshëm brenda afateve kohore të parapara me ligj. Gjithashtu organet kompetente të organizatës publike, me iniciativën e tyre mund të

revokojnë ose shfuqizojnë aktet administrative relativisht të pavlefshme brenda afateve kohore të parapara me ligj.

Pasojat e aktit administrativ relativisht të pavlefshme për sa kohë që nuk është revokuar ose shfuqizuar akti administrativ. Akti administrativ relativisht i pavlefshëm i cili në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim ose ankim, përkatësisht revokohet ose shfuqizohet pushon se prodhuari efekte juridike në të ardhmen. Pas revokimit apo shfuqizimit formal të aktit administrativ relativisht të pavlefshëm, organi i administratës publike kujdeset për kthimin e gjendjes që ekzistonte përpara nxjerrjes së aktit relativisht të pavlefshëm. Në qoftë se kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i mundur, organi i administratës merr në shqyrtim dhe zgjidh pretendimet e palëve të dëmtuara nga akti administrativ relativisht i pavlefshëm.

Konkluzioni - është akt administrativ me të cilin vendoset mbi çështjet që i përkasin procedurës. Me konkluzion vendoset edhe për ato çështje të cilat shfaqen si detyësore lidhur me zbatimin e procesit e që nuk vendosen me aktvendim. Konkluzionin e nxjerr personi zyrtar që e ushtron atë veprim të procesit gjatë të cilit është shfaqur çështja që është objekt i konkluzionit. Në qoftë se me këtë ligj ose me dispozita të tjera nuk është përcaktuar ndryshe. Në qoftë se me konkluzion urdhërohet zbatimi i ndonjë veprimi, do të caktohet edhe afati brenda të cilit ky veprim duhet të zbatohet. Konkluzioni palëve u komunikohet me gojë, gjersa me shkrim iu lëshohet me kërkesën e personave kur ata mund të bëjnë ankim të veçantë kundër konkluzionit, ose në rastet kur mund të kërkohet menjëherë ekzekutimi i konkluzionit. Kundër konkluzionit palët mund të ushtrojnë ankim të veçantë atëherë kur është paraparë shprehimisht me ligj. Konkluzioni i tillë duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë edhe udhëzimin apo këshillat juridike. Ankesa ushtrohet në të njëjtin afat, në të njëjtën mënyrë dhe i drejtohet organit të njëjtë sikurse ankimi kundër aktvendimit. Konkluzionet kundër të cilave nuk lejohet ankesa e veçantë, personat e interesuar mund t'i kundërshtojnë me ankim kundër aktvendimit, përveç në qoftë se ankimi kundër konkluzionit me ligj është përjashtuar. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e konkluzionit përveç në qoftë se me ligj ose me vet konkluzionin është caktuar ndryshe.

Revokimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ

Revokimi i aktit administrativ - organi administrativ që ka nxjerr aktin administrativ mund ta revokoj aktin. Akti administrativ revokohet në bazë të kërkesës së palës për rishqyrtimin e aktit. Pas dorëzimit të kërkesës së palëve të interesuara për rishqyrtimin e një akti administrativ organi i administratës publike vendos revokimin ose konfirmimin e aktit administrativ. Vendimi i organit të administratës publike, që shqyrtton kërkesën për rishqyrtim të aktit administrativ, konsiderohet akt administrativ dhe si i tillë duhet të jetë në pajtim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Kërkesa e palëve të interesuara për rishqyrtimin e një akti administrativ duhet të bëhet brenda afateve kohore të parashikuara nga ligji ose vet akti

administrativ. Kompetente për ta revokuar aktin administrativ është organi i administratës publike që e ka nxjerr atë.

Shfuqizimi i aktit administrativ - organi administrativ me iniciativën e tij mund ta shfuqizoj aktin administrativ ose nga pala e interesuar për ankim. Pala e interesuar me ankesë i drejtohet organit administrativ kundër aktit, organi kompetent i administratës publike vendos mbi ankesën lidhur me shfuqizimin ose lënien në fuqi të aktit administrativ të ankimuar. Vendimi i organit kompetent të administratës publike, që shqyrton ankimin e palëve kundër aktit administrativ, konsiderohet akt administrativ dhe si i tillë duhet të jetë në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Palët e interesuara mund të ushtrojnë ankimin kundër një akti administrativ por në afatet kohore të parashikuara me ligj ose vet aktin administrativ i ankimuar. Kompetenca për ta shfuqizuar aktin administrativ i përket organit me të lartë të administratës publike në raport me organin që e ka nxjerr aktin administrativ të ankimuar, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Afatet për revokimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ të vlefshëm - akti administrativ i vlefshëm mund të revokohet ose shfuqizohet në qoftë se ndryshimi i rrethanave ose i kuadrit ligjor nuk e justifikon më ekzistencën e aktit. Akti administrativ nuk mund të revokohet apo shfuqizohet në këto raste:

- Kur ligji në mënyrë të shprehur ndalon revokimin ose shfuqizimin e aktit;
- Kur akti krijon të drejta ligjore për personat fizik dhe juridik;
- Kur akti i jep administratës të drejta ose i ngarkon detyrime të tilla nga të cilat nuk mund të hiqet dorë.

Akti administrativ i vlefshëm me të cilin i njihet e drejta ligjore personit fizik apo juridik mund të revokohet ose shfuqizohet në rast se dëmtojnë interesat e palëve të cilave iu drejtohen, mirëpo edhe në situata kur të gjitha palët e interesuara dakordohen për revokimin ose shfuqizimin e aktit administrativ të vlefshëm me kusht që të drejtat e krijuara nga akti janë të tilla që prej tyre mund të hiqet dorë.

Revokimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ të pavlefshëm - akti administrativ i pavlefshëm mund të revokohet ose shfuqizohet vetëm për shkak të pavlefshmërisë dhe brenda afateve kohore të parashikuara për ankimin gjyqësor. Në rast se ekzistojnë më shumë se një afat ligjor për parashtrimin e ankimit gjyqësor zbatohet afati më i gjatë.

Hyrja në fuqi e revokimit dhe shfuqizimit të aktit administrativ - revokimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ ka fuqi vepruese vetëm për të ardhmen, me përjashtim të rasteve të parashikuara me këtë ligj. Revokimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ ka fuqi prapavepruese vetëm në ato raste kur akti administrativ revokohet ose shfuqizohet për shkak të pavlefshmërisë së tij absolute. Gjithashtu organi i administratës publike që e urdhëron revokimin ose shfuqizimin e një akti administrativ mund t'i jep fuqi prapavepruese aktit revokues apo shfuqizues në ato raste kur palët e interesuara

dakordohen me shkrim për këtë dhe me kusht që akti që kërkohet të revokohet apo shfuqizohet të ketë krijuar të drejta ose privilegje nga të cilat mund të hiqet dorë.

Korrigjimi i akteve administrative - nëse organi administrativ gjatë shprehjes së vullnetit ka bërë gabime materiale, nëse ato janë të dukshme mund të korrigjohen në çdo kohë nga organet që kanë të drejtën që ta bëjnë revokimin apo shfuqizimin e aktit administrativ. Korrigjimi i cili e ka fuqinë prapavepruese, mund të bëhet me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara. Korrigjimit i epet po i njëjti publicitet që i është bërë aktit të korrigjuar.

Njoftimi i aktit administrativ - organi administrativ gjatë procedurës ka për detyrim që të komunikoj me palët e interesuara për të gjitha veprimet e ndërmarra veçanërisht palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative me anë të cilave:

- Merren vendime lidhur me pretendimet e tyre;
- Caktohen detyrime dhe dënime ose shkaktohen dëme;
- Krijohen, marrin fund, zgjerohen ose kufizohen interesat legjitime ose të drejta të palëve, ose pengohen kushtet për gëzimin e tyre në ndonjë mënyrë tjetër.

Organet administrative përjashtohen nga detyrimi për t'i njoftuar palët lidhur me aktet administrative në këto raste:

- Kur aktet administrative komunikohen gojarisht në prani të palëve të interesuara;
- Kur palët e interesuara marrin pjesën gjatë zhvillimit të procedimit administrativ dhe manifestojnë njohje të plotë të akteve administrative në fjalë.

Njoftimi duhet të përmbajë këto informacione:

- Tekstin e plotë të aktit administrativ;
- Emrin e personit përgjegjës për aktin dhe datën;
- Emrin e organit që ka kompetencë për të vendosur lidhur me ankimet kundër aktit dhe afatet kohore përkatëse.

Afati kohor për njoftimin e palëve lidhur me aktin administrativ duhet të jetë brenda 8 ditëve, nga dita kur është nxjerr akti, me përjashtim të rasteve kur me ligj është parapa afat tjetër. Organi administrativ e bën njoftimin në këto mënyra:

- Me postë, me kusht që të ketë shërbim postar derë në derë në zonën, vendbanimin ose vendin e punës të palës që do të marr njoftimin;
- Personalisht, në rastet kur kjo mënyrë e njoftimit nuk komprometon shpejtësinë e procedurës në zhvillim ose kur njoftimi me postë është i pamundur;
- Me telegram, telefon, teleks, faks në rastet urgjente;
- Me njoftim publik, i cili shpallet në vende publike, ose me njoftim të publikuar në dy gazetatat me të shitura në zonën ose vendbanimin ose vendin e punës të

palës që do të njoftohet, në rastet kur palët e interesuara nuk njihen ose janë në një numër kaq të madh sa që çdo mënyrë tjetër njoftimi konsiderohet i papërshtatshëm.

- Në rastet e veçanta organi administrativ kur këtë e kërkon natyra e aktit thirret personi që të pranoj aktin personalisht.

Ekzekutimi i akteve administrative - ekzekutimi i akteve administrative është akti i fundit në procedurën administrative, ngase aktet administrative mund të ekzekutohen vetëm pasi të kenë marr formën e prerë. Me ekzekutimin e aktit administrativ nënkuptojmë procedurën sipas të cilës zbatohet ekzekutimi i vendimeve dhe përfundimeve të cilat janë bërë të ekzekutueshme, ose ujdive të lidhura në procedurën administrative. Pra organi kompetent i administratës publike ekzekuton aktin administrativ që e ka nxjerr, vetëm pasi akti të ketë hyrë në fuqi. Organi kompetent i administratës publike ekzekuton detyrimet e parashikuara në aktin administrativ që ka nxjerrë, vetëm nëse ligji shprehimisht ua beson atyre ekzekutimin e akteve.

Akte që nuk mund të ekzekutohen janë:

- Akti, veprimi i të cilit është pezulluar;
- Akti kundër të cilit është bërë ankim me efekt pezullues;
- Akti që hyn në fuqi vetëm pas miratimit të një organi tjetër administrativ, i ndryshëm nga organi që e ka nxjerr aktin administrativ.

Hyrja në fuqi e aktit administrativ mund të pezullohet nga organet administrative që kanë te drejtën e revokimit të tij, nga organet me të larta që kanë të drejtën e shfuqizimit ose nga gjykata në pajtim me rregullat e zbatueshme të procedurës civile.

Akti administrativ për të qenë i ekzekutueshëm nga ana e organit kompetent duhet t'i plotësoj këto kushte dhe garanci:

- Masat shtrënguese mund të ndërmerren vetëm pasi të jetë nxjerr akti, ekzekutimi i të cilit kërkohet;
- Personave fizik dhe juridik kundër të cilëve pritet të ekzekutohet akti administrativ iu jepet mundësia që ta zbatojnë vullnetarisht aktin brenda afateve kohore të parashikuara me ligj, ose vet akti që duhet të ekzekutohet. Në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, ashtu siç përcaktohet kjo e fundit me ligj, organet e administratës publike mund ta anashkalojnë detyrimin e sipër përmendur për t'ju dhënë personave fizik dhe juridik një afat të arsyeshëm për zbatimin e aktit administrativ.
- Masat shtrënguese të përdorura nga organet e administratës publike duhet të jenë të tilla që të bëjnë të mundur ekzekutimin e aktit administrativ duke iu shkaktuar dëmin me të vogël të mundshëm të drejtave dhe interesave ligjore të personave fizik dhe juridik.

Palët e interesuara mund të ushtrojnë ankesë kundër ekzekutimit të aktit administrativ tek organi administrativ me i lartë ose në gjykatë në ato raste kur masat e ndërmarra nga administrata gjatë ekzekutimit janë të paligjshme dhe disproporcionale, me kushtin që paligjshmëria e masave në fjalë të mos jetë pasojë e paligjshmërisë së aktit që ekzekutohet. Organi administrativ do të paralajmëroj personat fizik dhe juridik me rast të përdorimit të masave shtrënguese kundër të cilëve do të ekzekutohet akti administrativ. Organi administrativ mund të njoftoj masat shtrënguese së bashku me njoftimin e aktit administrativ dhe në këtë rast ekzekutimi bëhet menjëherë ose veçmas në një njoftim të posaçëm.

Akti administrativ me LPPA është parashikuar me (nenin 44) ku prcaktohet se:

1. Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe:
 - 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (akti administrative individual gjegjësisht kolektiv) apo
 - 1.2. i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme: (“akti administrativ i përgjithshëm”), apo
 - 1.3. përcakton statusin sipas të së drejtës administrative të një objekti (sendi) apo të përdorimit të tij nga publiku (“akti administrativ in rem”).

Akti administrativ me kusht, afat apo detyrime është parashikuar me (nenin 45)

1. Akti administrativ që miraton një të drejtë apo dobi (akt administrativ dobiprurës), mund të jetë objekt i një afati kohor, kushti ose të shoqërohet me një detyrim plotësues vetëm nëse parashikohet shprehimisht me ligj, apo nëse është e nevojshme të sigurojë plotësimin e kërkesave thelbësore ligjore për miratimin e aktit të kërkuar.
2. Në aktin administrativ me afat, e drejta ose përfitimi i dhënë nga akti, fillon apo mbaron në një datë të caktuar apo përkatësisht do të zgjasë për një periudhë të caktuar kohore.
3. Në aktin administrativ me kusht, e drejta ose përfitimi i dhënë nga akti fillon apo mbaron me ndodhjen e një ngjarjeje të ardhme dhe të pasigurt.
4. Në aktin administrativ me detyrim plotësues, pala është e detyruar që të kryejë, të pushojë apo të lejojë kryerjen e një veprimi të caktuar.

Forma e aktit administrativ përcaktohet me (nenin 46)

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ nxirret në formë të shkruar, verbale apo edhe çdo formë tjetër të përshtatshme, përfshirë shenja apo mjete të tjera teknike.
2. Forma e shkruar përmbushet edhe nga një dokument elektronik në pajtim me ligjin e posaçëm që rregullon dokumentin elektronik.
3. Me kërkesë, organi publik konfirmon pa vonesë, në formë të shkruar, përmbajtjen e aktit verbal apo aktit të miratuar në heshtje të përcaktuar në nenin 70 të këtij Ligji, pa i paragjykuar rregullat mbi pasojat juridike të akteve administrative. Paragrafi 2 i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.
4. Konfirmimi sipas paragrafit 3 të nenit 46, megjithëse nuk është akt administrativ i ri, duhet të jetë në pajtim me nenin 47 të këtij Ligji.

Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar është parashikuar me (nenin 47)

1. Akti administrativ i shkruar përmban:
 - 1.1. Pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;
 - 1.2. Pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.
 - 1.3. Pjesën arsyetuese.
 - 1.4. Pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin e mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht të kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjal. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruan një nga anëtarët e organit kolegjal.

3. Kërkesa e nënshkrimit, në rastin e një dokumenti elektronik, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm. Nënshkrimi elektronik duhet të bazohet në një certifikatë të kualifikuar, në të cilën shprehet identiteti i organit publik përkatës.
4. Qeveria e Republikës të Kosovës, me vendim të posaçëm, mund të përcaktojë një mënyrë tjetër të sigurt, që garanton autenticitetin dhe integritetin e dokumentit elektronik të dërguar dhe veçantitë e tij. Një dokument elektronik i garantuar në pajtim me një vendim të tillë të Qeverisë, do të vlerësohet, gjithashtu, si i nënshkruar.

Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim është e përcaktuar me (nenin 48)

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ.

Arsyetimi përmban:

- 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;
 - 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;
 - 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;
 - 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;
 - 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;
 - 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.
2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Panevojshmëria e arsyetimit parashihet me (nenin 49)

1. Arsyetimi i aktit të shkruar nuk është i nevojshëm kur:
 - 1.1. përjashtohet shprehimisht me ligj;
 - 1.2. akti administrativ i nxjerrë, sipas kërkesës, miraton në tërësi kërkesën e palës kërkuese dhe nuk i cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale të tjetër, ose
 - 1.3. akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale.
2. Në rastet e parashikuara në nënparagrafin 1.2 dhe 1.3 të nenit 49i, akti mund të përbëhet edhe vetëm nga dispozitivi në formën e shënimit të shkruar mbi kërkesën përkatëse.

Korrigjimi i gabimeve të dukshme në një akt administrative është rregulluar me (nenin 50)

1. Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ.
2. Organi publik, ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet si dhe të çdo kopjeje të njëjtësuar të tij.

Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të një akti administrative parashihen me (nenin 51)

1. Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij.
2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të prodhojë pasojat juridike, në ditën e skadimit të afatit për njoftimin e tij, siç është paraparë me nenin 98 dhe 99 të këtij Ligji.
3. Një akt administrativ mund të fillojë të prodhojë pasojat juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë mënyrë përpara njoftimit të palës në pajtim me paragrafin 1 të nenit 51. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave do të përfshihet shprehimisht në pjesën urdhëruese të aktit administrativ të shkruar.
4. Një akt administrativ do të prodhojë pasoja juridike për aq kohë sa nuk është anuluar apo shfuqizuar sipas detyrës zyrtare apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve juridike administrative apo gjyqësore, nuk skadon për arsye të kohës apo përmbushjes së qëllimit të tij, apo nuk pushon së prodhuari të pasojave, për çfarëdo arsye tjetër të paraparë me ligj.

Paligjshmëria e aktit administrative me (nenin 52)

1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:
 - 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji;
 - 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;
 - 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
 - 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
 - 1.5. është në kundërshtim me ligjin material;
 - 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo
 - 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.

Procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit të aktit administrative janë paraparë në (nenin 53)

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj.
2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.
3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

Anulimi i detyrueshëm i një akti administrativ të paligjshëm përcaktohet me (nenin 54)

1. Një akt administrativ i paligjshëm duhet të anulohet, nëse:
 - 1.1. është nxjerrë nën shtrëngim, zhvatje, shantazh, mashtrim, kanosje, ryshfet apo nën ndikimin e një veprë tjetër penale;
 - 1.2. objekti i tij është ligjërisht apo materialisht i pamundur, apo
 - 1.3. zbatimi i aktit do të përbënte vepër penale.

Anulimi apo shfuqizimi diskrecionar i një akti administrativ të paligjshëm më saktësisht parashihet në (nenin 55)

1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë.
2. Një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nëse pala përfituese është në mirëbesim, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.
3. Pala përfituese nuk do të vlerësohet në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit, ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë, të dhënë nga vetë pala.

Anulimi i një akti administrativ të ligjshëm është përcaktuar me (nenin 56)

1. Një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet, vetëm nëse:

- 1.1. anulimi është i dobiprurës për të gjitha palët apo anulimin është i pjesshëm dhe prek vetëm atë pjesë të aktit që nuk është dobiprurës për palën, apo
- 1.2. pala në një akt administrativ që i nënshtrohet një detyrimi, siç është paraparë në paragrafin 4 të nenit 45 të këtij Ligji, nuk e ka plotësuar tërësisht detyrimin plotësues apo nuk e ka bërë këtë brenda afatit të caktuar kohor.

Shfuqizimi i një akti administrativ të ligjshëm parashihet me (nenin 57)

1. Një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, pa rënë kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni.
2. Përpos nëse parashihet ndryshe me ligj, një akt administrativ dobiprurës i ligjshëm, mund të shfuqizohet vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, dhe kjo nuk do të mund të bëhet në mënyra tjera që do të cenonin më pak të drejtat apo interesat juridike të fituara të palës.
3. Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, do të ketë të drejtën e kompensimit monetar nëse ka hyrë në marrëdhënie juridiko-civile nga të cilat nuk mund tërhiqet më, apo nga të cilat mund tërhiqet vetëm duke pësuar dëme, që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo.
4. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala sikur akti i shfuqizuar të vazhdonte të prodhojë pasoja juridike. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar.

Afati për anulimin dhe shfuqizimin e një akti administrative përcaktohet me (nenin 58)

1. Anulimi si dhe shfuqizimi në rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, mund të bëhet në çdo kohë.
2. Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ.

Kthimi në rast të anulimit përcaktohet me (nenin 59)

1. Të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/apo nga organi publik në bazë të një akti të anuluar, do të kthehen.

2. Masa konkrete e kthimit të pagesave dhe kontributeve, paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, do të përcaktohet në aktin e anulimit dhe llogaritet nga organi publik, sipas dispozitave për pasurimin e pabazë sipas legjislacionit civil.

Kontratat Administrative

Si institut i ri në të drejtën administrative në Kosovë, është paraparë edhe Kontrata Administrative e cila është aplikuar në praktikën e punës së organeve administrative dhe është zhvilluar procedura deri në përfundimin e sajë, mirëpo deri me këtë ligj është është rregulluar me dispozita dhe akte tjera nën ligjore, e cila është është shumë me rëndësi në punën e organeve publike por edhe në interes të palëve dhe qytetarëve, andaj për rëndësin që ka Kontrata administrative dhe lejimi i saj është parashikuar me **(Nenin 60) të LPPA-së**, ku në nenet në vazhdim sqarohet e gjithë procedura lidhur me të njëjtat:

1. Një kontratë administrative quhet ajo marrëveshje në të cilën të paktën njëra prej palëve është organ publik dhe e cila themelon, ndryshon apo shuan një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative.
2. Organi publik, për realizmin e një interesi publik të cilit i shërben, mund të lidhë një kontratë administrative vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj, por pa cenuar të drejtat apo interesat juridike të palëve të treta.

Forma e kontratës administrative parashikohet me (neni 61)

1. Kontrata administrative lidhet në formë të shkruar, përveç rasteve kur me ligj parashihet një formë tjetër e posaçme.
2. Kontrata nënshkruhet nga palët apo përfaqësuesit e tyre. Kërkesa e nënshkrimit, në rastin e dokumenteve elektronike, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm. Nënshkrimi elektronik në emër të organit publik, duhet të bazohet mbi një certifikatë të kualifikuar, në të cilën shprehet identiteti i organit publik.

Kontrata administrative që zëvendëson aktin administrativ (kontrata zëvendësuese) me (nenin 62)

1. Një organ publik mund të lidhë një kontratë administrative me një palë, të cilës përndryshe do t'ia drejtonte aktin administrativ, nëse interesi publik që synohet nga organi publik mund të përmbushet më mirë përmes një kontrate të tillë.

2. Në kontratën zëvendësuese, pala jo organ publik detyrohet të kryejë a të mos kryejë një veprim apo të japë diçka (në vijim: prestacioni) kundrejt kryerjes së një veprimi nga organi publik.
3. Prestacioni i palës detyrohet kundrejt një qëllimi të caktuar, të përcaktuar në kontratë, që i shërben organit publik për përmbushjen e autoritetit publik dhe duhet të jetë materialisht e lidhur me veprimin që detyrohet organi publik dhe në proporcion me të.
4. Arsyetimi se interesi publik mund të përmbushet më mirë përmes kontratës, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshihet në hyrje të tekstit të kontratës.

Kontrata administrative e kompromisit është parashikuar me (nenin 63)

1. Një organ publik, mund të lidhë një kontratë kompromisi me personin të cilit do t'i drejtohej një akt administrativ, me qëllim të eliminimit të pasigurive në përmbajtjen e një akti administrativ, duke u dakorduar të dyja palët, nëse pas vlerësimit të duhur rezultojnë situata faktike apo ligjore nuk është e sigurtë dhe qartësi nuk është objektivisht i mundur.
2. Kontrata e kompromisit përcakton përmbajtjen e aktit administrativ përfundimtar dhe me lidhjen e saj, organi publik nxjerr një akt administrativ, përmbajtja e të cilit përputhet me atë të kontratës të lidhur. Akti administrativ, në pjesën hyrëse, duhet të përmendë kontratën e kompromisit, në bazë të së cilës është nxjerrë ky akt.

Kontrata administrative ndërmjet organeve publikepërcaktohet me (nenin 64)

Organet publike mund të lidhin ndërmjet tyre kontrata administrative për të rregulluar marrëdhëniet e tyre, për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët.

Pavlefshmëria e kontratës administrative përcaktohet me (nenin 65)

1. Një kontratë administrative nuk është e vlefshme për një nga këto shkaqe:
 - 1.1. nuk është e parashikuar me ligj, sipas nenit 60 të këtij Ligji;
 - 1.2. nuk është respektuar forma e kërkuar me ligj, në përputhje me dispozitat e nenit 61 të këtij Ligji;
 - 1.3. nuk janë respektuar kushtet për lidhjen kontratës zëvendësuese apo të kompromisit, siç është paraparë me nenin 62 gjegjësisht 63 të këtij Ligji;
 - 1.4. një akt administrativ me përmbajtje të barasvlershme do të ishte i paligjshëm në pajtim me këtë Ligj.

2. Nëse vetëm një pjesë e kontratës është e pavlefshme, ajo do të jetë tërësisht e pavlefshme, përpos nëse mund të supozohet se do të ishte lidhur edhe pa pjesën që është e pavlefshme.

Ndryshimi dhe prishja e kontratës administrative përcaktohet me (nenin 66)

1. Nëse për shkak të rrethanave që krijohen pas lidhjes së kontratës administrative, që nuk kanë mundur të parashikohen në kohën e lidhjes dhe në praninë e të cilave përmbushja e detyrimeve që burojnë nga kontrata bëhet jashtëzakonisht e vështirë për ndonjërin prej palëve kontraktuese, palët kontraktuese mund të pajtohen për ndryshimin apo prishjen e saj.
2. Një organ publik, mund të shkëputë njëanshëm një kontratë administrative, të ndryshme nga kontrata e kompromisit, vetëm nëse është e domosdoshme për të shmangur apo eliminuar një dëmtimin të rëndë të interesit publik. Në këtë rast, pala jo organ publik gëzon të drejtën e kompensimit për dëmet e pësuar.
3. Nëse ndryshimi i rrethanave e bën zbatimin e një kontrate të mëhershme të kompromisit të papërshtatshme në raport me interesin publik, apo në rast se një ndryshim pasues ligjor e bën atë të paligjshme, organi publik gëzon të drejtën që të shkëputë njëanshëm kontratën, pa pasur detyrim që të kompensojë palën, përveçse nëse një ndryshim i tillë i rrethanave vjen për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të vet organit publik, apo përveçse nëse shkëputja e kontratës nuk justifikohet nga ndonjë arsye e interesit publik.
4. Shkëputja e njëanshme, siç është paraparë me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, do të bëhet me një akt administrativ. Akti administrativ për shkëputjen e njëanshme duhet të jetë me shkrim dhe i arsyetuar sipas këtij Ligji.

Zbatueshmëria e dispozitave tjera ligjore parashihet me (nenin 67)

Për aq sa nenet 60, 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66 të këtij Ligji nuk e parashohin ndryshe, dispozitat e tjera të këtij Ligji për aktin administrativ si edhe dispozitat e ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, do të zbatohen përshtatshëmrisht, edhe për interpretimin, vlefshmërinë si dhe zbatimin e kontratës administrative.

Mosmarrëveshjet rregullohen me (nenin 68)

1. Ndaj aktit administrativ për shkëputjen e njëanshme të kontratës, sipas paragrafit 4 të nenit 66 të këtij Ligji, pala jo-organ publik mund të parashtrijë ankesë në pajtim me këtë Ligj.

2. Çdo mosmarrëveshje tjetër në mes të palëve kontraktuese, që buron nga një kontratë administrative, do të zgjidhet drejtpërdrejt nga gjykata kompetente për konfliktet administrative.

Akti real është parashikuar me (neni 69)

1. Akt real është çdo veprim i organit publik në fushëveprimin e së drejtës administrative, që nuk është akt administrativ apo kontratë administrative, dhe që mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi (siç janë informacionet publike, deklaratat, mbajtja e evidencave, lëshimi i certifikatave, veprimet e ekzekutimit dhe veprimet e tjera faktike).
2. Një akt real është i ligjshëm nëse është kryer nga organi kompetent, në pajtim me parimet dhe dispozitat e këtij Ligji, të cilat zbatohen përshtatshmërisht për aktet reale.

Mjetet Juridike në Procedurën Administrative

Mjetet juridike në procedure administrative, janë të një rëndësie shumë të madhe në gjithë procesin e zhvillimit të procedurës administrative në një çështje të caktuar, ngase janë mjeti kryesor i palëve në rastet kur nuk janë të knaqura ose kur pretendojnë se me një vendim të një organi public nuk janë dhënë të drejtat të cilat ju takojnë ose gabimisht i janë mohuar të njejtat.

Si mjete juridike në procedure administrative të rregullta sipas LPPA-së janë:

- ankesa,
- kundërshtimi administrative.

Ndërsa si mjet administrative përjashtimor është paraparë edhe

- rihapja e procedurës.

Pas shterimit të mjeteve të rregullta në procedure administrative pala ka të drejtë të paraqet padi në gjykatë, si dhe pa qenë nevoja të shterimit të mjeteve të rregullta administrative në këto raste:

1. Nëse nuk ekziston organi epror.
2. Palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interes juridike nga akti administrative që zgjidh ankesën apo
3. Nëse parashikohet shprehimisht me ligj.

Ankesa - është mjet i rregullt juridik e cila mund të paraqitet parimisht kundër çdo vendimi të nxjerrë në shkallë të parë në procedurën administrative. Ankesën mund ta paraqet pala kur konsideron, se me vendimin e organit të shkallës së parë, është shkelur ligji në dëm të tij. Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ në përputhje me rregullat e vendosura nga Ligji për Procedurën Administrative për ankim administrativ. Kjo e drejtë mund të ushtrohet nga pala e pakënaqur në këto dy mënyra:

- Kërkesës për rishqyrtim drejtuar nëpunësit përgjegjës për aktin;
- Përmes ankimit drejtuar organit me të lartë.

Ankimi administrativ - që një person mund të paraqet ankesë është e nevojshme që me vendimin e shkallës së parë të jetë prekur interesi i tij juridik në procedurën administrative. Ky interes juridik duhet të jetë konkret i drejtpërdrejtë dhe personal. Ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës. Çdo palë e pakënaqur me vendimin e organit administrativ ka të drejtë të ankohet kundër këtij akti. Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi e shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të ankimuar. Ankimi administrativ, qoftë në formën e kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës, pezullon ekzekutimin e aktit administrativ përveç se në këto raste:

- Akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve ose të ardhurave të tjera buxhetore;
- Akti administrativ ka të bëjë me masa policore;
- Pezullimi i zbatimit të aktit ndalohet me ligj;
- Zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe interesave të tjera publike.

Pala e interesuar kur ushtron kërkesë për rishqyrtim të aktit administrativ, ai këtë e dorëzon tek organi që ka nxjerr aktin administrativ të kontestuar ose që ka refuzuar të nxjerr aktin administrativ të kërkuar nga palët. Kur pala ushtron ankim administrativ në formë të ankesës, ai këtë e dorëzon tek organi me të lartë. Në rastet kur ankimi bëhet në formën e ankesës dhe për pasojë i drejtohet organit me të lartë, ky i fundit mund t'ia transferoj dosjen përkatëse organi që ka nxjerr ose që ka refuzuar të nxjerr aktin se bashku me orientimet e tij për zgjidhjen e çështjes.

Kushtet formale për zhvillimin e procedurës së ankimit - ankesa duhet të plotësoj kushtet e caktuara formale të parapara e Ligjin për Procedurën Administrative dhe fillimisht duhet të jetë paraqitur në formën e shkruar dhe se ankesa e shkruar duhet të përmbaj:

- Emrin dhe adresën e ankuesit;
- Aktin administrativ të nxjerrë apo të munguar që kontestohet;
- Shkaqet e ankimit;
- Çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga ankuesi.

Pala që ushtron ankesën duhet të theksoj përse është i pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, si dhe cilat janë shkaqet që ankuesi e konteston aktin administrativ të ankimuar. Në ankesë mund të paraqiten fakte dhe prova të reja, por ankuesi ka për obligim ta arsyetoj shkakun pse ato prova nuk i ka paraqitur gjatë zhvillimit të procedurës në shkallën e parë.

Mospranimi i ankimit - bëhet në ato raste kur ankimet kanë të bëjnë me akte për të cilat nuk lejohet ankimi, kur afatet kohore për ankim kanë kaluar (kur ankesa është e pasafatshme), kur akti administrativ i ankimuar konsiderohet i ligjshëm dhe i rregullt nga organi që e shqyrton ankimin dhe kur ankimi paraqitet nga personi a paautorizuar. Në rastet kur organi administrativ shqyrton ankimin konstaton se shfuqizimi, revokimi ose ndryshimi i aktit administrativ që apelohej, cenon në çfarëdo mënyre të drejtat dhe interesat ligjore të personit të tretë, ky i fundit njoftohet për të marr pjesë në shqyrtimin e ankimit dhe ka të drejtë të parashtrij pretendimet e tij. Organi administrativ mund të bie vendim me rastin e shqyrtimit të ankesës dhe ato janë:

- Lënien në fuqi të aktit dhe rrëzimin e ankimit;
- Shfuqizimin apo revokimin e aktit dhe pranimin e ankimit;
- Ndryshimin e aktit administrativ duke pranuar pjesërisht ankimin;
- Detyrimin e organit administrativ kompetent për të nxjerrë aktin administrativ kur është refuzuar pa të drejtë nxjerrja e aktit.

Kundërshtimi - ky mjet juridik i paraqitet organit kompetent që ka nxjerrë aktin administrativ ose që ka refuzuar të nxjerrë aktin të cilin palët e kanë kërkuar. Kërkesën e shqyrton personi zyrtar përgjegjës për aktin i cili do të nxjerrë vendim kur e pranon si të bazuar kërkesën. Nëse kërkesa e palës së pakënaqur do të refuzohet të shqyrtohet atëherë ajo kërkesë trajtohet si ankesë dhe në atë formë menjëherë i dërgohet organit me të lartë kompetent të shkallës së dytë, i cili në afatin prej 15 ditëve ka detyrim të nxjerrë vendim lidhur me ankesën (kërkesën për rishqyrtim).

Rihapja e procedurës - si mjet juridik mund të kërkohet nga ana e palës në rastet kur afati për parashtrimin e ankesës ndaj aktit ka kaluar, mirëpo nëse pas kalimit të afatit për ankesë është njohur me ndonjë shkak si:

1. Situata faktike apo ligjore mbi të cilin bazohej lëshimi i aktit administrativ të kundërshtuar, ka ndryshuar në të mirë të palës.
2. Janë zbuluar prova të reja, të cilat, po të kishin qenë të ditura në kohën e vendimmarrjes, mund të kishin ndikuar në lëshimin e aktit të administrativ të kundërshtuar.
3. Pas lëshimit të aktit, ka ndryshuar praktika administrative për çështjet e njëjta administrative.

Me Neni 124 të LPPA-së, janë paraparë **Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative**, ku përcaktohet se:

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë.
2. Përveç nëse caktohet ndryshe me ligj, mjetet juridike administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.
3. Mjetet juridike administrative, të rregullta, janë:
 - 3.1. ankesa;
 - 3.2. kundërshtimi administrativ.
4. Mjet juridik administrativ përjashtimor është rihapja e procedurës administrative.
5. Pala mund t'i ushtrojë vetëm një herë mjetet juridike administrative të rregullta për të njëjtën çështje.
6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në keto raste:
 - 6.1. nuk ekziston organi epror;
 - 6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo
 - 6.3. parashikohet shprehimisht me ligj.

Rregullat e përgjithshme dhe kushtet e pranueshmërisë së ankesës

Ankesa sipas LPPA-së, është paraparë me **(neni 125)**, ku përcaktohet se:

1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrahet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”).
2. Një veprim procedural i një organi publik gjatë procedurës administrative, mund të ankimohet ndaras, vetëm kur kjo parashihet shprehimisht me ligj.

3. Një veprim procedural, i paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, do të jetë cilido akt, veprim apo mosveprim i organit publik gjatë procedurës administrative, që nuk është një akt administrativ përfundimtar apo akti administrativ i përfundimit të procedurës administrative, siç është paraparë me nenin 97 të këtij Ligji.

Përmbajtja dhe forma e ankesës është paraparë me (nenin 126)

1. Ankesa duhet të përcaktojë aktin apo heshtjen administrative që ankimohet, shkaqet dhe arsyen pse ankimohet dhe organin publik kompetent për aktin. 2
2. Çdo kërkesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, në qoftë se qëllimi i palës për të kundërshtuar një akt apo heshtjen administrative është mjaftueshëmërisht i qartë.
3. Neni 73 i këtij Ligji do të jetë i zbatueshëm, përshtatshëmërisht edhe për formën dhe përmbajtjen e ankesës.

Afati kohor për parashtrimin e ankesës është përcaktuar me (nenin 127)

1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.
2. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga nxjerrja e aktit.
3. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj.
4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrative.

Adresimi i ankesës, është paraparë me (nenin 128)

1. Nëse nuk parashkohet ndryshe me ligj, një ankesë kundër një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik që ka nxjerrë apo ka kompetencë të nxjerrë aktin (në tekstin në vijim: organi kompetent), apo organit publik mbikëqyrës të organit kompetent, apo një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj (në vijim të dy këta të fundit: “organi epror”). Nëse ankesa i është drejtuar organit epror, ai ia përcjell, pa vonesë, organit kompetent.

2. Ankesa ndaj heshtjes administrative mund t'i drejtohet drejtpërdrejt organit epror. Nëse ankesa i është drejtuar organit kompetent, ai ia përcjell, pa vonesë, organit epror, së bashku me dosjen e çështjes dhe një raport të shkruar për arsyet e heshtjes.

Kushtet për pranueshmërinë e ankesës parashihen me (nenin 129)

1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte:
 - 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji;
 - 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji;
 - 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe
 - 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.

Efektet e parashtrimit të ankesës parashihen me (nenin 130)

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.
2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjta, ankesa e paraqitur nga njëra nga palët, pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit ndaj të gjitha palëve të përfshira.
3. Organi publik, i cili shqyrton ankesën, mund të vendosë me akt administrativ, ndalimin e efektit pezullues të tij, nëse vonesa në ekzekutimin e tij mund t'i shkaktojë një dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm interesit publik apo një pale të tretë. Akti për heqjen e efektit pezullues, përveç elementeve të parapara nga neni 47 i këtij Ligji, do të përfshijë arsyetimin e ekzistencës së kushteve të parashikuara nga ky paragraf.
4. Pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në gjykatën kompetente për konfliktet administrative, brenda pesë (5) ditëve nga njoftimi i tij.
5. Gjykata merr vendim brenda pesë (5) ditëve dhe vendosë prishjen e vendimit për shkak të mosekzistencës së kushteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, apo për shkak të disproporcionalitetit të ndalimit të efektit pezullues.

Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik parashihet me (nenin 131)

1. Ankesa kundër një akti administrativ do të shqyrtohet, në radhë të parë nga organi kompetent publik.

2. Organi kompetent publik fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ. Nëse është e nevojshme, organi kompetent publik mund të kryejë shqyrtime (hetime) administrative shtesë.
3. Nëse anulimi apo ndryshimi i aktit administrativ të ankimuar apo nxjerrja e aktit të refuzuar do t'i shkaktonte dëm një pale tjetër, organi kompetent duhet t'i japë asaj mundësinë për t'u dëgjuar, në pajtim me nenin 95 të këtij Ligji, përpara marrjes së vendimit për ankesën e paraqitur.
4. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulojë apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala.
5. Kur organi kompetent vlerëson se ankesa nuk është plotësisht e pranueshme dhe e bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, do të përcjellë ankesën te organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse dhe një raport me shkrim të qendrimit të saj.

Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror përcaktohet me (nenin 132)

1. Në rastin e paraparë nga paragrafi 5 i nenit 131 të këtij Ligji, organi epror do të shqyrtojë ankesën dhe, nëse është e nevojshme, do të zhvillojë shqyrtime shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to. Paragrafi 2 dhe 3 i nenit 131 të këtij Ligji zbatohen edhe në këtë rast.
2. Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë.
3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar.
4. Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.

5. Nëse është e nevojshme, organi epror mund të urdhërojë organin kompetent që të formulojë aktin që do të nxirret nga organi epror, bazuar në udhëzimet e këtij të fundit.
6. Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj.

Ankesa kundër heshtjes administrative parashihet (nenin 133)

1. Ankesa kundër heshtjes administrative shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë të gjithë lëndën e rastit dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative.
2. Organi epror fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë kërkesën e palës, siç i është parashtruar organit kompetent.
3. Organi epror do të vendosë mbi kërkesën në bazë të lëndës së rastit, apo nëse është e nevojshme do të zhvillojë shqyrtime administrative shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime administrative të tilla dhe ta njoftojë për rezultatet e shqyrtimit.
4. Përpos kur është e paraparë ndryshe me ligj, organi epror do të zgjidhë çështjen me një akt të vetin përfundimtar. Paragrafi 5 i nenit 131 të këtij ligji do zbatohet edhe në këtë rast.

Afati për njoftimin e aktit që zgjidh ankesën është paraparë me (nenin 135)

1. Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës.
2. Afati i paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shtyhet kur nevojiten shqyrtime administrative shtesë. Neni 99 i këtij Ligji do të zbatohet përshtatshmërisht gjithashtu për shtyrjen e afatit të paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni.
 - Neni 100 i këtij Ligji nuk zbatohet në rastin e ankesës administrative.

Kundërshtimi administrativ është i rregulluar me Nenin 136, ku flitet për Objektin e kundërshtimit administrative, ku përcaktohet se:

1. Kundërshtimi parashtrohet kundër një akti real apo kundër moskryerjes të një akti real të kërkuar nga pala. Pala, në kundërshtimin administrativ, mund të kërkojë:
 - 1.1. ndërprerjen e zbatimit të një akti real;
 - 1.2. tërheqjen dhe korrigjimin e një deklarate publike;
 - 1.3. deklarimin e paligjshmërisë së një akti real dhe eliminimin e pasojave të tij;
 - 1.4. kryerjen e një akti real, të cilin pala ka të drejtë dhe për të cilin ka aplikuar pa sukses.
2. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, kundërshtimi administrativ i një anëtari të organit kolegjial, sipas paragrafit 1 të nenit 124 të këtij Ligji, ka për qëllim deklarimin e paligjshmërisë së veprimit apo mosveprimit procedural dhe mund të shtrihet edhe në kërkimin e një ndalimi për të përsëritur në të ardhmen të njëjtin veprim apo mosveprim, nëse ekziston një rrezik i tillë. Parashtrimi i kundërshtimit, sipas këtij paragrafi, nuk pezullon procedurën administrative gjatë të cilës ka ndodhur veprimi apo mosveprimi i kundërshtuar, si dhe nuk ndikon në ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë nga organi kolegjial, si rezultat i kësaj procedure administrative.
3. Një palë në kundërshtimin administrativ në lidhje me një shërbim publik të interesit të përgjithshëm, mund të kërkojë që organi publik rregullator të ushtrojë autoritetin e vet mbikëqyrës mbi ofruesin e shërbimit publik, në mënyrë që të sigurohet që pala ankuese do të përfitojë shërbimin në të cilin ka të drejtë dhe se ofruesi i shërbimit do të plotësojë detyrimet në pajtim me paragrafin 1 të nenit 70 të këtij Ligji.
4. Kundërshtimi administrativ në rastin e një shërbimi publik të interesit të përgjithshëm lejohet vetëm kur, sipas të drejtës administrative, për çështjen e kontestuar nuk ekzistojnë mjetet e tjera juridike kundër ofruesit të shërbimit publik.

Forma, parashtrimi dhe afati për kundërshtimin administrativë, janë të parapara me (nenin 137), ku përcaktohet se:

1. Dispozitat e këtij Ligji mbi formën dhe përmbajtjen e ankesës do të zbatohen, përshatshmërisht, edhe për kundërshtimin administrativ.
2. Kundërshtimi administrativ do t'i adresohet organit kompetent publik, në rast të një akti real, gjegjësisht organit rregullator, në rastin e një kundërshtimi në lidhje me një shërbim publik të interesit të përgjithshëm.
3. Kundërshtimi mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur pala është njohur me aktin real të kundërshtuar, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj

nga kryerja e tij, gjegjësisht brenda dy (2) muajve nga parashtrimi i kërkesës për kryerjen e një akti real, në rast të mosveprimit nga organi publik.

Procedura e shqyrtimit të kundërshtimit administrativ në rastin e akteve reale, është paraparë me **(nenin 138)**, ku përcaktohet se:

1. Kundërshtimi ndaj një akti real apo moskryerjes të një akti real të kërkuar, do të shqyrtohet nga një njësi organizative e veçantë, apo një trup kolegjal i organit publik kompetent. Nëpunësi përgjegjës për kryerjen apo moskryerjen e aktin real, nuk do të marr pjesë në procedurën e shqyrtimit.
2. Njësia apo trupa kolegjiale do të vendosë me një akt administrativ që do të nxirret dhe njoftohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga parashtrimi i kundërshtimit. Paragrafi 2 i nenit 135 të këtij Ligji, zbatohet edhe në këtë rast.
3. Në rast se kundërshtimi zgjidhet në dobi të palës, organi publik kompetent duhet të zbatoj pa vonesë aktin administrativ të lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Rihapja e procedurës - është e rregulluar me **(nenin 140)** të ligjit, ku përcaktohet se:

1. Për të kundërshtuar një akt administrativ, afati për parashtrimin e ankesës ndaj të cilit ka kaluar, pala mund të kërkojë rihapjen e procedurës administrative, nëse pas kalimit të afatit për ankesën është njohur me ekzistencën e njërit prej këtyre shkaqeve:
 - 1.1. situata faktike apo ligjore mbi të cilin bazohet lëshimi i aktit administrativ të kundërshtuar, ka ndryshuar në të mirë të palës;
 - 1.2. janë zbuluar prova të reja, të cilat, po të kishin qenë të ditura në kohën e vendimmarrjes, mund të kishin ndikuar në lëshimin e aktit të administrativ të kundërshtuar;
 - 1.3. pas lëshimit të aktit, ka ndryshuar praktika administrative për çështje të njëjta apo të ngjashme administrative.
2. Pala nuk ka të drejtë të kërkojë rihapjen e procedurës administrative, nëse mosnjohja e shkaqeve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni i detyrohet neglizhencës të saj.

Afati dhe kërkesa për rihapjen e procedurës - janë rregulluar me **(nenin 141)** ku përcaktohet se:

1. Kërkesa për rihapjen e procedurës administrative mund të paraqitet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data kur pala ka marrë dijëni për shkakun e rihapjes, por jo më vonë se tre (3) vite nga njoftimi i aktit.

2. Kërkesa për rihapjen e procedurës administrative i adresohet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent për aktin.
3. Dispozitat e këtij Ligji mbi formën dhe përmbajtjen e ankesës, do të zbatohen, përshtatshmërisht edhe për kërkesën për rihapjen e procedurës administrative.

Vendimi i rihapjes - së procedurës është parashikuar me **(nenin 142)** ku përcaktohet se:

1. Organi publik kompetent për aktin, nëse pas shqyrtimit të kërkesës për rihapjen e procedurës administrative, vlerëson që, po të merrej në konsideratë shkaku i rihapjes, akti dministrativ do të kishte qenë i paligjshëm apo i papërshtatshëm, ai anulon apo ndryshon aktin, gjegjësisht nxjerr aktin e refuzuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën për rihapje.
2. Vendimi i marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të kundërshtohet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për shqyrtimin e koflikteve administrative.

Format Praktike

KËRKESA DHE PARASHTRIMI I SAJË

Në bazë të nenit 73 të LPPA-së, parashihet Forma dhe përmbajtja e kërkesës. Ku në par 1 të këtij neni përcaktohet se përveç kur ligji parashikon një formë tjetër të caktuar, kërkesa e palës për fillimin e procedurës administrative mund të bëhet:

1.1 në formë të shkruar

1.1.1 me gojë përpara organit publik dhe regjistrohet në procesverbal nga organi publik ose

1.1.2 në çdo formë tjetër të përshtatshme dhe të mundshme (që nënkupton mënyrën e dorëzimit të kërkesës me anë të postes dhe edhe në formë elektronike)

Bazuar në këtë nen me këtë udhëzues paraqesim formën standarde të një kërkesë të palës (personit fizik dhe juridik) e cila mund ti drejtohet cilit do nga organet administrative.

1. Me rastin e fillimit të procedurës administrative me kërkesën e palës (personit fizik apo juridik).

Shembulli nr. 1

(Emërtimi i Organit pranë të cilit parashtrohet kërkesa)

Pala Kërkuese: _____,
(Emri, Emri i Prindit dhe Mbiemri)

Nga _____,
(Adresa e plotë, rruga, nr, Qyteti, nr. i tel. Kontaktues)

Paraqet këtë:

K Ë R K E S Ë

Për Qëllim të:

(Arsyeja e paraqitjes së kërkesës)

Dhe kërkoj që:

Kërkesës i bashkangjes:

1. _____
2. _____
3. _____

(Nënshkrimi i palës)

(Vendi dhe Data e paraqitjes së Kërkesës)

Pas pranimit të kërkesës nga pala, Organi administrativ kujdeset që kërkesën e palës ta vendos në afat kohor të përcaktuar me ligj, kompetencën lidhur me vendosjen, dhe pas

shqyrtimit të këtyre rregullave, mund të konstatoj se ka filluar procedura administrative.

Në bazë të nenit 83 të LPPA-së, Procedura Administrative fillon me kërkesën e palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik.

1. Në çështjet në të cilat, sipas ligjit apo natyrës së çështjes, kërkohet kërkesa e palës, organi publik mund të veprojë vetëm në bazë të kërkesës së tillë,
2. Fillimi i një procedure administrative sipas detyrës zyrtare (ex officio) është në diskrecionin e organit publik, përpos në rastet kur:
 - ligji parasheh shprehimisht detyrimin për të filluar një procedurë,
 - organi publik vihet në dijeni të fakteve që kërkojnë fillimin e procedurës në mënyrë që të mbrohet interesi publik.

2. Me rastin e fillimit të procedurës administrative sipas detyrës zyrtare të organit publik, e njëjta procedurë fillon me një njoftim për organin tek i cili do të zhvillohet procedura.

Shembulli Nr. 2.

(Emërtimi i Organit Publik i cili e fillon procedurën sipas detyrës zyrtare)

N J O F T I M

(për fillimin e procedurës administrative)

(Emërtimi i Organit Publik tek i cili do të fillohet procedura)

Për arsyet si në vijim:

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data dhe Vendi

3. Me rastin e fillimit të procedurës administrative nga ana e organit publik sipas detyrës zyrtare por me kërkesën e palës së interesuar.

Shembulli Nr. 3

Nga: (Emri Mbiemri, adresa nr. i telit i palës së interesuar për fillimin e procedurës)

Për: (Emërtimi i Organit i cili duhet të filloj Procedurën)

K Ë R K E S Ë

Kërkoj që të fillohet procedura administrative nga ana e juaj si organ komptent për arsyet si në vijim:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____ etj..

Nënshkrimi i Palës së interesuar
(parashtruesit të kërkesës)

Data dhe vendi

Forma e Procesverbalit mbi fillimin e procedurës Administrative, sipas detyrës zyrtare nga Organi publik.

Shembulli Nr. 4.

(Emërtimi i Organit Publik që fillon Procedurën Administrative)

Në bazë të nenit 8 par. 1 lidhur me nën par. 3 pikat 1 dhe 2, te LPPA-së, sipas detyrës zyrtare, më datë _____:

Ju njoftojmë se arsye e vizitës apo kontrollit është:

Prezent janë:

Nga ana e Organit

Nga ana e palës

Fillon në ora: _____

Lidhur me çështjen e vizitës (kontrollit), pala deklaron:

Kërkesa për dokumentacion apo prova të çështjes,

Janë paraqitur këto prova (dokumentacion):

Pala ka bashkëpunuar me organin gjatë vizitës apo kontrollit,

Po/Jo

Vërejtjet eventuale gjatë procedurës,

Të gjeturat e organit,

Procesverbali pasi është lexuar u nënshkrua nga palët, PO/JO

Vërejtjet nga dy palët:

Përfundoi në ora: _____

Vërtetojnë:

Nënshkrimi i organit publik

Nënshkrimi i palës

Në bazë të nenit 83 par. 4 të LPPA-së, Procedura administrative vlerësohet të ketë filluar me kryerjen e qfardo veprimi procedural të organit publik në rastin e një procedure të filluar sipas detyrës apo me parashtrimin e kërkesës nga pala, në rastin e një procedure të filluar sipas kërkesës.

Në bazë të nenit 97 të LPPA-së, parashihet që:

- 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës së palës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative,*
- 2. Përfundimi i një procedure administrative e filluar sipas detyrës zyrtare është në diskrecion të organit publik, përpos kur parashihet ndryshe me ligj dhe bëhet me akt administrativ.*

Procedura administrative e filluar sipas kërkesës së palës, në bazë të këtij neni duhet të përfundohet në afat sa më të shpejtë dhe të arsyeshëm kohorë, por jo më vonë se afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj të procedurës, mirëpo në rastet kur nuk përcaktohet afati me ligj të veçantë jo më vonë se 45 ditë nga dita e fillimit të sajë.

Ky afat në bazë të nenit 99, mund të shtyhet në arsyet dhe kushtet e parapara me këtë ligj (për shkak të kompleksitetit të çështjes apo shkaqe tjera ligjore).

Me nenin 100 të LPPA-së, është paraparë edhe akti administrativ i miratuar në heshtje, e kjo vlen në rastet kur:

- 1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98,99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (akti administrativ i miratuar në heshtje).*
- 2. Ky nen nuk zbatohet në rastet kur parashihet ndryshe me ligj.*
- 3. Në rastet e aktit administrativ të miratuar në heshtje pala ka të drejtë të merr nga organi publik një vërtetim me shkrim për përmbajtjen e tij (aktit administrativ të miratuar në heshtje).*

PJESA - II -

Shembulli 1 - çështjet e shtetësisë.

Në bazë të Ligjit nr.04/L-215 PËR SHTETËSINË E KOSOVËS, në nenin 26 përcaktohet parashtrimi i kërkesave:

- 1. Kërkesat e përcaktuara në këtë ligj i parashtrohen organit kompetent.*
- 2. Kërkesat mund të parashtrohen edhe pranë administratës komunale në territorin e së cilës parashtruesi e ka vendbanimin. Në këtë rast, administrata komunale ka për detyrë t'ia përcjellë organit kompetent kërkesën e parashtruar.*
- 3. Në rast se parashtruesi e ka vendbanimin jashtë Republikës së Kosovës, kërkesa mund t'i parashtrohet përfaqësisë më të afërt diplomatike, përkatësisht konsullore të Republikës së Kosovës në regjion. Përfaqësia diplomatike, përkatësisht konsullore ka për detyrë t'ia përcjellë organit kompetent kërkesën e parashtruar.*

Pala e cila parashtron kërkesë në kuptim të dispozitës së cekur më lartë duhet kërkesën ta bazoj dhe ta kompletojë konform dispozitave ligjore të UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) Nr. 04/2014 PËR PROCEDURAT E FITIMIT TË SHTETËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, respektivisht neneve prej nenit 5 deri në nenin 15 të këtij Udhëzimi.

(formularin e kërkesës mund ta gjeni on-line në web faqen e Ministrisë)

Shëno llogon tuaj
REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria
Ministria e Punëve të Brendshme

Kërkesë për Fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës

Emri i Organit të Cilit i Drejtohet Kërkesa
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
Divizioni për Shtetësi

Zyra e Gjendjes Civile Komuna: Gjakovë

Të dhënat e nevojshme:

1. Emri dhe Mbiemri i Parashtruesit të kërkesës: _____

2. Mbiemri i Lindjes: _____

3. Gjinia: _____

4. Data dhe Vendi i Lindjes: 13.06.1975 Podgoricë - Mal i Zi

5. Nacionaliteti: Shqiptar

6. Emri dhe Mbiemri, data dhe vendi i Lindjes së prindërve,
mbiemri i vajzërisë së nënës: _____

7. Profesioni: Amvisë

8. Shtetësia dhe vendi i regjistrimit në regjistrin e shtetësisë: Kosovare - Gjakovë

9. Shtetësia e Mëparshme: Malazeze

10. Vendi dhe Adresa e vendbanimit aktual: Rruga "156" Komuna Gjakovë

11. Vendi dhe adresa e vendbanimit të mëparshëm: Podgoricë - Mal i Zi

12. Gjendja Martesore: E martuar

13. Emri, Mbiemri, Data, vendi dhe shteti i Lindjes së bashkëshortit/es:

XY-13.06.1975 - Gjakovë-Kosovë

14. Emri dhe mbiemri, data dhe vendi dhe shteti i lindjes së fëmijve të mitur të cilët përfshihen në kërkesë _____

15. Të shënohet emri, mbiemri, organi dhe funksioni, nëse ndonjëri nga anëtarët e afërm të familjes është i punësuar në organet e Republikës së Kosovës apo në botën e jashtme _____

16. Shërbimi Ushtarak i kryer ase jo, nëse po kur dhe në cilin vend.

17. Vendi dhe adresa e fundit në botën e jashtme (shteti, vendi, rruga dhe numri)

Pyetsori që i bashkangjitet formularit të kërkesës

Me rastin e parashtrimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës duhet të rumbullaksohet njëra nga bazat për fitimin e shtetësisë:

- Në bazë të vendbanimit të lajmëruar në Republikën e Kosovës
- Në bazë të lindjes në Republikën e Kosovës
- Në bazë të martesës me shtetasin e Republikës së Kosovës
- Në bazë të martesës me të shpërngulurin kosovar i/e cili ka fituar shtetësinë kosovare
- Në bazë të rekomandimit të organit kompetent konform nenit 10.3 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës
- Në bazë të shtetësisë së prindërve të cilët me natyralizim kanë fituar shtetësinë e Kosovës
- Në bazë të adoptimit me veprim prindëror
- Fitimi i serishëm i shtetësisë (pas humbjes së shtetësisë kosovare me lirim)
- Në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shtetësinë
- Në bazë të natyralizimit të pjesëtarit të diasporës kosovare
- Në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.

Data dhe vendi i parashtrimit të kërkesës
21.05.2014, Gjakovë

Nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës

Bazuar në Kushtetuten e Republikës së Kosovës kapitulli I nenin 14, Ligjit për Shtetësin e Kosovës, Kreu II, dhe nenin 19 të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2014 për Procedurat e Fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, ka autorizimet që të vendos lidhur me një kërkesë të parashtruar nga pala, dhe të merr vendim.

Në rastin konkret në bazë të kërkesës me nr. 1499/14 të datës 21.05.2014, të paraqitur nga parashtruesi për njohjen e shtetësisë mbi bazën e martesës me shtetasin kosovar, Divizioni për Shtetësi merr këtë vendim:

Shëno llogon tuaj
Ministria e Punëve të Brendshme
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
Divizioni për Shtetësi

Nr. 15/2014

Në mbështetje të kapitullit I neni 14 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kreun II të Ligjit Për Shtetësin e Kosovës nr. 04/L-215 dhe nenin 19 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 04/2014 Për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës, Divizioni për Shtetësi në kuadër të Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në rastin e shqyrtimit të kërkesës nr. 1499/14 të datës 21.05.2014, merr:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa nr. 1499/14 e datës 21.05.2014, e paraqitur nga X X, e lindur më datë 01.08.1977 në Podgoricë, për njohjen e të drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe regjistrimi në regjistrin e shtetësisë.

A r s y e t i m

Divizioni për Shtetësi më datë 19.09.2014, duke vendosur sipas kërkesës nr. 1499/14 të datës 21.05.2014, të parashtruar nga XX, nga Komuna e Gjakovës, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dëshmi të paraqitura, vlerëson se kërkesa nuk i përmbush kushtet e parapara me nenin 32 par. 1 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës nr. 04/L-215 si dhe nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 05/2014 për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish-RSF-jës dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës me 1 janar 1998, andaj duke u bazuar në shkresat e lëndës si rezultat i të gjykuarit të tërësishëm konstatoi që kërkesa nuk është e bazuar.

Pas analizimit të provave të cilat janë paraqitur si dëshmi nga ana e palës kërkuese konstatojmë që pala ankuese, nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, të cilat do të vërtetonin qëndrimin e saj të R. E Kosovës për pes vite pandërprerë para datës 01

janar 1999 ashtu siç parashihet me nenin 32 par. 1 të Ligjit për Shtetësin e Kosovës si dhe nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish RFJ-së dhe banimin e përherëshëm në territorin e Kosovës më datë 01 janar 1998.

Andaj bazuar në të cekurat si më lartë Divizioni për shtetësi, pasi vlerësoi kërkesën dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur, kundër këtij vendimi, ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave për Shtetësi, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimet të vendimit.

Prishtinë më: 19.09.2014

Udhëheqësi i Departamentit
Z Z

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës
- Divizionit për Shtetësi
- Zyrës së Gjendjes Civile
- Arkivit të MPB-së

Me dispozitën e neni 20 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 04/2014, Për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës, përcaktohet E drejta e ankesës e cila mund të ushtrohet kundër vendimit për refuzimin e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, kun ë bazë të këtij neni parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese në afat prej (tridhjetë) 30 ditësh në Komisionin për shqyrtimin e Ankesave të Shtetësisë në kuadër të MPB-së.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Komisionit të Ankesave për Shtetësi

Konform nenit 20 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 04/2014 për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës, në afat ligjorë ushtrojë:

A N K E S Ë

Kundër vendimit të Divizionit për Shtetësi nr. 15/2014 të datës 19.09.2014, për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të LPPA-së,
- Vërtetimit të gabuar të gjednjes faktike dhe
- aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

A r s y e t i m i

Pasi që si parashtuese e ankesës un XX nga fshati Vogovë, Komuna e Gjakovës e lindur më datë: 01.08.1977 në Podgoricë, R. E Malit të Zi, shtetase Malazeze me vendbanim të përherëshëm në fshatin Vogovë, Komuna Gjakovë, që nga data 13.08.1996, ku edhe tani jeton.

Me qenëse i plotësoj të gjitha kushtet në bazë të cilave mund të fitohet shtetësia e Republikës së Kosovës, dhe kërkesës ia kam bashkangjitur të gjitha dokumentet në bazë të Ligjit për Shtetësin e R. Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ, mirëpo me vendimin e përmendur nga organi kompetent në mënyrë tejet të kundërligjeshme edhe me dispozitat e përmendura më lartë në të cilat thirret edhe vet organi kompetent, më refuzohet kërkesa për njohjen e shtetësisë së R. Kosovës.

Organi i lartë përmendur, pa të drejtë dhe në mënyrë kundërligjore me vendimin e ankimuar, më ka refuzuar kërkesën për njohjen e shtetësisë, me arsyet e cekura në vendim.

Ky vendim është i kundërligjshëm për faktin se të njëjtit i mungon arsyetimi lidhur me refuzimin e kërkesës si dhe faktet dhe provat në të cilat bazohet një refuzim i tillë dhe

së fundi refuzimi është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë materie.

Andaj me qenë se Un XX e lindur më 01.08.1977 në Podgoricë, R. E Malit të Zi, shtetase Malazeze, nga i ati ZZ dhe e ëma YY, më datë 13.08.1996 kam lidhur martesë në zyrën e ofiqarisë në Brekoc, Komuna e Gjakovës me ZY nga fshati VOGOË Komuna e Gjakovës, shtetas i R. Kosovës, Organi kompetent duke u mbështet në dispozitat e cekura ligjore, pa të drejtë e ka refuzuar kërkesën për shtetsi, pasi që i ka poseduar edhe provat lidhur me këtë siç janë: Leja e Njoftimit, Pasaporta, të cilat dokumente janë lëshuar nga R. E Kosovës,

P r o p o z o j

Që ankesa të aprovohet, dhe bazuar në provat e prezantuara dhe në dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë materie, të më njihet e drejta e shtetësisë së R. Kosovës dhe e njëjta të regjistrohet në Regjistrin e Shtetësisë.

Prishtinë: 10.09.2015

Parashtruesja e kërkesës

XX

Shëno llogon tuaj

REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria

Ministria e Punëve të Brendshme

Në mbështetje të nenit 33 të Ligjit nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ nr. 06/2014 për Themelimin dhe Përcaktimin e Rregullave të Punës së Komisionit të Ankesave për Shtetësi, lidhur me ankesën nr. 117 të parashtruar nga ankuesja XX, lidhur me kërkesën për fitimin e shtetësisë të ushtruar kundër vendimit të Divizionit për Shtetësi nr. 15/2014 të datës 19.09.2014, mbahet:

PROCESVERBAL

i

Seancës së Komisionit të Ankesave për Shtetësi

Mbajtur më datë: 29.12.2015, për shqyrtimin e ankesës së parashtruar nga parashtruesja XX, nga Republika e Malit të Zi, në prezencën e:

Përbërja e Komisionit:

1. _____ Kryetar
2. _____ anëtarë
3. _____ anëtarë

Parashtruesi/ja e ankesës

Procesmbajtës/e:

Fillon në ora: 12:00

Parashtruesja e ankesës, znj.XX: paraqiti ankesën dhe pretendimet në ankesë si dhe provat në bazë të cilave e njëjta pretendon se i takon e drejta në shtetësinë e Kosovës.

Kryetari i Komisionit të Ankesave për Shtetësi: z. YYYYYY, e hap shqyrtimin e ankesës së parashtruese: (paraqitet ankesa dhe shkaqet e paraqitjes, si dhe propozimi në ankesë)

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Shtetësi, pasi i shqyrtoi të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë dhe dëshmime të cilat bazohet ankesa, me vendim unanim vendosi që ankesa të:

refuzohet si e pa bazuar.

Refuzimi i ankesës rezulton nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke u bazuar në nenin 32 par. 1 të ligjit për Shtetësinë e Kosovës, nr. 04/L-215, nenit 3 dhe 4

të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 05/2014 për kriteret që përbëjnë dëshmi për Shtetësin e ish RSFJ-së dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës nga 1 janari i vitit 1998.

Bazuar në të cekurat më lartë Komisioni për shtetësi merr:

V E N D I M

Ankesa me nr. 119/2014 e paraqitur nga yn, X X nga Republika e Malit të Zi, në mungesë të dëshmive, refuzohet si e pa bazuar.

Procedura e Votimit

Komisioni për Shtetësi, lidhur me vendimin e marrë lidhur me ankesën e shqyrtuar votoi unanim/ me konsensus, si:

1. _____ Pro/kundër
2. _____ Pro/Kundër
3. _____ Pro/kundër

Përfundoi në ora: 13:00

Palët prezente pasi e lexuan procesverbalin të njëjtin e nënshkruan, pa vërejte/me vërejtje.

Anëtarët e komisionit:

1. _____ Kryetari i Komisionit
2. _____ anëtarë
3. _____ anëtarë

Pala ankuese

Procesmbajtësja

Shëno llogon tuaj
Ministria e Punëve të Brendshme

Komisioni i Ankesave për Shtetësi

Në mbështetje të kapitullit I nenit 14 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe kreu II të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës nr. 04/L-215, si dhe kreu II neni 6 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 të udhëzimit Administrativ nr. 06/2014 për Themelimin dhe Përcaktimin e Rregullave të Punës së Komisionit për Ankesa për Shtetësi dhe Vendimit nr. 298/2014 të datës 08.09.2014 për emërimin e Komisionit për Ankesa dhe Shtetësi në përbërje: xxxxx-kryetar i Komisionit, xxx-anëtarë, në rastin e shqyrtimit të ankesës së znj.X X, merr:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa me nr. 117 e datës 10.09.2015, e paraqitur nga znj. X X, si e pabazuar.

II. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 1499/2014 i datës 21.05.2014, i Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migracion, lidhur me kërkesën për fitimin e shtetësisë së R. Kosovës, me natyralizim.

A r s y e t i m

Komisioni i Ankesave për Shtetësi (në tekstin e mëtejshëm Komisioni) pas shqyrtimit të ankesës së znj. XX, e lindur më datë 01.08.1979 në Podgoricë-Mal i Zi, të ushtruar kundër vendimit të Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migrim, ka shqyrtuar të gjitha provat dhe dëshmitë e paraqitura në ankesë e të cilat gjenden në dosjen nr. 1499/14 të datës 21.05.2014, të lëndës sipas kërkesës për fitimin e shtetësisë së R. Kosovës me natyralizim, si në vijim: certifikatën e vendbanimit të lëshuar nga Komuna e Gjakovës nr. B.007223 e datës 13.05.2014, certifikatën e martesës e lëshuar nga UNMIK-u nr. 42/1996 e datës 22.05.2006, certifikatën e lindjes e lëshuar nga Mali i Zi nr. 1604 e datës 22.03.2000, vërtetimi nga Komuna e Gjakovës që nuk ka obligime tatimore të papaguara nr. 100067 i datës 13.05.2014, kopja e faturës së tatimit në pronë datë 12.05.2014, kopja e letërnjoftimit e ish RFJ-së e lëshuar në Gjakovë më datë 01.10.1997, kopja e pasaportës nr. 1093847609.

Komisioni gjatë shqyrtimit të provave është bazuar në nenin 32 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-215 për SDhtetësinë e Kosovës si dhe enenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr.04/2014 për Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së R. Kosovës.

Pas analizimit të provave Komisioni konstaton që pala ankuuese, nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme, të cilat do të vërtetonin qëndrimin e sajë të R. E Kosovës për pesë vite

pandërprerë para datës 01 janar 1999 ashtu siç parashihet me nenin 32 par. 1 të Ligjit për Shtetësin e Kosovës si dhe nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e ish RFJ-së dhe banimin e përherëshëm në territorin e Kosovës më datë 01 janar 1998.

Komisioni gjatë analizimit të tërësishëm të dokumenteve në lëndë, konstatoi se dokumenti që gjendet në dosjen e aplikimit të palës i cili është kopje e letërnjoftimit të ish RSFJ-së, e lëshuar në Gjakovë më datë 13.08.1996, nuk është i vlefshëm për të fituar shtetësinë e R. Kosovës, sepse nuk përmbush periudhën kohore siç kërkohet me ligj 5 vite para datës 01 janar 1998 dhe nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ për kriteret që përbëjnë dëshmi për fitimin e shtetësisë së Kosovës më datë 01 janar 1998, ku thuhet se personi nëse ka qenë fëmijë i varur që nuk i ka plotësuar kushtet nën moshën 18 vjeqare ose nën moshën 23 vjeqare dhe nëse ka qenë duke e vijuar shkollimin e rregullt në ndonjë institucion arsimorë para 01 janar 1998 dhe nëse prindërit e tij/sajë bëjnë pjesë në par. 1.1, 1.2, ose 1.3 të këtij neni ose janë të regjistruar sipas nenit 3 të rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 mund të fitojë shtetësinë e Kosovës.

Komisioni para se të marrë vendimin, ka tentuar të komunikojë me palën, në numrin të cilin e ka paraqitur me kërkesë si nr. kontaktues, mirëpo qasja ka qenë jo aktive dhe nuk ka qenë e mundur kontakti me te në mënyrë që të ftohet për seancën e shqyrtimit të kërkesës dhe t'i mundësohet që të dorëzojë dokumente shtesë eventuale të vlefshme sipas ligjit, në mënyrë që të mbështeten pretendimet në ankesë, mirëpo pas shumë përpjekjeve ka qenë i pa arritshëm kontakti me palën.

Komisioni pas shqyrtimit të gjitha provave në lëndë, me qëllim të zbatimit të drejtë të dispozitave materiale dhe procedurale, konstaton se pala nuk ka ofruar dëshmi me të cilat do të plotësohte kushtet për fitimin e shtetësisë së Kosovës, andaj ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Kryetari i Komisionit

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala ka të drejtë të hapë konflikt administrativ me Padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. palës XX
2. Sekretaris së Komisionit
3. Arkivit të MPB-së.

Shembulli 2 - çështja e pensionit me paaftësi të përherëshme.

Duke u bazuar në Ligjin NR. 04/L-131 - PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI, respektivisht në Nenin 9, i cili rregullon Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë të përherëshme, në par. 3. Të këtij neni përcaktohet se: Kërkesa për pension të paaftësisë së përherëshme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitet e Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ 06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përherëshme, nenit 4 të të njëjtit ku përcaktohet procedura e paraqitjes së kërkesës dhe forma e saj si dhe dokumentet të cilat duhet të bashkangjiten.

(formularin e aplikimit-kërkesës, mund ta gjeni on linë në web faqen e Ministrisë)

Shëno llogon tuaj

REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Departamenti Administratës Pensionale të Kosovës

KËRKESA-FORMULARI
për Aplikim
Për për pensionin e personave me paaftësi të përherëshme

Për: Zyrën Regjionale të Administratës Pensionale
Në Komunën e _____.

Të dhënat e përgjithëshme të aplikuesit:

Emri: _____

Mbiemri: _____

Emri i Prindit: _____

Mbiemri i vajzërisë-nëse ka: _____

Datë Lindja: _____

Gjinia: _____

Vendi i Lindjes dhe Komuna: _____

Vendbanimi i tanishëm: _____

Adresa në të cilën jeton: _____

Nacionaliteti: _____

Adresa kontaktuese: _____

Nr. i telefonit: _____

Gjendja martesore: _____

Mbiemri i bashkëshortit/es: _____

Arsyet e parashtrimit të Kërkesës: _____

A keni aplikuar edhe më parë për këtë lloj pensioni Po/JO

Nëse PO-ju lutem shënoni kohën kur dhe arsyet e refuzimit të kërkesës

A e shfrytëzoni ndonjërin nga pensionet e parapara me skemën sociale të DAPK-së.
PO/Jo

Nëse PO, cilin nga pensionet e realizoni

DEKLARATA - për të cilën aplikuesi duhet të japë pëlqimin:

Dua të aplikoj për pensionin e paaftësisë së përherëshme, sepse kamë paaftësi të përherëshme për punë. Jamë banor i përherëshëm Kosovës dhe posedoj letërnjoftimin e lëshuar nga MPB. Pajtohem ti nënshtrohem kontrollit mjekësorë të Komisionit Mjekësorë në Kuadër të DAPK-së. Do të ju njoftoj për çdo ndryshim të informatave të lartëshënuara, e të cilat janë të dhëna në Formularin për Aplikim të cilat janë të sakta dhe mund të përdoren nga ana e MPMS-DAPK, për të vlerësuar kërkesën për pensionin e paaftësisë së përherëshme.

Nënshkrimi i aplikuesit

Data dhe Vendi

Të Dhënat për Përdorim Zyrtar nga Administrata Pensionale e Kosovës

Këto të dhëna plotësohen nga zyrtari i Administratës i cili e pranon formularin-kërkesën për Aplikim.

Emri i zyrës Regjionale _____ data e pranimit të kërkesës _____

Dokumentet e domosdoshme që duhet bashkangjitur:

- Fotokopja e letërnjoftimit-ID
- Fotokopja e kartelës së llogarisë së bankës
- Dëftesa e pranimit të formularit
- Certifikata e mjekut-dëshmia mjeksore për paaftësi
- Dëshmi tjera të kërkuara nga zyrtari përgjegjës, etj
- _____
- _____

Emri dhe Mbiemri i nënpunësit, i cili e pranon kërkesën _____ dhe nënshkrimi _____, data _____.

Në bazë të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përherëshme, përcaktohet kompetenca dhe procedura e Komisionit Mjekësorë për të vendosur lidhur me kërkesën e palës të parashtruar për njohjen e të drejtës në pensionin e paaftësisë së përherëshme.

Shëno llogon tuaj
REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Departamenti Administratës Pensionale të Kosovës

Komisioni Mjekësorë i Administratës Pensionale

Nr. dos. 5089059
Dt. 02.01.2019

Në bazë të Ligjit NR. 04/L-131 - PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI si dhe Udhëzimit Administrativ 06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përherëshme, nenit 8, Komisioni Mjekësorë i Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës, në seancë mjekësore të datës 06.03.2014 pas ekzaminimit të drejtë për drejtë të palës dhe vlerësimit të dëshmive të tjera mjeksore të paraqitura me kërkesë, më datë 27.03.2014 merr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për njohjen e pensionit me paaftësi të përherëshme me nr. të dos. 5089059 e datës 18.11.2018, e paraqitur nga **R.H** me nr. të letërnjoftimit 0879540175, nga Prishtina rr. Enver Berisha nr 105, e **pabazuar**.

A r s y e t i m

Komisioni Mjekësorë i Departamentit të Administratës Pensionale, duke vendosur lidhur me kërkesën e palës për njohjen e të drejtës së pensionit me paaftësi të përherëshme, bëri ekzaminin e drejtë përdrejtë të palës R.H dhe shqyrtimit të dokumentacionit mjekësorë të bashkangjitur me kërkesë, si certifikata e mjekut ne. 30 e datës 03.02.2013, udhëzimi mjekësorë i datës 27.01.2014, dokumentet e tjera mjekësore me nr. dhe datë të caktuar, në seancën e datës 06.03.2014, pasi vlerësoi të gjitha së bashku konstatoi dhe erdhi në përfundim se tek parashtrusja e kërkesës R.H paaftësia e përherëshme nuk ekziston.

Andaj bazuar në dispozitën e nenit 8 të Udhëzimit Administrativ 06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përherëshme, Komisioni Mjekësorë, passhqyrtimit, ekzaminimit dhe vlerësimit të palës dhe dokumenteve mjeksore të cekura më lartë e të cilat gjenden në dosjen e lëndës, konstatoi se tel pala kërkuese paatësia e përherëshme nuk ekziston, dhe vendosi që kërkesa për njojen e të drejtës në pensionin e paaftësisë së përherëshme të refuzohet.

Data: 02.01.2019

Kryetari i Komisionit

Këshillë juridike:

Pala ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit, në Komisionin e Ankesave në Departamentin e Administratës Pensionale, përmes Zyrës Regjionale.

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.06/2015, për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përherëshme, me nenin 11 të këtij udhëzimi, është paraparë se pala e pa knaqur me vendimin e organit të shkallës së parë, ka të drejtë të ushtrojë ankesë në Komisionin e Shkallës së Dytë të Ministrisë. E që në këtë rast ankesa i dorëzohet Komisionit të Ankesave në DAPK.

Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës
Komisionit të ankesave

Përmes Zyrës Regjionale në:

Datë: 27.01.2019

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 06/2015, për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përherëshme, nenin 11 par. 1 dhe 2, paraqes:

A N K E S Ë

Kundër vendimit nr. Nr. dos. 5089059 të datës 27.01.2019, të Komisionit mjekësorë të shkallës së parë, me të cilin më është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionin me paaftësi të përherëshme, si e pa bazuar.

Vendimin e lartë cekur e ankimojë për shkak të:

- vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe
- aplikimit të gabuar të drejtës materiale

A r s y e t i m i

Komisioni Mjekësorë i shkallës së parë, me rastin e vlerësimit të paaftësisë së përherëshme në rastin tim, ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, sepse me ekzaminimin e drejtë për drejtë të gjendjes time shëndetësore shihet qartë se jamë person me paaftësi të përherëshme sepse jamë invalid funksionoj dhe qarkulloj me karroc invalidësh në përditëshmërin time, e kjo shihet qysh në shikim të parë nga secili person e sidomos nga mjekë të cilët janë në komision të vlerësimit, nga dokumentacioni mjekësorë shihet qartë se vuaj nga shumë sëmundje unazat e shpinës, arsyeja e invaliditetit, smundja e mushkrive në shkallë të lartë, smundja e sheqerit në gjak, tensioni i lart, kam pasur edhe dy intervenime në zemer, e të gjitha këto janë të dëshmuara me prova si dokumentacioni mjekësorë i cili gjenden në dosjen e lëndës e të cilën komisioni mjekësorë e ka vlerësuar në mënyr të gabuar ose nuk e ka vlerësuar fare.

Duke mos e vlerësuar gjendjen time shëndetësore e as dokumentacionin ekësorë në mënyr të duhur, komisioni mjekësorë nuk e ka vlerësuar drejtë gjendjen shëndetësore, e

me këtë ka rezultuar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike e që kjo ka sjell edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Bazuar në kto pretendime, si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës:

P r o p o z o j

Organit të shakllës ës dytë që në seancë të re, të bëjë edhe një herë vlerësimin e gjendjen time shëndetësore me ekzaminim të drejtë për drejtë dhe dokumenteve mjekësore të cilat gjenden në dosje të lëndës dhe në bazë të vlerësimit të tyre të merr:

V E N D I M

Aprovohet ankesa e datës 01.02.2019, e ushtruar nga pala R.H, kundër vendimit me nr. Nr.dos. 5089059 të datës 27.01.2019, dhe të më njihet e drejta në pensionin e personave me paaftësi të përhershme.

Data: 27.01.2019

Ushtruesi/ja e ankesës

R.H

Nga -----.

Shëno llogon tuaj
REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Departamenti Administratës Pensionale të Kosovës

Komisioni Ankesave i Administratës Pensionale

Nr. dos. 5089059

Data:15.01.2019

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-131 - Për skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nenit 19 par. 4, 5 dhe 6, si dhe Udhëzimit Adfministrativ nr. Udhëzimin Administrativ nr. 06/2015, për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përherëshme, nenint 11 par. 1, 2 dhe 3, në seancën e datës: 15.01.2019, merr:

V E N D I M

I. Refuzohet Ankesa e R.H me nr. Nr.dos. 5089059 të datës 27.01.2019, e paraqitur kundër vendimit nr. Nr. dos. 5089059 të datës 02.01.2019, të Komisionit Mjekësorë të shkallës së parë, me të cilin i është refuzuar kërkesa e datës 18.11.2018, për njohjen e të drejtës në pensionin e personave me pa aftësi të përherëshme, si e **pa bazuar**.

II. Mbetet në Fuqi vendimi nr. Nr. dos. 5089059 të datës 02.01.2019, i Komisionit të Mjekësorë të shkallës së parë.

A r s y e t i m

Në procedurën sipas ankesës së ushtruar më datë 27.01.2019, Komisioni i Ankesave, si komision i shkallës së dytë, në përbërje të eksperte mjekësorë të lëmive përkatëse, në seancën e datës 15.01.2019, duke vepruar sipas ankesës së palës ankuese R.H, pretendimeve ankimore, dokumentacionit mjekësorë i cili gjendet në dosjen e lëndë, si dhe dokumentacionit shtesë i cili është dorzuar me rastin e ankesës, si dhe bazuar edhe në vlerësimin e komisionit të shkallës së parë të datës 27.01.2019, vlerësoi secilën veq e veq dhe të gjitha së bashku, dhe në fund konstatoi se bazuar në gjendjen faktike të vlerësuar, konstatohet se tek ankuesja R.H, pa aftësia e përherëshme nuk ekziston.

E gjithë kjo bazuar në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë këtë materie, dhe dokumuneteve mjeksëore dhe vlerësimit të komisionit mjeksëorë, nuk ka prova të mjaftueshme, për njohjen e të drejtës së pensionit të personave me paaftësi të përherëshme për R.H.

Andaj nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, ankesa e paraqitur nga pala Refuzohet si e pa bazuar, dhe vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.

Datë:

Kryetari i Komisionit

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pa knaqur ka të drejtë të ushtrojë padi për hapjen e konfliktit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- ankueses
- në dosjen e lëndës

Shembulli 3 - Kontest Pune

Këshillit Prokurorial të Kosovës

Në bazë të nenit 73 të LPPA-së, par. 1 të këtij neni, në pozitën e ekspertit për antikorrupsion në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës, paraqes këtë:

K Ë R K E S Ë

Për zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 02/151 për ngritjen e pagave për shërbyesit civil.

Me konkursin e datës 01.01.2010, është përcaktuar paga bazë për pozitën nëpunësve civil, në lartësi prej ----, dhe këto paga është dashur që të hyjnë në sistemin e pagava nga kjo datë. Më datë 06.01.2011, hyn në fuqi vendimi i Qeveris nr. 02/151, me të cilin parashihet ngritja e pagave pëpr disa kategori në Shërbimin civil e konkretisht në pikën 4 të vendimit parashihet ngritja e pagave për të gjithë shërbyesit civil prej 30%.

Pozita jonë si shërbyes civil përcaktohet edhe me kontratën e punës të datës 15.04.2011, me të cilën kemi lidhur kontratë pune, për marrëdhënie të punës në pozitë n nëpunësve civil, në Kuadër të Departamentit Special Antikorrupsion në Prokurorinë Speciale, e cila kontratë bazohet në Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në rregulloren nr. 2001/36 mbi procedurat e rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës, me të cilat përcaktohet edhe kategoria e pozitës tonë si shërbyes civil.

Sa për dijenin tuaj, një kërkesë përafërsisht të till e kemi drejtuar edhe në Ministrinë e Administratës Publike, lidhur me mos zbatimin e vendimit për ngritjen e pagave në rastinb tonë, e cila më datë 31.08.2011 me anë të shkresës na njofton se Kjo Ministri do të bëjë procedimin në sistemin e pagave për ngritje prej 30% të pagës, në bazë të vendimit të Qeverisë, me kusht që Prokuroria e Shtetit, të konfirmoj ekzistimin e mjeteve të mjaftueshme financiare në buxhetin e saj, të ndarë për këto pozita.

Pas kësaj më datës 19.07.2011 kemi drejtuar një kërkesë edhe në Prokurorinë e Shtetit lidhur me këtë çështje, ku është përgjegjur Divizioni i burimeve njerzore, më datë 20.10.2011, e cila përgjigje është e paqartë dhe jo ligjore. Pas kësaj i jemi drejtuar Prokurorisë së Shtetit përsëri më datë 20.10.2011, nëpërmjet një shkrese ku kemi kërkuar që gjatë përpilimit të buxhetit për vitin fiskal 2012, të ndajë mjete të mjaftueshme në mënyrë të mund të zbatohet vendimi i Qeveris për ngitje të pagave edhe për kategorinë tonë, dhe të mund të zbatohet shkresa e MAP-it, e cekur më lartë.

Edhe pas të gjitha këtyre shkresave dhe përpjekjeve të cekura si më lartë, nuk është ndërrmarë asnjë veprim për këtë çështje dhe nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga Prokuroria e Shtetit.

Lidhur me këtë çështje dhe bazuar në pretendimet e cekura më lartë, në pozitën e nëpunësve civil:

P r o p o z o j m ë

Kërkojmë që kjo kërkesë të shqyrtohet së bashku me të gjitha shkresat e bëra lidhur me këtë, e të cilat i janë bashkangjitur kësaj kërkesë dhe të merret parasysh se në bazë të Kontratës së Punës dhe procedurës së rekrutimit për këtë pozitë, janë bazuar në Ligjin për Shërbimin Civi dhe rregulloren e cila zbatohet në këtë çështje andaj:

Të aprovohet kërkesa dhe të zbatohet vendimi i Qeveris së Kosovës, nr. 02/151 i datës 06.01.2011, dhe të ngritën pagat e nëpunësve civil prej 30% ashtu siç përcaktohet me pikën 4 të këtij vendimi.

Prishtinë
12.01.2019

Parashtruesit e Kërkesës

Shëno llogon tuaj
Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK/nr. 55/2019

Datë: 04.02.2019

Në bazë të nenit 4 par. 1 pika 1.14 dhe nenit 22 par. 5, të Ligjit nr.03/L-244 PËR Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 04.02.2019, Këshilli Prokurorial merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa e nëpunësve civil, të punësuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës e datës 12.01.2019, për ngritjen e pagave prej 30% sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 02/151, të datës 06.01.2011.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 04.02.2019, shqyrtoi kërkesën e Nëpunësve civil, të punësuar në PSRK për ngritjen e pagave prej 30% sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 02/151 të datës 06.01.2011, dhe pasi vlerësoi të njëjtën së bashku me provat si shkresat të cilat gjenden në dosjen e lëndës, konstatoi se Nëpunësve civilkompenzohen me paga të cilat janë sistemit të pagave të Shërbyesve Civil (koeficient), prandaj gjeti se bazuar në nenin 10 par. 3 të ligjit për Buxhetin e R. Kosovës për vitin 2013, nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për rritje të pagës prej 30%, sipas vendimit të Qeverisë.

Gjithashtu Këshilli vërejtë se pika 1.1 dhe 1.2 e par. 1 të Vensimt të Qeverisë nr. 13/155 të datës 13 shkurt 2013, për kompenzimin e shtesave dhe stimulimit financiar për punonjësit e PSRK-së për vitin 2013, përcakton numrin e zyrtarëve dhe personelit mbështetës të cilët kanë të drejtë për kompenzim shtesë, mirëpo ekspertët anti korrupsion dhe dy zyrtarët e IT-së, nuk janë të përfshirë në atë listë. Prandaj duke konsideruar rendësinë e trajtimit të barabartë të të gjithë personelit në PRSK, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi i dërgohet:

- palës
- Arkivit

Kryetari i Këshillit Prokurorial

04.02.2019

Në bazë të Ligjit për Procedurën e Përgjithëshme Administrative Nr. 05/L -031, par. 124, 125, 126 dhe 128 të këtij ligji të cilat nene përcaktojnë të drejtën e palës për ushtrimin e ankesës dhe procedure lidhur me të njëjten dhe në bazë të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës nenin 16 par. 1 dhe 4, ankesa kundër vendimit të organit të punësimit i dorzohet KPMSHCK-së, si dhe në bazë të nenit 78 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës Nr. 03/L-149, nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues i pakënaqur me vendimin e Komisionit disiplinor, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për shërbimin civil brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit për vendimin, të njëjtat dispozita ligjore vlejné edhe për shembullin konkret.

Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Në kuptim të dispozitës së nenit 125 të Ligjit për procedurën e Përgjithëshme Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.02.2019, paraqesim këtë:

A N K E S Ë

Kundër Vendimit nr. **KPK/nr. 55/2019, të datës 04.02.2019**, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale
- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike
- Shkeljeve të dispozitave materiale

A r s y e t i m i

Me vendimin e ankimuar të cituar më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nuk e ka marrë parasysh kërkesën për zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/151 të datës 06.01.2011, për të cilin kërkohet edhe zbatimi në rastin konkret.

Provë: Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/151 të datës 06.01.2011

Vendimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave procedurale sepse i njëjti nuk përmban arsye lidhur me faktet vendimtare. Arsyet e paraqitura në vendim nuk kanë fuqi provuese për marrjen e vendimit meritor, për çka do të bëhet fjalë lidhur me arsyetimin e bazës ankimore, të gjendjes së fakteve. I njëjti nuk përmban arsyet lidhur me provat e provuara dhe ato të pa provuara, sidomos nuk përmban arsyet për provat e paprovuara respektivisht provat e paraqitura nga ankuesit në momentin e marrjes së vendimit nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Gjendja faktike me vendimin e ankimuar është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Kjo për faktin se me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe me

vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, shumë qartë parashihet se kur do të ndërmerren veprimet e cekura dhe kush e realizon të drejtën e rritjes së pagës.

Nisur nga ky fakt legjislacioni e parasheh në mënyrë të saktë se kush do të konsiderohet të jetë shërbyes civil si dhe në këtë drejtim janë paraparë edhe kushtet të cilat duhet të plotësohen që një nën punës të cilësohet dhe konsiderohet si shërbyes civil. Gjithashtu, edhe me vendimin e sjellë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht në pikën 4 parashihen edhe kategoritë e shërbyesve civil të cilët gëzojnë të drejtën e rritjes së pagës në përqindjen e cekur si më lartë.

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 02/110 të datës 26.02.2010, Qeveria në Bashkëpunim me EULEX-in, kërkon nga Prokuroria Speciale e R. Kosovës, që në kuadër të sajë të themelojë Departamentin Special, me qëllim të hulumtimit dhe luftimit të dukurive korruptuese në Kosovë.

Në pikën 5 të këtij vendimi, parashihet përzgjedhja e nëpunësve civil.

**Provë: vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës
nr. 02/110 të datës 26.02.2010.**

Bazuar në këtë vendim, më datë 09.10.2010, Ministria e Drejtësisë publikon konkursin nëpërmjet së cilës kërkon plotësimin e pozitave të punës dhe atë ky konkurs bazohet në Rregulloren nr.2001/36 mbi shërbimin civil të Republikës së Kosovës, duke caktuar njëkohësisht edhe pagën bazë prej -----euro në muaj.

**Provë: konkursi i Ministrisë së drejtësisë
nr. referencë MD/PRSK/09-10-01-2010**

Siç mund të shihet nga kjo kronologji e rastit, konkursi është shpallur dhe procedurat e intervistimit dhe përzgjedhjes kanë përfunduar gjatë vitit 2010, para hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilën parashihet ngritja e pagës në përqindjen të cekur si më lartë.

Edhe pse për shkaqe teknike është shtyrë fillimi i punës sene, më datë 15.04.2011, kemi filluar punën pranë Prokurorisë së R. Kosovës dhe që nga ai moment edhe pse të gjithë shërbyesit civil tjerë e kanë gëzuar këtë të drejtë, ne jemi privuar dhe nuk e kemi gëzuar këtë të drejtë. Kjo për faktin se menaxhmenti dhe shërbimi i administratës vazhdimisht ka insistuar, se ne nuk kemi të drejtën e realizimit të rritjes së pagës.

Provë: Kontrata e punës

Pas bisedave të cilat i kemi zhvilluar me zv. -----, dhe administratoren e Organit të punësimit, si dhe kërkesat e vazhdueshme verbale në këtë drejtim, më datë 19.07.2011

jemi detyruar që me shkrim të kërkojmë sqarime për mosrealizimin e rritjes së pagës prej 30% si dhe fillimin e zbatimit të kësaj të drejte.

Provë: Shkresa e datë 19.07.2011.

Referuar kësaj shkrese me datë 11.08.2011, kemi pranuar përgjigjen nga Institucioni përgjegjës, ku në mes të tjerash thuhet të njëjtit nëpunës janë duke marrë ngritjen e pagës prej 30%, jeni rekrutuar për të ndihmuar organin dhe se për ju janë paraparë paga më të mëdha se ato të shërbyesve civil e që të njëjtat janë fikse dhe ju nuk keni koeficient sikurse shërbyesit civil. Ndërsa, në po të njëjtën shkresë thuhet se ju jeni duke marrë rritjen prej 30%.

Prandaj konsiderojmë se kjo përgjigje nuk është e bazuar në ligjet ekzistuese, është kontradiktore dhe për asnjë moment nuk bazohet në prova fakte, sepse sikurse është shpjeguar më lartë, tani ankuesit rekrutohen para hyrjes në fuqi të Vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave, me konkurs është caktuar paga bazë, pa u përfshirë ngritja.

Gjithashtu, tani ankuesit nuk janë rekrutuar për të ndihmuar organin në punën e tij por, janë pjesë e stafit të shërbyesve civil të tij

Provë: Përgjigja e dt.11.08.2011

Prandaj, bazuar në përgjigjen e mësipërme dhe kontradiktore, tani ankuesit detyrohen që të ndjekin rrugë ligjore tjetër me qëllim të realizimit të së drejtës së tyre për realizimin e ngritjes së pagës prej 30%.

Gjithashtu me datë 04.07.2011, tani ankuesit kanë dërguar shkresë për sqarim lidhur me zbatimin e Vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave edhe Ministrisë së Administratës Publike. Po nga e njëjta Ministri, me datë 07.09.2011, pranohet shkresa-konfirmimi, ku thuhet se MAP bën procedimin në sistemin e pagave të kërkesës tuaj për ngritjen e pagave në lartësi prej 30%, sipas Vendimit nr.02/110 të datës 24.02.2010, me kusht që institucioni juaj të ketë një dëshmi me shkrim për ekzistimin e mjeteve të mjaftueshme financiare, në mënyrë që ne të bëjmë ekzekutimin e vendimit të lartpërmendur.

Nga kjo përgjigje, kuptohet se ne gëzojmë të drejtën e realizimit të ngritjes së pagës për 30%, por njëkohësisht kërkohet që institucioni ynë të jap dëshmi se ekzistojnë këto mjete që të bëhet realizimi përfundimtar.

Provë: Shkresa e datës 30.08.2011

Me datës 19.10.2011, tani ankuesit kanë adresuar edhe një shkresë, Prokurorisë së Shtetit-Drejtorisë së Përgjithshme, nëpërmjet së cilës është kërkuar që duke u thirrur në

shkresën e sipër cekur të Ministrisë së Administratës Publike, gjatë hartimit të Buxhetit të Prokurorisë së Shtetit për vitin 2012, të përfshihen mjete të mjaftueshme në mënyrë që të ekzekutohet kjo ngritje e pagës dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/151 i datës 06.01.2011. Kjo kërkesë e tani ankueseve nuk është realizuar dhe as që është dhënë kurrfarë përgjigje lidhur me këtë çështje.

Pas gjithë këtyre shkresave dhe mosrealizimit të kërkesës së tani ankueseve, me datë 08.02.2013, është dërguar edhe një kërkesë për zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/151 për ngritjen e pagave të shërbyesve civil Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku kërkohet që duke u thirrur në të gjitha faktet relevante ligjore dhe duke marrë për bazë tërë procedurën e zhvilluar të cekur si më lartë në këtë ankesë, të merr vendim meritore.

Thirrur në këtë kërkesë, Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur me datë 04.03.2013, vendos që për sa i përket kërkesës së tani ankuesve lidhur me rritjen e pagës për 30% nuk e aprovon me arsyetimin se nëpunësve civil janë jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civil dhe atë duke u thirrur në nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin kalendarik të vitit 2013.

Ky arsyetim dhe baza ligjore e cekur në Vendimin e atakuar është i pa bazuar në gjendjen faktike. Kjo për arsye se neni 10 paragrafi 3 decidivisht e parasheh se "Punonjësit e organizatave buxhetore të institucioneve të pavarura që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civil, nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për shujta, kompensime të tjera dhe rritjen prej 30% sipas Vendimit të Qeverisë.

Siç mund të kuptohet, përshkrimi i nenit 10 paragrafi 3, aspak nuk korrespondon me gjendjen faktike të tani ankuesve, pasi që ata janë shërbyes civil, gjenden në sistemin e pagave të shërbyesve civil dhe po ashtu, ekzistojnë institucione tjera të cilat nuk ju janë mohuar të drejtën e realizimit të ngritjes së pagës prej 30%. Për më tepër, në Vendimin e atakuar, pjesa e I, përmendet koeficienti duke u thirrur në nenin e lartcekur, kurse në realitet ky nen as që flet për koeficient.

Lidhur me këtë çështje, tani ankuesit me datë 14.03.2013 nr. reference 1345, i janë adresuar Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil (MAP), me kërkesë për sqarime në lidhje me zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pagave prej 30% dhe po nga i njëjti institucion është pranuar përgjigja se ekspertet antikorrupsion:

- Janë brenda sistemit të pagave të shërbyesve civil
- Ekzistojnë shërbyes civil në institucionet e Kosovës, të cilët kanë paga fikse dhe e realizojnë të drejtën prej 30% në bazë të Vendimit të Qeverisë.

Provë: Përgjigja e dt. 19.03.2013.

Si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave materiale. Më aktvendimin e ankimuar e drejta materiale është zbatuar në dëm të tani ankueseve, respektivisht nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat nga Ligji mbi Shërbyesit Civil, nuk është respektuar Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/151 i datës 06.01.2011 duke e zbatuar gabimisht dhe dispozitat tjera ligjore të udhëzuara nga kjo dispozitë, të cilat në mënyrë shumë të qartë parashohin veprimet të cilat duhet të ndërmerren apo është dashur të ndërmerren.

Nga sa u parashtrua më lartë, propozojmë që ankesa të aprovohet në alternativën e propozuar në dispozitiv të saj.

Prishtinë;

Me datë: _____

Parashtruesit e Ankesesës:

1. _____
2. _____ etj.

Shëno llogon tuaj
Republika e Kosovës
Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

A/02/467/2019

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje: _____ kryetar dhe _____ anëtarve (të ceur me emër e mbiemër) për shqyrtimin e ankesësën të datës 20.02.2019, e ushtruar nga ankuesit, për shkak të kompenzimit material, duke vepruar konform nenit 16, 17 dhe 18 dhe neni 21 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës si dhe enenin 18 të Rregullores 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe vendosjes së Ankesave në Këshillin e pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën e këshillimit dhe votimit, më datë: 04.03.2019 merr këtë:

V E N D I M

Refizohet ankesa e datës 20.02.2019, e ushtruar nga nëpunësit civil, kundër vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me nr. KPK/nr. 55/2019 të datës 04.02.2019, për kompenzim material në pagë, si e **pa bazuar**.

A r s y e t i m

Ankuesit Nëpunësve civil, të punësuar në Prokurorin Speciale të Kosovës, të pa knaqur me vendimin nr. KPK/nr. 55/2019 të datës 04.02.2019, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që ka të bëjë me ngritjen e pagave prej 30%, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/151 të datës 06.01.2011, me pretendimin se i njëjti është i pa arsyetuar me shkelje procedurale dhe materialet dhe jo ligjorë, me propozim që ankesa të aprovohet ndërsa vendimi të anulohet dhe tu njohët e drejta në kompenzim të cituar si më lartë.

Kolegji i Këshillit të Pavarur Mbikqyrës, në seancën e mbajtur më datë 20.02.2019, për të shqyrtuar ankën e datës 20.02.2019, ka bërë administrimin e provave: kontratën e punës, aktemrimiedatës 26.02.2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/151 të datës 06.01.2011, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/110 të datës 26.02.2010, konkursi i Ministris së drejtësisë nr. refernce MD/PRSK/09-10-01-2010, etj.....(shënohet gjitha provat e paraqitura të cilat gjenden në dosjen e lëndës).

Pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të administruara dhe vlerësimit të secilës veq e veq dhe të gjithave së bashku, Kolegji i Këshillit konstatoi: se ankesa është e **pabazuar**.

KOLEGJI I Këshillit me rastin e vlerësimit të ankesës konstatoi se, nuk është kontestuese se palët, janë rekrutuar dhe përzgjedhur përmes Konkursit të Ministrisë së Drejtësisë nr. refernce MD/PRSK/09-10-01-2010, sipas Ligjit për Shërbimin Civil të R. Kosovës, dhe Rregullores për procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civil, mirëpo i njëjti konkurs dhe pesë pozitat e rekrutuara janë krijuar me procedurë të veçantë në bazë të Vendimit nr. 02/110 të datës 26.02.2010,, me pozitë të veçantë dhe me pagë fikse (pa koeficient për shërbyes civil), e cila ka qenë dukshëm më e madhe se e nëpunësve në shërbimin civil sepse pozitat e tilla nuk janë krijuar nga Organogrami i institucionit, por nga nevoja që ka pasur institucioni lidhur me kryejën e punëve në këtë Departament.

Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/151 të datës 06.01.2011, për ngritjen e pagave prej 30% për të gjithë shërbyesit civil, që parashihet në pikën 4 të këtij vendimi, nuk ka mundur të zbatohet në rastin konkret nga shkakku se ankuesit nuk bëjnë pjesë në këtë pikë sa i përket pagës të cilën aktualisht e marrin dhe nuk e kanë sistemin e përcaktuar të pagës në bazë të Ligjit për Shërbimin civil dhe nuk janë të barabartë me shërbyesit civil në këtë drejtim.

Vendimi në fjalë që të mund të zbatohet edhe ndaj ankuese është dashur që rritjen e pagës për 30% ta përcaktoj me pikë të veçantë ashtu siç ka vepruar në pikën 2, 3 dhe 5 për ngritje të pagës, në vendimin për ngritje pagash.

Kolegji i Këshillit, pasi e vlerësoi vendimin e ankimuar sa i përket pretendimeve të ankuesve, konstaton se vendimi i ankimuar është vendim i drejtë, ligjorë i arsyetuar mirë dhe i bazuar në dispozita procedurale dhe materiale, pasi që i njëjti ka arsyetimin e duhur lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesve dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë, sepse edhe sipas mendimit të këtij kolegji, ankuesit, janë të përjashtuar nga vendimi i Qeverisë nr.02/151 i datës 06.01.2011, për ngritjen e pagës në 30% të pagës pbazë.

Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
A/02/467/2019 të datës 04.03.2019

Kryetari i Kolegjit

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, ka të drejtë të hapë procedurën e konfliktit administrativ me padi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- ankuesve ekspertët antikorrupsion
- PPSH-së
- Burimeve Njerzore në Prokurorin e Shtetit
- Arkiv

Shembulli i 4-të çështjet e Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Paisje Medicinale.

LIGJI NR. 04/L -190 -PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE, në bazë të Nenit 5 Inspektoratit Farmaceutik me:

par.1. përcaktohet se Inspektorati Farmaceutik ushtron mbikëqyrjen e jashtme të prodhuesve, portuesve, qarkulluesve me shumicë dhe pakicë të produkteve medicinale dhe të pajisjeve edicinale, nëpërmjet vlerësimit të përsëritur të performancës, përcjelljes, si dhe inspektimeve ad-hoc dhe me kërkesë.

Në bazë të udhëzimit Administrativ 08/2009 për Inspektoratin Shendetesor per Produkte dhe Pajisje Medicinale, përcaktohen kompetencat të drejtat dhe detyrat e Inspektoriatit farmaceutik të Produkte dhe Paisje medicinale:

**Shëno llogon tuaj
REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria**

**Ministria e Shëndetësisë
Inspektoriat Farmaceutik për Produkte dhe Paisje Medicinale**

Inspektoriat i IFPPM-së:

Nr. serik 004260

Datë: 05.03.2019

Procesverbal mbi Inspektimin e Bërë

Filloi ora: 11:00

Në: Barnatoren “Drita”, në Kaçanik rr. Bill Kllinton nr. 65 me nr. Bizn. 12357, personi përgjegjës: Ali Aliu pronar i Barnatores.

Të pranishëm:

Për palën:

1. L.L-puntor

2. _____

Personat e Autorizuar:

1. K.L-inspektor

2. P.P-inspektor

Me rastin e inspektimit u konstatua kjo gjendje: Pala apo pronari i Barnatores ka aplikuar për licencën për barnatoremë datë 20.02.2019, me nr. Të prot. 476. Sot inspektorët bënë përpjekje për të kontaktuar me përgjegjësin mirëpo i njëjti nuk ishte prezent dhe mos prezencën nuk e arsyetoi.

Duke marrë parashysh të gjeturat gjatë këtij inspektimi:

Urdhërohet që: Barnatorja të mos e ushtrojë veprimtarinë e sajë, deri në licencimin e ligjshëm me vendim nga organi kompetent.

Vërejtjet në procesverbal _____

Përfundoi ora: _____

Procesverbali është përpiluar në katër kopje, prej të cilave, dy kopje ju lanë palës së inpektuar, ndërsa dy të tjera organit kompetent.

Për palën: _____

Për Inspektoriatin: _____

Inspektorët: _____

Shëno llogon tuaj
REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria

Ministria e Shëndetësisë
Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale
Inspektoriati Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale

Nr. 12/2019
10.03.2019

Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 46 të Ligjit për nr. 04/L-125 për Shëndetësi, nenit 26 par. 1 pika 1 lidhur me dispozitën ligjore të nenit 37 dhe 39 të Ligjit nr. 03/L-188 për Produkte dhe Pajisje medicinale dhe të dispozitave të nenit 4, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit për Produkte dhe Pajisje Medicinale nr. 08/2009, AKPM-Inspektoriati Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Mdecinale merr:

V E N D I M

I. I Urdhërohet, Qarkulluesit Farmaceutikme Pakicë Barnatores “Drita”, në Kaqanik rr. Bill Kllinton nr. 65 me nr. biznesi. 12357, që të operojë vetëm me staf të kompletuar professional conform Udhëzimit Administrativ nr. 14/2013.

II. Personi juridik barnatorja “Drita”, është përgjegjës për shkeljen e dispozitave ligjore të Ligjit 03/L-188, nenit 18 par. 1 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 14/2013 për Qarkulluesit Farmaceutik me pakicë e paraparë me nenin 13 par. 2 nën par. 2.1 dhe nenit 15 par. 1.2 të këtij Udhëzimi, e pët të cilat shkejele ndëshkohet: me gjobë në vlerë prej 2000 (dy mijë) euro.

III. Gjoha e shqiptuar (prej 2000 euro), duhet të paguhet në afat prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij vendimi në xhirollogarinë (10003000927539187623) e Ministrisë së Shëndetësisë së R. Kosovës.

IV. Ankesa e ushtruar, kundër këtij vendimi, nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

A r s y e t i m

Inspektoriati Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale, më date 05.03.2019, ka kryer kontrollin inspektues, në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë, Barnatoren Drita me seli në Prishtinë, me çrast me procesverbalin e datës 05.3.2019, ka konstatuar se 9 barnatorja është hasur duke operuar pa praninë e farmacistit) duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Udhëzimit Admnistrativ nr. 14/2013, për Qarkulluesit

Farmaceutik me Pakicë respektivisht duke bërë shkelje të nenit 13 par. 2 nën parë 2.1 të këtij Udhëzimi.

Bazuar në theksimete cekura më lartë, dhe në dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi dhe rregullojnë këtë materie, u vendos sin ë dispozitiv të këtij vendimi.

Kryeinspektori:

Këshilla Juridike:

Pala e paknaqur me këtë vendim, ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij vendimi, në Bordin e Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale.

Vendimi i dërgohet:

- palës
- arkivit

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2009 Inspektorati Shendetësor për Produkte dhe Pajisje Medicinale Ministria e Shendetësisë, Nenin 8 parashihet E drejta e ankesës:

1. Pala e pakënaqur me masat e shqiptuara nga ana e inspektorëve ka të drejtë, që brenda 8 (tetë) ditëve, të parashtrijë ankesë në Inspektoratin Shendetësor për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Me par. 3. të këtij neni, përcaktohet se Ankesa e ushtruar në pajtim me paragrafin 1. nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

AGJENCIONIT TË KOSOVËS PËR PRODUKTE MEDICINALE

Bordit të Ankesave

Të pa knaqur me vendimin nr. Nr. 12/2019 të datës 10.03.2019, conform rregullativës ligjore parashtrijmë këtë:

A N K E S Ë

- Për shkak të shpëljes së dispozitave procedural e të LPPA-së dhe
- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike

A r s y e t i m

Ankesën e parashtrijmë për të kërkuar anulimin e gjobës së shqiptuar sepse mendojmë se me rishikimin e serishëm të lëndës nga ana e Bordit të Ankesave, do të vërtetohet se është bërë vërtetimit i gabuar i gjendjes me rastin e inpektimit të bërë e krejt kjo ka ndikuar në marrjen e një vendimi të paligjshëm dhe me shqiptimin e gjobës në mënyr të padrejtë.

Në raport me gjobën e shqiptuar deklarojmë se vendimi është është i pa drejtë dhe jo i argumentuar sepse i njëjti nuk është mbështetur në asnjë provë të vlefshme për arsye se barnatorja Drita me seli në Prishtinë, ka të punësuar në stafe të mjaftueshëm profesional, si farmacist, teknikun e farmacisë dhe furnizuesi-shitësi. Të gjitha këto konform nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MSH 14/2013, barnatorja Drita, posedon kontrata të vërtetuara për të punësuarit në barnatore, të cilat parqesin edhe kusht për marrjen e licencës.

Me rastin e inspektimit në barnatoren tonë, inspektorët nuk kanë pasur durimin e duhur që të preson 10 min farmacistin e barnatores i cili ka qenë rrugës për në Barnatore.

Andaj nga të gjitha këto arsye të cekura më lartë, konsiderojmë se gjoba në shumën prej 2000 (dy mijë) euro, është e padrejtë, jo e argumentuar dhe si e tillë është

sistematike dhe tendicioze, me qëllim që duke shqiptuar gjobë mund të vijë deri te një pozitë që të pa mundësohet ushtrimi i veprimtarisë ë këtij bioznesi.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë:

P r o p o z o j m

Bordit të Ankesave në AKPM, që pas shqyrtimit me kujdes të këtij rasti të merr vendim me të cilin do ta anuloj vendimin nr. 12/2019, të datës 10.3.2019, dhe parashtruesin e ankesës ta lirojë nga Gjoba e shqiptuar, me anë të këtij vendimi.

Prishtinë, Datë _____

Parashtruesi i Ankesës _____

Përfaqësuesi _____

Në bazë të LIGJI NR. 04/ -190 PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE, respektivisht nenit 8 par. 1. parshikohet se: Bordi i Ankesave ka përgjegjësinë për shqyrtimin e çdo ankese të ngritur nga një subjekt ose person fizik, përkitazi me vendime të nxjerra nga AKPPM, në bazë të këtij ligji dhe akteve nën-ligjore të nxjerra në pajtim me këtë ligj.

Kundër vendimit përfundimtar, mund të ngritet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh.

Shëno llogon tuaj
REPUBLIKA E KOSOVËS
Qeveria
Ministria e Shëndetësisë
Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale
Bordi i Ankesave

Agjencia e Produkteve Medicinale - Bordi i Ankesave, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 04/L-190 Për produkte dhe Pajisje medicinale, nenit 8 par. 1 pika 1, dispozitave të LPPA-së, shqyrtoi ankesën nr. 791 e datës 19.03.2019, të qarkulluesit farmaceutik Barnatorja Drita me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër vendimit të Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale nr. 12/2019 të datës 10.03.2019, më datë 25.04.2019, merr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet Ankesa nr. 791 e datës 19.03.2019, e Qarkulluesit Farmaceutik Barnatores “Drita” me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër vendimit nr. 12/1019 të datës 10.03.2019, të Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale, si e **pabazuar**.

II. Mbetet në fuqi vendimi nr. 12/2019 i datës 10.03.2019, i organit të shkallës së parë, Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

A r s y e t i m

Inspektorët e Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me rastin e kontrollimit inspektues të Qarkulluesit farmaceutik Barnatorja Drita, përmes procesverbalit të kontrollit me nr. 004260 të datës 05.03.2019, kanë konstatuar se qarkulluesi farmaceutik i sipërshtënuar, ushtron veprimtarinë e barnatores, përkatësisht produktet medicinale për përdorim tek njerzit, disponzohen dhe qarkullojnë me pakicë pa prezencën e farmacistit të licencuar.

Organi i shkallës së parë, Inspektoriati Farmaceutik për Produkte dhe Paisje Medicinale, me vendimin nr. 12/2019 të datës 10.03.2019, Qarkulluesit Farmaceutik barnatores Drita me seli në Prishtinë, e ka urdhëruar që veprimtarinë e sajë ta ushtrojë vetëm në prezencën e farmacistit të licencuar, për arsye se e njëjta ka operuar pa farmacist të licencuar, duke ra ndesh me dispozitat ligjore të nenit 13 par. 1 pika 3 të UA nr. 014/2013, për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Paisje Medicinale, ku për shkak të ktyre parregullsive të gjetura dhe shkeljes së dispozitave ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë materie, qarkulluesit farmaceutik me pakicë barnatores Drita me seli në Prishtinë, i është shqiptuar gjoha në vlerë prej 2000 (dy mijë) euro.

Qarkulluesi Farmaceutik me Pakicë sipërshënuar, brenda afatit ka ushtruar ankesë, në të cilën ndër të tjera ka theksuar se e kundërshton vendimin e ankimuar të organit të shkallës së parë, duke potencuar se çdo herë ky subjekt veprimtarinë e ushtron në prezencën e farmacistit, mirëpo ditën kritike inspektorët nuk kanë pasur durim të presin 10 min derisa farmacisti të vije në punë sepse i njëjti ka qenë rrugës duke ardhur, me propozim që organi i shkallës së dytë ta anuloj vendimin dhe të njëjtin ta liroj nga gjoha e shqiptuar.

Bordi i Ankesave si organ i shkallës së dytë, pasi i shqyrtoi pretendimet e Qarkulluesit Farmaceutik me pakicë Barnatores Drita, dhe pasi vlerësoi edhe vendimin e organit të shkallës së parë i kontestuar me ankesë, konstatoi se të njëjtat pretendime janë të pabazuara në fakte dhe prova dhe në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar faktike dhe të njëjtat nuk i arsyetojnë shkeljen e dispozitave ligjore të ligjeve në fuqi të cilat e rregullojnë këtë materie, ngase sipas dispozitave të nenit 13 par. 1 pika 3 të Udhëzimit Administrativ MSH nr.11/2015 për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Paisje Medicinale parashihet *“Në rastet kur farmacisti përgjegjës nuk mund të jetë prezent në barnatore, barnatorja është e obliguar që të angazhojë farmacist të licencuar zëvendësues”*, norma këto të sanksionuara me dispozita të këtij Udhëzuesi.

Nga kjo dispozitë ligjore vërtetohet se qarkulluesi farmaceutik me pakicë ka rënë ndesh me këtë shkelje ligjore, ku duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-190 për Produkte dhe Paisje Medicinale në nenin 37, parashihet se në rast të shkeljes së kësaj dispozite ligjore të cekur më lartë, subjektet të cilët bien ndesh me kto dispozita dhe të tjerat që janë në fuqi, jzanë subjekt i ndëshkimit me anë të gjobave dhe masave të tjera, ku në rastin konkret barnatorja Drita për shkak të mosrespektimit të ktyre dispozitave ligjore, është gjobitur me gjobë në lartësi prej 2000 (dy mijë) euro, e cila gjobë është ekuivalente me shkeljet e gjetura.

Andaj bazuar, në të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- IFPPM
- Barnatores Drita
- Arkivit

Bordi i Ankesave:

- 1.
- 2.
- 3.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pa knaqur, në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së këtij vendimi, ka të drejtë të ushtroj padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative.

Shembulli 5-stë, kontest nga Minsitria e Infrastrukturës

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 251 dhe 252 të Ligjit Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor dhe nenit 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007. Me qëllim të përcaktimit të kushteve dhe procedurës për licencimin e pyetësve, nxjerr: Udhëzim Administrativ nr.2008/2 Për licencimin e pyetsit, ku në nenin nenin 1 përcaktohet se me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësoj kandidati për licencim për pyetës (ekzaminër), mënyra e dhënies së provimit, kriteret e vlerësimit, programi, pezullimi dhe revokimi i licencës së pyetësit.

Shëno llogon tuaj
Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Infrastrukturës
L A J M Ë R I M

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 2008/2 për Licencimin e pyetsit, Ministria e Infrastrukturës organizon provimin për Licencimin dhe rilicencimin e tyre.

Për të aplikuar për licencim respektivisht ri licencim, kërkohen këto dokumente:

- Aplikacioni
- Dëshminë për Prgaditje profesionale dhe vërtetimin për përvojën e punës,
- Letërnjoftimin ose pasaportën valide,
- Dëshminë e lëshuar nga Gjykata që kandidati nuk ka pengesa ligjore për ushtrimin e veprimtarisë.

Si dhe dokumentacioni shtesë sipas nenit 3 dhe nenit 13 të U.A 2008/2

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, për verifikim prezantohet origjinali.

Afati për paraqitjen e provimit fillon nga data 15.06.2018 deri më datë 20.06.2018.

Paraqitja e provimit bëhet në adresën Ministria e Infrastrukturës, në Prishtinë

Provimi mbahet më datë 22.06.2018 në Ministrinë e Infrastrukturës, duke filluar nga ora 14:00.

Për çdo ndryshim të datës, orës dhe vendit të mbajtjes se provimit do të njoftoheni përmes web faqes së Ministrisë së Infrastrukturës.

(Aplikacioni gjendet online në web portalin e Ministrisë së Infrastrukturës)

“[shëno logon tuaj]”
Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Infrastrukturës

Nr. 3460/2018
Datë 24.06.2018

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 38 të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr.82,21 tetor 2010), neni 103.1 të Ligjit nr.02/L-28 për rProcedurën Administrative, neni 17 paragrafi 5 dhe 6, neni 38 par 3, të Rregullorës nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (datë 22.03.2011), neni 252 të Ligjit nr.02/L-70 për Siguri në Komunikacion Rrugor, Udhëzimit Administrativ nr. 2008/2 për Organizimin e Provimit për Licencimin e Pyetësit, neni 5 paragrafi 5.4. c) të Rregullores nr.2001/19 për Degën e Ekzekutivit, merrë këtë:

V E N D I M

I. ANULOHET provimi për Licencimin dhe Ri-licencimin për pyetës i mbajtur me datë 22.06.2018.

II. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ministria e Infrastrukturës-Departamenti i Automjetëve, gjegjësisht Divizioni për Autoshkolla, ka shpallur Lajmrimin me datë 14.06.2018 në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës për organizimin e provimit për Licencim dhe Ri-licencim për pyetës i paraparë të mbahet me datë 22.06.2018.

Në nenin 9 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 për Organizimin e Provimit për Licencimin e Pyetësit, është përcaktuar se Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe anëtarët e komisionit.

Me vendimin nr.3288 të datës 20.06.2016, është emruar komisioni për mbajtjen e provimit për Licencim dhe përtëritje të licencës. Komisioni me datë 22.06.2016, ka mbajtur provimin për Licencim dhe Ri-licencim për pyetës, në bazë të Raportit të Komisionit nr.3409 i datës 23.06.2016 dhe listës për pyetës të datës 22.06.2016,

Komisioni ka vepruar në përbërje jo të plotë. Në komision nuk ka marrë pjesë anëtarja e tretë e komisionit, nga ky fakt shihet se Komisionit i ka munguar përbërja e plotë për të vepruar si komision.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni:

Kryetari _____

Anëtari _____

Anëtari _____

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtoj ankesë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimt të këtij vendimi, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Ministrisë së Infrastrukturës.

Vendimi ju dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm;
- Departamentit Automjeteve dhe
- Arkivit të MI-së.

“[shëno logon tuaj]”
Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Infrastrukturës

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë personat të cilët kanë aplikuar për licencim dhe për përtëritje licencës për pyetës, se me vendimin Nr. 3460 të datës 24.06.2018, është anuluar provimi i mbajtur me datë 22.06.2018, për licencim dhe përtëritje të licencës për pyetës.

Ministria e Infrastrukturës-Departamenti Automjeteve, përmes web faqes zyrtare, do t'ju njoftoj për datën dhe orën e mbajtjes së provimit për pyetës.

Prishtinë, datë 25.06.2018

*Në bazë të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr.2008/2 PËR LICENCIMIN E PYETËSIT respektivisht nenit 19 Procedura e ankimit, përcaktohet:
par. 1. se pyetësi ka të drejtë të ushtroj ankesë në Ministri në pajtim me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative.*

**Ministrinë e Infrastrukturës
Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave**

Bazuar në dispozitën e nenit 19 par. 1. të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr.2008/2 PËR LICENCIMIN E PYETËSIT, paraqesë këtë:

A N K E S Ë

Kundër vendimit Nr.3460/2018 të datë 24.06.2018, të organit të shkallës së parë, për shkak të:

- shkeljes së dispozitave procedurale të LPPA-së
- konstatimit të gabuar të gjendjes faktike

A r s y e t i m

Me datë 22.06.2018, është mbajtur provimi për pyetës, po atë ditë është komunikuar rezultati dhe kam kaluar provimin.

Ndërsa, me vendimin nr. 3460/18 me datë 24.06.2018, të shpallur në ëeb faqen e Ministrisë së Infrastrukturës sipas të cilit njoftim është anuluar provimi në mënyrë të pa drejt, pa asnjë sqarim të shkruar ose elektronik.

Vendim të cilin e kundërshtoj si të pa drejtë, ka të bëjë me anulimin e provimit pasi që un si kandidat ju kam nënshtruar të gjitha procedurave dhe mbajtjes së provimit. E kjo është bër edhe pasi që un si kandidat jam njoftuar se të njëjtin testim e kaluar.

Vendimin e kundërshtoj si të pa drejtë pasi që nuk ka pasur asnjë arsye të ligjshme, për tu anuluar i njëjti, pasi që i jam nënshtruar dhe e kam kaluar.

Organi i shkallës së parë nëse vetm kanë ekzistuar shkeljet siç potencohen në vendim e të cilat kanë ardhur deri te anulimi i procedurës së konkurrimit dhe i të gjitha rezultateve pas saj, nuk është dashur që të vazhdoj më tutje me procedurën.

Bazuar në të cekurat dhe në gjithë rrjedhën e çështjes,

P r o p o z o j

I. Të aprovohet ankesa e paraqitur A. S. Nga Prishtina e datës 30.06.2018.

II. Vendimi nr. nr. 3460/18 me datë 24.06.2018, i organit të shkallës së parë, të anulohet si i kundërligjshëm.

III. A.S nga Prishtina, i njihet provimi i dhënë sipas rezultateve të shpallura, dhe ti ipet licenca për pyetës.

Parashtruesi i ankesës

A.S. Nga Prishtina,
Rruga “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, Prishtinë.

Datë: 30.06.2018

*Në bazë të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr.2008/2 PËR LICENCIMIN E PYETËSIT respektivisht nenit 19 Procedura e ankimit, përcaktohet:
par.2. se komisioni i emëruar nga 1 vendos lidhur me ankesën.*

“[shëno logon tuaj]”
Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Infrastrukturës

Nr. 3810/2016
15.07.2018

Në bazë të Ligjit nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Udhëzimit Administrativ Nr.2008/2 për Licencimin e Pyetsit nenit 19 par. 2, duke e shqyrtuar ankesën e palës të parashtruar më datë 30.06.2018, kundër vendimit të organit të shkallës së parë nr. 3460/18 me datë 24.06.2018, Komisioni për shqyrtimin e Ankesave, merr:

V E N D I M

I. Refuzohet ankesa e A.S nga Prishtina, e datës 30.06.2018

II. Mbetet në fuqi vendimi nr. 3460/18 me datë 24.06.2018, i organit të shkallës së parë.

A r s y e t i m

Me vendimin e organit të shkallës së parë me nr. 3460/18 me datë 24.06.2018, është anuluar provimi për Licencimin dhe Ri-licencimin për pyetës i mbajtur me datë 22.06.2018.

Lidhur me këtë vendim kandidatët të cilët ju kanë nënshtruar këtij provimi janë Njoftuar përmes ëeb portalit të Ministris së Infrastrukturës, me njoftimin e datës **25.06.2018**.

Me të njëjtin njoftim Ministria e Infrastrukturës-Departamenti Automjeteve, ka theksuar se përmes ëeb faqes zyrtare, do t’ju njoftoj për datën dhe orën e ri-mbajtjes së provimit për pyetës.

Në vendimin e kundërshtuar të organit të shkallës së parë, respektivisht në arsyetimin e vendimit thuhet se: *“Në nenin 9 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 për Organizimin e Provimit për Licencimin e Pyetësit, është përcaktuar se Komisioni përbëhet nga Kryetari dhe anëtarët e komisionit.*

Me vendimin nr.3288 të datës 20.06.2016, është emruar komisioni për mbajtjen e provimit për Licencim dhe përtëritje të licencës. Komisioni me datë 22.06.2016, ka mbajtur provimin për Licencim dhe Ri-licencim për pyetës, në bazë të Raportit të Komisionit nr.3409 i datës 23.06.2016 dhe listës për pyetës të datës 22.06.2016, Komisioni ka vepruar në përbërje jo të plotë. Në komision nuk ka marrë pjesë anëtarja e tretë e komisionit, nga ky fakt shihet se Komisionit i ka munguar përbërja e plotë për të vepruar si komision”.

Njëjtë sikurse edhe organi i shkallës së parë, edhe ky Komision vlerëson se provimi për licencimin dhe rilicencimin e pytësit, është mbajtur në kundërshtim me nenin 9 të U.A nr.2008/2, andaj i njëjti është dashur të anulohet, dhe vendimi i organit të shkallës së parë është i drejtë i ligjshëm, për arsye se procedura për mbajtjen e provimit është mbajtur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në bazë të cekurave më lartë u, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Kshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Kryetari i Komisionit

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës

Në kuptim të dispozitave ligjore të LPPA-së, kundër vendimit nr.3810/2016 të datës 15.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe vendimit nr.3460 datë 24.06.2018, mbi anulimin e provimit për licensim dhe ri liçencim të Ministrisë së Infrastrukturës.

Në pajtim me nenin 50 dhe 82 parag. 2, të Ligjit nr. 03/L-149, mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 12 të Rregullorës nr. 05/2011 për procedurat e zgjedhjeve të kontesteve dhe të ankesave paraqes këtë:

A N K E S Ë

Për shkak të:

Shkeljes së Ligjit 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ligjit nr. 02/L-28, për procedurën administrative, ligji nr. 02/L-70, për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, ligji nr.05/L-064, për Patentë Shofer dhe Udhëzimit administrativë nr. 2008/2 për licencimin e pyetësit, dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithëshme Administrative.

A r s y e t i m

Ministria e Infrastrukturës me datë 14.06.2018 për licencimin e pyetësit, publikon lajmërimin duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr..2008/2, mbi organizimin e provimit të licencimit, me afat të paraqitjes së provimit nga data 15.06.2018 – 20.06.2018.

Prova: Lajmërimi

Ankuesi i nënshtrohet provimit me datë 22.06.2018 para komisionit për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës në përbërje prej 3 (tre) anëtarësh i emëruar me vendim nr.3288 të datës 20.06.2018, që ka qenë i pranishëm gjatë tërë kohëzgjatjes deri sa ka përfunduar provimi. Pas përfundimit të provimit ankuesi është njoftuar se ka kaluar provimin, duke e komunikuar komisioni rezultatin se kush e ka kaluar e kush jo, mirpo organi i punësimit nuk e ka bërë njoftimin me shkrim.

Mirëpo me datë 24.06.2018 në Ëeb faqe është publikuar njoftimi pa datë dhe pa nënshkrim, në emër të Departamentit të Automjeteve të Ministrisë së Infrastrukturës, me të cilin njoftohet ankuesi dhe të tjerët se: “me vendimin 3460 të datës 24.06.2018 është anuluar provimi i mbajtur me datë 22.06.2018 për licencim dhe përtëritje të licencës për pyetës”, mirëpo pa e publikuar vendimin dhe pa i’u dorëzuar ankuesit dhe të tjerëve, por as arsyet për të cilat është marrë një vendim i tillë.

Prova: Njoftimi

Ankuesi i pakënaqur me vendimin mbi anulimin me datë 30.06.2018 i është drejtuar Komisionit për Zgjedhje të Kontesteve dhe Ankesave, me ankesën nr. 3542 me pretendimet ankimore se vendimi nr. 3460, i datës i cili nuk i është dorëzuar ankuesit por është publikuar në Eëb faqen zyrtare me të cilin i është anuluar provimi i kryer dhe komunikuar nga Komisioni është i padrejtë dhe i kundërligjshëm.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me vendimin nr. 3810 të datës 15.07.2018, refuzon ankesën si të pa bazuar, me arsyetimin se, “Komisioni kishte vepruar në përbërje jo të plotë dhe në punën e komisionit nuk ka marrë pjesë anëtarja e tret e komisionit dhe ky aktivitet nuk ka qenë në përputhje me udhëzimin administrativ nr.2008/2” dhe se vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës ishte i bazuar dhe i arsyetuar ashtu siç duhet.

Prandaj nga rrjedhat e përshkruara më lartë nga lajmërimi për organizimin e provimit për licencim dhe ri licencim, e deri te vendimi i komisionit për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës konstatohet se:

Anulimi i organizimit, mbajtjes së provimit dhe rezultateve të provimit të treguar nga kandidatët dhe ankuesi në këtë rast, të cilët i janë nënshtruar para komisionit për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës është e padrejtë, e pa qëndrueshme dhe në kundërshtim me procedurat dhe ligjin.

Arsyetimi i vendimit nr. 381082018, të lëshuar nga Komisioni për Zgjidhjen të Kontesteve dhe Ankesave, është i pa mbështetur në të drejtën materiale dhe faktike, sepse është i paqëndrueshëm dhe e pa vërtet se njëri nga anëtarët e komisionit ka munguar, ku me vetë faktin se një nga provat e administruar cek edhe raportin e komisionit nr.3409 të datës 22.06.2018, i cili është zyrtarizuar me rastin e protokollimit të tij dhe e dyta nuk jepet asnjë dëshmi se komisioni ka konstatuar ndonjë parregullsi, qoftë para, gjatë dhe pas përfundimit të provimit.

Përkundrazi komisioni pas përfundimit ka thirrur me emër sipas listës dhe sistemit të vlerësimit “shabllon”, dhe duke i komunikuar rezultatin me “kalo” dhe “nuk kalo”, secilit kandidat që i është nënshtruar provimit.

Me nenin 1 parag. 3 të ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se në shërbimin civil administrata publike e institucionit duhet që të bëjë avancimin e karrierës si dhe në zhvillim profesional të nëpunësve civil, që në rastin konkret ministria ka penguar gjegjësisht ka shkelur të drejtën për zhvillimin profesional me licencimin për pyetës.

Sipas nenit 5 parag. 1 nën-parag. 1.7 të ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovës, mbi parimet e shërbimit civil, çartë është përcaktuar me parimin e transparencës, se proceset në shërbimin civil duhet të jenë të hapura, ndërsa në rastin e organizimit të provimit, ankuesit nuk i është dorëzuar vendimi mbi anulimin e provimit, sepse me që ka të bëjë me realizimin e një të drejte nga marrëdhënia e punës ka qenë gabim ligjor.

Me njoftimin e datës 24.06.2018 dhe vendimin mbi anulimin e provimit për licencim dhe rilicencim, nr.3460 të datës 24.06.2018, organi i punësimit ka shkelur nenin 35 të ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: “nëpunësit civil kanë të drejtë dhe janë të detyruar t’i rrisin aftësitë e tyre profesionale përmes trajnimit të shërbimit civil. Nëpunësit civil mund të autorizohen që të marrin pjesë në programe speciale arsimore jashtë shërbimit civil, me kusht që këto programe të jenë të rëndësishme për Shërbimin Civil të Kosovës”, gjë që anulimi i provimit të kaluar në procedurë të rregullt është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimin dhe obligimin ligjor sipas nenit në fjalë.

Anulimi i rezultatit përfundimtar të provimit të kryer nga Komisioni për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës me vendimin e paarsyetuar dhe vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, po ashtu të pa arsyetuar dhe të pa bazë të mbështetjes në gjendjen faktike dhe materiale është në kundërshtim edhe me nenin 55 të ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: “ është detyrë e administratës publike që ti heqë të gjitha pengesat administrative, të cilat i kufizojnë liritë dhe barazinë e nëpunësve civil të cilat pengojnë zhvillimin e tyre profesional dhe i kufizojnë mundësitë për pjesëmarrje efektive në realizimin e qëllimeve të vendosura për shërbimin civil.

Zyrtari kryesor administrativ që është më statusin e nëpunësit të lartë drejtues civil, por edhe Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, kanë nxjerrë dhe vërtetuar vendime mbi anulimin me ndikim politik, janë përgjegjës sepse kanë vepruar në kundërshtim me nenin 55 parag. 2 të ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mbi detyrimin për informim dhe arsyetim të veprimeve administrative, ku thuhet se: “nëpunësit civil duhet ti ofrojnë arsyeime adekuate për të gjitha veprimet dhe vendimet e marra gjatë ushtrimit të funksionit të tyre”.

Anulimi i raportit të komisionit për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës, nr.3409 të datës 22.06.2018, si akt administrative që krijon pasoja juridike për realizimin e të drejtave të ankuesit është në kundërshtim me nenin 2 të ligjit 02/L-28, mbi procedurën administrative, zyrtari kryesor administrativ dhe komisioni për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave, me vendimet e veta kanë rënë ndesh me parimin e objektivitetit dhe paanshmërisë të të njëjtit ligj neni 7 parag.7.2, ku çartë është e përcaktuar se: “Organet e Administratës Publike sigurojnë se veprimtaria e tyre nuk është e influencuar nga interesa private, ose personale, ose paragjyqime të nëpunësve, që ushtrojnë këtë veprimtari”. Po ashtu edhe me parimin e publicitetit të përcaktuar me

nenin 9 parag.9.1 të të njëjtit ligj, ku thuhet se: Organet e Administratës Publike, ushtrojnë veprimtarin administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizik dhe juridik të përfshirë në të”, duke mos i ofruar ankuesit aktet administrative të cilat kanë të bëjnë më të drejtat e tij, nga marrëdhënia e punës.

Anulimi i provimit të kaluar nga ankuesi dhe njëherit edhe i raportit të komisionit për vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës nr. 3409 të datës 22.06.2018, si akt administrativ është në kundërshtim me nenin 92 të ligjit nr. 02/L-28, mbi procedurën administrative ku çartë është përcaktuar se kur mund të shpallët një akt administrativ i pavlefshëm.

Andaj kërkoj nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të shqyrtoj ankesën e ankuesit dhe në bazë të provave të bashkangjitura:

P r o p o z o j

APROVOHET ankesa e A.S si e bazuar;

ANULOHET njoftimi i datës 24.06.2018 dhe vendimi mbi anulimin e provimit për licencim dhe ri licencim nr.3460 i datës 24.06.2018, dhe mbetet në fuqi Raporti i Komisionit për Vlerësimin e njohurive të kandidatëve për pyetës nr.3409 të datës 22.06.2018.

Obligohet Ministria e Infrastrukturës që ankuesit ti lëshoj licencën për pyetës – ekzaminer, konform ligjit në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Me respekt!

Paraqitësi i ankesës

Më 30.06.2018

A.S

Shëno llogon tuaj

A/02/327/2017

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: L.P, kryetar, G.G dhe H.S, anëtarë, për shqyrtimin e ankesës të datës 12.08.2017, të parashtruar nga ankuesi Z.Z, kundër organit të punësimit Ministrisë së Infrastrukturës, në çështjen juridike anulim i provimit për licencim dhe përtëritje të licencës së pyetësit, duke vepruar në pajtim me nenin 10 parag. 1.1, Ligjit nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 16 parag. 1.4 të Rregullores nr.02/2014, për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.09.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. Obligohet Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, që ankesën e ankuesit Z.Z., të datës 30.06.2017, ta dërgoj për vendosje tek organi kompetent në pajtim me nenin 18 paragrafi 18.1 pika b) e Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

II. Shpallet Akt absolutisht i pa vlefshëm vendimi nr.3810/2017 i datës 15.07.2017, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në ministrinë e Infrastrukturës që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi, Z.Z., i punësuar në pozitën Zyrtar në Njësinë e Patentë Shoferit, në Prizren/Ministria e Infrastrukturës, më dt.22.06.2017,i është nënshtruar provimit për licencim dhe përtëritjen e licencës së pyetësit. Komisioni për mbajtjen e provimit për licencimin dhe përtëritjen e licencës së pyetësit, i emëruar sipas vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës të datës 20.06.2017, me datë 23.06.2017, ka nxjerr Raportin për licencim dhe përtëritjen e licencës për pyetës nga pjesa teorike.

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës më datë 24.06.2017, ka nxjerr vendim me nr.3460/2017, me të cilin ka bërë anulimin e provimit për licencim dhe përtëritjen e licencës për pyetës, me arsyetimin se komisioni ka vepruar në përbërje jo të plotë.

Ankuesi i pa kënaqur me këtë vendim, me datë 30.06.2017, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës me datë 15.07.2017, ka nxjerrë vendim me nr.3810/17, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi, i pa kënaqur me vendimin nr. 3810/2017 të datës 15.07.2017, të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.08.2017, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.08.2017, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Ministria e Infrastrukturës për përgjigje në ankesë. Me datë 26.08.2017, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës (faqe 1-14).

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa e dt.12.08.2017, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi nr.3810/2016 i datës 15.07.2017, i Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, njoftimi nga ministria e Infrastrukturës, Lajmërimi nga Ministria e Infrastrukturës, përgjigjen në ankesë të datës 26.08.2017.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresa e lëndës, dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur duke obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, që ankesën e ankuesit Z. Z., të datës 30.06.2017, ta dërgoj për vendosje tek organi kompetent në pajtim me nenin 18 paragrafi 18.1 pika b) të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi ankesën e tij kundër anulimit të testit, është dashur ta parashtroj në Komisionin e posacëm për ankesa të cilin e formon Ministri i Infrastrukturës, ashtu siç parasheh neni 19 paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/2 për Liqencimin e Pyetësit, i cili përcakton se: Pyetësi ka të drejtë të ushtroj ankesë në Minsitri në pajtim me Ligjin e Procedurës së

Përgjithshme Administrative. 2. Komisioni i emëruar nga Ministri vendos lidhur me ankesën”.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se për ankesën e ankuesit të datës 30.06.2017, organi kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur ka qenë Komisioni i cili formohet nga Ministri i Infrastrukturës, ashtu sic parashihet me nenin 19 paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/2 për Licencimin e Pyetësit, i cili përcakton se: 1. “Pyetësi ka të drejtë të ushtrojë ankesë në Ministri në pajtim me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative. 2. Komisioni i emëruar nga Ministri vendos lidhur me ankesën”, andaj vendimi nr.3807/2017 i datës 15.07.2017, i Komisionit për Zgjidhjene e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, është vendim i nxjerrë nga organi jo kompetent, dhe është akt absolutisht i pavlefshëm sic parashihet nën 92 pika b) e Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili përcakton se: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme... b) kur akti është nxjerr nga organi administrativ jo kompetent” dhe si i tillë nuk prodhon asnjë pasojë juridike, ashtu sic parashihet me nenin 93 paragrafi 93.1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, i cili përcakton se: “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk prodhon asnjë pasojë juridike”.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se meqë ankesa e ankuesit është drejtuar tek organi jo kompetent për të vendosur lidhur me këtë ankesë, Komisioni për Zgjidhjene e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, është i obliguar që ankesën t’ia dërgoj organit kompetent me një letër përcjellëse të nesërmen e deklarimit të jo kompetencës, ashtu sic parashihet me dispozitat e nenit 18 paragrafi 18.1 pika b) të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative i cili përcakton se: *“18.1. Në ato raste kur personat fizikë dhe juridikë, gabimisht, dorëzojnë kërkesat e tyre te një organ i administratës publike, që nuk ka kompetencë mbi çështjen që është objekt i kërkesës, për trajtimin e kërkesës do të ndiqet procedura e mëposhtme: b) në qoftë se organi kompetent të cilit duhet t’i kishte shkuar kërkesa i përket të njëjtës ministri, agjenci, institucion apo strukturë, kërkesa e dorëzuar gabimisht i dërgohet organit kompetent, e shoqëruar me një letër përcjellëse nga organi që e ka marrë gabimisht atë, të nesërmen e deklarimit të jo kompetencës. Personi fizik dhe juridik, që ka bërë dorëzimin e gabuar, njoftohet sipas procedurës së parashikuar në Seksionin VI, të pjesës V të këtij Ligji”.*

Duke marrë parasysh këtë obligim ligjor si dhe duke pasur parasysh faktin që vendimi me numër 3810/2017 I datës 15.07.2017, i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, është shpallur akt absolutisht i pavlefshëm, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vendosur për obligimin e Komisionit për Zgjidhjene e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës, që ankesën e ankuesit Z.Z., të datës 30.06.2017, ta dërgoi për vendosje tek organi kompetent-Komisioni për ankesa i formuar nga Ministri në pajtim me nenin 18 paragrafi 18.1 pika b) të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

Organi i punësimit gjegjësisht zyrtarët/ komisionet përgjegjëse janë të obliguara që të veprojnë në pajtim me këtë vendim si dhe dispozitat e legjislacionit përkatës për këtë çështje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pa kënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda nr.02/327/2017, datë 26.09.2017

Kryetari i Kolegjit
L. P.

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, Z.Z.;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MI-së;
- Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MI;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Ministria e Infrastruktues, duke vepruar në bazë të vendimit të KPMSHCK-së, konform dispozitave ligjore në fuqi të cilat e rregullojnë këtë materie, ka marrë në shqyrtim ankesën e palës dhe ka vendosur sikurse në vendimin e më poshtëm.

“[shëno logon tuaj]”
Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Infrastrukturës

Komisioni për Shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për licencim dhe përtëritje të licencës për pyetës, i emëruar me vendimin e Ministrit me nr. KM/MI 37333 të datë 07.10.2018, duke vepruar në pajtim me paragrafin 2 të nenit 19 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 për Licencimin e Pyetësit dhe nenit 136 të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e A.S, me nr.3542 e datës 30.06.2018, e parashtruar kundër vendimit nr.3460 datë 24.06.2018.

A r s y e t i m

Ministria e Infrastrukturës me datë 24.06.2018, ka marr vendim me nr.3460/2018, me të cilin ka bërë anulimin e provimit për licencim dhe përtëritje të licencës për pyetës.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin për anulimin e provimit me datë 30.06.2016, ka arashtruar ankesë me nr.3452, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontestëve dhe Ankesave në MI.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontestëve dhe Ankesave me datë 15.07.2016, ka nxjerr vendimin me nr.3810/2018, me të cilën e ka refuzuar ankesën si të pa bazuar. Kundër këtij vendimi me datë 12.08.2018, A.S, ka parashtruar anksë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës me vendimin me nr. A/02/327/2018, ka obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontestëve dhe Ankesave në MI, që ankesën e ankuesit ta dërgoj tek organi kompetent-Komisioni për ankesa i formuar nga Ministria.

Komisioni i emëruar nga Ministri me vendimin nr.KM/MI 37333 të datës 07.10.2018, pas shqyrtimit të ankesës dhe administrimit të provave, vendimit me nr.KM/MI 37245/18 të datës 20.06.2016, raportit të Komisionit me nr.3409 datë 23.06.2018 dhe listave për pyetës (faqe nga 1 deri 4) datë 22.06.2018, vendimit me nr.3460 datë 24.06.2018, njoftimit të datës 24.06.2016, ankesës me nr.3542 datë 30.06.2016 dhe

vendimit me nr.3810 datë 15.07.2016, konstatoi se me vendimin me nr.37245/16, është emëruar komisioni sic është përcaktuar me paragrafin 1 dhe 2 të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 për licencimin e pyetësit. Më datë 22.06.2016 është mbajtur provimi ku testimi i kandidatëve është bërë nga kryetari dhe një anëtar i komisionit e jo nga anëtarja tjetër e caktuar me vendim. Në këtë rast komisioni nuk ka vepruar në përbërje të plotë.

Nga kjo që u theksuar më lartë rezulton se anulimi i provimit është bërë për arsye se komisionit i ka munguar përbërja e plotë për të vepruar bazuar në paragrafin 2 të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2 dhe vendimit me nr.37245/16 (provë listat për pyetës dhe raporti i komisionit të cilat nuk janë të nënshkruara nga anëtarja e komisionit), andak u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur brenda afatit prej 30 ditësh, mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Komisioni:

Kryetari _____

Anëtari _____

Anëtari _____

Vendimi ju dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës Sekretarit;
- Ankuesit;
- DFSHP;
- Departamentit Automjeteve dhe
- Arkivit të MI-së.

**Shembulli i 6-shtë - kontest nga mardhënia e punës
Largim nga puna**

Në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.03/L-149, neni 5 parashihen Parimet Themelore, ku përcaktohet se: nëpunësi civil duhet të ushtrojë detyrën e tij të punës duke respektuar parimet themelore në shërbimin civil të parapara me nenin 5 të këtij ligji.

Nenin 51 Ushtrimi i detyrës dhe detyrimi për zbatimin e ligjit-në par. 1 Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës. dhe par.3 Nëpunësit civilë duhet të veprojnë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe veprimet e tyre duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike, par. 4, Nëpunësit civilë, të cilët tregojnë pakujdesi në respektimin dhe zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore.

Ndërsa në nenin 64 Përgjegjësia disiplinore, në par. 1 nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji, dhe par. 3 Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore.

Gjithashtu në nenin 67 Masat disiplinore, në par 1 vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: nën par. 1.2 vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, pika 1.2.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension.

Bazuar në këto dispozita ligjore Komuna e Shtimes ka filluar procedurën administrative duke i shqiptuar të punsuarit të sajë masën për largim nga puna, pa e dëmtuar të drejtën në pension.

“[shëno logon tuaj]”

Data:	18.12.2015
Nr.:	08/15
Nga:	Drejtoresha XXXX

Për:	Znj. A. E., Zyrtares për Mbrojtjen e Mjedisit
Cc:	Znj. K. I, Menaxher i Personelit
Lenda	Vërejtje me shkrim

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 5, paragrafi 1 pika 5, neni 51 pika 1 dhe 4, neni 55 pika 2, neni 61 pika 1 dhe 2 dhe Rregullorës nr.04/2011 për Procedurat disiplinore në shërbimin civil neni 6 pika 1.10, Drejtori i Drejtorisë paraqet:

VËREJTJE ME SHKRIM PËR SHKELJE DISIPLINORE

Kundër:

- E., Zyrtares për Mbrojtjen e Mjedisit, e autorizuar nga ana e Drejtorisë së DSHP-së për të kryer detyrat edhe të Inspektores për Mbrojtjen e Mjedisit.

Për shkak se:

E njëjta ka bërë shkelje të rëndë të detyrës zyrtare, ka refuzuar që të kryej detyrat e punës të përcaktuara me ligj.

A r s y e t i m

Me datë 19.03.2015, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-025, neni 81 pika 4, për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në bazë kompetencave të drejtorit të DSHP-së, dhe për shkak të mungesës së Inspektorit të Mjedisit kam autorizuar znj. A. E., që të kryej detyrat e Inspektores së Mjedisit.

Pas pranimit të këtij autorizimi nga ana e zyrtares në fjalë kam kërkuar që ti merr të gjitha veprimet e nevojshme që të ndalet aktiviteti i të gjitha furrave për pjekjen e gëlqeres ku si lëndë djegëse kanë gommat në tërë territorin e Komunës së Shtimes.

Pasi ka identifikuar furrat që ushtrojnë këtë veprimtari dhe ka bërë procesverbalet, Inspektoria në fjalë ka lëshuar aktvendim ku urdhëron pronarët e këtyre furrave të gëlqeres që ta ndërprerjen menjëherë këtë aktivitet.

Pas mosrespektimit të këtij afati nga ana e pronarëve të këtyre furrave zyrtarja ka obligim ligjor që ti merr të gjitha veprimet që me një aktvendim tjetër ti urdhëron pronarët që në një kohë sa më të shkurtër ti mënjanojë vet furrat e gëlqeres në të kundërtën ajo duhet të nxjerr konkluzion për rrënimin e furrave.

Inspektorja në fjalë ka refuzuar procedimin e mëtutjeshëm të lëndës me arsyetimin se nuk është kompetencë e saj.

Në rrethanat e krijuara me datë 10.12.2015, iu kam drejtuar me një kërkesë zyrtarit ligjor në Komunën e Shtimes z. L. M., që të bën një interpretim ligjor se kompetencë e kujt është procedimi i mëtutjeshëm i lëndës në fjalë.

Me datë 16.12.2015, nga zyrtari ligjor kam marrë përgjigje me shkrim se:

Kompetent për nxjerrjen e konkluzionit për sanimin e gjendjes së krijuar është zyrtari apo inspektori për mbrojtjen e mjedisit;

Fjala rrënim zëvendësohet me fjalën sanim, ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit NR.03/L-025, neni 69 alinea 1.2.

Kërkohen përmirësimet në vijim sipas këtyre rekomandimeve:

1. Që të kryej detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe të ligjeve në fuqi;
2. Që ti kryej detyrat të autorizuara nga ana e drejtorit;
3. Që në afatin brenda dy ditëve të nxjerr konkluzion për rrënimin e furrave.

Vërejtje:

Në rast se brenda këtij afati Zyrtarja (Inspektorja) në fjalë nuk respekton pikat e lartpërmendura dhe të nxjerrë konkluzion për rrënimin e furrave për pjekjen e gëlqeres atëherë do të iniciohet procedurë disiplinore për mos kryerjen e detyrës zyrtare.

Drejtori,

“[shëno logon tuaj]”

02/Nr. _____

Datë 24.08.2016

**Formular për Paralajmërimin me shkrim
Konfidenciale pas kompletimit**

Emri dhe Mbiemri: A. E
Titulli i postit: Zyrtar për Mjedisë
Sektori: Drejtoria për Shërbime Publike

I nderuar:

PARALAJMËRIMI (QORTIM) ME SHKRIM PËR SHKELJE DISIPLINORE

Kjo letër është t’ju paralajmëroj formalisht se sjellja juaj me dhënien e deklaratës si dëshmitare siç dhe hezitimi për të treguar të vërteten në rastin xxxxxxxxxxxxxx, paraqet shkelje disiplinore konform kodit të mirësjelljes nr.01/2006, neni 4.2, 4.5 dhe 4.6, dhe Rregullores nr.04/2011, neni 5 pika 1.1.

Është shkelje disiplinore dhe është e pa pranueshme.

Kërkohen përmirësimet në vijim:

1. Duhet ti qaseni punëve dhe detyrave në mënyrë të drejtë dhe efikase;
2. Gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare duhet të krijoni dhe ruani besimin e organit ku punoni;
3. Kur kërkohet diçka nga institucioni ju duhet ti përgjigjeni pa hezitim, ta përmbusheni obligimin tuaj në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme;
4. Respektimi i kodit të mirësjelljes së shërbimit civil.

Për mos përmirësim do të pasojnë masa më të rrepta disiplinore. Kjo nënkupton edhe mos vazhdimin e kontratës.

Një kopje e këtij paralajmërimi do të vendoset në dosjen e personelit konfidenciale.

Udhëheqësi më i lartë i administrativ,

“[shëno logon tuaj]”

05/Nr. _____

Datë 02.11.2017

**Formular për Paralajmërimin me shkrim
Konfidenciale pas kompletimit**

Emri dhe Mbiemri: A. E

Titulli i postit: Zyrtar për Mjedisë

Spektori: Drejtoria për Shërbime Publike

I nderuar:

PARALAJMËRIMI (QORTIM) MË SHKRIM PËR SHKELJE DISIPLINORE

Kjo letër është t’ju paralajmëroj formalisht se sjellja juaj lidhur me përgjegjësit e juaja ndaj eprorit nuk është në nivel dhe se mosinformimi i eprorit për mungesë në punë paraqet shkelje disiplinore konform Rregullores nr.04/2011, për Procedurë Disiplinore, neni 5 parag. 1 pika 7.

Është shkelje disiplinore dhe është e pa pranueshme.

Kërkohen përmirësimet në vijim:

1. Informimi i eprorit për çdo lëshim (mungesë) nga vendi i punës.

Për mos përmirësim do të pasojnë masa më të rrepta disiplinore. Kjo nënkupton edhe mos vazhdimin e kontratës.

Një kopje e këtij paralajmërimi do të vendoset në dosjen e personelit konfidenciale.

Udhëheqësi më i lartë i administrativ,

“*[shëno logon tuaj]*”
REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA-SHTIME

02/1 Nr.18
Datë:13.02.2018

Komisioni Disiplinor i përbërë nga anëtarët, M. H. kryetar, M. M. dhe Sh. A anëtar, duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, nr. 02/016/13002, të datës 28.04.2018, paraqitur kundër zyrtares A. E., në bazë të Ligjit për Procedurën Administrative, nr.05/L-031, Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.03/L-149, neni 5, neni 51 paragrafi 1 dhe 3 dhe 4, neni 64 paragrafi 1 dhe 3, neni 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.4, Kodit të Mirësjelljes për Shërbyesit Civil nr.04/2015, neni 5 paragrafi 1 dhe 2, neni 9 par.1.2 dhe 3, neni 10 pika 1 dhe 3, Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 par.1.1, 1.16 dhe 1.17 dhe paragrafi 2 neni 13 neni 8 par.1 pika 4 Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nr. A/02/499/2018 Nr.prot.228/18, datë 19.01.2018, në bazë të kompetencave që ka, rishqyrton dhe mori këtë:

V E N D I M

I. Punëtores A. E, e punësuar në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, e caktuar në punë dhe detyra të punës Zyrtare për Mjedis, i ri-vendoset masa **NDERPRITET MARRDHËNIA E PUNËS** pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension.

II. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 19.01.2018 merr vendim me nr. A/02/499/2018 dhe e shfuqizon vendimin me nr.02/1/016/30826/7 i datës 02.11.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave si dhe vendimin me numër 02/1/Nr.63 i datës 04.10.2018 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Shtimes.

Ky vendim e obligon Komisionin Disiplinor që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ti ndërmerret të gjitha veprimet procedural ligjore për ta rishqyrtuar lëndën e ankueses A.E.

Ne arsyetimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, konstatohet se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar shkeljen e kryer nga ankuesja, por masa e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor nuk është proporcion me shkeljen dhe se me këtë rast Komisioni Disiplinor nuk ka arritur që të shqyrtoj drejt gjendjen faktike dhe ligjore, duke vepruar

në kundërshtim me nenin 66 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se “Masa disiplinore zbatohet në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil”.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes, Brenda afatit ligjor prej 15 ditësh të përcaktuar me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës A.02/499/2018, me datë 13.02.2018, mbajti seancë për ta shqyrtuar lëndën e ankueses. Komisioni nuk e pa të nevojshme që edhe njëherë ti ftoj palët për ti dëgjuar pasi që shkelja është konstatuar, bëri vetëm administrimin e provave nga seanca e kaluar e datës 05.05.2018, si dhe shkresa e tjera të lëndës.

Komisioni Disiplinor për të vërtetuar gjendjen faktike dhe ligjore si dhe marrjen e vendimit të drejt administroj këto prova: Formulari për Raportin e shkeljes disiplinore e dt.28.04.2018, me numër protokollit 08/13; procesverbali i datës 05.05.2018, i Komisionit Disiplinor; vendimi i Komisionit Disiplinor, paralajmërimi me shkrim i dt.24.08.2017, dhe 02.11.2017, formulari i vlerësimit të punës i datës 31.12.2017.

Komisioni Disiplinor, gjatë rishqyrtimit të provave dhe shkresave të tjera të lëndës, gjeti se kërkesa e Drejtorisë për Shërbime Publik është e bazuar dhe se veprimet e zyrtares A.E. bien në kundërshtim të plotë me dispozitat e lartcekura në pjesën hyrëse të këtij vendimi dhe të vërtetuara me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës A02/304/2018.

Komisioni Disiplinor, duke marrë për bazë të gjitha provat e lartshënuara, konstaton se është përmbushur mjaftueshëm elementi i nenit 66 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 dhe se masa është shqiptuar në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunëses civile.

Për të arsyetuar sjelljen recidiviste të zyrtares në fjalë, komisioni ka gjetur se zyrtares në fjalë i janë shqiptuar tri vërejtje me shkrim radhazi, vërejtja e parë është shqiptuar me datë 18.12.2016, nga Drejtori, vërejtja e dytë i është shqiptuar me datë 24.08.2017, nga Kryetari i Komunës, vërejtja e tretë i është shqiptuar me datë 02.11.2017, nga Drejtori aktual. Me datë 28.10.2017, ndaj zyrtares në fjalë është iniciuar procedurë disiplinore nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike për shkak të një varg shkeljesh të detyrave të punës dhe me këtë rast me datë 18.11.2017, Komisioni Disiplinor, merr vendimin nr.02/1Nr.230, për shkëputjen e marrëdhënies së punës ndaj A. E, po ashtu Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe ankesave të Komunës së Shtimes, me datë 21.12.2017 nr.08-016-31856 e vërteton vendimin e Komisionit Disiplinor dhe e Refuzon ankesën e Zyrtares. Për këtë çështje Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil, me datë 10.03.2017, merr vendim për ta kthyer zyrtaren në fjalë në pozitën saj Zyrtare e Mjedisit, me arsyetimin se drejtoresha nuk ka qenë kompetente për të iniciuar procedurën disiplinore dhe duke mos u lëshuar fare në

shqyrtimin e shkeljeve të shumta të detyrave të punës për të cilat kishte fakte të mjaftueshme. Komuna e Shtimes e zbaton vendimin e KPMSHCK-së, por nuk pajtohet me vendimin e saj, dhe për këtë çështje me datë 04.04.2018, parashtron padi për hapjen e konfliktit administrative pranë gjykatës kompetente e cila është në procedurë gjyqësore dhe pa një vendim përfundimtar.

Pas gjithë këtyre masave të shqiptuara ndaj zyrtares në fjalë dhe mundësive që ajo të reflektoj në sjelljet e saj, sidomos me kthimin e saj në vendin e punës nga ana e KPMSHCK-së dhe kompensimin e të gjitha pagave për aq kohë sa nuk ishte në punë, kjo tregon se vendimi i Këshillit nuk ishte i drejtë dhe ka krijuar një precedent negative edhe për zyrtarët tjerë, sepse zyrtarja në fjalë në vend që të përmirësohet dhe të jetë e përgjegjshme për sjelljet e saja dhe në detyrat e punës, ajo vazhdon me të njëjtat veprime të sjelljes, ndoshta edhe më të rënda duke u sjellë në mënyrë ofenduese ndaj eprorit të saj, duke shqetësuar stafin punonjës dhe duke shfaqur një papërgjegjësi totale ndaj institucionit në përgjithësi me bindjen e plotë që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, prapë do të marrë vendim në favorin e saj.

Komisioni Disiplinor, në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore, deklaratës së A. E., shkresave tjera të lëndës, konstatoi se në veprimet e A. E., ekzistojnë elementet e shkeljes së rëndë-serioze të detyrave të punës dhe Kodit të Mirësjelljes, për çka është fajtorë dhe të njëjtës i është shqiptuar masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës komfor nenit 66 paragrafi 1, neni 67 par.1.2.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi. Ankesa i dërgohet Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtrësive, pranë Administratës Komunale.

Vendimi ju dërgohet:

- Kryetarit;
- Zyrtarit/es
- Arkivit

Anëtarët e Komisionit,

Kryetar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

Për: Komunën e Shtimes-Komisionin për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave
Nga: A. E, nga Shtimja, rruga “Emin Duraku”, Shtime.

Kundër vendimit Nr.02 /1 Nr.18 të datës 13.02.2018, të marrë nga Komuna e Shtimes, respektivisht Komisioni Disiplinor, paraqes këtë:

A N K E S Ë

Për shkak se:

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është në kundërshtim me dispozitivin e vendimit A/02/304/2017, të nxjerr nga Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.09.2017.

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është nxjerr në kundërshtim me nenin 84 par.2 pika c) dhe d) neni 85. 1 pika a), b) dhe c) dhe neni 86.1 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative

A r s y e t i m

Vendimi nr. 02/1.18 i datës 13.02.2018, i marr nga Komisioni Disiplinor, është në kundërshtim të plotë me vendimin A/02/304/2017, të nxjerr nga Këshilli e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ku me atë vendim janë shfuqizuar vendimi me nr.02/1/016 i datës 01.07.2017, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes dhe vendimi i Komisionit Disiplinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në bazë të vendimit me nr. A/02/304/2016 të datës 21.09.2017, pas shfuqizimit të vendimit të lartcekur kishte obliguar Komisionin disiplinor në Komunën e Shtime që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ti ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta rishqyrtuar lëndën e ankueses A. E.

I nderuar Komision për Shqyrtimin e Ankesave dhe Parashtresave, pranë Administratës Komunale vendimi nr.02/1.18 i datë 13.02.2018, i Komisionit Disiplinor është vendim tendencioz dhe në kundërshtim të plotë me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse një vendim i tillë tani më është shfuqizuar dhe nuk mund të përsëritet prapë.

Nga të gjitha të lart:

P r o p o z o j

Që Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes, mbi këtë çështje të marr Vendim me të cilin e Aprovon ankesën si të bazuar dhe shfuqizon

vendimin e atakuar me këtë ankesë, të më kthen në vendin e punës si dhe ti kompensoj pagat e humbura dhe atë nga data 27.05.2017, deri në ditën e kthimit në vendin e punës, sikur ajo fare të mos ishte larguar nga puna

Më datë 12.03.2018

Parashtruesja e ankesës,
A. E. _____

“[shëno logon tuaj]”
Republika e Kosovës
KOMUNA SHTIME

Nr.02/1-26

Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave në përbërje prej: S. A, kryesues, H.J dhe I. B anëtar të komisionit, me rastin e shqyrtimit të ankesës së punëtores A. E në vendin e punës Zyrtare për Mjedis, ankesa me nr. 23333 të datës 15.02.2018, duke u bazuar në Ligjin nr.02/L-28 mbi Procedurën Administrative, neni 136 pika a), në seancën e mbajtur më datës 13.03.2018, merr këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET ankesa nr. 23333 e dt.15.02.2018, e parashtruar nga A. E.

II. Mbetët në fuqi Vendimi nr.02/1 nr.18 i datës 13.02.2018 i Komisionit Disiplinor.

A r s y e t i m

Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave, pas fillimit të shqyrtimit të ankesës nr.23333 të datës 15.02.2018, të parashtruar nga ankuesja A. E., në vendin e punës Zyrtare për Mjedis, konstaton se ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor, ndërsa me datë 22.02.2018, fton palët në procedurë dhe në pamundësi të arritjes së aktgjatimit në mes të palëve në procedurë, në mbështetje të nenit 6 pika 3, të Rregullores nr.05/2011, për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ka filluar shqyrtimin e ankesës.

Komisioni, në përbërje të plotë, pas ftesës së bërë A. E., më datë 22.02.2018, e cila ka marrë pjesë në seancë, me ç ‘rast ka deklaruar se: “Unë nuk kam koment në veprimet e institucionit, fakte të reja nuk kam për të ofruar, të gjitha faktet lidhur me rastin i kam dorëzuar. Njëherit mbetëm pranë deklaratës që kam dhënë në seancat e mëhershme”.

Drejtoresha për Shërbime Publike, para Komisionit ka deklaruar se pajtohem me vendimin e Komisionit Disiplinor, konsideroj se ky vendim është i drejtë dhe i bazuar në fakte. Kërkoj nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave që vendimin e Komisionit Disiplinor, ta lë në fuqi dhe të refuzojë ankesën e ankueses. Në deklaratën e dhënë para Komisionit Disiplinor deklaroi se me datë 27.04.2017, pas inspektimit të inspektorëve të Ministrisë së Mjedisit u përshëndeta me inspektorë për t’u informuar rreth inspektimit të kryer në terren me Udhëheqës të Sektorit për Inspektorat, u ktheva në zyrë për t’u informuar rreth inspektimit të kryer pasi që unë kisha harruar të marr një kopje të procesverbalit nga inspektimi, nga Inspektori B. K, me telefon kërkova që nëse ende nuk janë larguar të përcjellë një kopje të procesverbalit nga terreni. Ai më

tregoi se janë në zyrën e zyrtares së Mjedisit A. E., pasi ka ardhur inspektori, gojarisht i kam kërkuar një kopje të procesverbalit, pasi që lëndën e ka në zyrë te A. E., po shkoj dhe po ju sjelli kopjen. Unë duke pritur inspektorin në zyrë hyn zyrtarja e mjedisit A.E., me një arrogancë duke më përplasur procesverbalin e inspektorit në tavolinë, me fjalët “hapi sytë mirë dhe lexoi ligjet mirë”, dhe me arrogancë doli nga zyra ime. Procesverbalin nuk e kërkoja nga zyrtarja e mjedisit A.E.

Pas një momenti unë mora procesverbalin dhe shkova në zyrën e zyrtares A.E., ku ishin prezent dy inspektorët e Ministrisë së Mjedisit si dhe një zyrtar pranë kësaj drejtorie dhe ju kam drejtuar me fjalët “ nuk është mirë me u sill në atë mënyrë se këtu është institucion dhe duhet respektohet kodi i mirësjelljes, nuk është edukatë familjare sjellja juaj”, pasi jam kthyer në zyrë pas disa minutave më thërret në telefon A.E., ku mu drejtua duke bërë titur dhe provokuar me fjalët “ tani kam me shkuar te menaxheri i personelit dhe te Kryetari do t’ju tregoj që spo më lini rahat, unë i thash se, edhe un jam duke e përgatitur vërejtjen me shkrim dhe po vi me ty.

Inspektori Sanitar pranë drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektorat para Komisionit deklaruan se mbetet pranë deklaratës së dhënë para Komisionit Disiplinor. Në deklaratën e tij ai ka deklaruar se: Me datë 27.04.2017, isha në përcjellje të inspektorëve të Ministrisë së Mjedisit dhe pastaj informova drejtoreshën për ecurinë e inspektimit dhe i tregova se vetëm inspektorët e ministrisë kanë përpiluar procesverbal. Drejtoresha në bisedë telefonike nga I. D. Kërkon një kopje të tij. Inspektori tregon se lëndën e ka në zyre te A. E., dhe se tani po e sjell një kopje. Pas pak minutave në zyrë hynë A.E., me kopje të procesverbalit të cilin e hodhi në tavolinën e drejtoreshës me ton të lart duke thënë “Hapi sytë më mirë dhe lexoj ligjet më mirë” dhe menjëherë doli nga zyra. Drejtoresha me kopjen e procesverbalit në dorë doli në zyrën e A.E., pasi që dera ishte e hapur dëgjova duke i thënë se “duhet të sillësh komfor kodit të mirësjelljes se këtu është institucion”. Pastaj drejtoresha është kthyer në zyrë dhe pas pak i cingëron telefoni, drejtoresha bisedon me dikën dhe i thotë se “shko te zyra e personelit se edhe unë po vij dhe jam duke përgatitur vërejtjen me shkrim për ty, Drejtoresha doli nga zyra dhe në atë moment u dëgjua një ulërimë, unë dola para zyrës për të parë se çka po ndodh, A. E., ishte shkallëve duke u lëshuar teposhtë dhe drejtoresha ishte mbrapa.

Komisioni në përbërje të plotë, ka bërë administrimin e provave dhe atë: Formularin për Raportin e shkeljes disiplinore, datë 28.04.2017, procesverbalin e Komisionit Disiplinor të dt.05.05.2017, Paralajmërimin me shkrim i dt.24.08.2016, Vërejtjen me shkrim të datës 18.12.2015, paralajmërimin me shkrim i datës 02.11.2016, Formularin e shkeljes disiplinore i dt.28.10.2016.

Komisioni në bazë të shkresave të lëndës dhe provave të administruara konstaton se A. E., në vendin e punës Zyrtare për Mjedis ka bërë shkelje disiplinore (shkelje të rëndë dhe serioze) sjellje jo të mirë në raport me udhëheqësin me c ‘rast ka fyer rëndë

personalitetin e drejtorit të drejtorisë në prezencë të zyrtarëve të tjerë, sipas Rregullores 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 pika 1 dhe paragrafi 2. Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1, 1.16, 1.17 dhe paragrafi 2, zyrtarja A.E, me sjelljet e veta ka bërë shkelje të nenit 51 pika 1,2,3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 136 pika a) të Ligjit nr.02/L-28 mbi Procedurën Administrative nenit 6, 9, të Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontestëve dhe Ankesave, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Vendimi ju dërgohet:

- Kryetarit;
- Zyrtarit/es
- Arkivit

Anëtarët e Komisionit,

1. _____
2. _____
3. _____

PËR: Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kundër vendimit Nr.02/1-26, të marrë nga Komuna e Shtimes, respektivisht Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave me dt.13.03.2018, në bazë të nenit 78 par.1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës Nr.03/L-149, në përputhje me nenin 3 par.3 dhe 4 si dhe komforë nenit 4 të Rregullores nr.02/2014, për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja A.E, nga Shtimja, në afatin ligjor paraqet:

A N K E S Ë

Për shkak se:

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është në kundërshtim me dispozitivin e vendimit A/02/499/2017, të nxjerr nga Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.01.2018.

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është nxjerr në kundërshtim me nenin 84 par.2 pika c) dhe d) neni 85. 1 pika a), b) dhe c) dhe neni 86.1 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

A r s y e t i m

Parashtruesja e kësaj ankesë është e bindur thell se vendimi nr. 02/1-26 i marr nga Komuna e Shtimes-Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave me dt. 13.03.2017, është në kundërshtim të plotë me vendimin A/02/499/2017, të nxjerr nga Këshilli e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.01.2018 si dhe në kundërshtim me nenin 84 par.2 pika c) dhe d) neni 85. 1 pika a), b) dhe c) dhe neni 86.1 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative dhe se Komisioni i cekur më lart shihet qartë se në rastin konkret ka përsëritur avazin e njëjtë për të trilluar një gjendje krejt tjetër faktike nga ajo që është në rastin konkret dhe këtë veprim ky Komision e ka bërë me të vetmin qëllim që me çdo kusht të mbrohet dhe të përkrahen sjelljet e drejtoreshës së Shërbimeve Publike, duke bërë ashtu që jo vetëm të mos merret parasysh ankesa e punëtores së larguar nga puna A. E, por as vendimi i A/02/499/2017, të nxjerr nga Këshilli e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.01.2017, me çka edhe ai komision:

Refuzoj ankesën 03/070/05/3835, e dt.15.02.2018 të A.E, në vendin e punës zyrtare për Mjedis dhe la në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor 02/1, nr.13 të dt.13.02.2017.

Provë: vendimi nr. 02/1-26, dt. 13.03.2018, dhe vendimin e Komisionit Disiplinor 02/1, nr.13 të dt.13.02.2017.

Me vendimin e Komisionit Disiplinor 02/1, nr.13 të dt.13.02.2017, A. E., edhe për kundër faktit se me vendimin A/02/499/2017, të nxjerr nga KPMSHCK, me dt.19.01.2018, ishte obliguar që në rastin e shqyrtimit të lëndës të ankueses, ky komision të veproj në pajtim me të gjeturat e atij këshilli, ai komision disiplinor vendosi që ankuesen mos ta kthej në vendin e punës zyrtare për mjedis-inspektore e ambientit nën arsyetimin se komisioni kishte gjetur si të bazuar kërkesën e drejtorisë së shërbimeve publike, ku sipas komisionit në fjalë, sjelljet e A.E ishin në kundërshtim me dispozitat e cekura në hyrje të vendimit të tyre.

Konsiderojmë se minimumi që duhet të bëjë KPMSHCK, gjatë vendosjes sipas kësaj ankese, që si Këshilli i Pavarur të keni guximin që në rastin konkret, së paku ta materializoj premtimin/kërcënimin juridik të dhënë në faqen 3 të vendimit 02/499/2017 dt.19.01.2018, ku thuhet se “ në të kundërtën Kolegji për shqyrtimin e ankesave do të vendos meritorisht për lëndën”.

I nderuar Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, jam e bindur se, sikur se edhe vendimet e mëparshme të nxjerra në këtë çështje, po ashtu Vendimi i atakuar me këtë ankesë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 84 par. 84.2 pika c) dhe d), neni 85 par. 1 pika a), b) dhe c) dhe neni 86 par.1 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 84 par 84.2 pika c) dhe d) të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, pasi që si i tillë sikur se edhe vendimet e nxjerra në këtë çështje (për të njëjtin rast) nga organet gjegjëse të Komunës së Shtimes, del se i njëjti po ashtu nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në prova të besueshme të paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara për çështjen konkrete, po ashtu akti në fjalë nuk ka as një deklaratë me bazë ligjore në të cilën është mbështetur vendimi.

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 85 par 85.1 pika a), b) dhe c) të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, pas që i njëjti sigurisht se meqë ankueses ia shuan vendin e punës, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë është dashur të arsyetohet domosdoshmërisht me prova bindëse, e jo me trillime sepse të vërtet në at vendim asgjë nuk ka që mund të provohet me argumente.

Vendimi i atakuar me këtë ankesë, konsiderojmë se domosdoshmërisht është dasht të arsyetohet me fakte dhe prova besueshme, lidhur me faktin se pse në rastin konkret, nuk është vepruar konform asaj siç kishte rekomanduar me vendimin A/02/499/2016, dt.19.01.2018 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku sipas atij vendimi Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes ishte obliguar që me rastin e rishqyrtimit të lëndës të ankueses ky komision të veproj në pajtim me të gjeturat e atij Këshilli.

Dhe se vendimi i atakuar me këtë ankesë nuk do koment se është arsyetuar vetëm sipas vullnetit të njëanshëm dhe jo objektiv nga Komuna e Shtimes pasi si i tillë përveç se i mungojnë arsyet bindëse me pretendimet e kundërta lidhur me pretendimet e palëve, arsyetimi i vendimit në fjalë është kundërshtim edhe me informacionin apo përfundimin e organeve zyrtare siç është ai i Mjekësisë Ligjore dhe Prokurorisë Themelore Ferizaj fakte këto të paraqitura sipas ankesës së ankueses së ankueses A/02/499/2016 i dt.21.11.2016.

Vendimi i atakuar me këtë ankesë është nxjerrë në kundërshtim me nenet 86.1 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative pasi që si i tillë nuk jep as një shpjegim të qartë të bazës ligjore në raport me gjendjen faktike të rastit konkret dhe si i tillë ai vendim është tërësisht i pa bazuar.

Nga të gjitha të lart theksuarat:

P r o p o z o j

Që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor nenit 16 par.1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores nr.02/2014, për Rregullat dhe procedurat e ankesave në KPMSHCK, mbi këtë çështje të marr aktvendim me të cilin Aprovon ankesën si të bazuar dhe shfuqizon vendimin e atakuar me këtë ankesë, duke bërë që të Detyrohet KK Shtime që ankuesen A. E nga Shtimja, ta kthen në vendin e punës si dhe të Obligon KK Shtime që parashtrueses së kësaj ankese t'ia kompensoj pagat e humbura dhe atë nga data 27.05.2017, deri në ditën e kthimit në vendin e punës, sikur ajo fare të mos ishte larguar nga puna si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës administrative komfor tarifës së OAK-së, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi.

Më datë 21.03.2018

Parashtruesja e ankesës,
A.E. _____

“*[shëno logon tuaj]*”
Republika e Kosovës
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË
KOSOVËS**

Nr.02/1-26

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e ankesave i përbërë nga SH. E. - kryetar, P. L dhe S. H, anëtar, për shqyrtimin e ankesës së ankueses A. E, me numër A 02/132/2017, të datës 22.03.2018, kundër organit të punësimit Komuna e Shtimes, në çështjen juridike Ndërprerje e marrëdhënies së punës, duke vepruar në pajtim me nenin 10 paragrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për Këshillim dhe votim me datë 19.04.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e parashtruar nga ankuesja A.E., e datës 22.03.2018.

II. Shfuqizohet vendimi i datës 13.03.2018, me numër të protokollit 02/1-26, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes, si dhe vendimi i Komisionit Disiplinor numër 02/1 nr.13 datë 13.02.2018.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Shtimes që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit 15 ditor nga data e pranimit të këtij vendimi, që ankuesen A.E, ta kthej në vendin e punës Zyrtare për Mjedis, sipas Akt Emërimit të datës 05.05.2015.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.09.2017, ka nxjerr vendim nr.A02/304/2016, me të cilin ka shfuqizuar vendimin e datës 01.07.2017, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe vendimin e datës 27.05.201, duke e obliguar Komisionin Disiplinor të Komunës së Shtimes që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit për ta rishqyrtuar lëndën e ankueses A. E.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes me datë 04.10.2017, ka nxjerr vendim me të cilin ka rivendosur masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pa dëmtuar ose reduktuar të drejtën në pension.

Ankuesja A.E., e pa kënaqur me vendimin 02/1. Nr.63 të datës 04.10.2016, të Komisionit Disiplinor, me datë 07.10.2017, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Komuna e Shtimes.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i Komunës së Shtimes, me datë 02.11.2017, ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuseses si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin me numër 02/1, nr.63 të datës 04.10.2016, të Komisionit Disiplinor.

Ankuesja, A. E, e pa kënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Shtimes, të datës 02.11.2017, brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.11.2017, parashtron ankesë në KPMSHCK, me pretendimet ankimore Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.01.2018, ka nxjerr vendim nr.A02/499/2017, me të cilin shfuqizon vendimin e datës 02.11.2017, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, si dhe vendimin e datës 04.10.2017 të Komisionit Disiplinor, duke e obliguar komisionin disiplinor të Komunës së Shtimes që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit për ta rishqyrtuar lëndën e ankuseses A. E.

Komisioni Disiplinor, i Komunës së Shtimes, me datë 13.02.2018, nxjerr vendim me të cilin ka rivendosur masën “Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil” pa dëmtuar ose reduktuar të drejtën në pension.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e lartcekur me datë 15.02.2018, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.03.2018, parashtron ankesë në KPMSHCK, me pretendimet ankimore Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.03.2018, e ka proceduar tek Komuna e Shtimes kërkesën për përgjigje në ankesë, me datë 30.03.2018, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura 1/46.

Kolegji për marrjen e vendimit meritor Administroj këto prova: Ankesa nr. e datës.. Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i dt.13.03.2018,

vendimi i dt.13.02.2018, Formularin për Raportin e shkeljes disiplinore, datë 28.04.2017, procesverbalin e Komisionit Disiplinor të dt.05.05.2017, Paralajmërimin me shkrim i dt.24.08.2016, Vërejtjen me shkrim të datës 18.12.2015, paralajmërimin me shkrim i datës 02.11.2016, Formularin e shkeljes disiplinore i dt.28.10.2016.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se veprimet e ankueses nuk kanë qenë të natyrës së tillë që të shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punë në shërbimin civil gjegjësisht në Komunën e Shtimes dhe se komisioni Disiplinor në Komunën e Shtimes nuk ka bërë përshkrimin e veprimeve të ankueses dhe Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, sepse nga shkresat e lëndës del qartë se ndaj Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Shtimes, nga Prokuroria Themelore në Ferizaj është ngritur aktakuzë sipas dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me rastin e ankueses A.E me të cilin sipas aktakuzës Drejtoresha ka sulmuar ankuesen A. E.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe veprimet e ankueses ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes ka dështuar të shqyrtoj gjendjen faktike dhe juridike ndaj ankueses A. E., prandaj ka vepruar në kundërshtim me nenin 66 par.1 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se “Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nënpunësit civil”, sepse Komisioni Disiplinor përsëri ka rivendosur të njëjtën masë ndaj ankueses ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke mos marr për bazë fare vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër A02/499/2016, i cili vendim kishte udhëzuar qartë se si të veproj Komisioni Disiplinor.

Gjithashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 71, nën paragrafi 1.1, 1.2, të Ligjit nr.03/L-149, ku përcaktohet se 1.2. të vendos në bazë të provave, nëse është kryer shkelja dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar, sepse nuk ka bërë vlerësimin e drejtë të provave të prezantuar nga palët gjatë dëgjimit të palëve, sepse nga shkresat el ëndës del qartë se ankuesja ka pasur një debat verbal me drejtoreshën e drejtorisë së shërbimeve publike, veprime këto të ankueses A.E, nuk kanë plotësuar kushtet që ankueses ti shqiptohet një masë e tillë kur kihet parasysh se Komisioni Disiplinor, ka mundur të shqyrtoj ndonjë masë më ta letë, që do të kishte arritur efektin tek ankuesja për përmirësimin e sjelljeve në të ardhmen në kuadër të Shërbimit Civil, gjegjësisht të Komunës së Shtimes.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se komisioni për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtimes, me rastin e nxjerrjes së vendimit nr.02/1-26 të datës 13.03.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregulloren nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes se

Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur që të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike të ligjshmërisë së vendimit 02/1 nr.13 të datës 13.02.2018, Komisionit Disiplinor lidhur me shqiptimin e masës disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pa dëmtuar dhe reduktuar të drejtën në pension.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komuna e Shtimes-Komisioni Disiplinor, në rast të paraqitjeve të kërkesave për iniciimin e procedurave disiplinore është i obliguar të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, lidhur me shqiptimin e masave disiplinore ndaj nënpunësve civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr.A 02/132/2018, më datë 19.04.2018**

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses;
- Kryetarit të K. së Shtimes;
- Udhëheqësit të Personelit në K. e Shtimes;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Kryetari i Kolegjit

Shembulli i 7-tatë - natyra e kontestit nga marrëdhënia e punës Kompensim page

Në bazë të kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të datës 11.04.2014, nenit 36 par.9 nën par. 4 dhe 5, pala ka ushtruar këtë ankesë-kërkesë për realizimin e pagës jubilarë me rastin e pensionimit.

“Dispozita ligjore e nenit 11 paragrafi 3 të Rregullores nr.01/2011, për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, e obligon organin që të nxjerr vendim për pensionimin e nënpunësit, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Mitrovicës duke vepruar në kundërshtim me këtë rregullore, nuk ka lëshuar vendim lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të Kosovës palës ankuese andaj për realizimin e të drejtës së tij, pala ju ka drejtuar Komunës së Mitrovicës me ankesë për realizimin e të drejtës në shpërbim jubilar me rastin e pensionimit. Drejtoria e Arsimit, si organ përgjegjës edhe pse ka qenë e obliguar që të nxjerr vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për ankuesin nuk e ka bërë një gjë të tillë por vetëm e ka larguar nga listat e pagave. Me këtë rast Drejtoria e Arsimit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të cekura më lartë”.

Komuna e Mitrovicës-Komisionit për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave

Parashtruesi i Ankesës

H. A. – ish zëvendësdrejtor në Gjimnazin “Sami Frashëri”, Mitrovicë.

Lënda: Ankesë

Të nderuar anëtar të Komisionit për Shqyrtimin e kontesteve dhe Ankesave, pran Komunës së Mitrovicës

Me anë të kësaj ankese unë H. A, tani i pensionuar, kam qenë i punësuar si zëvendësdrejtor në gjimnazin “Sami Frashëri”, Mitrovicë, dyzetë (40) vite përvojë punë në arsim. Konsideroj se me rastin e pensionimit tim institucioni ku kam punuar, respektivisht Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komonale e Arsimit, nuk më ka mundësuar t’i realizoj disa të drejta që konsideroj që unë në këtë rast është ti gëzoj, prandaj nga ju anëtar të Komisionit kërkoj:

Të më mundësohet kompensimi i pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2016 (duke llogaritur periudhën kohore janar gusht 2016), respektivisht paga për 25 ditë punë.

Duke pas parasysh se në ditën e daljes në pension unë në arsim kam mbushur 40 vite përvojë pune, kërkoj të më epet shpërblimi jubilar në vlerë prej 3 pagave bazë, siç parashihet me nenin 36 paragrafi 9, nën paragrafi 4 dhe 5 të Kontratës kolektive, të

arsimit parauniversitar i dt.11.04.2014. (Sipas kontratës kolektive shpërblimi jubilar e paguan punëdhënësi i fundit).

Po ashtu, të më ipen 3 (tri) paga me rastin e pensionimit, siç parashihet me nenin 36 paragrafi 10, të Kontratës Kolektive të Arsimit Universitar i dt.11.04.2014.

Dhe në fund ju përkujtoj se këto të drejta janë të zbatueshme nga data 01.01.2015 sipas nenit 51 të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar.

Sipas pikave të lartcekura kërkoj kompensimet në vlera si në vijim:

Kompensimi për pushimin vjetor të pashfrytëzuar 25 ditë pune e barasvlershme me një pagë prej 630.56 Euro.

Shpërblimi jubilar në vlerë prej 3 pagave bazë $3 \times 476.25 = 1428.75$ euro, dhe 3 (tri) paga me rastin e pensionimit $3 \times 630,56 = 891.68$ euro.

Gjithsejtë kompensim 3,950.90 euro.

Më datë 10.11.2018

Parashtruesi i ankesës,

Ankesës i bashkëngjis:

H. A

Vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies se punës dhe

Akt emërimin nr.1111 i datës 31.12.1979

“[shëno logon tuaj]”

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KONTESTEVE DHE ANKESAVE, i Komunës së Mitrovicës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), në përbërje prej: S. B-kryetar, B. Sh dhe P. E., anëtar, duke vepruar në bazë të nenit 81 dhe 82 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.72 dt.25.06.2010),nenit 5 dhe 9 par.4 të Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave lidhur me shqyrtimin e ankesës nr. 11111 të dt. 10.11.2018, të ushtruar nga ankuesi H. A., ish zëvendës drejtor në Gjinnazin “Sami Frashëri” në Mitrovicë, në çështjen administrative, “Kompensim material”, në seancën për Këshillim dhe Votim, me datë 08.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Miratohet pjesërisht si e bazuar ankesa nr.11111 e datë 10.11.2018, e parashtruar nga H.A-ish mësimdhënësi në Gjinnazin “Sami Frashëri” në Mitrovicë.

II. Obligohet Komuna e Mitrovicës, përkatësisht Drejtoria e Arsimit që ankuesit H.A., t’ia kompensoj vlerën e përgjithshme prej 724.11 euro (shtatëqind e njëzet e katër euro e njëmbëdhjetë cent).

III. Vendimi hynë në fuqi pas plotfuqishmërisë së tij.

A r s y e t i m

Me datë 10.11.2018, ankuesi H.A., ish zëvendës drejtor në Gjinnazin “Sami Frashëri” në Mitrovicë, ka ushtruar ankesë me nr.11111, në çështjen administrative, kompensim material me rastin e pensionimit.

Sipas ankesës së H. A., pretendon se Drejtoria e Arsimit, nuk i ka mundur realizimin e të drejtave të parapara me rastin e pensionimit të tij duke përfshirë, kompensimin e mos shfrytëzimit të pushimit vjetor, pagesën e pagave jubilarë si dhe kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit. Prandaj, ankuesi kërkon nga Komisioni që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta obligoj komunën që t’i kompensoj pushimin vjetor për 25 ditë të pashfrytëzuar në vlerë prej 630.56 euro, shpërblimi jubilar në vlerë prej 3 pagave bazë në vlerë prej 1428.75 euro, si dhe kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit në vlerë prej 1891.68 euro. Të gjitha këto në vlerën e përgjithshme prej 3,950.90 euro.

Komisioni në seancën e datës 23.11.2018, ka obliguar Zyrën e Personelit që të kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që të përgjigjet në pretendimet ankimore të ankuesit dhe të sjell dokumentet si në vijim: Vendimin për pensionim (përfshirë datën e pranimit të vendimit nga ankuesi); Kontratën e punës së ankuesit, kompensimet e realizuara nga

ankuesi me rastin e pensionimit, dëshmi mbi pushimin vjetor të shfrytëzuar ose të pa shfrytëzuar, si dhe prova tjera relevante që kanë të bëjnë me ankuesin.

Drejtoria e Arsimit, me datë 30.11.2018, ka sjellë shkresën me numër 2222, duke i bashkangjitur vetëm kontratën e punës për ankuesin.

Komisioni konstaton se ankuesit, i kanë shfrytëzuar mjetet juridike dhe në bazë të Rregullores nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave i ka plotësuar kushtet për shqyrtimin e ankesës.

Komisioni gjatë shqyrtimit të ankesës me kujdes administroi këto prova: Ankesën e dt.10.11.2016, Njoftimin drejtuar Drejtorisë së Arsimit e dt.23.11.2016, përgjigjen e Drejtorisë së Arsimit të datës 30.11.2016, vërtetimin e dt.08.12.2016, Kontratën e punës së ankuesit, konfirmimin nga MAP/DASHC për pagën mesatare në Shërbimin Civil.

Komisioni duke u bazuar në nenin 82 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në bazë të shqyrtimit të gjithanshëm të të gjitha shkresave të lëndës erdhi në përfundim se ankesa është pjesërisht e bazuar, sepse:

Me akt emërimit e datës 23.12.2013 H.A, ka qenë i caktuar në pozitën Zëvendësrektor i Gjimnazit “Sami Frashëri” në Mitrovicë, me afat të pacaktuar. Me këtë është konfirmuar që ankuesi gëzon statusin e nënpunësit civil dhe të njëjtit i kanë takuar të gjitha të drejtat dhe përgjegjësit sipas Ligjit për Shërbimin Civil dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore.

Duke u bazuar në certifikatën e lindjes H.A., ka lindur me datë 10.09.1951 dhe rrjedhimisht me datë 10.09.2016 i ka plotësuar kushtet ligjore për pensionim. Në nenin 11 paragrafi 2 të Rregullores nr.01/2011, për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, është përcaktuar që marrëdhënia e punës së nënpunësit civil përfundon me: “arritjen e moshës së pensionimit”, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen obligon organin që të nxjerr vendim për pensionimin e nënpunësit. Përkundër kësaj, Drejtoria e Arsimit, si organ përgjegjës edhe pse ka qenë e obliguar që të nxjerr vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për ankuesin nuk e ka bërë një gjë të tillë por vetëm e ka larguar nga listat e pagave. Me këtë rast Drejtoria e Arsimit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore.

Sa i përket pretendimit të ankuesit për kompensimin e tri (3) pagave me rastin e pensionimit, me nenin 22 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nënpunësve Civil është rregulluar e drejta e kompensimit të nënpunësit civil që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil. Për më tepër, neni 19 paragrafi 2 i Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimi e të tjera të Nënpunësve Civil thotë: “Nënpunësi civil, që

arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”.

Konform kësaj dispozite, Komisioni konstaton që ankuesit i takon kompensimi me rastin e pensionimit dhe atë në shumë prej një page, në vlerën e pagës së fundit. Sipas listës së pagave, paga e H.A., për muajin gusht 2016, ka qenë në shumën bruto prej 630.56 euro. Rrjedhimisht Komisioni konstaton që ankuesit, si shpërblim për pensionim i takon shuma prej 630.56 euro.

Sa i përket pretendimit të ankuesit për shpërblimin e përvjetorit në vlerë prej 3 pagave bazë, Komisioni ka analizuar nenin 21 të Rregullores nr.33/2012, i cili përcakton se: Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nënpunësve Civil nënpunësit civil të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme punë në Shërbimin civil iu takon një shpërblim në vlerë 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjet pune”. Sipas Vërtetimit të datës 08.12.2016, ankuesi ka qenë në pozitën Zëvendës drejtor i Gjimnazit “Sami Frashëri” në Mitrovicë nga data 01.03.2005 deri me datë 10.09.2016, datë kur është pensionuar. Meqenëse ankuesi ka arritur dhjetë (10) vjet pune të vazhdueshme në Shërbimin Civil, Komisioni konstaton që ankuesit i takon shpërblimi i përvjetorit në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil. Me shkresën e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike të datës 24.07.2015, paga mesatare në Shërbimin Civil është konfirmuar në shumën prej 374.23 euro. Prandaj Komisioni konstaton që ankuesit si shpërblim i përvjetorit i takon shuma prej 93.55 euro.

Sa i përket pretendimit të ankuesit për kompensimin e 25 ditëve të pushimit vjetor të pa shfrytëzuara me nenin 5 të Rregullores nr.06/2011 për Pushimin e Nënpunësve Civil është rregulluar mënyra e shfrytëzimit të pushimit vjetor. Paragrafi 4 i nenit të lartë cekur përcakton se: “Nënpunësit civil nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për pushim vjetor..”, ndërsa paragrafi 6 thotë: Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar”. Ankuesi nuk ka sjellë asnjë dëshmi se kërkesa e tij për shfrytëzimin e pushimit vjetor është refuzuar nga mbikëqyrësi. Prandaj, Komisioni konstaton që ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen as në vlerë monetare e as në vlerë jo monetare.

Prandaj Komisioni pas administrimit të të gjitha provave, shkresave të lëndës dhe akteve ligjore në fuqi, në mënyrë unanime, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave
Lënda nr.01/400, 08.12.2016

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afatin prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni:

Kryetari _____

Anëtari _____

Anëtari _____

Vendimi ju dërgohet:

- Ankuesit;
- Kryetarit të Komunës
- Zyrës së Personelit
- Arkivit

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Parashtruesi i Ankesës

H. A., ish zëvendës drejtor në Gjimnazin “Sami Frashëri”, Mitrovicë.

Lënda: Ankesë kundër vendimit nr.01/400 i dt.08.12.2016, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës

Në pajtim me nenin 50 dhe 82 parag. 2, të Ligjit nr. 03/L-149, mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 12 të Rregullores nr. 05/2011 për procedurat e zgjedhjeve të kontesteve dhe të ankesave paraqes këtë:

A N K E S Ë

Për shkak të:

Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;

Konstatimit të gabuar dhe shkeljeve të Ligjit 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Kontratës kolektive të arsimit para universitar i dt.11.04.2014.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës të dt.08.12.2018, është Miratuar pjesërisht si e bazuar ankesa nr.11111 e datë 10.11.2018, dhe është Obliguar Komuna e Mitrovicës, përkatësisht Drejtoria e Arsimit që ankuesit H.A., t’i kompensoj vlerën e përgjithshme prej 724.11 euro (shtatëqind e njëzet e katër euro e njëmbëdhjetë cent).

Me anë të kësaj ankese e kundërshtoj vendimin e dt.08.12.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës.

Me rastin e shqyrtimit të ankesës sime nga ana e Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës, konsideroj se vendimi është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil dhe Kontratës Kolektive. Prandaj të njëjtën e kundërshtoj si të pa bazë, të pa argumentuar, jo profesionale dhe e mbështetur në shkelje të ligjeve të lartcekura.

Me rastin e pensionimit tim institucioni ku kam punuar, respektivisht Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit nuk më ka mundësuar ti realizoj disa të drejta që konsideroj që unë në këtë rast është dashë ti gëzoj:

Të më mundësohet kompensimi i pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2016 (duke llogaritur periudhën kohore janar gusht 2016) respektivisht paga për 25 ditë pune.

Duke pas parasysh se në ditën e daljes në pension, kam mbushur plotë 40 vite përvojë pune, kërkoj të më epet shpërblimi jubilar në vlerë prej 3 pagave në bazë siç parashihet me nenin 36 paragrafi 9 nën paragrafi 4 dhe 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar i dt.11.04.2014 (sipas kontratës kolektive shpërblimin jubilar e paguan punëdhënësi i fundit).

Po ashtu, të më ipen tri paga me rastin e pensionimit siç parashihet me nenin 36 paragrafi 10 i Kontratës Kolektive të arsimit para universitar i dt.11.04.2014.

Këto të drejta janë të zbatueshme nga 01.01.2015, sipas nenit 51 të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar.

Prandaj duke pas parasysh faktet e lartcekura:

P r o p o z o j

Të anulohet vendimi nr. 01/400 i dt.08.12.2016, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Mitrovicës, të miratoni ankesën dhe të sillni vendim me të cilin të obligohet Komuna e Mitrovicës, të më bëjë kompensimin në vlerë të përgjithshme prej 3950.99 euro, në vlerat si në vijim: Kompensimin për pushimin vjetor për vitin 2015 (Janar – Gusht) të pashfrytëzuar 25 ditë pune e barasvlershme me një pagë mujore prej 630.56 euro, Shpërblimin jubilar në vlerë prej 3 pagave bazë $3 \times 476.25 = 1428.75$ euro dhe 3 (tri) paga me rastin e pensionimit, $3 \times 630.56 = 1891.68$ euro, gjithsej kompensim 3950.99 euro.

Ankesës ia bashkëngjis:

- Vendimin nr.01/400 i datës 08.12.2016
- Akt emërimit i datës 23.12.2014
- Ankesën e datës 08.12.2016

Parashtruesi i ankesës

H.A

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: L.P, kryetar, G.G dhe H.S, anëtarë, për shqyrtimin e ankesës të datës 28.012.2016, të parashtruar nga ankuesi H.A, kundër vendimit të komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Komunës së Mitrovicës të datës 08.12.2016, me çështjen juridike kompensim material, duke vepruar në pajtim me nenin 10 parag. 1.1, neni 12.parag.2, të ligjit nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 16 parag. 1 nën parag.1.1, të Rregullores nr.02/2014 për rregullat dhe procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e datës 28.12.2016, e parashtruar nga ankuesi H.A.

II. Mbetet në fuqi vendimi nr.01/400 i datës 08.12.2016, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, H.A., ish i punësuar sipas akt emërimit të datës 23.12.2014, në vendin e punës zëvendës drejtor në Gjimnazin “Sami Frashri”, në Mitrovicë. Ankuesi me datë 10.09.2016, i ka mbushur 65 vjet, rrjedhimisht i ka plotësuar kushtet ligjore për pensionim.

Ankuesi H.A, me datë 10.11.2016, parashtron ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Mitrovicës, me pretendimet ankimore: Kompensim i pushimit vjetor Janar-Gusht 2016, respektivisht 25 dit pune me vlerën e një page mujore prej 630.56 euro, shpërblimin jubilar në vlerë të tri pagave bazë sipas kontratës kolektive në shumën 1428.75 euro dhe kompensimin e 3 (tri) pagave në rastin e pensionimit në shumën prej 1891.68 euro, gjithsej shuma për kompensim 3950.99 euro.

Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 08.12.2016, nxjerrë vendim me të cilin e aprovon pjesërisht ankesën e datës 10.11.2016.

Ankuesi H.A, i pa kënaqur me vendimin nr. 01/400 i datës 08.12.2016, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.12.2016.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: ankesën e datës 28.12.2016, të parashtruar në KPMSHCK, ankesën e dt.10.11.2016, e parashtruar në Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, akt emërimit e datës 23.12.2014, vendimin e datës 08.12.2016, të Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura 1 deri 28.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankuesit H.A, është e pa bazuar sepse: Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i Komunës së Mitrovicës, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit H.A, ka shqyrtuar drejt gjendjen faktike dhe ligjore dhe ka nxjerr vendim me nr. 01/400, me të cilin e aprovon pjesërisht ankesën e ankuesit, në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil që kanë të bëjnë me të drejtën e ankesës së nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se ankuesit me datë 10.09.2016, i ka përfunduar marrëdhënia e punës për arsye të arritjes së moshës së pensionit. Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit merr vendim me nr.01/400 me datë 08.12.2016, me të cilën e aprovon pjesërisht ankesën.

Kolegji, ka konstatuar se Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ka vepruar drejtë kur ka konstatuar se ankuesit i takon një pagë përcjellëse me rastin e pensionimit në bazë të nenit 19 par.2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të Nënpunësve Civil i cili përcakton se: “ Nënpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”. Në pajtim me këtë dispozitë ankuesit i takon kompensim në shumën e një page, në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji i Këshillit, gjithashtu ka konstatuar se Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i komunës së Mitrovicës, ka vepruar drejtë edhe me rastin kur ankuesit ia ka njohur të drejtën e kompensimit prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil për çdo (10) vjet pune. Sipas nenit 21 të Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nënpunësve Civil thuhet: “Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nënpunësve Civil, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme të punës në shërbimin civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh punës”.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pa kënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda nr.02/605/2016, datë 23.02.2017

Kryetari i Kolegjit
L. P

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, H. A.;
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në K. Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK.

***Shembulli i 8-të-natyra e çështjes.
Tender-OSHP***

Sipas LPPA-së, me neni 83 parashihet Fillimi i një procedure administrative

Procedura administrative fillon sipas kërkesës të palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik.

Me par. 3. Përcaktohet se Fillimi i një procedure administrative sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e ligjshëm të organit publik, përpos në rastet kur:

3.1. ligji parasheh shprehimisht detyrimin për të filluar një procedurë;

3.2. organi publik vihet në dijeni të fakteve që kërkojnë fillimin e procedurës në mënyrë që të mbrohet interesi publik.

Procedura administrative vlerësohet të ketë filluar me kryerjen e çfarëdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e një procedure të filluar sipas detyrës zyrtare apo me parashtrimin e kërkesës nga pala, në rastin e një procedure të filluar sipas kërkesës.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore në shembullin e tanishëm, procedura administrative ka filluar sipas detyrës zyrtare të organit Kompetent.

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Kosovë, ku parashihet Njoftimi i Kontratës, Kur një autoritet kontraktues synon që të ndërmarrë prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do të përgatisë një njoftim të kontratës në gjuhët e cekura në Nenin 13.

Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi të kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike.

Bazuar në LPPA, dhe sipas kësaj dispozite ligjore me rastin e Njoftimit për Kontratë fillon procedura administrative në rastin e këtyre llojeve të kontesteve.

“[shëno logon tuaj]”
NJOFTIM PËR KONTRATË
Shërbime

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik në Kosovë

Data e përgatitjes së njoftimit: 05.05.2018

Nr i Prokurimit	KMDK	15	005	236
------------------------	-------------	-----------	------------	------------

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip Serbisht Anglisht

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: -----		
Adresa Postare: Rr. "Deshmoret e Kombit", Prishtinë		
Qyteti: Prishtine	Kodi postar: 10000	Vendi: Prishtine
Personi kontaktues:		Telefoni: +38344/
Email: <u>jjjjj@gmail.com</u>		Faksi: “[shëno numrin e faksit]”
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		“[shëno web e AK]”

Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese

Po Jo

Nëse po, specifikoj identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referojnë një Aneksi.

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve”		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)		
<input type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve _____	Vendi kryesor i dorëzimit _____	Vendi kryesor i realizimit Zyret e KMDK-së, Prishtine
II.1.3) Njoftimi përfshinë		
Një kontratë publike	Po <input checked="" type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
Krijimin e kontratës publike kornizë	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):		
Kontrate publike kornizë me një operator	<input type="checkbox"/>	
Kontrate publike kornizë me disa operator	<input type="checkbox"/>	
Ekzekutimi i kontratës:		
Thirrje/Porosi	<input type="checkbox"/>	
Kontrata ndihmëse/Mini-konkurrencë	<input type="checkbox"/>	
Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj _____		
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës “Shërbimet e sigurimit dhe regjistrimit të automjeteve për KMDK-në”		
II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 30		
II.1.7) Variantet pranohen	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.8) Ndarja në Pjesë	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po, tenderët duhet të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)</i>		
<input type="checkbox"/> vetëm një pjesë	<input type="checkbox"/> një a ma shumë pjesë	<input type="checkbox"/> Të gjitha pjesët

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

--

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

--

ENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit	Po <input checked="" type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
<i>Nëse po</i> , vlera e sigurisë së ekzekutimit 1,000.00 Euro		
III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):		
<hr/>		
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po</i> , përshkrimi i kushteve të veçanta		

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: <ul style="list-style-type: none">a. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.b. Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.c. Vërtetimin nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- te jete i lëshuar se paku deri në tre mujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. Originali ose Kopje e vërtetuar. <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <ul style="list-style-type: none">a. Deklaratë nën betim (Originali).b. Një vërtetim nga Administrata Tatimore.c. Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinali ose kopje e vërtetuar. <p><u>Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës.</u></p>
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: <ul style="list-style-type: none">1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;2. Regjistrimi i TVSH;3. Regjistrimi i Numrit Fiskal;4. Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar. <p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <ul style="list-style-type: none">1. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit. (kopje)

2. Certifikata e TVSH-se (kopje) 3. Certifikata me Numër Fiskal (kopje) 4. Licencen për shërbime (kopje)
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar 1. <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional 1. <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> 1.

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po,</i> referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse		
III.3.2) Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës	
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur	
<input type="checkbox"/> E kufizuar	
<input type="checkbox"/> E negociuar	Arsyetimi për zgjedhjen e procedurës së negociuar

IV.2) KRITERET E DHËNIES

<i>Shëno në kutinë e duhur dhe fshije tjetrën</i> <input checked="" type="checkbox"/> Çmimi më i ulët
--

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
<i>Nëse po,</i> Njoftim paraprak: _____ Publikime tjera (nëse aplikohen): _____		

IV.3.2) Kushtet për marrjen e [dosjes së tenderit]	
Afati i fundit për pranimin e kërkesave për [dosjen e tenderit]: data	
Dokumentet me pagës	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Nëse po, çmimi _____	
Kushtet dhe metoda e pagesës: _____	
IV.3.3) Afati i fundit për pranim të [tenderëve]:	
data koha 14:00 vendi Zyret e , Prishtinë	
IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e [tenderëve] është shkurtuar:	
<input type="checkbox"/> po <input checked="" type="checkbox"/> jo	
Nëse po, jep arsyetim	
IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:	
	Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit	
Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë apo muaj _____	
IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:	
IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:	
data koha 14:30 vendi Zyret e , Prishtinë	

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit, në bazë të dispozitave të Pjesës IX të Ligjit Nr. 04/L-042, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë.

V.1.1) ADRESA E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

Emri zyrtar: Organi Shqyrtues i Prokurimit	
Adresa e OSHP: Rruga, Garibaldi	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar:
Adresa elektronike (nëse aplikohet):	
Personi kontaktues:	E-mail:
Telefoni:	Faksi:

V.2) INFORMACIONET SHITESË

--

“shëno logon tuajj”
REPUBLIKA E KOSOVËS
SHQYRTUES I PROKURIMIT

Me qenë se AK nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së nr.27/2018 të datës 27.02.2018, në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr.04/L-042, OSHP me datë 19.03.2018, merr këtë:

URDHËRESË
PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË OSHP-SË NR.27/2018, TË DATËS
27.02.2018

Urdhërohet Autoriteti Kontraktues /Policia e Kosovës (PK), që ta zbatoj Vendimin e OSHP-së Nr.27/18, të datës 27.02.2018, për ri-vlerësimin e ofertave konform LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve” me nr. 132 12 903 111.

I. Urdhërohet Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës që ta anuloj njoftimin për anulim në KRPP, të këtij aktiviteti të prokurimit të datës 14.03.2018, sit ë kundërligjshëm, për aq më pakë kur kontrata e tillë është kontratë kornizë e cila pritet të realizohet jo për 12 muaj por për 36 muaj.

II. OSHP-ja me datë 27.02.2018, duke u bazuar në Raportin e ekspertit shqyrtues të dt.25.02.2018, dhe në faktet tjera të vërtetuar ka marr vendim që procedura e prokurimit me titull “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve” me nr.132/12/903/111, të kthehet në ri-vlerësim, duke evidentuar shkelje të neneve 7, 54 dhe neni 59 të LPP-së.

III. Operatori Ekonomik “NN” sh.p.k Prishtinë, me datë 15.03.2018, ka njoftuar OSHP-në me rastin e ri-vlerësimit, AK-ja nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së nr.27/2018, të dt.27.02.2018, duke anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi. AK-së me datë 14.03.2018, ka njoftuar OSHP-në. me ri-vlerësimin, ku Komisioni i vlerësimit ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e përgjegjshme përmbajnë çmime të cilat në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e këtij AK.

IV. Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se Autoriteti Kontraktues/ Policia e Kosovës, nuk e ka respektuar Vendimin e OSHP-së Nr.27/18, të datës 27.02.2018, por është përpjekur që në kundërshtim me nenin 105 pika 2.1, 2.3, 2.4 të LPP-së t’i bishtnojë zbatimit të vendimit dhe urdhëresave të OSHP-së.

V. Mos respektimi i Vendimit të OSHP-së i datës 27.02.2018, e detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së, ndaj Autoritetit Kontraktues të vendos një gjobë jo më pakë se 5,000.00 (pesëmijë) euro dhe

njëkohësisht të merr masa ndaj Menaxherit të prokurimit konform nenit 25.8 të LPP-së.

VI. Kjo urdhëresë hyn në fuqi brenda pesë (5) ditëve.

Kryetari i Panelit,

Urdhëresa t'i dorëzohet:

1. 1x1 Policisë së Kosovës;
2. 1x1 "NN" shpk Prishtinë;
3. 1x1 Arkivës së OSHP-së.

“[shëno logon tuaj]”

Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar¹

[Shëno datë dhe vendin]

[Shëno emrin dhe adresën e autoritetit kontraktues]

[Shëno emrin dhe adresën e tenderuesit]

Nr. i prokurimit:									
--------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Titulli: [shëno titullin e aktivitetit të prokurimit]

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] [shëno emrin e personit kontaktues të operatorit ekonomik]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[shënoni katrorin gjegjës]:

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

- Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;

¹ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

- Gabimi (et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]

- Nuk keni paraqitur një deklaratë të qartë se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, në rast se grupit i është dhënë kontrata, performancën e kontratës;
- Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga secili anëtar, e cila konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër pjesëmarrës në procedurën e njëjtë të prokurimit;
- Nuk keni paraqitur deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit e cila autorizon partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit;
- Partneri juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Në rast të nënkontraktimit]

- Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

- Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara te cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme te kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye:

[Deklaroni arsyet e hollësishme mbi refuzimin në përputhje me rrethanat]

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)

(Nënshkrimi)

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.
05/L-092*

Një ankesë kundër: *(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)*

Sa i përket tenderit për *(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)*

*(formulari standard i ankesës të cilën mund ta gjeni në web portalin e organit
administrativ.)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

(Adresa)

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

** Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autor

Organin Shqyrtues të Prokurimit - Prishtinë.

Parashtruesi i Ankesës

“S. S”, shpk. Rr. Dëshmorët e Kombit, nr. 12. Prishtinë, NRB 4506280.

Kundër; Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, rr. “Luan Haradinaj”, pn. 10000 Prishtinë, (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues).

Nr. Prokurorimit: 132 12 903 111

Titulli i Kontratës: “Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve”.

I pa kënaqur me Njoftimin për dhënien e kontratës furnizime i Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, të dt.08.04.2018 (në tekstin e mëtejme: autoriteti kontraktues) me objekt të prokurimit “Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve” me numër të prokurimit 132 12 903 111, brenda afatit ligjor e në bazë të nenit 109 par.1 të Ligjit nr.04/L-04 i dt. 29.08.2011 (në tekstin e mëtejme LPP), operatori ekonomik “S.S” sh.p.k, paraqet këtë:

A N K E S Ë

Për shkak të:

1. Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, lidhur me aktivitetin e zbatimit të prokurimit publik;
2. Shkeljes thelbësore të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Përshkrimi i shkurtër i Aktivitetit të Prokurimit

- 1) Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin me datë 08.11.2017, me titull “Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve”, me numër të prokurimit 132 12 903 111.
- 2) Procedura e tenderit ka qenë e hapur dhe dhënia e kontratës është parashtruar me çmimin më të ulët të ofertuesit.
- 3) Me procesverbalin e hapjes së tenderit të Autoritetit Kontraktues me titullin “Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve”, me numër të prokurimit 132 12 903 111, të datës 18.12.2017, është konstatuar se kanë ofertuar dhe janë

kualifikuar pesë (5) Operatorë Ekonomik, e në mesin e tyre edhe “S.S” sh.p.k, nga Prishtina, me NRB 4506280 dhe “ A.S” shpk Prishtinë me NRB 11111111. Ky i fundit i regjistruar në ARBK, për ushtrimin e veprimtarisë së lëmit ndërtimor, i cili paraqet veprimtarinë kryesore të këtij Operatori Ekonomik. Një gjë e tillë rezulton nga:

- a) Dokumentacioni i siguruar i ARBK-së i dt.15.04.2013, nga i cili nuk rezulton se ky operator ekonomik të ketë të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së teknologjisë informative.
 - b) Lista e 49 kontratave të dhëna si referencë në ofertën e këtij tenderuesi.
- 4) Nga ekstrakti elektronik nga web faqja e ARBK-së rezulton se “A. S” shpk në Prishtinë, merret me punën ndërtimore (ndërtim i lartë dhe i ulët).
- 5) Operatori Ekonomik “S.S” shpk, ankues, merret kryesisht me teknologji informative, hardëare, softëare, instalime elektronike dhe veprimtari tjera të lidhura me makinat llogarisë, gjë kjo e cila garanton nivel të lartë të punëve që kanë të bëjnë me natyrën e tenderit me nr. të prokurimit 132 12 903 111.

PROVË:

- Ekstrakti i dt.15.04.2018, nga Website i ARBK-së për Operatorin Ekonomik “A.S”, sh.p.k,
 - Ekstrakti i dt.15.04.2018, nga Website i ARBK-së dhe “S. S” sh.p.k me listën e aktiviteteve.
 - Lista e kontratave për punës e kryera ndërtimore nga ana e operatorit ekonomik “A. S” sh.p.k.
- 6) Operatori Ekonomik ankues ushtrimin e veprimtarisë të ligjshme dhe të regjistruar në ARBK në lëmin e teknologjisë informative e kryen pesë vjetë të plota me një performancë shumë të suksesshme. Pra, ofrimi i këtyre shërbimeve dhe furnizimeve të këtij operatori ekonomik nga teknologjia informative ka qenë mjaftë i sukseshëm duke përbushur tërësisht dhe saktësisht të gjitha detyrimet kontraktuese me ndershmëri, ndërgjeshmëri dhe përgjegjësi të lartë profesionale sipas rregullave, praktikave dhe standarde të kësaj lëmije profesionale. Po kështu, ky operator ekonomik, i ka përbushur të gjitha kontratat me partnerët e saj sipas sasisë, cilësisë, kërkesave dhe kriterëve tekniko-teknologjike sipas normave dhe standardeve përkatëse.
- 7) Sipas procesverbalit të hapjes së tenderit të autoritetit kontraktues “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve” me nr. të protokollit 132 12 903 111, të datës 18.12.2017, operatori ekonomik ka ofruar çmim prej 120,000.00 euro që ka qenë çmim më i ulët, ndërkaq “A.S” shpk, ka ofruar çmimin prej 38,000.00 euro,

që sipas nenit 61 të LPP-së të kualifikuar si tender jo-normalisht i ulët. Në ndërkohë, autoriteti kontraktues me email-in e dt.23.01.2018, ka kërkuar nga Operatori ekonomik "A.S" shpk, që të deklarohet se ky çmim tejet i ulët eventualisht mos i referohet gabimit aritmetikor, gjë të cilën edhe i njëjti e ka konfirmuar, dhe kështu çmimi i ofertës së tij është përcaktuar në shumë prej 170,000.00 euro.

Provë: Procesverbali i hapjes së tenderit me nr. të prokurimit 132 12 903 111, i dt. 18.12.2018.

- 8) Me njoftimin për dhënien e kontratës së furnizimit sipas numrit të prokurimit sipas procedurave të hapura dhe me kriter të dhënies së kontratës me çmim më të ulët i jepet operatorit ekonomik "SS" shpk, në cilësinë e operatorit të përgjegjshëm që është në përputhje me dosjen e tenderit, duke i plotësuar kërkesat teknike dhe rrjedhimisht i ka përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktues të specifikuar në dosjen e tenderit.
- 9) Me vendimin e panelit shqyrtues të Prokurimit me PSH. Nr. 27/2018 i dt.27.02.2018 në paragrafin I. Është miratuar ankesa e operatorit ekonomik "A.S" shpk, me nr. të prokurimit 132 12 903 111, dhe në paragrafin II është anuluar vendimi i autoritetit kontraktues për dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit "Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve" dhe lënda i kthehet autoritetit kontraktues në rivlerësim. Në arsyetimin e dhënë të këtij vendimi është konstatuar se operatori ekonomik "S.S" shpk, i rekomanduar për dhënien e kontratës, nuk ka plotësuar pjesën "C"-në formularin e dorëzimit të tenderit-në faqën 60/50 të dosjes së tenderit. Ndërkaq, eksperti shqyrtues, me ekspertizën e dt.25.02.2018, ka konstatuar se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës "S S" shpk, në deklaratën e liferimit të mallit ka saktësuar, plotësuar dhe specifikuar validitetin e ofertës prej 120 ditësh, gjë kjo e cila tërësisht dhe saktësisht e konkretizon dhe e mbulon në çmim në mes të operatorit ekonomik "A.S" shpk dhe operatorit "S.S" shpk, ka propozuar që pretendimi i operatorit ekonomik "A.S" shpk. të refuzohet dhe të konfirmohet vendimi i autoritetit kontraktues, i cili ka parashikuar dhënien e kontratës për furnizime operatorit ekonomik " S. S" shpk.
- 10) Përveç kësaj, KRPP, sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të LPP-së, ka këshilluar këtë autoritet kontraktues që ofertat e operatorit "S. S" shpk, të cilësohen si e përgjegjshme dhe valide.

Provë: email i KRPP-së

- 11) Me urdhërin e Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.27/2018 të dt.19.03.2018 është urdhëruar autoriteti kontraktues të zbatoj vendimin e këtij organi nr. 27/18 i

dt.27.02.2018, për rivlerësimin e ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve” me nr. të prokurimit 132 12 903 111.

Provë: Urdhëri i dt.19.03.2018.

- 12) Nuk është kontestuese se autoriteti kontraktues, duke iu qasur rivlerësimin të ofertës “A.S” shpk, dhe duke qenë se specifikimet teknike të këtij operatori ekonomik kanë qenë jo adekuare, ndaj edhe autoriteti kontraktues, me email-in e datës 21.03.2018 ka kërkuar që deri më 25.03.2018, në orën 15:00 të saktësojë prodhuesin, emrin dhe modelin e pajisjeve duke i sjellë ato specifikime për të gjitha pajisjet e ofruara.
- 13) Me email-in e datës 25.03.2018, me afat deri në orën 15:00 të së njëjtës ditë, autoriteti kontraktues kishte kërkuar përsëri nga ky operator ekonomik t’i sjell specifikimet teknike, ngase aot të dorëzuara më parë nuk ishin konform standardeve e as që ishte saktësuar modeli i artikullit.
- 14) Me email-in e dt. 27.03.2018, pas kërkesave dhe urdhërave të autoritetit kontraktues dhe pas sqarimeve verbale është bërë vlerësimi pozitiv i kriterëve dhe specifikimeve teknike, ndaj edhe në fund pason edhe njoftimi për dhënien e kontratës për furnizime të operatorit ekonomik “AS” i dt.08.04.2018, pasi që paraprakisht, sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar është eliminuar operatori ekonomik “SS” shpk, nga Prishtina me arsyetim se në formularin e tenderit nuk është plotësuar vlefshmëria e tenderit, ndonëse në deklaratën e livrimit të mallit është përcaktuar vlefshmëria për këtë tender prej 120 ditë.

Provë: Njoftimi për dhënie të kontratës i dt.08.04.2018.

A. Shkelje thelbërore të dispozitave të Ligjit për Prokurimin publik.

- 1) Njoftimi për dhënien e kontratës për furnizime sipas numrit të prokurimit 132 12 903 111 lidhur me modernizimin e sigurisë fizike në dhomat e serverëve të dt. 08.04.2018, është përfshirë me shkelje thelbësore nga neni 7 par.1 dhe 2, neni 53 par.6, si dhe nenet 54, 59 dhe 60 të LPP-së.
- 2) Shkeljet thelbësore të dispozitave të nenit 7 par.1 dhe 2 të LPP-së, konsiston në faktin relevant se me këtë dispozitë parashihet, citoi: “1. *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.* 2. *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik*”.

- 3) Nuk është kontestuese se me procesverbalin e hapjes së tenderit lidhur me lëndën e kontratës “Modernizimin e sigurisë fizike në dhomat e serverëve” ofertuesi i tretë “A.S” shpk, ka ofertuar me çmim 38,000.00 euro dhe se pas kërkesës së autoritetit kontraktues për tu deklaruar për çmim, ngase ai çmim ka qenë tepër i ulët, atëherë ajo është korrigjuar në shumë prej 170,000.00 euro. Pra, me kërkesë të autoritetit kontraktues, operatori ekonomik “A.S” shpk, i është dhënë mundësia dhe e drejta që ajo shumë të korrigohet dhe të plotësohet. Në ndërkohë, më këtë ofertë të korrigjuar është njoftuar edhe “S.S” shpk.
- 4) Ndërkaq, autoriteti kontraktues, tri herë radhazi edhe atë: me datës 21.03.2018, më 25.03.2018 dhe më 27.03.2018, ka kërkuar, insistuar dhe urdhëruar operatorin ekonomik, tashmë i rekomanduar për dhënien e kontratës, t’i evitojë mangësitë dhe të metat duke saktësuar, konkretizuar emrin e prodhuesit, emrin e modelit të pajisjeve dhe në kundërshtim me nenin 7 par.1 dhe 2 të LPP-së, po që se kishte për të pasur eventualisht paqartësi dhe mëdyshje, atëherë ka pasur për detyrim që sipas nenit 53 par 6 dhe nenit 59 par.2 dhe 3 të LPP-së, t’i mundësohet “S. S” shpk, që të evitohet gabimin aritmetik apo teknik të përvjedhur lidhur me caktimin e vlefshmërisë së ofertës prej 120 ditësh, ndonëse në deklaratën e livrimit të mallit është saktësuar vlefshmëria me një kohëzgjatje të tillë (120 ditë). Prandaj, autoriteti kontraktues, në njërën anë duke i mundësuar dhe duke kërkuar tre herë radhazi nga operatori ekonomik “A. S” shpk, t’i evitohet mangësitë në specifikimet dhe kriteret teknike, në anën tjetër ia pamundëson operatorit ekonomik ankues që gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit por edhe me rastin e dhënies së njoftimit për dhënien e kontratës të datës 08.04.2018, të përmirësojë gabimin e përvjedhur, duke e trajtuar operatorin ekonomik “S.S” shpk, në këtë mënyrë të pa barabartë dhe me veprim diskriminues, kurse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës.
- 5) Po kështu, letra standarde për tenderin e eliminuar i dt. 14.03.2018 është marrë me shkelje thelbësore të nenit 7 par.1 dhe 2 të LPP-së. Kjo pikërisht për arsye se për derisa autoriteti kontraktues me procedurën e prokurimit, nga operatori ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës ka kërkuar dhe i ka dhënë mundësi si dhe të drejtë për evitimin e mangësive dhe gabimeve të kriterëve teknike, ndërkaq një e drejtë e tillë i është pamundësuar operatorit ekonomik ankues.
- 6) Arsyet e eliminimit të operatorit ekonomik ankues me shpjegimin se nuk është plotësuar vlefshmëria e tenderit për 90 ditë, janë të pa pranueshme, të pa qarta, të pakuptueshme, të pa bazuara dhe kundërthënëse. Kjo për arsye se KRPP me email-in e tij me kërkesë të autoritetit kontraktues e kishte këshilluar të njëjtin që të merr si të vlefshëm tenderin e operatorit ekonomik ankues. Përpos kësaj, me ekspertizën e ekspertit shqyrtues, të dt. 25.02.2018, është konstatuar se tenderi i operatorit ekonomik ankues është cilësuar si i vlefshëm, ngase në deklaratën e livrimit të mallit është saktësuar një afat prej 120 ditësh. Prandaj, sikundër letra standarde për

tenderuesin e eliminuar e dt.14.03.2018 dhe njoftimi për dhënen e kontratës i dt.08.03.2018 është marrë me veprim diskriminues në dëm të operatorit ekonomik ankues, ngase nuk është vepruar në mënyrë proporcionale me evitimin e të metave dhe në mbrojtje të interesit publik. Kjo aq më tepër ngase me njoftimin për dhënen e kontratës për furnizime i dt.08.04.2018, i është dhënë operatorit ekonomik “A. S” shpk, i cili ka ofruar çmim më të lartë se operatori ekonomik ankues, për aq sa është dëmtuar edhe buxheti i Republikës së Kosovës, i dedikuar për Policinë e Kosovës.

- 7) Njoftimi për dhënen e kontratës i dt.08.04.2018, është marrë me shkelje të dispozitave të nenit 53 par.6 dhe neni 59 të LPP-së. Me nenin 53 par.6 të LPP parashihet:

Citat:

“Nëse autoriteti kontraktues konstaton se ndonjëra nga informatat e kërkuara sqaruese ose plotësuese e cila kërkohet nga operatorët ekonomik për kontraktim është e domosdoshme për ta, autoriteti kontraktues menjëherë dhe në të njëjtën kohë siguron informata me shkrim, përmes mjeteve më të shpejta të mundshme, të gjithë operatorëve ekonomik, që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës ose ftesën për tenderim. Autoriteti kontraktues nuk do të zbulojë identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese”.

- 8) *Në rastin konkret autoriteti kontraktues nuk ka ndërmarrë veprime konkrete juridike për t'i trajtuar në mënyrë të barabartë dhe të drejtë të gjithë operatorët ekonomik. Kjo për faktin se, për derisa nga operatori ekonomik “A.S” shpk, ka kërkuar ti evitoj të metat, duke i dhënë mundësi t'i ndrojë dhe plotësojë specifikat teknike, ndërkaq operatorit ekonomik ankues nuk i është mundësuar një gjë e tillë. Ndaj edhe këto veprime juridike janë përfshirë me favorizimin e operatorit ekonomik “A. S” shpk, e në anën tjetër është diskriminuar me pa të drejtë operatori ekonomik ankues për një gabim aq minor dhe të parëndësishëm që nuk ka aspak ndikim në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e ofertës së tij.*
- 9) *Njoftimi për dhënen e kontratës për furnizime operatorit ekonomik “A. S” shpk, I dt.08.04.2018, është përfshirë me shkelje të dispozitave të nenit 59 par2 dhe 3 të LPP-së. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se autoriteti kontraktues nuk mund të kërkoj apo të pranoj ndonjë ndryshim material të tenderëve të paraqitur, por mund të përmirësoj gabimet në ato tender të paraqitur që janë tërësisht aritmetik, gabime këto të cilat zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Prandaj, autoriteti kontraktues, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e cituar, nuk ia ka mundësuar dhe rrjedhimisht nuk i ka dhënë të drejtë operatorit ekonomik ankues që të përmirësojë, ngase ashtu mund të thuhet, gabimin teknik duke plotësuar formularin në paragrafin “C” të faqes së theksuar vlefshmëria prej 120 ditësh, gjë*

që e njëjta është konfirmuar si ofertë e vlefshme nga ekspertiza e ekspertit shqyrtues I dt.25.02.2018 me konstatimin se I njëjti është tender I vlefshëm.

- 10) Po ashtu, me kërkesën e autoritetit kontraktues të dt.04.04.2018, operatori ekonomik ankues, të njëjtën ditë ka ofertuar vlefshmërinë e ofertës së tij nga data 18.03.2013 dhe më 20.04.2018.
- 11) Konsiderojmë se për faktin se me kërkesën e autoritetit kontraktues, operatorit ekonomik i rekomanduar për dhënien e kontratës, është dhënë mundësia t'i ndërrojë, shtojë, plotësojë specifikat teknike, ndaj veprimet e njëjta tenderuese bien ndesh me nenin 59 par 4 të LPP-së. Kjo për faktin se me ndërrimin, shtimin, plotësimin e specifikave teknike nuk mund t'i atribuohen devijimeve të vogla, por i referohen ndryshimeve të specifikave teknike tërësisht të ndërruara. Për më tepër në dosjen e tenderit nuk është parashikuar mundësia e paraqitjes së specifikave teknike me shumë variante. Ndërkaq, operatorit ekonomik "A. S" shpk i është ofruar mundësia e tillë dhe kështu ai ka ofruar shumë prodhues për një artikull.
- 12) Përpos kësaj, autoriteti kontraktues e ka bërë eliminimin e operatorit ekonomik ankues me arsyetim se vlefshmërinë e tenderit prej 90 ditësh e ka shënuar veçmas e jo në formular, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 të LPP-së. Ky gabim në plotësimin ekskluzivisht të vlefshmërisë së kontratës prej 120 ditësh në pjesën "C" të formularit është i karakterit teknik dhe i parëndësishëm dhe rrjedhimisht, nuk ka pasur ndikim dhe lidhje kauzale drejtpërdrejtë që ky operator ekonomik të eliminohet në aktivitetin e këtij prokurimi. Eliminimi i këtij operatori ekonomik është i pa drejtë, i paligjshëm, arbitrar. Po kështu, eliminimi i këtij operatori mund të kuptohet si vendimmarrje me elemente të njëanshme dhe jo-objektive. Kjo pikërisht për arsye se sipas kësaj dispozite ligjore, njoftimi për dhënien e kontratës për furnizime por edhe kësaj dispozite ligjore, njoftimi për dhënien e kontratës për furnizime por edhe letra standarde për tenderuesin e eliminuar, detyrimisht duhet të përfshijnë sqarime dhe shpjegime të drejta, të plota, të qarta dhe të kuptueshme, gjë që nuk është vepruar në këtë rast. Çdo vendim i autoritetit kontraktues duhet të përfshijë një përmbledhje të çështjeve faktike dhe konkludimit juridik e kësaj nuk është vepruar. Prandaj, mosdhënia e sqarimeve të plota, të drejta dhe të ligjshme sikundër për konstatimet faktike ashtu edhe për qëndrimin juridik është i barsvlershëm me mungesën e arsytimit gjë që këto akte i bënë të jenë absolutisht të pavlefshme. Ndaj, edhe për këto shkaqe dhe arsye, propozojmë që njoftimi për dhënien e kontratës për furnizime të operatorit ekonomik "A. S" shpk e dt. 08.04.2018, të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe lënda t'i kthehet autoritetit kontraktues në rivlerësim.

Për këto shkaqe dhe baza ankimore i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), që pas vlerësimit dhe shqyrtimit të provave të propozuara të merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet ankesa e Operatorit Ekonomik “S.S” shpk., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve”, me numër të prokurimit 132 12 903 111 të realizuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës si e bazuar.

II. Vendimi i Autoritetit Kontraktues-Policia e Kosovës, për dhënien e kontratës për aktivitetin e Prokurimit “Modernizimi i Sigurisë Fizike në Dhomat e Serverëve”, me numër të prokurimit 132 12 903 111, dhe lënda i kthehet në rivlerësim autoriteti kontraktues.

III. Detyrohet Autoriteti Kontraktues që Operatorit Ekonomik ankues t’ia shpërblejë kompensimin e dëmit në shumë prej 1,000.00 Euro.

Prishtinë, më datë 15.04.2018

Parashtruese i ankesës,
S.S

Shtojcat:

1. Kopja e Njoftimit për dhënien e kontratës-furnizime e dt.08.04.2018;
2. Procesverbali i hapjes së tenderit me nr. të prok. 132 12 903 111, e dt.18.12.2017;
3. Kopja e njoftimit mbi tenderuesin e eliminuar të dt.08.04.2013;
4. Urdhëri i OSHP-së i dt.19.03.2018;
5. Ekstrakti nga Webfaqja e ARBK-së për “A. S” shpk;
6. Ekstrakti nga Webfaqja e ARBK-së për “S. S” shpk;
7. Autorizimi.

*Me nenin 105 par.1 dhe 2 pika 2.1, të Ligjit për Prokurimin Publik, parashihet kompetenca e OSHP për të vendosur lidhur me ankesën, dhe me nenin 116 të po këtij ligji përcaktohet se: **kundër një ankesë të palës lidhur me aktivitetin e prokurimit do të marrë vendim.***

“[shëno logon tuaj]”
REPUBLIKA E KOSOVËS
SHQYRTUES I PROKURIMIT

PSH.Nr. 94/2019

Në bazë të nenit 97 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28, nenit 105 dhe nenit 111, të Ligjit mbi Prokurorimin të Kosovës Nr.04/L-042-Kryetari i OSHP-Z. Hysni Hoxha me datë:15.01.2018, nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e OE “NN” Prishtinë, me nr.94/18 e dt.16.04.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve” me numër të protokollit: 132 12 903 111, e iniciuar nga autoriteti Kontraktues (AK) - Policia e Kosovës.

II. LEJOHET Autoritetit Kontraktues/Policia e Kosovës/ që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve”, me nr. 132 12 903 111.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, pas vlerësimit të ofertave lidhur me tenderin Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve”, me nr. 234/12/341/111, me datë 25.01.2018, ka shpallur të papërgjegjshëm OE “NN” –Prishtinë, OE. Ndërsa OE “NN” në Prishtinë, të pa kënaqur me vendimin e AK-së me dt.08.02.1018, ka paraqitur ankesë me nr. 27/18, në OSHP, me arsyetimin se AK-ja ka shkelur nenet 51,52,54,57,59,65,66 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e OE ankues të cilat janë cekur në ankesë i konsideron si të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe njëkohësisht vjen në përfundim se AK-ja, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit i ka respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale të LPP-së, përkatësisht me rastin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Operatori Ekonomik me anë të parashtresës së datës: 26.02.2018, ka njoftuar OSHP, se nuk pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

AK-ja me anë të parashtrësës së datës 26.02.2018, ka njoftuar OSHP, se pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues me datë 27.02.2018, ka marrë vendim që procedura e lartpërmendur e prokurimit të kthehet në ri-vlerësim.

AK-ja ka bërë rivlerësimin e ofertave dhe me dt.28.02.2018, ka bërë njoftimin për anulim të dhënies së kontratës, ku është anuluar në tërësi aktiviteti i prokurimit.

Operatori Ekonomik “NN” Prishtinë, si palë e pa kënaqur, me datë 15.03.2018, për shkresës zyrtare ka njoftuar OSHP, se AK-ja nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit, por ka bërë anulimin e aktivitetit prokurimit në tërësi dhe kërkon që të urdhërohet AK-ja të respektoj vendimin e OSHP-së për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Autoriteti Kontraktues gjatë ri-vlerësimit të ofertave nuk është përmbajtur rekomandimeve të Panelit Shqyrtues të dhëna në Vendimin e datës 27.02.2018.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me dt.19.03.2018, lëshon Urdhëresë, ku urdhëron AK, të zbatoj vendimin Nr.27/18 të datës 27.03.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve”, me nr. 132 12 903 111.

Organi shqyrtues i Prokurimit, me datë 04.04.2013, lëshon edhe një Urdhëresë tjetër, ku urdhëron AK, që të zbatoj vendimin nr.27/18, të datës 27.02.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Modernizimi i sigurisë fizike në dhomat e serverëve”, me nr. 132 12 903 111.

AK-ja pastaj ka bërë rivlerësimin e ofertave, konform nenit 59, të LPP-së dhe me datës 08.04.2018, ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës në KRPP dhe ka shpallur fitues OE “NN” sh.p.k. Prishtinë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, vlerëson se për të njëjtën çështje nuk mund të vendoset dy herë sepse, kjo çështje është *Res Judicata* për faktin se Paneli Shqyrtues, për të njëjtën çështje me datë 27.02.2018, ka vendosur me vendim meritor, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “NN” sh.p.k. Prishtinë.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
H. H.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj padi, në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Organi shqyrtues i Prokurimit Publik, duke vendosur lidhur me ankesën e palës, në rastin konkret (REALISHT) ka vendosur me konkluzion, duke vepruar kështu në kundërshtim me LPPA-në, dhe vet ligjin e Prokurimit Publik.

(Këshilla juridike e dhënë në këtë Udhëzim Juridik të këtij Konkluzioni (e cila thot se pala ka të drejtë të bëjë padi vetëm për kompenzimin e dëmit në Gjykatë, dhe nuk ka të drejtë ankese ndaj konkluzionit) është në kundërshtim me LPPA-në, sepse vendimi i OSHP-së, i marrë konform dispozitave ligjore, duhet të ketë këshillën juridike që ligjshmëria e të njëjtit të vlerësohet nga gjykata, e pastaj të mund të kërkohet kompenzimi i dëmit nga pala, që dmth se kjo këshillë juridike e dhënë në formën siç është paraqitur apo siç paraqitet në vendimet e OSHP-së është në kundërshtim me ligjin, dhe i jep palës orientim të gabuar lidhur me vazhdimin e procedurës në gjykatë)

(Kundër çdo vendimi përfundimtar të marrë në procedurë administrative, lejohet fillimi i konfliktit administrativ me padi, në rastin konkret i njëjti nuk është vendim përfundimtar sepse me konkluzion organi administrativ mund të vendos vetëm për çështjet procedurale lidhur me zhvillimin e procedurës, e jo si në rastin konkret lidhur me ankesën e ushtruar si mjet i fundit në proc. Administrative)

(Të gjitha konkluzionet e vendosura në procedurë përfundimtare pranë OSHP-së, si vendime përfundimtare në procedurë administrative, do të anulohen nga gjykata dhe organi administrativ detyrohet që lidhur me ankesën e palës të merr vendim konform dispozitave ligjore të LPPA-së).

***Shembulli i 9-të-natyra e kontestit
Ri-atëdhësim***

(Formulari për kërkesës mund të merret Online në web faqen e Komunës)

**“*[shëno logon tuaj]*”
KOMUNA E MITROVICËS
Kryetari i Komunës**

Nr.43912 datë 06.05.2015

Në bazë të nenin 13 dhe 5 të ligjit nr.03/L-040, për Vetqeverisje Lokale, nenit 25 të rregullores QRK-së, nr. 20/2013, për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar, dhe menagjimin e programit të ri-integrimit dhe në bazë të rekomandimeve të dala nga takimi i rregullt i komisionit komunal për ri-integrim i datës 19.05.2015, Kryetari i Komunës sjellë:

VENDIM

1. Rfuzohet kërkesa nr.43912 e datës 06.05.2015, e parashtruar nga H.O, i ri-atdhesuar nga Gjermania, e sigurimit të banimit përmes qirasë për gjasht muaj.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen organet përgjegjëse pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëher

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Ri-integrim, në seancën e mbajtur me datë 19.05.2015, kqa shqyrtuar kërkesën e parashtruar me datë 15.05.2015, nga i ri-atdhesuari H.O, nga Mitrovica për përfitim nga prgrami i ri-integrimit për lejimin dhe sigurimin e banimit përmesë qirasë.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuar dhe sipas dëshmime të paraqitura konstaton se i ri-atdhesuari nuk i plotëson kriterët për mbështetje nga programi i ri-integrimit të përcaktuara me rregulloren e QRK-së nr.20/2013, për ri-integrimin e personave të ri-adhesuar dhe menaxhimin e programit te ri-integrimit, andaj u vendos si në dispozitivë të këtij vendimi.

Për KKR-në:
B.S

Kryetari i Komunës
XX

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së këtij vendimi, komisionit për ankesa në Departamentin për ri-integrim në MPB në Prishtinë.

Ti dërgohet:

- Palës H.O
- Zyrës Komunale për Kthim dhe komunitet
- MPB-së dhe
- Arkivit.

**MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR RI-INTEGRIM PËR
KOMISIONIN PËR ANKESA**

Nga H.O, i lindur në Mitrovicë, nga Mitrovica, me dokument identifikues të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB- Republika e Kosovës me nr. personal xxxxxxxxxx, në afat ligjorë ushtrij këtë:

ANKESË

Për shkakë të:

Vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike;
Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale;

A r s y e t i m

Me vendimin e kryetarit të Mitrovicës të datës 19.05.2015, është refuzuar kërkesa e datës 06.05.2015, e parashtruesit të kërkesës H.O, i ri-atdhesuar nga Gjermania, me të cilën kërkesë ka kërkuar ti sigurohet banimi përmes qirasë për 6 muaj, i cili është në kundërshtim me kriteret për përfitim, konform rregullores QRK-nr.20/2013.

Në arsyetimin e vendimit Komisioni Komunal në seancën e mbajtur të datës 19.05.2015, pasi që ka shqyrtuar kërkesën e datës 15.05.2015, ka konstatuar se i ri-atdhesuari nuk i plotëson kriteret për mbështetje nga programi i ri-integrimit të përcaktuar me rregulloren e QRK-së - 20/2013.

Sipas rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.20/2013, neni 2, paragrafi 1, përcakton "kjo rregullore zbatohet për personat të cilët e kanë lëshuar Kosovën përpara datës 28.07.2010, dhe të cilët e kanë dorëzuar kërkesën për përfitim brenda afatit të përcaktuar me këtë rregullore (gjashtë (6) muaj, eventualisht edhe gjashtë (6) Muaj").

Sipas nenit 7... 1. Banimi përmes qirasë, së tregut me bonus banimi mund të sigurohet për personat e ri-atdhesuar, nëse ata nuk kanë ndonjë akomodim tjetër në dispozicion dhe për shkak të kushteve të vështira ekonomike nuk mund të përballojnë të paguaj vet shpenzimet e akomodimit. 2. Bonusi për banim do t'ju sigurohet për banim për një periudhë gjashtë mujore me një mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj tjerë. 3. Qiraja kontraktohet sipas ofertës, çmimi përcaktohet në bazë të ofertës më të lirë për komunat përkatëse. 4. Për arsye të veçanta kur personat e ri-atdhesuar nuk kanë asnjë mundësi tjetër te akomodimit afati mund të zgjatët edhe për gjashtë muaj të tjerë.

Organi i shkallës së parë nuk ka arritur të vërtetoj në tërësi gjendjen faktike të H.O i ri-atdhesuar. paraprakisht i njëjti nuk është ri-atdhesuar nga shteti i Gjermanisë por nga

shteti i Italisë. i njëjti është në migrim që nga viti 1992 dhe është kthyer në Kosovë me datë 08.07.2010 (shiko dokumentin e organit kompetent të shtetit të Italisë) dhe jo në vitin 2015 sikur se është përshkruar në konfirmimin nr.74/2016, të datës 10.02.2016 të zyrës komunale për komunitet dhe kthim.

Konsistojë në atë se H.O, ka plotësuar kushtet sa i përket nenit 2, të rregullores dhe nenit 7, ashtu që organi i shkallës së parë është dashur që ti siguro të njëjti akomodim, për shkak se i njëjti nuk ka pasur mundësi financiare për pagesë të qirasë.

Përveç kësaj sipas rregullores, përveç banesës për akomodim, të njëjti duhet ti paguan shpenzimet e dommosdoshme të akomodimit dhe ndihma për jetesë me ushqim dhe të tjera dhe atë sipas nenit 8.

Meqenëse ndaj të njëjtit nuk janë zbatuar drejt obligimet o organit të shkallës së parë, sipas rregullores nr. 20/2013 dhe i janë mohuar të drejtat të cilat, rregullorja në mënyrë eksplicite rregullon se kujt i takon dhe kujt jo, kërkojmë nga komisioni që ti ketë parasysh të gjitha rrethanat dhe dokumentacionin në shkresat e lëndës, ashtu që të sjellë vendim me të cilin e aprovon ankesën e palës autorizuese dhe ndaj H.O, të aprovohet kërkesa për ndihmë sipas rregullores.

Mitrovicë, datë 07.04.2016

Parashtruesi i Ankesës

H.O

“[shëno logon tuaj]”
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Departamenti për Ri-Integrim
Komisioni i Ankesave për Ri-integrim

Nr. rend.: 022/2015

Datë: 27.08.2015

Në mbështetje të nenit 27 dhe 42 të rregullores KRK, nr.08/2015, për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit, bazuar në pikën 2 dhe 3 të vendimit nr.07/158 të datës 29.11.2013 të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe bazuar në nenin 3 paragrafët 1 dhe 2, nenin 131 paragrafi 1 dhe nenin 136 paragrafi 1 pika a), të ligjit nr.02/L-2, për procedurën administrative nxjerr:

VENDIM

I. Refuzohet si e pa bazë ankesa me nr. prot.53, e datës 07.08.2015, e ushtruar nga H.O, nga Komuna e Mitrovicës, i ri-atdhesuari nga Gjermania, me datën 18.06.2010, për mos njohjen e të drejtës për mbështetje nga programi për ri-integrimin, për vazhdimin e banimit përmes qirasë.

II. Mbetet në fuqi vendimi nr.17-031-43912 i datës 06.05.2015, i nxjerrë nga Komisioni Komunal për ri-integrimin, i Komunës së Mitrovicës.

A r s y e t i m

Komisioni i ankesave për ri-integrimin, në seancën e mbajtur me datë 27.08.2015, ka shqyrtuar ankesën e të ri-atdhesuarit H.O, i ri-atdhesuari nga Gjermania, me datë 18.06.2010, jashtë afatit ligjor ka paraqitur kërkesë në Komunën e Mitrovicës, për përfitim nga programi për ri-integrimin, përkatësisht për vazhdimin e banimit përmes qirasë. Komisioni Komunal për ri-integrimin, me vendimin nr.43912 të datës 06.05.2015, ka vendosur që t'ia njohe të drejtën për përfitim nga programi për ri-integrimin, përkatësisht për vazhdimin e banimit përmes qirasë. Bazuar në dispozitat përkatëse të rregullores së QRK-së, nr.20/2013, për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të ri-integrimit.

I ri-atdhesuari me datë 30.06.2015, përmes Komunës së Mitrovicës, ka paraqitur ankesë e cila ankesë në komisionin e ankesave për ri-integrimin, ka arritur me datë 07.08.2015, me të cilën ankesë i ri-atdhesuari ka kundërshtuar vendimin nr.43912, të datës 06.05.2015, të nxjerrë nga KKR-ja, Komunës së Mitrovicës dhe njëkohësisht ka kërkuar nga komisioni i ankesave që ta ndryshoj vendimin e lartcekur, të KKR-së dhe ta aprovoj ankesën e tij.

Komisioni i Ankesave për ri-integrimin, në seancën e mbajtur me datë 27.08.2015, pasi e shqyrtoj ankesën së bashku me shkresat e tjera përcjellëse, të paraqitura nga i ri-atdhesuari, konstatoj se i ri-atdhesuari ka paraqitur kërkesë jashtë afatit ligjor për te realizuar të drejtën e banimit përmes qirasë nga programi i ri-integrimit, e drejt kjo e përcaktuar me rregulloren e QRK-së nr.20/2013, për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar, dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit.

Bazuar në faktin e lartcekur dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës, komisioni i ankesave për ri-integrimin, vërtetoi se KKR-ja e Komunës së Mitrovicës ka vendosur në përputhje të plotë me nenin 2, nenin 34, paragrafin 1.1, të rregullores së QRK-së, nr.20/2013, për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit. Sipas këtyre dispozitave personat e ri-atdhesuar të cilët kanë lëshuar Kosovën para datës 28.07.2010, dhe të cilët kanë dorëzuar kërkesën për përfitim brenda afatit 6 muaj eventualisht edhe gjashtë muaj, nga data e ri-atdhesimit të tyre, përfitojnë nga programi i ri-atdhesimit, kurse dispozita tjetër thotë se personat e ri-atdhesuar humbin të drejtën e ndihmës dhe përfitimin nga programi i ri-integrimit, me skadimin e periudhës kohore të përcaktuar me rregulloren në fjalë.

Prandaj duke u bazuar në faktet e lartcekura dhe në dispozitat e tjera përkatëse Komisioni i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tredhjet (30) ditësh, nga dita e pranimit së këtij vendimi.

**Kryesuesi i Komisionit
H.M**

Vendimi ti dërgohet:

- Ankuesit H.O
- Anëtarëve të Komisionit
- Komisionit Qendrorë për ri-integrimin
- Komisionit Komunal për ri-integrimin
- Departamentit për ri-integrimin
- Arkivit të MPB-së

***Shembulli i 10-të - natyra e kontestit
Gjobë-TEIP***

Në bazë të nenit 83 të LPPA-së, Procedura Administrative fillon me kërkesën e palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik, respektivisht në par. 3. Fillimi i një procedure administrative sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e ligjshëm të organit publik, përpos në rastet kur:

3.1. ligji parasheh shprehimisht detyrimin për të filluar një procedurë;

3.2. organi publik vihet në dijeni të fakteve që kërkojnë fillimin e procedurës në mënyrë që të mbrohet interesi publik

Procedura administrative vlerësohet të ketë filluar me kryerjen e çfarëdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e një procedure të filluar sipas detyrës zyrtare apo me parashtrimin e kërkesës nga pala, në rastin e një procedure të filluar sipas kërkesës.

Nga: Drejtoria e Hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore –Prishtinë

Për: Inspektoriatin e Punës-Regjioni Prishtinë

K Ë R K E S Ë

Të nderuar,

Njësia e hetimeve të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Prishtinë, në ditët në vijim planifikon realizimin e disa kontrolleve në lokacione të ndryshme në regjionin e Prishtinës. Për implementimin e këtij plani janë përfshirë njësi dhe agjencione të ndryshme, mes tyre edhe Inspektoriatin e Punës Regjioni në Prishtinë.

Prandaj, kërkojmë nga ana e juaj që edhe kësaj here, Brenda mundësive që keni tëna asistoni me së paku dy inspektor të punës, me qëllim të implementimit sa më me sukses të këtij plani.

Për detajet e tjera do të njoftoheni me kohë.

Ju lutem të na e konfirmoni gatishmërinë tuaj për të na asistuar.

Me respekt!

Toger: _____
Shefi i NJHTQNJ-Prishtinë

Datë: 13.06.2016

“[shëno logon tuaj]”

**TRUPI EKZEKUTIV I INSPEKTORATIT TË PUNËS
RAPORT ZYRTAR**

I hartuar me datë 16.06.2016, përkitazi me kontrollimin inspektues të punëdhënësit, F.XH., N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, i regjistruar _____, Nr. B 1111111 dhe Nr.F 600000;

PREZENT

PËR PUNËDHËNËSIN

INSPEKTORI/ËT I/E PUNËS

1. F.XH
2. (Pronar-Prishtinë)

1. K. T
2. _____

Filluar: 23:20

Inspektori/et i/e punës të autorizuar me dispozitën e nenit 94, të Ligjit nr.03/L-212, i Punës dispozitive të nenit 1,2, 5 të ligjit nr.2002/9 për inspektoratin e Punës në Kosovë dhe dispozitën e nenit 17 të Ligjit nr.2003/19 për sigurinë në Punë, Mbrojtje të shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, pas kontrollimit të dokumentacionit dhe administrimit të provave tjera relevante konstatuan këtë gjendje faktike:

Me rastin e kontrollimit inspektues të jashtëzakonshëm me asistimin e policisë është konstatuar me sa vijon:

Ushtron këtë aktivitet kryesor: 5511 hotele dhe motele me Restorant janë hasur duke punuar N.N., M.M., A.A., F. F., M.H., dhe K. A., B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë, Xh. I-Tiranë-R. e Shqipërisë, L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë.

Bazuar në gjendjen e konstatuar, inspektorët e punës për evitimin e të metave të konstatuara, urdhëron punëdhënësin ti ndërmarr këto masa:

Të prezantohen kontratat e punës (të gjithë punëtorëve të hasur) të prezantohen formularët e ATK-së, të prezantohen leje qëndrimet dhe lejet e punës për shtetasit e Shqipërisë.

Afati: me 20.06.2016 dhe detyrë e përhershme.

Lidhur me gjendjen e konstatuar punëdhënësi deklaron: nuk kam vërejtje me konstatimin nga ana e inspektorit me këtë raport zyrtarë.

Punëdhënësi ka mundësi që brenda afatit të caktuar nga inspektorët e punës, ti paraqes vërejtjet në gjendjen e konstatuar të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e raportit zyrtar.

Raporti zyrtar është hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 5 par.5.5 të ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punë në Kosovë, dy kopje i lihen punëdhënësit, kurse kopjet tjera i mbajnë inspektorët për procedurë të mëtutjeshme.

Kontrollimi inspektues është kryer me datë 17.06.2016 në orën 24:15.

PËR PUNËDHËNSIN

1. Nënshkrimi i pronarit

1. Nënshkrimi i X.X

2. _____

2. _____

3. _____

3. _____

VËREJTJE:

Kjo kopje e raportit është identike në përmbajtje me origjinalin e Raportit Zyrtar nr. 1236.

“[shëno logon tuaj]”

**TRUPI EKZEKUTIV I INSPEKTORATIT TË PUNËS
RAPORT ZYRTAR**

I hartuar me datë 22.06.2016, përkitazi me kontrollimin inspektues të punëdhënësit, F.XH., N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, i regjistruar _____, Nr. B 1111111 dhe Nr.F 600000;

PREZENT

PËR PUNËDHËNËSIN

INSPEKTORI/ËT I/E PUNËS

1. F.XH
2. (Pronar-Prishtinë)

1. K. T
2. _____

Filluar: 13:30

Inspektori/et i/e punës të autorizuar me dispozitën e nenit 94, të Ligjit nr.03/L-212, i Punës dispozitave të nenit 1,2, 5 të ligjit nr.2002/9 për inspektoratin e Punës në Kosovë dhe dispozitën e nenit 17 të Ligjit nr.2003/19 për sigurinë në Punë, Mbrojtje të shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, pas kontrollimit të dokumentacionit dhe administrimit të provave tjera relevante konstatuan këtë gjendje faktike:

Me rastin e ri kontrollimit inspektues në këtë subjekt është konstatuar me sa vijon:

Punëdhënësi (pronari i subjektit) ka ndërmarrë masat për evitimin e të metave të konstatuara me raportit zyrtar nr. 1236 të datës 16.06.2016.

Dëshmoj, (prezantoj) kontratat e punës, listën e pagave dhe leje qëndrimin për këta punëtor: N.N., M.M., A.A., F. F., M.H., dhe K. A., nuk dëshmon (prezanton) kontratat e punës dhe leje qëndrimin për këta punëtor:

1. B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë
2. Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë
3. L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë

Ligji nr.04/L-219, neni 71 par.1 neni 67 par.1 të njëjtit Ligj, neni 10, 11, të Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe neni 7 par.4 të Ligjit të Punës.

Bazuar në gjendjen e konstatuar, inspektorët e punës për evitimin e të metave të konstatuara, urdhëron punëdhënësin ti ndërmarr këto masa:

Të lidhën kontratat e punës dhe të mirën leje qëndrimet, me leje të punës për këta punëtorë të cekur më lartë.

Afati: menjëherë dhe detyrë e përhershme.

Lidhur me gjendjen e konstatuar deklaron: nuk kam vërejtje me konstatimin nga ana e inspektorit me këtë raport zyrtarë.

Punëdhënësi ka mundësi që brenda afatit të caktuar nga inspektorët e punës, ti paraqes vërejtjet në gjendjen e konstatuar të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e raportit zyrtar.

Raporti zyrtar është hartuar në pajtim me dispozitat e nenit 5 par.5.5 të ligjit nr.2002/9 për Inspektoratin e Punë në Kosovë, dy kopje i lihen punëdhënësit, kurse kopjet tjera i mbajnë inspektorët për procedurë të mëtutjeshme.

Kontrollimi inspektues është kryer me datë 22.06.2016 në orën 13:50

PËR PUNËDHËNSIN

1. Nënshkrimi i pronarit

1. Nënshkrimi i X.X

2. _____

2. _____

3. _____

3. _____

VËREJTJE:

Kjo kopje e raportit është identike në përmbajtje me origjinalin e Raportit Zyrtar nr. 1240

“[shëno logon tuaj]”
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
TRUPI EKZEKUTIV I INSPEKTORATIT TË PUNËS

Nr.40/600

Inspektorati i punës, përmes inspektorit të punë T.K., bazuar në dispozitën e nenit 83 dhe 84 të ligjit të punës (Ligji 03/L-2012), neni 6 par.1 të udhëzimit Administrativ nr.07/2012, për Përcaktimin e gjobave për shkelje të dispozitave të ligjit të punës dhe nenit 5.5 pika c), të Ligjit nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, neni 2 të Ligjit për të Huajt nr.04/L-219, dhe në harmoni të nenit 82 të LPA-së, nr.02/L-28, duke vendosur mbi konstatimin e gjendjes faktike sipas Raportit Zyrtar nr.1236 të dt.16.06.2016 dhe Raportit zyrtar 1240 të dt.22.06.2016, merr këtë:

V E N D I M

I. I shqiptohet gjoba në shumën prej 5,600.00 euro (pesëmijë e gjashtëqind euro), punëdhënësit F. XH, në cilësinë e personit fizik, pronar i subjektit afarist N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, i regjistruar _____, Nr. B 1111111 dhe Nr.F 600000;

II. Për shkak të mos zbatimit të dispozitave nga neni 7, par.4 neni 10 paragrafi 1, të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, e që sanksionohet sipas nenit 92 paragrafi 1, të të njëjtit ligj dhe në pajtim me nenin 67 paragrafi 1 të Ligjit për të Huajt nr.04/L-219.

Afati: Pagesa e gjobës së shqiptuar të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi në xhirrollogarinë nr.1000000000 TEIP, në të kundërtën iniciohet procedura e përmbarimit të ekzekutimit në organin kompetent.

Obligohet punëdhënësi që faturën për pagesën e gjobës ta marrë në zyrën e Inspektoratit të Punës në Prishtinë, dhe pas pagesës ta dorëzon një kopje të fletëpagesës tek inspektorati i Punës, bë të kundërtën konsiderohet se nuk është ekzekutuar aktvendimi.

A r s y e t i m

Inspektori i punës K.T., me rastin e inspektimit të përbashkët me njësitin e policisë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe inspektorët financiar të ATK-së të regjionit të Prishtinës, në objektin afarist N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, me datë 16.06.2016, prej orës 23:20, kanë konstatuar gjendjen faktike mbi zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe nga Ligji për të Huajt, nr. 04/L-219, si dhe akteve tjera nënligjore në fuqi, sipas Raportit Zyrtar nr.1236 të datës 16.06.2016, ku është konstatuar kjo gjendje

faktike në vendngjarje, me ç ‘rast janë hasur duke punuar këta punëtor:

N.N., nga Prishtina për të cilin punëdhënësi dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë, pa leje qëndrim, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

M.M., nga Prishtina, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

A.A., nga Prishtina, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë, pa leje qëndrimi, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

F. F., M.H., dhe K. A., nuk dëshmon (prezanton) kontratat e punës dhe leje qëndrimin për këta punëtor:

L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon leje qëndrim, nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

Nga të dhënat e lartpërmendura konstatohet se punëdhënësi nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 10 par. 1 nga se me kërkesën e inspektoratit të punës nuk i ka dëshmuar kontratat e punës të punëtorëve, përkatësisht nuk e ka lidhur kontratën e punës me punëtorët e lartpërmendur dhe nga neni 7 par.4 nga se nuk ka dëshmuar formularët e ATK-së, për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore të ligjit të punës si dhe neni 67 par.1 të ligjit për të huajt.

Prandaj, bazuar në gjendjen faktike në ditën e inspektimit, inspektori i punës për evitimin e të metave të konstatuara në raportin zyrtar, Raporti Zyrtar nr.1236 të dt. 16.06.2016, punëdhënësi F.XH e urdhëron që deri më 20.06.2016, me të gjithë punëtorët e lartpërmendur të lidh kontratat e punës, sipas nenit 10 par.1 dhe të njëjtit të lajmërohen në ATK, sipas nenit 7 par.4 të Ligjit të Punës dhe të dëshmojnë leje qëndrimet dhe lejet e punës për shtetasit e huaj, sipas nenit 67 par.1 të Ligjit për të Huajt.

Mirëpo, sipas Raportit Zyrtar nr.1240, të dt.20.06.2016, mbi ri kontrollimin inspektues konstatohet kjo gjendje faktike:

punëdhënësi dëshmon dhe prezanton këtë dokumentacion: kontratat e punës, formularët e ATK-së, leje qëndrimet dhe listën e pagave për punëtorët: N.N., M.M., A.A., F. F., M.H., dhe K. A.,

Ndërsa punëdhënësi nuk dëshmon (prezanton) kontratat e punës as formularët e ATK-së as leje qëndrimin dhe as lejet e punës për këta punëtor:1. B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë; 2. Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë; 3. L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë.

Prandaj, nga të dhënat e lartpërmendura, sipas Raportit Zyrtar mbi ri kontrollimin inspektues nr.1240 të dt.22.06.2016, përfundimisht konstatohet se punëdhënësi nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 10 par.1, ngase nuk i ka dëshmuar kontratat e punës të punëtorëve përkatësisht nuk i ka lidhur kontratat e punës me punëtorët e lartpërmendur dhe nga neni 7 par.4 ngase nuk i ka dëshmuar formularët e ATK-së për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore të Ligjit të Punës nga neni 67 par.1, të Ligjit për të Huajt, punëtorët B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë; 2. Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë; 3. L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë, shtetas të huaj me ç ‘rast ka bërë shkelje të dispozitat ligjore nga nenet e lartpërmendura të ligjit të punës dhe të ligjit për të huajt, për çka inspektori i punës është i obliguar të zbatoj dispozitën ligjore nga neni 92, par.1 mbi masat ndëshkimore të Ligjit të Punës dhe në pajtim me nenin 6 par.1, konform nenit 7 par.2 pika 2.1 dhe 2.2 dhe nenit 8 par.1 mbi individualizimin e shkeljes së dispozitave ligjore ndaj së cilit punëtor veç e veç, të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012, për Përcaktimin e Gjobave për shkeljet e dispozitave të ligjit të punës, dhe nga neni 67 par.1 të Ligjit për të Huajt.

Prandaj, nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë Inspektoratit të Punës në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij vendimi.

Ankesa dërgohet përmes Inspektorit të Punës.

Vendimi i dorëzohet:

- Arkivit të Inspektoratit të Punës;
- Punëdhënësit.

Inspektori i Punës

Në bazë të LIGJIT Nr. 2002/9 PËR INSPEKTORATIN E PUNËS NË KOSOVË, Nenit 6 rregullohet Procedura sipas ankesës kundër vendimit të organit të shkallës së parë respektivisht Inspektoriatit të Punës.

Me par. 6.1 të këtij neni, përcaktohet se: kundër vendimit të inspektorit të punës mund t'i bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, autoritetit të Inspektoratit të Punës..

Nërsa me par. 6.4 përcaktohet se: Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Për: Ministrinë Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i inspektoratit e Punës në Prishtinë;

Nga: N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, i regjistruar _____, Nr. B 1111111 dhe Nr..F 600000, me pronar F. XH nga Prishtina.

F.XH nga Prishtina

Kundër vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë i datës 11.07.2016, në afatin ligjorë paraqesë këtë:

ANKESË

Për shkak të:

Shkeljeve të dispozitave procedurale;

Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe

Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale;

A r s y e t i m i

Me vendimin e inspektoratit të punës me nr. 0000 i datës 11.07.2016, mua F.Xh pronar i restorantit N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, më është shqiptuar dënimi në shumën prej 5600 euro (pesë mijë e gjashtëqind) euro, sipas nenit 10 paragrafit 1 dhe nenit 7 paragrafit 4 të Ligjit të Punës dhe ligjit për të huajt, ku në dispozitiv të vendimit thuhet se me rastin e inspektimit të parë pronarit i gjenden punëtorë të cilët nuk janë të regjistruar, por në fakt të gjithë punëtorët kanë qenë të regjistruar, mirëpo me rastin e inspektimit të parë konkretisht sipas raportit zyrtar me numër 1236 të datës 16.06.2016, në ato ditë kemi qenë shumë të ngarkuar me punë dhe me disa renovime dhe nuk kemi mundur që të njëjtit ti përgjigjemi menjëherë me dokumentacion, pastaj i njëjti me rastin e ri kontrollimit konkretisht sipas raportit zyrtar e konstatojmë shumë mire gjendjen faktike, duke i prezantuar dokumentacionin e nevojshëm si kontratat e punës, formularët e ATK-së, leje qëndrimet dhe listën e pagave të punëtorëve dhe në këtë rast

e kemi respektuar ligjin e punës, ligjin për të huajt, mirëpo i njëjti bënë një lëshim dhe atë në mesin e punëtorëve tanë, futë në listë si të punësuar edhe tre persona të tjerë të cilët siç duket edhe me rastin e kontrollimit të parë kanë qenë mysafir në restorantin tonë dhe me këtë ne nuk mund ta pengojmë se përveç gjinisë mashkullore tek ne janë prezent edhe gjinia femërore dhe janë jashtëzakonisht shumë dhe i njëjti në këtë rast inspektori thirret në atë se personat B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë; Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë; L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë, të cilët nuk i njohim, vetëm nëse kanë qenë të shoqëruar me vajzat të cilat kanë qenë të punësuar tek ne të cilën e vërtetojnë ato me deklaratat apo në forma të ndryshme, ndërsa për të gjithë punëtorët tjerë ne kemi prezantuar dokumentacionin dhe kemi respektuar ligjin në përpikëri, si ligjin e punës, ligjin për të huajt, dhe udhëzimet administrative. Ne gjatë kohës sa kemi të hapur lokalin shumë femra të njëjtin e vizitojnë dhe me atë rast të njëjtat i bashkohen grupit të vallëzimit të punëtorëve tona dhe fatkeqësisht ditën e inspektimit, inspektori ka hasur në klient të restorantit, mirëpo të njëjtit nuk kanë punuar tek ne dhe as që i njohim fare mirëpo, është mirë që kjo gjendje të rishikohet edhe njëherë për arsye se kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe nga ky rast ne nuk duam të pësojmë me humbje për arsye se një dënim i tillë veç se e ngulfate biznesin tonë dhe nuk mund të qëndrojmë edhe punojmë siç kemi punuar më herët, vlen të ceket se për të gjithë punëtorët jemi kujdesur në mënyrën më të mirë të mundshme për shëndetin e tyre.

PROVË: Kontratat e punës së punëtorëve, leje qëndrimet, lista e pagave, Procesverbali me numër 1240.

Andaj, duke i marrur parasysh të lartcekurat kërojmë nga inspektorati i Punës në Prishtinë, që të aprovoj ankesën time dhe vendimin e dt.11.07.2016, ta anuloj apo edhe ta nderyshoj dhe unë të lirohem nga i njëjti dënim.

Prishtinë, dt. 28.07.2016

**Parashtruesi i ankesës,
F.XH**

Në bazë të LIGJIT Nr. 2002/9 PËR INSPEKTORATIN E PUNËS NË KOSOVË, Nenit 6 par. 6.2. përcaktohet se: Autoriteti i Inspektoratit të punës (TEIP) është i obliguar që në afat prej 60 ditësh të vendos sipas ankesës të ushtruar në vendimin e inspektorit të punës.

“[shëno logon tuaj]
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës

Bazuar në dispozitën e nenit 94 të Ligjit nr.03/L-212 i Punës të Kosovës, nenin 116 të Ligjit Nr.04/L-219 për të Huajt, neni 24 të Ligjit nr.04/L-161, për siguri dhe Shëndet në Punë, nenit 4, 6 të Ligjit nr.03/L-017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr.2002/9, vendimit nr.94/2014 dhe nenit 136 të Ligjit nr.02/L-28 për Procedurë Administrative, organi i shkallës së dytë i TEIP-së, duke vendosur sipas ankesës së pronarit F. XH të subjektit në procedurë N.P.H "NNNNN" - Prishtinë, të ushtruar kundër vendimit të organit të shkallës parë nr.40/600 merr:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e pronarit F.XH të subjektit në procedurë N.P.H "NNNNN" - me seli Prishtinë.

Vërtetohet vendimi i organit të shkallës së parë nr. 40/600.

A r s y e t i m

Me vendimin e organit të shkallës së parë nr.40/600, pronarit F.XH të subjektit në procedurë N.P.H "NNNNN" me seli në Prishtinë, i është shqiptuar gjoha në shumën prej 5,600.00 (pesëmijë e gjashtëqind euro). Në bazë nenit 92 të Ligjit të Punës, nenit 132 të Ligjit për të Huajt, nenit 25 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, neni 5 Ligjit nr.03/L-017, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Inspektoratin e Punës. Kundër këtij vendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë pronari F.Xh., i subjektit në procedurë N.P.H "NNNNN" me seli në Prishtinë, për shkelje thelbësore të dispozitave ligjore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që organi i shkallës së dytë i IP-së, të aprovoj ankesën dhe vendimin e kundërshtuar ta revokoj. Organi i Shkallës së dytë i IP-së i shqyrtoj shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se:

Ankesa është e **pa bazuar**.

Duke i vlerësuar pretendimet ankimore të pronarit F.XH., të subjektit afarist N.P.H "NNNNN", se vendimi i kundërshtuar përmban aplikim të gabuar të dispozitave ligjore të nenit 7 par.4, nenit 10 par.1, nenit 67 par.1 dhe 7 të Ligjit për të Huajt.

Organi i shkallës së dytë i IP-së, pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se vendimi i kundërshtuar nuk përbën aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, ky pretendim ankimor është i pa bazuar, përkundrazi dispozitivi i vendimit të kundërshtuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye për aplikimin e drejtë të dispozitave ligjore dhe mbi faktet vendimtare që vendimin e bëjnë të qartë dhe të kuptueshëm.

Pretendimi ankimor se në vendimin e kundërshtuar gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pas vlerësimit të organit të shkallës së dytë të IP-së, është i pa bazuar. Inspektori i punës, me rastin e inspektimit të përbashkët me njësitin e policisë për luftimin e trafikimit me qeneje njerëzore dhe inspektorët financiar të ATK-së të regjionit të Prishtinës, në subjektin afarist N.P.H "NNNNN" me seli në Prishtinë, me 16.06.2016 prej orës 23:20 kanë konstatuar gjendjen faktike mbi zbatimin e dispozitave ligjore nga ligji i Punës dhe nga Ligji për të huajt, si dhe akteve tjera nënligjore në fuqi, sipas Raportit Zyrtar nr.1236 të dt.16.06.2016, ku është konstatuar kjo gjendje faktike në vend ngjarje, me që rast janë hasur duke punuar këta punëtor:

N.N., nga Prishtina për të cilin punëdhënësi dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë, pa leje qëndrim, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

M.M., nga Prishtina, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

A.A., nga Prishtina, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë, pa leje qëndrimi, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

F. F., M.H., dhe K. A., nuk dëshmon (prezanton) kontratat e punës dhe leje qëndrimin për këta punëtor:

L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë, për të cilin punëdhënësi nuk dëshmon leje qëndrim, nuk dëshmon kontratën e punës sipas nenit 10 paragrafi 1 dhe nuk dëshmon Formularin e ATK-së, sipas nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës.

Nga të dhënat e lartpërmendura konstatohet se punëdhënësi nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 10 par.1, ngase me kërkesën e inspektorit të punës nuk i ka dëshmuar kontratat e punës të punëtorëve përkatësisht nuk i ka lidhur kontratat e punës me punëtorët e lartpërmendur dhe nga neni 7 par.4 ngase nuk i ka dëshmuar formularët e ATK-së për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore të Ligjit të punës, si dhe nga neni 67 par.1 të Ligjit për të Huajt. Prandaj, bazuar në gjendjen faktike në ditën e inspektimit, inspektori i punës për evitimin e të metave të konstatuara në raportin zyrtar nr.1236 të datës 16.06.2016, punëdhënësin F. XH., e urdhëron që deri me datë 20.06.2016, me të gjithë punëtorët e lartpërmendur të lidhë kontratat e punës sipas nenit 10 par.1 dhe të njëjtit të lajmërohen në ATK, sipas nenit 7 par.4 të Ligjit të Punës dhe të dëshmojnë leje qëndrimit dhe lejet e punës për shtetasit e huaj sipas nenit 67 par.1 të Ligjit për të Huajt. Mirëpo, sipas raportit Zyrtar nr.1240 të datës 22.06.2016, me ri-inspektim konstatohet kjo gjendje faktike: Punëdhënësi dëshmon dhe prezanton këtë dokumentacion kontratat e punës formularët e ATK-së dhe listën e pagave për punëtorët: N.N., M.M., A.A., F. F., M.H., dhe K. A. Ndërsa punëdhënësi nuk dëshmon (prezanton) kontratat e punës as formularët e ATK-së as leje qëndrimit dhe as lejet e punës për këta punëtor: 1. B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë; 2. Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë; 3. L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë. Prandaj nga të dhënat e lartpërmendura sipas Raportit Zyrtar mbi ri-inspektimin nr.1240 të dt.22.06.2016, përfundimisht konstatohet se punëdhënësi nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 10 par.1, ngase nuk i ka dëshmuar kontratat e punës të punëtorëve, nuk i ka lidhur kontratat e punës me punëtorët e lartpërmendur dhe nga neni 7 par.4, ngase nuk i ka dëshmuar formularët e ATK-së për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore të Ligjit të Punës, nga neni 67 par.1 të Ligjit për të Huajt për punëtorët: 1. B. A - Tiranë-R. e Shqipërisë; 2. Xh. I- Tiranë-R. e Shqipërisë; 3. L. S- Tiranë-R. e Shqipërisë, me që rast ka bërë shkelje të dispozitave ligjore nga nenet e lartpërmendura të Ligjit të Punës dhe të Ligjit për të Huajt, për çka inspektori i punës është i obliguar të zbatoj dispozitën ligjore nga neni 92 par.1, mbi masat ndëshkimore të ligjit të punës dhe në pajtim me nenin 6 par.1, konsform nenit 7 par.2 pika 2.1 dhe 2.2 dhe nenit 8 par.1 Mbi Individualizimin e shkeljes së dispozitave ligjore ndaj secilit punëtor veç e veç, të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012, për Përcaktimin e Gjobave për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, dhe nga neni 67 par. 1 dhe 7 të Ligjit për të Huajt, si rezultat i moszbatimit të dispozitave ligjore inspektorët e punës i kanë shqiptuar masën ndëshkuese gjobë.

Andaj inspektorët e punës kanë vepruar në bazë të nenit 92 të Ligjit të Punës, nenit 132 të Ligjit për Huajt, nene të cilat i sanksionojnë subjektet për mos zbatim të dispozitave ligjore, për këto arsye organi i shkallës së dytë i IP-së, gjeti se në vendimin e kundërshtuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejt dhe të plotë, andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar, sepse pronari F.XH. i subjektit afarist N.P.H "NNNNN", vetëm bënë një përshkrim për një konstatim të vërtet të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të dispozitave ligjore por, nuk sjell ndonjë fakt apo argument të inspektorët e punës gjatë inspektimit, se ka vepruar në bazë të këtyre dispozitave

ligjore. Andaj, inspektorët e punës drejtë i kanë aplikuar dispozitat ligjore, i kanë vlerësuar drejt të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në lartësinë e gjobës, të cilat rrethana i aprovoj edhe organi i shkallës së dytë.

Andaj, nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryeinspektori i punës,

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit së këtij vendimi.

Shembulli i 11-të - natyra e kontestit
Kompenzim material-MSH

(Aplikacioni për kompensim mjekësor gjendet online në web faqen e Ministrisë së Shëndetësisë)

“[shëno logon tuaj]”
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
Komisioni për Vlerësimin Mjekësor

Datë 09.09.2014

Në bazë të nenit 7 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativë nr.10/2013, për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike, merr kete:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa e H.R, nga Gjilani, e datës 18.03.2014.

A r s y e t i m

H.R, ka parashtruar kërkesë në komisionin mjekësor, për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike në Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me kompensimin e mjeteve për trajtimin e kryer në institucionin shëndetësorë, jashtë institucioneve publike të Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të H.R, komisioni mjekësor për shqyrtimin e kërkesave të pacientëve për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike, konstaton se bazuar në Udhëzimin Administrativë nr.10/2013, për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike, neni 7 paragrafi 3 përcakton që: refuzohet kërkesa e pacientit për kompensim sipas nenit 4 dhe 6 të këtij Udhëzimi Administrativë, nëse pacienti ka filluar trajtimin mjekësorë pa përfunduar procedurat e rregullta administrative sipas këtij Udhëzimi Administrativ.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë brenda afatit prej 15 ditësh në Ministrinë e Shëndetësisë - Komisionin për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave, nga dita e pranimit së këtij vendimi.

Kryetari i Komisionit mjekësor:
Dr. _____

Anëtarët e Komisionit:

Dr. _____

Dr. _____

**PËR: MINISTRINË E SHËNDETËSISË-KOMISIONIT PËR ANKESA
NGA: H.R nga Gjilani.**

Kundër vlerësimit të Komisionit mjekësor të datës 09.09.2014, në afatin ligjorë paraqesë këtë:

ANKESË

Unë H.R, nga Prishtina, kam pasur infrakt akut me datë 12.03.2014, në ora 17 h, jam paraqitur në emergjencë në Gjilan, nga kjo emergjencë më kanë dërguar në emergjencën e Prishtinës, pas kontrollimit pasi që aparati i kësaj emergjence nuk punonte, më kanë sugjeruar të shkoj në spital privat "NNN".

Kështu në fillim më kanë thënë, pasi që rasti është urgjent shko në spital privat se shpenzimet kanë me tu paguar-kompensuar. Emergjenca e Prishtinës e ka ftuar spitalin privat "NNN" dhe kanë ardhur më kanë marr në ora 21 h të njëjtën ditë më kanë operuar, ku operacioni ka zgjatur 2 orë dhe më janë vendosur 3 stenda të cilat më kanë kushtuar 7,500.00 euro.

PROVË: fatura nga spitali "NNN"

Pranë Ministrisë së Shëndetësisë kam aplikuar për herë të parë me datë 18.03.2014, me tërë dokumentacionin e kompletuar mjekësor. Me kalimin e kohës prapë më është keqësuar gjendja shëndetësore dhe me datë 17.07.2014, të njëjtën situatë e kam pasur si problem dhe jam paraqitur në emergjencë të Gjilanit dhe të Prishtinës, prapë më kanë propozuar që të shkoj në spitalin privat ku i kam ngjit edhe dy stenda të cilat më kanë kushtuar 3,500.00 euro të cilat janë në dokumentacionin e dorëzuar.

Me datë 09.09.2014, kjo Ministri aplikacionin tim në këtë shqyrtim ma ka refuzuar në mënyrë të pa drejtë sepse dokumentacioni ka qenë komplet dhe me sugjerim të emergjencës së Prishtinës, unë jam shtruar në spitalin privat.

Pasi që komisioni i Ministrisë ka refuzuar kërkesë time dhe në mënyrë shumë të pa drejtë kanë vepruar. Unë jam pensionist me një pension prej 140 euro, tani kur i kam mbushur 65 vjet, ndërsa gjerë në këtë kohë kamë qenë rast social dhe kamë marrë vetëm ndihmë sociale.

Nga Komisioni për ankesa pranë kësaj ministrie, kërkoj që ankesën time ta shqyrtoj me vëmendje duke u bazuar edhe në dokumentacionin të cilin e keni sipas aplikacionit dhe mua të më kompensohen mjetet të cilat i kamë marrë hua dhe nuk kamë mundësi ti kthej fare.

Me datë 22.09.2014

**Ankuesi
H.R**

“*[shëno logon tuaj]*”
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr.24/2014
Datë 01.10.2014
Prishtinë

Në mbështetje të Udhëzimit Administrativë nr.10/2013, vendimit nr.89/13 të datës 29.08.2013, Komisioni për shqyrtimin e ankesave të pacientëve për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike në Ministrinë e Shëndetësisë, në takimin e mbajtur me datë 01.10.2014 merr:

V E N D I M

Refuzohet ankesa e H.R, nga Gjilani, me nr. 05-5516 të datës 26.09.2014.

A r s y e t i m

H.R, ka parashtruar ankesë në komisionin për shqyrtimin e ankesave të pacientëve për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike në Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me kompensimin e mjeteve për trajtimin e kryer në institucionin shëndetësorë, jashtë institucioneve publike të Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të H.R, komisioni për shqyrtimin e ankesave të pacientëve për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike, konstaton se bazuar në Udhëzimin Administrativë nr.10/2013, për trajtim mjekësorë jashtë institucioneve shëndetësore publike, neni 7 paragrafi 3 përcakton që: refuzohet kërkesa e pacientit për kompensim sipas nenit 4 dhe 6 të këtij Udhëzimi Administrativë, nëse pacienti ka filluar trajtimin mjekësorë pa përfunduar procedurat e rregullta administrative sipas këtij Udhëzimi Administrativ.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit së këtij vendimi.

Kryesuesi i Komisionit

Vendimi i dorëzohet:

- Ministrisë së Shëndetësisë
- Zyrës së Sekretarit në MSH
- Ankuesit H. R
- Arkivit të MSH-së
- Zyrë për trajtim

Shembulli i 12-të - natyra e kontestit
Energji-ZRRE

Procedura administrative te llojet e kontesteve që kanë të bëjnë me energjinë, fillon me anë të ankesës së konsumatorit lidhur me ndonjë veprim të organit administrativ KES/CO.

(formularin e ankesës lidhur me këto çështje mund ta gjeni online në web portalin e KES/CO-s).

(Shëno llogon tuaj)
KES/CO
DIVIZIONI I FURNIZIMIT PRISHTINË
SEKTORI PËR PËRKUJDESJE NDAJ KONSUMATORIT

Nr. 001/2017
30.05.2016

Me rastin e shqyrtimit të ankesës së konsumatorit M.D shifra 9012360 e datës 12.05.2016, të paraqitur për shkak të faturimit të gabuar në leximin jo të saktë për periudhën mars 2016, sektori për përkujdesje ndaj konsumatorit, më datë 30.05.2016, merr:

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht ankesa e konsumatorit M.D e paraqitur më datë 12.05.2016, dhe bëhet korrigjimi i faturës së borgjit për energji elektrike nr. 970155555, e datës 22.12.2016, dhe i zbritet borgji -26.13 euro, nga borgji në vlerë prej 1,022 euro.

A r s y e t i m i

Sektori për përkujdesje ndaj konsumatorit, pasi i ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit të datës 12.05.2016, rrjerrën e energjisë elektrike në pikën matse nr. 9700000 të konsumatorit me DPR 90127638, kartelën e transaksioneve të konsumatorit, ka vendosur që nga vlera e faturës 1,022 euro të paraqitur si borgj për shpenzimin e energjisë elektrike, të aprovoj pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe i zbritet vlera - 26.13 euro.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, Rregullin për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sektorin e Energjisë, Rregullës mbi kushtet e përgjithëshme të furnizimit me energji, pasi bëri me kujdes shqyrtimin e lëndës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pa knaqur me këtë vendim, ka të drejtë ankese në ZRRE, në afat prej 14 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Divizioni i Furnizimit KEDS-Prishtinë
Zyrtari përgjegjës

ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI
Divizionit për Konsumator

Kundër vendimit të Sektorit të përkujdesjes ndaj Konsumatorit-KESCO, me nr. 001/17 i datës 15.04.2017, paraqes këtë:

A N K E S Ë

Për shkak të:

Shkeljes së dispozitave ligjore të cilat rregullojnë çështjen e energjisë dhe Vëretimit të gabuar të gjendjes faktike.

A r s y e t i m i

Vendimin e lartë cekur të organit të shkallës së parë e kundërshtoj për shkak se KESCO ka bërë korrigjim të gabuar të faturës 114356 DPR 9000478 të datës 29.11.2016, pasi që kërkesa për çkyqe është bërë më datë 01.06.2016, por që asnjëherë ekipet e KESCO-së dhe KEDS-it, nuk kanë bërë inspektimi e pikës matëse për ta pranuar kyqjen e re, andaj edhe më datë 22.09.2016 është detyruar që ta përsërisë kërkesën për lidhje të re. Energjia e regjistruar në njëhësorë është shpenzuar gjatë ndërtimit të shtëpisë. Andaj, bazuar në këtë dhe në shkresat të cilat gjenden në dosjen e lëndës,

P r o p o z o j

Që ankesa e parashtruar të aprovohet dhe të bëhet rivlerësimi i faturës 114356 DPR 9000478 të datës 29.11.2016, dhe të lirohem nga borgji i ngarkuar.

Parashtruesi i ankesës
M.D

Prishtinë
Dt.15.04.2017

“[shëno logon tuaj]”
ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Nr. ankesës në DMK të ZRRE-së: 2080/07.2015

ZRRE/DMK_V_1483_05_17

Emri i Konsumatorit: D.D

Prishtinë: 10.05.2017

Parashtruesi i ankesës: M.D

Shifra e konsumatorit: DPR-90100237

Adresa: rr."Bill Klinton", Prishtinë

Nr. i njehsorit: 97018599

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK), i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit D.D, parashtruesi i ankesës (M.D), kundër vendimit të KESCO-s, mbi kontestimin e faturës për periudhën nëntor 2015, duke u bazuar në:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e përcaktuara në kreun e V-të, përkatësisht nenin 14.4 të Rregullores për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe proceset e paraqitura nga palët me datë 10.05.2017, nxjerrë këtë:

VENDIM

Aprovohet ankesa e konsumatorit D.D (parashtruesi i ankesës M.D), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së, në ZRRE, me datë 03.07.2016, ka apeluar përgjigjen e KESCO-s, Divizioni i Furnizimit, Departamenti për Konsumator te datës 01.07.2016, lidhur me kontestimin e faturës për periudhën nëntor 2015, për shkak të faturimit të shpenzimit të energjisë elektrike (kilovator-kwh), të grumbulluar.

Me datë 01.06.2012, konsumatori D.D, ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK, për lidhje të re si dhe të njëjtën e ka përsëritur edhe në KEDS, me datë 22.09.2015. Në dy kërkesat e konsumatorit, konsumatori ka evidentuar numrin e njehsorit elektrik nr. 97018599.

Provë: Kërkesat e konsumatorit për lidhje të re të datës 01.06.2011 dhe datës 22.09.2014.

Me datë 14.11.2015, punëtorët e autorizuar të KEDS-it, për pranimin e njehsorit elektrik kanë inspektuar pikën matëse te konsumatorit dhe kanë bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik, nr.97018599, me gjendje TL=6445 KWH, dhe TU=56 KWH. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it po ashtu kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse, si dhe anë evidentuar kyç jen, si lidhje të përkohshme.

Provë: Procesverbali për pranim të instalimit elektrik, i KEDS-it, nr.057220 i datës 14.11.2015.

Departamenti i faturimit në KEDS, me datë 29.11.2014, i ka dërguar konsumatorit faturën mujore për periudhën nëntor 2015, me 120 kwh, apo e shprehur në vlerë financiare 1,022.35 euro.

Provë: Fatura nr.11140DPR-90100237, e datës 29.11.2015.

Me datë 01.12.2014, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEDS, duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë për periudhën nëntor 2015, të cilën e ka përsëritur edhe me datë 12.05.2016.

Provë: Ankesa e konsumatorit datë 01.12.2015 dhe 12.05.2016.

Me datë 13.06.2016, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.97018599, ku TL-016925 (tarifa e lartë) dhe TU=010364 (tarifa e ulët).

Provë: Procesverbali i inspektimit nr..0828973 e dt. 13.06.2016.

Me datë 01.07.2016 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe kërkesës për lidhje të re datë 22.09.2015 duke bërë korrigjimin e faturave vetëm të periudhës 10/11.2015 në vlerë -26.13 euro.

Provë: Përgjigja e KESCO-së e datës 01.07.2016

I pa kënaqur me përgjigjen e KESCO-së konsumatori me datë 03.07.2016, ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e KESCO-së duke kundërshtuar korrigjimin e bërë nga KESCO, si dhe ka kërkuar që t'i bëhet korrigjimi i faturës 11140DPR-90100237 i datës 29.11.2015 bazuar në kërkesën e datës 01.06.2012. Konsumatori në deklaratën e tij thekson se kërkesa për kyçje është bërë me datë 01.06.2012, por që asnjëherë ekipet e KEK-ut dhe KEDS-it nuk kanë bërë inspektimin e pikës matëse për ta pranuar kyç jen andaj edhe me datë 22.09.2015, është detyruar që ta përsërisë kërkesën për lidhje të re. Konsumatori po ashtu thekson se

energija e regjistruar në njehsor elektrik është shpenzuar gjatë ndërtimit të shtëpisë.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK-të ZRRE-së e datës 03.07.2016

DMK duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KESCO-së, ka vërejtur se:

Konsumatori me datë 01.06.2012 ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK për lidhje të re, të cilën kërkesë konsumatori e ka përsëritur edhe me datë 22.03.2015 në KEDS, ku sipas kërkesave të parashtruara vërtetohet edhe numri i njehsorit elektrik nr.9291734. Bazuar në kërkesën e konsumatorit të datës 22.09.2015, punëtorët e autorizuar për regjistrim të njehsorit elektrik të KEDS-it me datë 14.11.2015 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë bërë pranimin e instalimit elektrik për njehsorin elektrik nr.97018599 me gjendje TL=6445 kWh dhe TU=56 kWh. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it po ashtu, kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse, si dhe kanë evidentuar kyç jen si lidhje të përkohshme. Duhet theksuar se bazuar në të dhënat e evidentuara konstatohet se njehsori elektrik ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik para se të bëhet edhe pranimi teknik i kyçjes nga ekipet e KEDS-it dhe si rrjedhojë njehsori elektrik ka pasur të regjistruar KË të shpenzuar.

Provë: Kërkesat e konsumatorit për lidhje të re të datës 01.06.2011 dhe 22.09.2015, si dhe procesverbali për pranim të instalimit elektrik nr.057220 i datës 14.11.2015.

Pas hapjes së shifrës së konsumatorit DPR-90100237, Departamenti i faturimit në KEDS me datë 29.11.2015 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore për periudhën nëntor 2014 me 8,120 kWh apo shprehur në vlerë financiare 1,022.35 euro. Sipas programit të faturimit (ang. Customer Care Parcakge-CCP) dhe transaksioneve të konsumatorit, shpenzimi i paraqitur në faturën e muajit 11/2015 paraqet kwh e regjistruar në procesverbalin për pranim të instalimit elektrik nr.057220 të datës 14.11.2015, si dhe shpenzimet e konsumatorit të regjistruara në njehsorin elektrik nr.97018599 nga data 14.11.2015 deri me datë 29.11.2015.

Vlen të theksohet se konsumatori me datë 01.11.2015 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë për periudhën nëntor 2015 të cilën ankesë e ka përsëritur edhe me datë 12.05.2016 pasi që për ankesën e parë nuk ka pranuar përgjigje.

Provë: Fatura nr.11140DPR-90100237 e datës 29.11.2015 dhe ankesat në KEDS me datë 01.12.2015 dhe KESCO të datës 12.05.2016.

Pas ankesës së konsumatorit, me datë 13.06.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë

evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.97018599 ku TL=016925 dhe TU=010364. Bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit konstatohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në programin e faturimit – CCP për periudhën Maj dhe Qershor 2016 përputhen plotësisht me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit, por që ankesa e konsumatori nuk ka pasur të bëjë me inspektimin e pikës matëse por me faturimin e kWh të grumbulluar në periudhën 11/2015.

Provë: Procesverbali i inspektimit nr.0828973 e datës 13.06.2016

Gjatë analizës së lëndës DMK ka konstatuar se KEK-u atëkohë dhe pastaj edhe KEDS-i nuk ka vepruar konform Kreut III të Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, përkatësisht neni 9, paragrafi 7.1 dhe neni 10. Duhet theksuar se Kreu III i kësaj rregulle përshkruan detajisht gjithë procesin e regjistrimit të një Konsumatori të ri në rrjetin elektrik, që nga aplikimi për lidhje të re, e deri të kycja e tij në rrjetin elektrik si dhe nënshkrimi i kontratës për furnizim me energji elektrike. Konsumatori kur ka parashtruar kërkesë për lidhje të re me datë 01.06.2015 ka vepruar konform nenit 8 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, ndërsa punëtorët e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë është dashur që konform nenit 9 të dalin te konsumatori për të inspektuar gjendjen teknike dhe t'i dërgojë konsumatorit ofertën për kyçje dhe nëse është gjithçka në rregullë konform nenit 11 të bëjë marrëveshjen për kyçje dhe konform nenit 12 të bëjë kyçjen e konsumatorit në rrjetin elektrik. Ndërsa, në rast se kyçja nuk është e mundshme teknikisht ose ekonomikisht apo nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes konform nenit 10 të rregullës së lartcekur mund të refuzoj kyçjen por, që duhet të lëshohen dhe dërgohen tek aplikuesi një njoftim në formë të shkruar që paraqet arsyen e refuzimit brenda periudhës që nuk tejkalon tridhjetë ditë kalendarike prej datës së dërgimit të aplikacionit, gjë për të cilën te rasti i konsumatorit nuk ka ndodhur një veprim i tillë.

Me datë 25.06.2016, Departamenti i faturimit në KESCO përmes urdhër lejimit/korrigjimit nr. 75307DPR-90100237 ka bërë korrigjimin e faturave për periudhën 10/2015 deri në periudhën 11/2015 në vlerë -26.13 bazuar në kërkesën e konsumatorit për lidhje të re të datës 22.09.2015. DMK konstaton se KESCO nuk ka vepruar drejt pasi që nuk ka marrë për bazë kërkesën e konsumatorit për lidhje të re të datës 01.06.2012 të parashtruar nga konsumatori në KEK për regjistrim të njehsorit elektrik. DMK konstaton se konsumatori është dashur t'i bëhet korrigjimi i faturës 11140DPR-90100237 i datës 29.11.2015 në vlerë-514.90 euro, duke bërë shpërndarjen e kWh nga periudha 06/2012 deri në periudhën 11/2015 kur edhe i është bërë pranimi teknik i instalimit për njehsorin elektrik nr.97018599 duke marrë për bazë kërkesën e konsumatorit për lidhje të re të datës 01.06.2012.

Provë: Korrigjimi nr.75307DPR-90100237 i datës 25.06.2016.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, duke u bazuar në analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura e në veçanti rrjedhën e energjisë elektrike, kërkesat e konsumatorit për lidhje të re të datës 01.06.2012 dhe 22.09.2015, procesverbalin për pranim të instalimit elektrik nr.057220 të datës 14.11.2015, korrigjimin nr.75307DPR-90100237 të datës 25.06.2016, si dhe mosrespektimit të sakt të kreut III të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, aprovon ankesën e konsumatorit dhe obligon KESCO-në që të:

1. Anulon korrigjimin nr.75307DPR-90100237 datë 25.06.2016 në vlerë -26.13 euro në shifrën DPR – 90100237.
2. Korrigjon faturën nr.11140DPR-90100237 të datës 29.11.2015 në vlerë -514,90 euro duke bërë shpërndarjen e kWh të faturura për periudhën 06/2011-11/2015 në shifrën DPR-90100237 shpërndarjen e kWh të faturuar për periudhën 06/2001-11/2015 në shifrën DPR-90100237.

DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE
ZRRE/DMK_V_1483_05_17

Kryesuesi i DMK-së
G. B

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ankohet në Bordin e ZRRE-së në afat prej 14 ditëve kalendarike nga data e pranimin të këtij vendimi, apo nga data e shpalljes në ueb faqen e ZRRE-së.

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të ankesës
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

Konsumatori D.D, nga Prishtina rr."Bill Klinton", Prishtinë, të cilin e përfaqëson M.D, nga Prishtina.

I pakënaqur me vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. V-1483-05-17, në afat ligjor paraqes këtë:

ANKESË

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në mënyrë të shkëlqyer i ka shqyrtuar të gjitha faktet e parashtruara në ankesë të datës 03.07.2015.

Zyra e Rregullatorit për Energji e ka anashkaluar Ligjin mbi Detyrimet të Republikës së Kosovës nr.16 të datës 19.06.2013, i cili thekson se citoj "Afati njëvjeçar i parashkrimit, kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti, 1.1 kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, etj.

Me që Zyra e rregullatorit për energji, nuk ka respektuar ligjin e lartcekur, kërkoj nga bordi të marrë këtë:

VENDIM

Aprovohet ankesa e parashtruesit të konsumatorit dhe në bazë të ligjit mbi Detyrimet të parashkruhet borgji i vjetruar, i cili ka mbetur pa paguar me fajin e KESCO-s, për keq menaxhim dhe zvarritje procedurës.

Prishtinë
31.05.2017

Parashtruesi i ankesës

“[shëno logon tuaj]”
ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, neni 14 paragrafi 2. nënparagrafi 2.14, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185), nenit 17 dhe 18 të Rregullorës për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, Vendimi i DMK-së të ZRRE-së, ZRRE/DMK_V_1465_03_17, ankesa e konsumatorit e datës 27.05.2017, në seancën e mbajtur me datë 27.05.2017, mori këtë:

VENDIM

I Refuzohet ankesa e konsumatorit D.D me shifër DPR-90100237, ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetim të këtij vendimi.

II Mbetet në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr.ZRRE/DMK_V_1465_03_17, i datës 10.05.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 03.06.2017, ka pranuar ankesën e parshtruar nga konsumatori D.D, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit në ZRRE, për këto shkaqe: konsumatori në ankesën e tij fillimisht ka theksuar se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, në mënyrë të shkëlqyer ka shqyrtuar të gjitha faktet e parashtruar në ankesë, por që ka anashkaluar Ligjin mbi Marëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me parashkrim e borgjit një vjeçar. Konsumatori në ankesë ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të merrë për bazë kërkesën për parashkrim borxhi, i cili borxh është vjetërsuar dhe ka mbetur pa paguar me fajin e KESCO-së.

Me datë 01.06.2012 konsumatori D.D, ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK, për lidhje të re, si dhe të njejtën e ka përsëritur edhe në KEDS, me datë 22.09.2015. Në dy kërkesat e konsumatorit, konsumatori ka evidentuar numrin e njëhësorit nr.97018599.

Me datë 14.11.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it, për praninim e njëhësorit elektrik kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë pranimin e instalimit të njëhësorit elektrik nr.97018599 me gjendje TL=6445 KWH, dhe TU=56 KWH. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it po ashtu kanë evidentuar të dhënat teknike të pikës matëse, si dhe kanë evidentuar kyç jen si lidhje të përkohshme.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 29.11.2015, i ka dërguar konsumatorit faturën mujore për periudhën nëntor 2014 me 8,120 KWH, apo e shprehur në vlerë financiare 1,022.35 euro.

Me datë 01.12.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator KEDS, duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë për periudhën nëntor 2015, të cilën e ka përsëritur edhe me datë 12.05.2016.

Me datë 13.06.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it, për inspektimin e pikave matëse, kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik 9701859, ku TL=016925 KWH (tarifa e lartë) dhe TU=010364 (tarifa e ulët).

Me datë 01.07.2016, Departamenti për Konsumatorë në KESCO, i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij, bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe kërkesës për lidhje të re me datë 22.09.2015, duke bërë korrigjimin e faturave, vetëm të periudhës 10.11.2015, në vlerë prej 26.13 euro.

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-së, konsumatori me datë 03.07.2016, ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së, duke e kundërshtuar përgjigjen e KESCO-së, duke kundërshtuar korrigjimin e bërë nga KESCO, si dhe ka kërkuar që ti bëhet korrigjimi i faturës 11140DPR-90100237, e datës 29.11.2015, bazuar në kërkesën e datës 01.06.2012. Konsumatori në deklaratën e tij thekson se kërkesa për kyçje është bërë me datë 01.06.2012, por që asnjëherë ekipet e KEK-ut dhe KEDS-it, nuk kanë bërë inspektimin e pikës matëse për ta pranuar kyçjen, andaj me datë 22.09.2015, është detyruar që ta përsërisë kërkesën për lidhje të re. Konsumatori po ashtu thekson se energjia e regjistruar në njehsorin elektrik është shpenzuar gjatë ndërtimit të shtëpisë.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, si organ i shkallës së parë duke u bazuar në analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura ka aprovuar ankesën e konsumatorit duke vendosur që të anulon korrigjimin nr. 75307DPR-90100237, e datës 25.06.2016, në vlerë prej 26.13 euro, në shifrën DPR-90100237, si dhe të korrigjon faturën nr.11140DPR-90100237, të datës 29.11.2015, në vlerë 514.90 euro duke bërë shpërndarjen e KWH të faturuar në periudhën 06/2001-11/2015 në shifrën DPR-90100237.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2017, ka analizuar të gjitha shkresat, e lëndës të prezantuar nga ana e konsumatorit D.D, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së, është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së, me të drejtë ka vërejtur se organi i shkallës së parë DMK, me të drejtë ka vërtetuar gjithë gjendjen faktike të konsumatorit dhe ka evidentuar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë pikë matëse.

Bordi i ZRRE-së, gjithashtu ka vërtetuar se organi i shkallës së parë me të drejtë ka

konstatuar se KEK-u, në atë kohë dhe pastaj KEDS-i, nuk ka vepruar konform nenit III të Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, përkatësisht neni 9, paragrafi 7.1 dhe neni 10.

Duhet theksuar se kreu i III-të i kësaj Rregulle përshkruan detajisht gjithë procesin e regjistrimit të një konsumatori të ri në rrjetin elektrik, që nga aplikimi për lidhje të re, deri te kyçja e tij në rrjetin elektrik, si dhe nënshkrimi i kontratës për furnizim me energji elektrike. Konsumatori kur ka parashtruar kërkesë për lidhje të re me datë 01.06.2012 ka vepruar konform nenit 8 të Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, ndërsa punëtorët e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë, është dashur që konform nenit 9, të dalin te konsumatori për të inspektuar gjendjen teknike dhe ti dërgoj konsumatorit ofertën për kyçje dhe nëse është gjithçka në rregull konform nenit 11, të bëjë marrëveshjen për kyçje dhe konform nenit 12 të bëjë kyçjen e konsumatorit në rrjetin elektrik.

Ndërsa në raste se kyçja nuk është e mundur teknikisht ose ekonomikisht, apo nuk është në përputhje me dispozitat e kodit të rrjetit dhe shpërndarjes ose kodet e tjera ne fuqi, atëherë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes konform nenit 10 të rregullores së lartcekur mund të refuzoj kyçje, por qe duhet të lëshon dhe dërgon tek aplikuesi një njoftim ne formë të shkruar që paraqet arsyen e refuzimit brenda periudhës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarik prej datës së dërgimit të aplikacionit, gjë për të cilën te rasti i konsumatorit ndërmarrja e energjisë nuk ka vepruar.

Për të evituar gjithë neglizhencën e bërë nga ana e KEK-ut, fillimisht me vonë KEDS dhe me qëllim që të mos dëmtohet konsumatori në vlerë financiare organi i shkallës së parë DMK ka vepruar drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore duke anuluar korrigjimin e bërë nga ana e KEDS, korrigjimi nr. 75307DPR-90100237 e datës 25.06.2016 në vlerë prej 26.13 euro, në shifrën DPR-90100237, si dhe ka bërë korrigjimin e faturës nr.11140DPR-90100237, të datës 29.11.2015, në vlerë 514.90 euro duke bërë shpërndarjen e KWH të faturuar në periudhën 06/2001-11/2015 në shifrën DPR-90100237.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar kërkesën e konsumatorit që ka të bëjë me parashkrimin e borxhit të energjisë elektrike dhe për këtë ka vendosur se ZRRE-ja, nuk ka vërtetuar ndonjë element të parashkrimit të borxhit të energjisë elektrike, ne kemi analizuar gjithë lëndën lidhur me grumbullimin e borxhit të energjisë elektrike dhe faturimin e këtij borxhi me vetëm një faturë dhe për këtë kemi bërë korrigjimin e kësaj fature në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa lidhur me çështjen e parashkrimit të borxhit bordi ka konstatuar se për raste të tilla konsumatori mund ti drejtohet Gjykatave kompetente.

Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së, si organ i shkallës së parë

nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në rregulla dhe ligje.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2017, pas analizimit të asaj që u theksua më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III.Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mos përputhjes në mesë versioneve do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV.Vendimi hyn në fuqi me datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Kryesuesi _____

Anëtar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

*Shembulli i 13-të - natyra e çështjes
Tri paga përcjellëse pas pensionimit*

“[shëno logon tuaj]”

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
Lajmërim për Përfundimin e Shërbimit/Obavestenje o Prestanke Sluzbe
TË DHËNAT PERSONALE/LICNI PODACI

Emri/Ime: **A...** Mbiemri: **N...**

Numri i punëtorit/broj zaposlenog **060**, Data e lindjes/Datum rodjenja: **10.05.1950**.

Titulli i postit/Naziv posla: **Zyrtar i Burimeve Njerëzore.**

Departamenti/Zyra/Odeljenje/kancelarja: **Përkrahjes**

Lokacioni i vendit të punës/lokacija radnog mesta: **Drejtoria e Përgjithshme-Prishtinë**

Data e përfundimit të shërbimit/**Datum okoncanja radnog odnosa:10.05.2015.**

Arsyeja e përfundimit të shërbimit/Razlozi zavrsetka sluzbe: **Pensionim i vjetërsisë**

(Moshë e Pensionimit) Dorëheqja, Stazhi i dështuar, Shkarkim, të tjera

Meqenëse, me datën 10.05.2015 arrin moshën e pensionimit, sic është e përcaktuar me nenin 90 paragrafi 90.2 pika 90.2.1 të Ligjit nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, kërkohet nga ju që brenda kësaj periudhe sa ju kanë mbetur deri në pensionim t'i shfrytëzoni ditët e pushimit vjetor të cilat i keni në dispozicion, në të kundërtën ato që nuk i shfrytëzoni nuk do të ju kompensohen.

Po ashtu, nga ju kërkohet që deri në ditën e fundit të Shërbimit t'i ktheheni tek Zyrtari i pasurisë të gjitha të mirat që janë pronë e ATK-së, dhe me të cilat jeni të ngarkuar që ditën e fundit t'a dorëzoni edhe kartelën zyrtare tek Menaxherja e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve.

Ua përkujtojmë se edhe pas ndërprerjes së kontratës së punës i nënshtroheni neneve mbi konfidencialitetin e Kodit të Mirësjelljes së Shërbimit Civil dhe Kodit të Mirësjelljes së Administratës Tatimore të Kosovës për mospërhapjen e informatave të ndjeshme.

Nënshkrimi/Potpis _____

Data/Datum:15.01.2015

Emri dhe Mbiemri/Ime i Prezime: **M.T**

Menaxhere e Lartë e Burimeve Njerëzore/

Visa Menadjerka Personalna

“[shëno logon tuaj]”
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Duke u mbështetur në nenin 90, nënparagrafi 2.1 për arritjen e moshës së pensionimit të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 22 paragrafi 2.2 – pagesën për shkak të pensionimit të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nënpunësve Civil në Republikën e Kosovës si dhe nenit 19 pika 1 dhe 2-pagesa për pensionim-Te Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nënpunësve Civil, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës merrë këtë:

VENDIM

Mbi pagesën e A... N..., në lartësi prej 495.13 Euro të njëherëshme (vlera mujore e pagës së tij e fundit) me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Arsyetim

A... N..., ka qenë i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, në Departamentin e Përkrahjes Divizioni i burimeve Njerëzore pozitën e punës: Zyrtar i Personelit. Me rastin e arritjes së moshës së pensionimit sipas rregullave ekzistuese duhet bërë pagesën në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në lartësinë e pagës së fundit të tij.

Pagesa e kësaj shume me rastin e pensionimit është e mbështetur në nenin 90, nën paragrafi 2.1 arritjen e moshës së pensionimit të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 22 paragrafi 2.2 – pagesën për shkak të pensionimit të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nënpunësve Civil në Republikën e Kosovës si dhe nenit 19 pika 1 dhe 2-pagesa për pensionim-Te Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nënpunësve Civil.

Drejtori i Përgjithshëm ATK-së
H...B...

Për: Administratën Tatimore të Kosovës

Komisionit të Ankesave;

Nga: A... N..., Ish i punësuar në ATK në pozitën Zyrtar i Personelit

Lënda: Kompensim me rastin e pensionimit në lartësi prej tri (3) paga mujore.

Me datën 10.05.2015, kam mbushur moshën e pensionimit për pensionim. Pasi kam pranuar pgaesën e pagës për muajin Maj 2015, kam konstatuar se nuk më janë përlloritur tri (3) paga si kompensim me rastin e pensionimit të parapara sipas Marrveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko-Social të Kosovës ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015. Pjesë e nënshkrimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës, të bërë me datë 18.03.2014 ka qenë edhe Qeveria e Kosovës, ku unë kam qenë pjesë e të njëjtës administratë deri me rastin e pensionimit.

Meqenëse kam qenë pjesë e Administratës së Qeverisë së Kosovës kërkoj që në vend të një page të më llogariten tri (3) paga ashtu sic parashihet me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me rastin e pensionimit në bazë të moshës.

Me nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës thuhet, citoi: *“I punësuarit me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr tre (3) muajt e fundit”*.

Gjithashtu kam njohur se nga muaji Maj-2015, për të punësuarit në Shërbimin civil të Kosovës është përlloritur dhe paguar shtesa në emër të përvojës në punë të paraparë edhe me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të precizuar me nenin 48 të saj.

Shtrohet pyetja si është e mundur që një akt juridik i nxjerr të mos zbatohet në kohën e paraparë apo të zbatohet pjesërisht kur nga aprovuesi është precizuar koha e hyrjes në fuqi, nëse në ndërkohë nuk është plotësuar apo ndryshuar në procedurën e njëjtë me rastin e aprovimit.

Nga të cekura më lartë, kërkoj nga Komisioni i Ankesave të ATK-së që të miraton kërkesën time për pagesë ose të hap rrugë për instanca tjera ankimore.

Prishtinë, 03.06.2015

**Parashtruesi i Ankesës,
A.. N..**

“*[shëno logon tuaj]*”
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
Komisioni për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregullorës Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, Komisioni i Ankesave pranë ATK-së në shqyrtimin e ankesës së ankuesit me datë 02.07.2015, merr këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e ankuesit A... N..., pensionist e datës 03.06.2015.

A r s y e t i m

Ankuesi A.. N., ish i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, tani i pensionuar që nga data 11.05.2015, ka ushtruar ankesë brenda afatit ligjor për kompensimin e tri (3) pagave mujore, bazuar në nenin 53 të Marrëveshjes Kolektive të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës përkatësisht Zyra e Burimeve Njerëzore pranë këtij institucioni duke u bazuar në nenin 19 pika 2 të Rregullorës Nr.33/2012 mbiShtesa në Pagë dhe Kompensimet tjera të Shërbyesve Civil, pas arritjes së moshës së pensionimit ka kompensuar të njëjtin me një pagë në vlerë të pagës së fundit.

Administrata Tatimore e Kosovës ankuesit të lartpërmendur në bazë të vendimit të datës 06.05.2015, ja ka paguar një pagë prej 495.13 euro, e cila mund të vërtetohet nga listat e veçanta të pagave.

Komisioni i ankesave, bazuar në shkresat elëndës dhe dispozitave ligjore konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk është duke u zbatuar plotësisht edhe pse e njëjta ka hyrë në fuqi që nga janari 2015. Andaj, lidhur me kërkesën tuaj për pagesën e 3 pagave mujore sipas dispozitave ligjore të cekura më lartë nuk mund të aprovohet pasi që marrëveshja në fjalë ende nuk ka gjetur zbatim të tërësishëm në institucionet e Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditëve pas marrjes së këtij vendimi, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMShCK).

Ky vendim t’i dorëzohet:
- Parashtruesit të ankesës;
- Dosjes personale.

Kryetari i Komisionit,
H..E..

Për: Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK).

Nga: A... N..., i punësuar në ATK në pozitën Zyrtar i Personelit

Kundër vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës-Komisionit për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave i datës 02.07.2015, në afatin ligjorë paraqesë këtë:

ANKESË

Për shkak të:

Shkeljeve të dispozitave procedurale;
Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale;

A r s y e t i m

Me vendimin e ATK-së të datës 02.07.2015, është refuzuar ankesa e datës 03.06.2015, e parashtruar nga A.N, pensionist, me të cilën ka kërkuar ti kompensohen tri paga mujore me rastin e pensionimit.

Në arsyetimin e vendimit Komisioni për shqyrtimin e kontesteve dhe ankesave pran ATK-së ka konstatuar se ATK duke u bazuar në nenin 19 pika 2 të Rregullorës Nr.33/2012 mbi Shtesat në Pagë dhe Kompensimet tjera të Shërbyesve Civil, pas arritjes së moshës së pensionimit ka kompensuar të njëjtin me një pagë në vlerë të pagës së fundit dhe gjithashtu ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk është duke u zbatuar plotësisht edhe pse e njëjta ka hyrë në fuqi që nga janari 2015, andaj nuk mund të aprovohet ankesa juaj.

Me datën 10.05.2015, kam mbushur moshën e pensionimit për pensionim. Pasi kam pranuar pgaesën e pagës për muajin Maj 2015, kam konstatuar se nuk më janë përlogaritur tri (3) paga si kompensim me rastin e pensionimit të parapara sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e miratuar dhe nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko-Social të Kosovës me datë 18.03.2014, ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015. Pjesë e nënshkrimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës, përkatësisht në emër të Qeverisë e ka nënshkruar, vet kryeministri. Kjo marrëveshje ka të bëjë dhe duhet të zbatohet edhe për të punësuarit në Shërbimin Civil të Kosovës që nga Janari-2015.

Provë: Kopje të faqes 1, 23 dhe 24 të Marrëveshjes Kolektive të Kosovës

Meqenëse kam qenë pjesë e Administratës së Qeverisë së Kosovës kërkoj që në vend të një page të më llogariten tri (3) paga ashtu sic parashihet me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me rastin e pensionimit në bazë të moshës.

Lidhur me mospagesën e 3 pagave paraprakisht dhe në afatin ligjore i jam drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore e cila më është refuzuar si e pa bazë, për cka më është mundësuar të i drejtohem KPMSHCK-së për shqyrtim të mëtejme.

Provë: Kopja e vendimit të ATK-Komisionit për Shqyrtimin e Kontesteve dhe Ankesave i dt.02.07.2015.

Me nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës thuhet, citoi: *“I punësuari me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr tre (3) muajt e fundti”.*

Gjithashtu kam njohuri se nga muaji Maj-2015, për të punësuarit në Shërbimin civil të Kosovës është përlllogaritur dhe paguar shtesa në emër të përvojës në punë të paraparë edhe me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të precizuar me nenin 48 të saj, veprim ky i cili ankesën time e bënë më të justifikuar se Marrëveshja nuk mund të zbatohet parcialisht kur ajo është në fuqi për zbatim nga janari 2015 dhe në ndërkohë nuk ka pësuar ndryshime.

Dëshiroj të theksoj se në përvojën time si Zyrtar i personelit dhe menaxher i personelit në ATK, kemi pas disa raste (se paku 2) kur po ky Këshill i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës në ankesë të punësuarit me rastin e pensionimit ka nxjerr vendim ku e ka obliguar autoritetin punëdhënës që të i kompensohen 2 (dy) paga mesatare mujore për tre muajt e fundit duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Përgjithshme, këtu mendohet në Kontratën Kolektive të Përgjithshme para kësaj të fundit.

Provë: Kopje e faqes së parë të vendimit të KPMSHCK-së të datës 22.03.2012

Duke theksuar arsyet e cekura më lartë, kërkoj nga KPMSHCK-ja që të miraton kërkesën time dhe të nxjerr vendim që të më kompensohen 3 paga baë për pagesë, ashtu sic parashihet me Marrëveshjen Kolektive të Kosovës.

Prishtinë, 08.07.2015

**Parashtruesi i Ankesës,
A..N..**

“[shëno logon tuaj]”

**A 02/172/2015,
Datë 06.09.2015**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Sh. A kryetar, M. Sh., P.L, anëtar, për shqyrtimin e ankesës të datës 08.07.2015, të parashtruar nga ankuesi A.N, kundër vendimit të komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike, kompensim material, duke vepruar në pajtim me nenin 10 parag. 1.1, të ligjit nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 20 parag. 1 nën parag.1.1, të Rregullores nr.03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.09.2015 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A 02/339/2015 e datës 08.07.2015, e parashtruar nga ankuesi A.N.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me nr, 11/10, i datës 02.07.2015, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, A.N, ish i punësuar në ATK, në vendin e punës zyrtar i personelit. Ankuesi me datë 10.05.2015, i ka mbushur 65 vjet, rrjedhimisht i ka plotësuar kushtet ligjore për pensionim.

Ankuesi A.N, me datë 03.06.2015, parashtron ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në ATK, me pretendimet ankimore: Kompensim e 3 (tri) pagave në rastin e pensionimit në shumën.

Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 02.07.2015, nxjerrë vendim me të cilin e refuzon ankesën e datës 03.06.2015.

Ankuesi A. N., i pa kënaqur me vendimin e datës 03.06.2015, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.07.2015.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka adminsitruar këto prova: Ankesën e parashtruar me datë 08.07.2015 vendimin e dt 02.07.2015, vendimin e ATK-së.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit A.N, është e pa bazuar për këtë arsye:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se organi i punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, duhet të bëjë pagesën në vlerën e tri (3) pagave me rastine pensionimit, sipas kontratës kolektive.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke analaizuar provat e lëndës konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit i cvili pretendon se organi i punësimit duhet të bëjë pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit është i pa bazuar, sepse për kompensimet e nënpunësve civil janë të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit nr.03/L-147 për Pagar e Nënpuënsve Civil dhe aktet të tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nënpunësve civil me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme e jo tri (3) pagave sic ankuesi pretendon kjo parashihet me dispozitat e nenit 22 par.2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nënpuënsve Civil dhe dispozitat ku përcaktohet se: “Pagesën për shkak të pensionimit” si dhe nenit 19 paragrafit 2 i Rregullorës Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nënpuënsve Civil i cili përcakton se: “Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një page në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komsioni për Zgjidhjen e Kontestve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, vendimin me numër 11/10 me datën 02.07.2015, e ka marr në pajtim em dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative dhe Rregullorën Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontestëve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazë juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës, në rastin e marrjes së vendimit pas moshës së pensionimit si dhe kompensimin e një page pas moshës së pensionimit, për nënpunësin civil A.N, është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marr në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nënpuënsve Civil, si dhe Rregullorën Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nënpuënsve Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda nr. A 02/172/2015, me datë 06.09.2015

Kryetari i Kolegjit,

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit së këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së
- Udhëheqësit të Personelit në ATK dhe
- Arkivit të KPMSHCK

***Shembulli i 14-të, natyra e çështjes
Çështje doganore***

Rasti konkret ka të bëjë me taksën e akcizës:

Në këtë natyrë të çështjeve, procedura administrative fillon sipas detyrës zyrtare, të organit administrativ, në rastin konkret Doganës së Kosovës, me anë të Formularit për taksë të akcizës, në rastin konkret për lojrat e fatit.

(Formularin lidhur me këtë çështje, mund ta gjeni on line, në web faqen e Ministrisë së Financave-Doganën e Kosovës)

**(shëno llogon tuaj)
MINISTRIA E FINANCAVE
Dogana e Kosovës**

**Spektori i Akcizës
Nr.03.4.1
I.I-CS-01728376**

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas detyrës zyrtare, për subjektin në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, konform dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-220, për Normat e Akcizës dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, më datë 05.12.2017 merr këtë:

V E N D I M

I. Obligohet subjekti në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, të paguaj në emër të taksës së Akcizës, shumë në vlerë prej 57,100.00 euro, për muajin dhjetor-2017.

II. Subjekti në procedurë, vlerën si në pikën I të dispozitivit, detyrohet ta paguaj në afat prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi-urdhërpagesës.

III. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

IV. Mospagesa me kohë e obligimeve duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, tërheqë sanksione ligjore në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

A r s y e t i m i

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas dispozitave ligjor enë fuqi, sipas detyrës zyrtare, konform vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të datës 29.04.2011, për zbatimin e tij, vlerëson se subjekti në procedurë NTSh P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, i nënshtrohet obligimit për pagimin e takësës për Akcizë në përlllogaritjen si më poshtë:

Automate lojra fati.....104x500.00=52,00.00

Ruletë.....17x300.00=5.100.00

Totali: 57.100.00 euro

Bashkangjitur këtij vendimi e kemi edhe formularin mbi kalkulimin.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në Sektorin për Rishqyrtime të Vendimeve pranë Doganës së Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Udhëheqësi i Departamentit Qëndror

A.N

(Formularin lidhur me këtë çështje, mund ta gjeni on linë, në web faqen e Ministrisë së Financave-Doganën e Kosovës)

(shëno llogon tuaj)
MINISTRIA E FINANCAVE
Dogana e Kosovës

Sektor i Akcizës
Nr.03.4.1
EG-CS-0637

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas detyrës zyrtare, për subjektin në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, konform dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-220, për Normat e Akcizës dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, më datë 05.10.2016 merr këtë:

V E N D I M

I. Obligohet subjekti në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, të paguaj në emër të taksës së Akcizës, shumën në vlerë prej 49,600.00 euro, për muajin shtator-2017.

II. Subjekti në procedurë, vlerën si në pikën I të dispozitivit, detyrohet ta paguaj në afat prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi-urdhërpagesës.

III. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

IV. Mospagesa me kohë e obligimeve duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, tërheqë sanksione ligjore në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

A r s y e t i m

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas dispozitave ligjor enë fuqi, sipas detyrës zyrtare, konform vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të datës 29.04.2011, për zbatimin e tij, vlerëson se subjekti në procedurë NTSh P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, i nënshtrohet obligimit për pagimin e takësës për Akcizë në përlllogaritjen si më poshtë:

Automate lojra fati.....	89x500.00=42,00.00
Ruletë.....	17x300.00=5.100.00

Totali: 49.600.00 euro

Bashkangjitur këtij vendimi e kemi edhe formularin mbi kalkulimin.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në Sektorin për Rishqyrtime të Vendimeve pranë Doganës së Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Udhëheqësi i Departamentit Qëndror

A.N

(Formularin lidhur me këtë çështje, mund ta gjeni online, në web faqen e Ministrisë së Financave-Doganën e Kosovës)

(shëno llogon tuaj)
MINISTRIA E FINANCAVE
Dogana e Kosovës

Spektori i Akcizës
Nr.03.4.1
EG-CS-0987

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas detyrës zyrtare, për subjektin në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, konform dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-220, për Normat e Akcizës dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, më datë 05.11.2017 merr këtë:

V E N D I M

I. Obligohet subjekti në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, të paguaj në emër të taksës së Akcizës, shumën në vlerë prej 57,100.00 euro, për muajin Tetor-2018.

II. Subjekti në procedurë, vlerën si në pikën I të dispozitivit, detyrohet ta paguaj në afat prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi-urdhërpagesës.

III. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

IV. Mospagesa me kohë e obligimeve duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, tërheqë sanksione ligjore në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

A r s y e t i m

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas dispozitave ligjor enë fuqi, sipas detyrës zyrtare, konform vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të datës 29.04.2011, për zbatimin e tij, vlerëson se subjekti në procedurë NTSh P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, i nënshtrohet obligimit për pagimin e takësës për Akcizë në përlllogaritjen si më poshtë:

Automate loja fati.....104x500.00=52,00.00
Ruletë.....17x300.00=5.100.00

Totali: 57.100.00 euro

Bashkangjitur këtij vendimi e kemi edhe formularin mbi kalkulimin.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në Sektorin për Rishqyrtime të Vendimeve pranë Doganës së Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Udhëheqësi i Departamentit Qëndror

A.N

(Formularin lidhur me këtë çështje, mund ta gjeni on linë, në web faqen e Ministrisë së Financave-Doganën e Kosovës)

(shëno llogon tuaj)
MINISTRIA E FINANCAVE
Dogana e Kosovës

Spektori i Akcizës
Nr.03.4.1
LI-CS-01728376

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas detyrës zyrtare, për subjektin në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, konform dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-220, për Normat e Akcizës dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, më datë 05.12.2017 merr këtë:

V E N D I M

I. Obligohet subjekti në procedurë NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, të paguaj në emër të taksës së Akcizës, shumën në vlerë prej 57,100.00 euro, për muajin nëntor-2018.

II. Subjekti në procedurë, vlerën si në pikën I të dispozitivit, detyrohet ta paguaj në afat prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi-urdhërpagesës.

III. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

IV. Mospagesa me kohë e obligimeve duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë nr. 03/13 të datës 29.04.2011, tërheqë sanksione ligjore në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

A r s y e t i m

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas dispozitave ligjor enë fuqi, sipas detyrës zyrtare, konform vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të datës 29.04.2011, për zbatimin e tij, vlerëson se subjekti në procedurë NTSh P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, i nënshtrohet obligimit për pagimin e takësës për Akcizë në përlllogaritjen si më poshtë:

Automate lojra fati.....	104x500.00=52,00.00
Ruletë.....	17x300.00=5.100.00

Totali: 57.100.00 euro

Bashkangjitur këtij vendimi e kemi edhe formularin mbi kalkulimin.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në Sektorin për Rishqyrtime të Vendimeve pranë Doganës së Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Udhëheqësi i Departamentit Qëndror

A.N

Minsitria e Financave
Dogana e Kosovës
Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve

Kundër vendimeve të Sektorit të Akcizave në kuadër të Doganës së Kosovës, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, paraqesë këtë:

A N K E S Ë

Për shkak të: Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike
Aplikimit jo të drejtë të dispozitave materiale

A r s y e t i m

Dokana e Kosovës, -Sektori i Akcizës, ka nxjerrë aktvendimet Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, me të cilët janë më ka obliguar të paguaj shumat e cekura si në venimet e atakuara, në emër të akcizës, mirëpo të njëjtat janë përcaktuar duke bërë shkeljen e dispozitave ligjore, dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale, duke na obliguar me gjobë e cila është tejte e lartë dhe e kundërligjshme.

Provë: aktvendimet e atakuara.

Me aktvendimet e atakuara, me asgjë konkretet nuk dëshmohet se si ka ardhur deri te kjo shumë astronomike e shqiptuar për muajt kontestues, me të cilët shumë na ngarkon në emër të Akcizës për muajt gusht, shtator, tetor dhe nëntor 2017, ku për dallim nga ne që kemi ofruar prova me shkrim për kohën dhe numrin e aparateve të pasivizuara, si dhe adresën e saktë të vendëdhjes së depozitës.

Aktvendimet e atakuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave ligjore të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e aplikimit dhe zbatimit të akcizës, ngase shumë çartë mes tjerash në Ligjin për Akcizën thuhet se: akciza aplikohet për çdo ditë –secilën ditë para që para që aparatet kanë qenë aktiv, e jo për tërë muajin. Duke u nisur pikërisht nga kjo dispozitë ligjore e cila me rastin e nxjerrjes së aktvendimeve është shkelur në tërësi, neve si subjekt juridik ndaj të cilit kemi aplikuar akcizën është dashtë të ngarkohemi për sasinë e aparateve aktive para pasivizimit nga data 01.02.2016 deri më datë 16.02.2016, e jo për tërë muajt siç ka ndodhur me vendimet e atakuara.

Provë: njoftimi i datës 17.02.2016.

Duket e pakuptimt kur D.K i injoron faktet e sipërcekura, e sidomos shkresën e lëshuar në formë tabelare nga ATK-ja, ku çartë shihet numri i saktë i aparateve aktiv e që është

rreth 99 dhe i atyre pasiv rreth 391, e bazuar në këtë citojmë: Dogana e Kosovës, nuk mund ta pranoj si provë shkresën kinse të ATK-së, pasi ajo shkresë është formuluar, e mbushur, plotësuar dhe nënshkruar nga subjekti ankimor dhe nuk është e nënshkruar dhe e vërtetuar nga organi kompetent dhe se ky dokument si i till është një kërkesë e palës e cila deri sa të verifikohet nuk prodhon efekt juridik, ose subjekti ankimor realisht nuk i ka pasivizuar aparatet, ky citat thjesht është injorim i dëshmime materiale e njëkohësisht edhe mvëshje e përgjegjësisë që neve nuk na takon.

Me përgjegjësinë më të plotë me këtë rast mund të konstatojmë se të gjitha shkresat tona drejtuar ATK-së, mbi pasivizimin e aparateve janë më se të sakta dhe se shkresa me llogo të Ministris dhe ATK-së, e cila e pasqyron gjendjen reale dhe momentale është e mbushur dhe plotësuar ekskluzivisht nga stafi i ATK-së, dhe pranuar nga punëtori ynë, dhe kjo ka ndodhë për shkak të neglizhencës së ATK-së të cilët nuk e kanë vulosur këtë shkresë dhe se nuk ka ndalur me kohë me pa gjendjen në depo, të gjobitemi ne, kjo nuk ka fare kuptim. Edhe pse kjo shkresë nuk është e jona, e njëjta ka të bëjë pikërisht me subjektin tonë.

Provë: shkresa e lëshuar nga ATK-e datës 06.02.2016.

Për deri sa ne si subjekt jemi drejtuar ATK-së, me shkresa dhe e kemi njoftuar mbi gjendjen dhe numrin e aparateve të pasivizuar dhe e kemi dhënë adresën e saktë e pas kësaj të mendohet se nuk kemi qenë të gatshëm që në këto terminë të takohemi me zyrtarët e ATK dhe bashkarisht ta vizitojmë depon me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike të aparateve të pasivizuara është e pakuptimt, jo profesionale dhe denigruese për ne si biznes. Nuk ka kurfar logjike të arsyeshme të përjashtohet ky konstatim i till qfare është dhënë në vendime.

Se njoftimet tona me shkrim drejtuar ATK-së, kompetente për licencim dhe përcjellje të punës së gjithëmbarshme të biznesit ton, ishin të sakta më si miri e vërteton rasti i vizitës së zyrtarve të ATK-së, bashkë me ata doganëre që i bënë depon tonë edhe pse u dashtë të pritët të vijnë më datë 25.07.2016, më tepër se një muaj prej datës kur ne i jemi drejtuar me shkresë ATKs-ë, me ç rast u binden se në depo ishin vendosur 535 aparate të lojrave të fatit, ashtu siç edhe i kishim njoftuar tashmë një kohë të gjatë. Vlenë të ceket se me këtë rast nga zyrtarët e të dyja institucioneve është lëshuar dokumenti zyrtar i cili e bënë përshkrimin e gjendjes faktike.

Provë: Formulari mbi plumbimin i datës 26.02.2016, i lëshuar nga D.K

Pas gjithë kësaj na jep me kuptu se gjendja e vërtetuar nga zyrtarët tuaj me datën 25.02.2016, në depon tonë është gjendje e rastit apo e momentit, por është pasojë rrjedhimisht e angazhimit dhe punës së stafit të subjektit tonë, me qëllim të pasivizimit të një numri të aparateve dhe atë sipas njoftimit me shkrim që kemi bërë në ATK.

Shpresojmë, se kësaj radhe organi për rishqyrtimin e vendimeve me kujdesin dhe profesionalizmin më të madhe do të konsultojë dispozita ligjore në fuqi e të cilat e rregullojnë këtë materie, si kundër që do i merr në shqyrtim provat materiale të ofruara nga ne dhe do bjen aktvendim meritore dhe të bazuar në ligj. Faktet tona në këtë rast janë më së bindëse e jo të vendoset shabllon njësoj për të gjitha subjektet e lojrave të fatit mbi pretendimet tona për kohën e pasivizimit të aparateve tanë.

Vlenë të ceket me këtë rast edhe një herë se neve si biznes jemi të gatshëm që edhe sikundër që kemi vepruar, edhe në të kaluarën, të kryejm çdo obligim financiar karshi shtetit respektivisht institucioneve e në këtë rast edhe D.K, por asesi nuk pajtohemi që të ngarkohemi me shuma të caktuara për diçka që në fakt ska ndodhë dhe për neglizhencë të institucioneve, pavarësisht se për cilin institucion zyrtar është fjala.

Me këtë ankesë, bazuar në të gjitha të cekurat më lartë, Sektorit për Rishqyrtimin e vendimeve i:

P r o p o z o j m ë

I. Të Anulojë vendimet Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, me të cilat ne si subjekt afarist, ngarkohemi që në emër të akcizës ta paguajm shumën në vlerën e përcaktuar si në vendimet e atakuara.

II. Subjekti afarist NTSH P.GG, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, të lirohet nga gjoba e shqiptuar, pa asnjë bazë ligjore.

Prishtinë, 25.12.2017

Parashtruesi i ankesës

NTSH P.GG

Shëno llogon tuaj
MINISTRIA E FINANCAVE
Dogana e Kosovës

Nr.03.1.4
H.L

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës së subjektit në Procedurë, NTSH P.GG, ne Prishtinë, me nr. të certifikatës së biznesit 980000000, për rishqyrtimin e vendimeve Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, të subjektit në procedurë, në vështrim të nenit 291 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-099, si dhe konform nenit 136, pika (a) dhe nenit 134 pika (b), të Ligjit për procedurën Administrative, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë NTSH P.GG, ne Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, të lëshuar nga Sektori i Akcizave si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Sektori i akcizave duke vepruar sipas detyrës detyrës zyrtare me vendimin e lartëcekur subjektin ankimor e ka obliguar që të paguaj obligimin në emër të taksës së akcizës për muajin Qershor dhe Korrik. Në arsyetimin e lëshuar nga Sektori i Akcizave thuhet se subjekti ankimor është obliguar për pagesë ta taksës së akcizës bazuar në vendimin e Qeverisë me nr.03/13 datës 29.04.2011.

Subjekti në procedurë, brenda afatit ligjor me datë 25.11.2016 ka parashtuar kërkesë për shqyrtimin e vendimeve të Sektori të Akcizës me Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, me të cilin potencon vendimin paraprak të nxjerr nga dogana e Kosovës si dhe kundërshton aktvendimin e sektorit të Akcizave për obligimin e taksës së akcizës në lojrat e fatit sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës dhe ligjit 03/L-220 mbi normat e Akcizës dhe në bazë të vendimit të Qeverisë nr.03/13 të datës 29.04.2011.

Subjekti ankimor e atakon vendimin e lëshuar nga Sektori i Akcizave për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale. Subjekti thekson që Sektori i Akcizave ka nxjerr dy vendime me numër dhe datë të njëjt me crast ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke na ngarkuar dhe njëkohësisht edhe obliguar neve me akcize dhe pagesën e saj, për muajin Qershor dhe Korrik e që është një shumë tepër e lartë. Subjekti ankimor thekson që dogana e Kosovës nuk ka

pranuar si provë këtë shkresë ngase ajo është plotësuar dhe nënshkruar nga subjekti ankimor e jo nga ATK-ja, ndërsa ne me përgjegjësi të plotë konstatojmë se të gjitha shkresat tona drejtuar ATK-së për pasivizimin e aparateve janë më se të sakta dhe se shkresa e lartcekur pasqyron gjendjen reale dhe momentale.

Administrimi i provave: Kërkesa e subjektit ankimor dt.... vendimet Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 I.I-CS-01728376, Nr.03.4.1 EG-CS-0987, Nr.03.4.1 EG-CS-0637, vendimi i Qeverisë 03/13.

Dogana e Kosovës pas pranimit të ankesës së subjektit ankimor, për shqyrtimin e vendimit të lëshuar nga Sektori i Akcizave, duke vlerësuar gjendjen faktike, shkresat e lëndës, shkaqet e vendimit të goditur si dhe duke vlerësuar thëniet dhe pretendimet e subjektit në procedurë konstaton se kërkesa për rishqyrtim e subjektit në procedurë është e pa themelt për arsye se:

Nuk është kontestuese se Qeveria e Kosovës, ka nxjerr vendimin numër 03/13 me datë 29.04.2011, me të cilin ka përcaktuar normat e tatimit të akcizës në lojrat e fatit dhe për zbatimin e tij ka obliguar Doganën e Kosovës, ashtu sic nuk është kontestues se me vendim numër 05/34 është bërë plotësimi dhe ndryshimi i aktvendimit 03/13 datë 29.04.2011 në pikat 1.5 dhe 1.6 të vendimit të mëparshëm nga ku është e qart se pagesa për operatorët e lojrave në automat është 500 euro, ashtu sic është e qartë se për rulet për makinat elektronike me më shumë se një pozicion pagesa është 300 euro për njësi cdo muaj kalendarik.

Sektori i Akcizës i cili është organ kompetent sipas vendimit të lartpërmendur ka vepruar drejt kur subjektin ankimor për muajin Qershor dhe Korrik e ka obliguar që të paguaj sipas listës përfundimtare e cila është marr nga ATK-ja pasi që Dogana e Kosovës edhe njëherë përsërit faktin se nuk e konteston të drejtën e operatorëve ekonomik që të pasivizojnë lojrat e fatit (aparartet, bastoret rulet dhe gjitha lojrat tjera) por konstaton se është obligim i tyre që në të ardhmen kur dëshirojnë të pasivizojnë këto lojra të parashtrajnë kërkesë për pasivizimin e tyre duke caktuar datën e saktë të pasivizimit në mënyrë që ti japin afat Doganës që të vërtetoj gjendjen faktike gjithmonë duke pasur parasysh se këto kërkesa nuk kanë dhe nuk mund të kenë fuqi prapavepruese sic pretendon subjekti në rastin konkret dhe gjithashtu nuk mund të prodhojnë efekte juridike deri sa nuk vërtetohet ajo që është paraqitur apo deri sa nuk vërtetohet se realisht janë pasivizuar ato lojra fati apo jo.

Dogana e Kosovës konstaton se nga Administrata Tatimore ka marr përgjigje përfundimtare më datë 08.08.2016 me të cilën është vërtetuar se subjekti ankimor ka numrin e automatëve 407 copë për aq sa edhe e ka obliguar sektroi i Akcizës, prandaj pretendimi i subjektit ankimor se ka lajmruar të njëjtën administratë për pasivizimin e këtyre automateve është i paqëndrueshëm pasi që vetëm lajmërimi (sic u tha më lartë) nuk është i mjaftueshëm për tu liruar nga obligimet akcizore derisa nuk është vërtetuar

gjendja faktike ose fakti se subjekti realisht ka pasivizuar automatet.

Dogana e Kosovës, vërteton se subjekti me datë 22.06.2016, ka lajmruar se nga data 31.05.2016 ka bërë tërheqjen respektivisht ndalimin e funksionimit të 180 aparatave të lojrave të fatit dhe ky lajmërim është verifikuar nga sektori i Akcizave me datë 20.07.2016 mirëpo, në rastin konkret ky verifikim nuk mund të ketë fuqi prapavepruese nga muaji i pestë por mund dhe duhet të ketë efekte juridike nga data 01.08.2016 dhe këtë sqarim Dogana e Kosovës operatorëve ekonomik të cilët zhvillojnë veprimtarinë me lojrat e fatit u ka bërë me dije në të gjitha aktvendimet paraprahe duke sugjeruar që së pari të bëjnë lajmërimin duke caktuar datën e pasivizimit në të ardhmen e pastaj ti pasivizojn nga ajo datë gjithmonë duke ju ofruar autoritete doganore kohën dhe mundësin e nevojshme për verifikim të gjendjes faktike, pra në rastin konkret pasi Dogana e Kosovës ka verifikuar gjendjen faktike subjektin e ka obliguar bazuar në këtë gjendje faktike dhe ky fakt pranohet nga vet subjekti në ankesën e tij.

Dogana e Kosovës nuk mund ta pranoj as faktin e cekur në ankesë lidhur me shkresën e cila është me logo të Ministrisë dhe ATK-së, të cilën me parë e ka shpallur të papranueshme pasi që të gjitha shkresat të cilat përpilohen, pranohen ose lëshohen nga autoritetet shtetërore për tu pranuar si prova të besueshme duhet të jenë të protokolluara por edhe të nënshkruara nga autoriteti shtetëror nga i cili pranohen ose lëshohen ato dokumente.

Në këtë kuptim Dogana e Kosovës nuk është kompetente të komentoj shkresat e autoriteteve të tjera, por është kompetente që kur një dokument i caktuar dorëzohet pranë Doganës nga cilido autoritet shtetëror të vlerësoj pranueshmërin ose besueshmërinë te atyre dokumenteve.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përvec asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 10 janar 2018

Drejtori Gjeneral

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të filloj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative,-Divizioni Fiskal, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit së këtij vendimi.

Procedura e shqyrtimit të ankesave pranë Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve:

- *Procedura e shqyrtimit të ankesave pranë SRV-së është e përcaktuar (rregulluar) me Nenin 291 të KDA-së dhe Ligjin për Procedurë Administrative nr.03/L-031.*
- *Çdo palë e pakënaqur me një vendim të sjellë nga Dogana e Kosovës, qoftë ai vendim i Zyrave Doganore, Sektorit të Pranimi Qendror (pjesa më e madhe e ankesave ka të bëjë me rivlerësimin e mallit), sektorët e tjerë, departamentet dhe drejtoritë e Doganës së Kosovës.*
- *Palët e pakënaqura me një vendim mund të paraqesin ankesë pranë Zyrës Administrative në Drejtorinë Qendrore apo edhe në Zyrët Doganore (të cilat pastaj dërgohen në Prishtinë).*
- *Afati për parashtrimin e një ankesë është 30 ditë, pasi që pala ka pranuar vendimin nga Dogana.*
- *Tek vendimet e nxjerra nga Sektori për Kundërvajtje Doganore afati për parashtrimin e kundërshtimit është 8 ditë pas pranimit të vendimit, afati për këtë kategori të vendimeve është i rregulluar me Ligjin e Përgjithshëm për Kundërvajtje (ligj bazik për kundërvajtjet në Kosovë).*
- *Ankesa e parashtruar regjistrohet nga zyra administrative dhe merr një numër unik të protokollit, ku një kopje e ankesës me numër protokollit i ofrohet edhe palës, në mënyrë që të dijë numrin e protokollit që e përcjellë atë lëndë.*
- *Ankesës pala mund ti bashkangjës të gjitha dokumentet të cilat i konsideron si prova që mund të mbështesin pretendimit e tij.*
- *Në ankesën e parashtruar nga pala duhet të ceket vendimi kundër të cilit parashtrohet ankesë, po ashtu ankesa duhet të jetë e nënshkruar nga pala, qoftë nga peroni i autorizuar.*
- *Tashmë përmes sistemit LESS ankesat regjistrohen në mënyrë elektronike dhe numrin e protokollit ua jap sistemi.*
- *Po ashtu ankesat që parashtrohen në zyre doganore drejtpërdrejt regjistrohen në SRV dhe marrin numër protokollit unik.*
- *Zyra Adminsitrate ankesën e parashtruar nga ana e subjektit evidenton ne sistemin LEES e cila si dosje fizike e lendes me pas përcillet ne Sektorin e Rishqyrtimit te Vendimeve. Pas pranimit te ankesës se nga zyra administrative edhe te kopjes fizike dhe përmes sistemit udhëheqësi i Sektorit te Rishqyrtimit te*

Vendimeve delegon lenden për trajtim tek zyrtari përmes sistemit të radhës duke u bazuar në numrin e protokollit i cili është përgjegjës për trajtimin e ankesës.

- *Lënda trajtohet/shqyrtohet nga zyrtari/eksperti i rishqyrtimit të vendimeve që i është ndarë lënda duke analizuar të gjitha shkresat e lëndës gjegjësisht faktet dhe dokumentet të cilat gjenden në dosje duke analizuar në sistemin COGNOS dhe ASYCUDA ku bazuar në faktet dhe analizat atëherë vendoset lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e subjektit.*
- *Përjashtimi i vetëm ekziston tek rastet/ kundërshtimet e vendimeve të Sektorit për Kundërvajtje Doganore, pasi që Ligji për Kundërvajtjet parasheh që këto kundërshtime ndaj këtyre vendimeve trajtohen nga një komision prej tre anëtarëve i themeluar nga DGJ, ku këtë komision e përbëjnë: Udhëheqësi i SRV-së, zyrtari që i është ndarë lënda si dhe një anëtar që e ka të përfunduar provimin e jurisprudencës.*
- *Afati ligjor për trajtimin e ankesës/kërkesës është 60 ditë (i caktuar përmes Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe atij të plotësuar).*
- *Nëse për shkak të kompleksitetit të lëndës dhe nevojave për informata dhe prova të reja që janë në pritje është e pamundur të përfundohet shqyrtimi i ankesës brenda afatit prej 60 ditëve, atëherë afati duhet të zgjatet edhe për maksimum 60 ditë të tjera, pasi që LPA përcakton që afati i dytë (vazhdimi i afatit) nuk mund të jetë më i gjatë se sa afati fillestar.*

Nëse për vendosjen e drejt të çështjes është e nevojshme të vendoset një çështje paraprake e pavarur nga lënda që shqyrtohet nga një organ tjetër, shqyrtimi i ankesës pezullohet derisa të përfundohet çështja paraprake.

Veprimet e para me rastin e trajtimit të ankesës që duhet ndërmarrë nga zyrtari i lëndës janë:

- *Fillimisht shikohet nëse është ushtruar ankesa nga personi i autorizuar, apo nëse është parashtruar nga përfaqësuesi i palës a është bashkangjitur autorizimi për përfaqësim;*
- *A është ushtruar ankesa brenda afatit ligjor;*
- *Shqyrtohet kompetenca për të trajtuar lëndën.*

Me rastin e shqyrtimit të ankesës zyrtari shtjellon të gjitha dokumentet e lëndës, shqyrton vendimin e atakuar nëse është i bazuar, nëse janë aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe nëse është vërtetuar drejt gjendja faktike, shqyrtohen pretendimet e palës. Pas shtjellimit të të gjitha provave nxjerrët aktvendim lidhur me çështjen kontrstuese. Me rastin e nxjerrjes së aktvendimit SRV vendos në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

- a) *refuzon ankesën;*

- b) aprovon ankesën;
- c) aprovon pjesërisht ankesën;
- d) hudhë poshtë ankesën si të ushtruar jashtë afatit ligjor;
- e) hudhë poshtë ankesën si të ushtruar nga personi i paaautorizuar.

Aktvendimi nxjerrët në formën e përcaktuar nga LPA dhe përmban:

- Numrin identifikues të protokolit;
- Inicialet e zyrtarit që ka përgatitur aktvendimin;
- Preambulën apo pjesën hyrëse;
- Dispozitivin apo çështjen kryesore;
- Arsyetimi se si ka ardhur deri të mënyra e përshkruar në dispozitiv;
- Këshillën juridike dhe
- Datën dhe vendin e nxjerrjes së vendimit;
- Nënshkrimin e personit të autorizuar për të nxjerrë aktvendimin që është Udhëheqësi i Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve.

Aktvendimi përmban këshillën juridike, se pala ka të drejtë të ushtroj ankesë në GJTH-Departamentin për Çështje Administrative - Divizionin Fiskal, 30 ditë pasi që të pranoj aktvendimin.

SRV po ashtu shqyrton lëndët që kthehen në rivendosje dhe rishqyrtim nga GJTH për lëndët që ka vendosur me herët SRV dhe për të cilat pala ka ushtruar padi në GJTH, duke shqyrtuar vërejtjet e potencuara nga gjykata dhe sjellë aktvendim merititor.

Rasti i rivlerësimit të mallit doganor vijon si:

Me qëllim të zbatimit të legjislacionit doganor, çdo person i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në veprimtarinë e tregtisë së mallrave, duhet t'ia paraqes Doganës të gjitha dokumentet e kërkuara dhe të dhënat e nevojshme.

Kur një person kërkon që Dogana të merr një vendim në lidhje me aplikimin e legjislacionit doganor, ai person duhet të sigurojë të gjitha informatat dhe dokumentet që kërkohen nga Dogana, në mënyrë që të merret një vendim.

Një vendim i tillë do të merret dhe do të njoftohet kërkuesi në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Në rastet të kontestimit të vlerave të deklaruara nga ana e zyrove doganore apo në rast të marrjes së ndonjë vendimi nga ana e degëve apo Sektorëve, do të arsyetojnë bazën në të cilën mbështetet ai vendim dhe do t'iu njohin të drejtën për ankesë të paraparë sipas nenin 291 bazuar ne dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovës.

Në procedurën e zhdoganimit, rivlerësimi i mallit behet duke u bazuar në 6 metodat e vlerësimit.

Metoda 1 e Vlerësimit: *Dega Doganore e konteston vlerën e transaksionit të deklaruar (neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë).*

Metoda 2 e Vlerësimit: *Neni 34.2.a) Vlera e transaksionit të mallrave identike, Numri i DUD-it datë _____
Nuk kemi mallra identike brenda periudhës 90-ditë.*

Metoda 3 e Vlerësimit: *Neni 34.2.b) Vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme, Numri i ____
Nuk kemi mallra të ngjashme brenda periudhës 90-ditë.*

Metoda 4 e Vlerësimit: *Neni 34.2.c) Vlera e bazuar në çmimin për njësi Të cekën të dhënat e tregut në detale (cili treg është vizituar, cili çmim është vërtetuar, cilat shpenzime zbriten nga çmimi i tregut etj.).*

Metoda 5 e Vlerësimit: *Neni 34.2.d) Vlera e llogaritur Të cekën të dhënat e llogaritura të kostos për prodhimin e mallrave identike*

Metoda 6 e Vlerësimit: *Neni 35 Të dhënat e disponueshme Të cekën të dhënat e disponueshme në detale:*

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative aplikohen në procedurat, të cilat i zhvillon Dogana, vetëm nëse nuk është paraparë ndryshe me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Subjektet e pakënaqura me cilindo vendim të marr kanë të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të sjellë nga Dogana, e i cili ka të bëjë me aplikim e legjislacionit doganor, i cili ka të bëjë me atë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit ushtrohet pranë Doganës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit e cila dorëzohet në zyrën administrative, zyra administrative pas evidentimit në sistemin LEES të njëjtën e dërgon tek organi kompetente, i cili e trajton ankesën e subjektit (Sektori i Rishqyrtimit të Vendimeve).

Shembuj të ndryshëm të vendimeve për çështjet doganore:

Rasti-1 - hudhet poshtë ankesa.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

01.3.2.2/818

B.S.

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së subjektit në procedurë Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës së subjektit në procedurë *****, me numër personal të letërnjoftimit *****, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-***** të datës 12.10.2017 të ZBD Prishtinë, në vështrim të nenit 291 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109), i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-099, konform nenit 129, paragrafi 1.3, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr.05/L-031, sjell këtë;

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË - kërkesa e subjektit në procedurë *****, për rishqyrtimin vendimit për rishqyrtimin e vendimit nr. R-***** të datës 12.10.2017 të ZBD Prishtinë, si e ushtruar jashtë afatit ligjor.

A r s y e t i m

Spektori i Pranimit Qendror, subjektit në procedurë *****, i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratës Unike Doganore kontestuese, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së 6 (gjashtë) të vlerësimit, neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, katalogut përkatës schwacke.net.

Provë: Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Raporti i vlerësimit katalogu schwacke.net.

Subjekti në procedurë ***** me datë 30.11.2017 jashtë afatit ligjor ka parashtruar ankesë për rishqyrtimin e vendimit të lartcekur.

Lëndës i janë bashkangjitur: Kërkesa e subjektit e datës 30.11.2017, Deklarata Unike Doganore kontestuese, Procesverbali mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Raporti i vlerësimit – katalogu schwacke.net, Libreza e automjetit, Fotografitë e automjetit, Kopja e letërnjoftimit të subjektit, Certifikata e homologimit nga QAK.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesës së subjektit në procedurë pas shqyrtimit të pretendimeve të palës si dhe pas shqyrtimit të dokumenteve (provave) të bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se kërkesa është e ushtuar jashtë afatit ligjor për arsye se;

Gjatë shqyrtimit të lëndës, Dogana e Kosovës pasi ka bërë përlllogaritjen e ditëve kalendarike konstaton se kërkesa e bërë për rishqyrtimin e vendimit nr.R-***** të datës 12.10.2017 të ZBD Prishtinë, është e ushtuar jashtë afatit ligjor, pasi që vendimin e lartcekur, subjekti siç konfirmohet edhe nga raporti i vlerësimit e ka pranuar me datë 12.10.2017, kurse ankesën e ka dorëzuar pranë Zyrës Administrative në Drejtorinë Qendrore Prishtinë me datë 30.11.2017, andaj meqenëse subjekti konform nenit 291, paragrafi 2 të KDA-së ka pasur të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e aktvendimit të lartcekur brenda afatit prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit të vendimit, kurse subjekti ka parashtruar ankesën pas kalimit të këtij afati, sipas dispozitave të nenit 291, paragrafi 2 të KDA-së, andaj ankesa është e parashtruar jashtë afatit ligjor.

Në nenin e lartcekur është paraparë afati i ankesës prej 30 ditë nga dita e marrjes së vendimit, andaj meqenëse subjekti nuk ka parashtruar ankesë brenda këtij afati, atëherë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor.

Për këtë arsye konform nenit 129, paragrafi 1.3, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr.05/L-031 veprohet si në dispozitiv të aktvendimit, duke e hedhur poshtë kërkesën e palës si të ushtuar jashtë afatit ligjor.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përveç asaj që është thënë në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, datë: 11/Janar/2018

Drejtori Gjeneral

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek *Divizioni fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës* në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimimit të aktvendimit.

Aktvendimi nga një kopje për:

1. Palën në procedurë,
2. Shkresat e lëndës
3. Për arkivin
4. Për ZBD Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

01.3.2.2/2018

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së ***** i cili e përfaqëson subjektin në procedurë *****, me numër fiskal ***** dhe numër të biznesit ***** për rishqyrtimin e vendimit nr.R-*****/20.09.2017 të ZBD Prishtina 3, në vështrim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109) të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 neni 291 paragrafi 3) pika b) si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, sjell këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET - kërkesa e subjektit në procedurë *****, për rishqyrtimin e vendimeve nr.*****/20.09.2017 të ZBD Prishtina 3, si e bazuar.

II. LEJOHET – kthimi i mjeteve të paguara më tepër, subjektit në procedurë *****, në xhirlogarinë rrjedhëse ***** të evidentuar pranë ***** Bank, dhe atë:

Për Deklaratën Unike Doganore nr. R-5347/20.09.2017 në emër të:

Taksës Doganore 10%	= *****€
TVSH 18%	= *****€
Gjithsej	= *****€

A r s y e t i m

Zyra e Pranimit Qendror, subjektit në procedurë i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratave Unike Doganore (në tekstin e mëtejme DUD-i) të lartcekur, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme që Dogana e Kosovës disponon.

Provë: Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave.

Subjekti në procedurë përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor me datë 19.10.2017 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të lartcekur. Subjekti e atakon vendimin për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, të shkeljeve të dispozitave procedurale, të rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit. Në arsyetim subjekti thekson se me rastin e paraqitjes së mallit pranë ZBD Prishtinë me rastin e paraqitjes së mallit doganor për zhdoganim Deklaratës Doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet sipas nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 mbi implementimin e KDA-së. Të gjitha këto dokumente janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së transaksionit të kryer për mallin e blerë. Subjekti tutje thekson se Dogana e Kosovës nuk ka arritur të kontestoj asnjë nga dokumentet e bashkangjitura, të cilat dëshmojnë vlerën e transaksionit dhe në mënyrë arbitrare e ka rritur çmimin duke iu referuar përkatësisht metodës së 6 të vlerësimit të mallit. Subjekti thekson se zyra doganore në mënyrë të gabuar ka vlerësuar mallin me metodën e 6-të të vlerësimit të mallit, për arsye se nuk e ka arsyetuar anashkalimin e metodave të tjera të vlerësimit, pasi nuk mund të kalohet në metodat e tjera të vlerësimit të mallit pa kaluar nëpër metodat paraprake, si dhe zyra doganore nuk ka dhënë asnjë arsye se pse vlera e deklaruar e mallit nuk mund të pranohet si vlerë reale e saj përderisa malli lëndor është përcjellë me të gjithë dokumentacionin e kërkuar ligjërisht. Subjekti metutje thekson se zyra doganore në mënyrë paushalle ka vlerësuar mallin e paraqitur për zhdoganim duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, në bazë të dhënave të disponueshme në disa nga emërtimet në DUD-in kontestues, kjo do të thotë që në të njëjtin DUD për disa emërtime të mallit Dogana nuk e ka kontestuar vlerën e mallit ndërsa për disa të tjera ka caktuar bazë të re doganore. Subjekti pretendon se në bazë të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike zyra doganore ka aplikuar gabimisht dispozitat materiale dhe e ka detyruar ankuesin të paguajë taksë importuese më të larta sesa taksat reale që duhej të paguante realisht, ka shkelë dispozitat procedurale sepse nuk mund t'i kontestohet çmimi i mallit pa u dëshmuar jovaliditeti i dokumenteve të mallit si dhe ka bërë rivlerësimin e këtij malli doganor jashtë çdo kriteri duke e rivlerësuar mallin doganor kontestues disa herë më shumë sesa të njëjtin mall doganor të importuar më parë nga subjekti në procedurë. Subjekti potencon se rivlerësimi i mallit doganor i bërë në bazë të nenit 35.1 të KDA-së është i papabuar dhe në kundërshtim me nenin 35.2 pika g),

kjo nga fakti se në rastet kur zbatohet paragrafi 1 i nenit 35 asnjë vlerë doganore nuk mund të përcaktohet në bazë të vlerave arbitrare apo fiktive. Subjekti metutje thekson se për të verifikuar në mënyrë të saktë gjendjen faktike ka paraqitur edhe një kërkesë për kontroll paraprak të mallit dhe pas përfundimit në dy emërtime, në emërtimin 9 dhe 12 janë bërë disa ndryshime në sasinë e mallit dhe në emërtimin e tyre. Subjekti në fund kërkon që më rastin e shqyrtimit të kësaj çështje të marrë parasysh vlerën aktuale të mallit doganor dhe në bazë të kësaj gjendje faktike të marrë një vendim merititor.

Lëndës i janë bashkangjitur: Ankesa e subjektit, Deklarata Unike Doganore kontestuese, Faturat e mallit, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Kontrata e shitblerjes me eksportuesin, Transferi bankar, Deklarata eksportuese, Akgjykimet e Gjykatës Themelore, Faturat e shitjes së brendshme.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesës së subjektit në procedurë dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të palës si dhe pas shqyrtimit të dokumenteve (provave) të bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se kërkesa është e bazuar për arsye se,

Zyra e Pranimit nuk ka vepruar drejtë kur për Deklaratën Unike Doganore të lartcekur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, pasi që subjekti në procedurë në fazën e ankimit ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, kjo në kuptim të faktit se ka paraqitur faturën e mallit, kontratën e shitblerjes, deklaratën eksportuese dhe transferin bankar dhe të gjitha këto dokumente janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit. Po ashtu subjekti në procedurë për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit ka bashkangjitur edhe faturat e shitjes së brendshme.

Në këtë kuptim Zyra e Pranimit nuk ka vepruar drejtë kur gjatë rivlerësimit të mallit ka aplikuar metodën e gjashtë të vlerësimit, nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht duke u thirrë në çmimet e disponueshme nga moduli i vlerës, pasi që bazuar në analizat e realizuara në sistem vërehet se shumica e emërtimeve subjektit i pranohet vlera e transaksionit dhe vetëm disa prej tyre i kontestohen, sikurse janë evidentuar edhe raste kur për një artikull të caktuar njëherë i pranohet vlera e deklaruar dhe herën tjetër i kontestohet, po ashtu rivlerësimi nga zhdoganimet e mëhershme kryesisht bazohet në DUD-a të rivlerësuar, andaj pasi që Dogana e Kosovës ka analizuar këto fakte dhe pas analizimit të dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor si dhe dokumentacionit shtesë të cilin subjekti në procedurë e ka prezantuar se bashku me kërkesën për rishqyrtim për të vërtetuar se subjekti ankimor ka të kompletuar dokumentacionin lidhur me importin kontestues, konstaton se ky dokumentacion është i harmonizuar në kuptim të vlerës pasi që vlera faturale e deklaruar nga ana e subjektit në procedurë përputhet me vlerën e cila është paguar sipas transfereve bankare si edhe me deklaratën eksportuese dhe kontratën e shitblerjes.

Provë: Fatura e mallit, Transferi bankar, Deklarata eksportuese, Kontrata e shitblerjes, Faturat e shitjes së brendshme.

Dogana e Kosovës gjatë shqyrtimit të lëndës kontestuese, kemi pranuar nga subjekti edhe aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë për subjektet të tjera të njëjtëve pronar si ***** , përmes të cilave dëshmohet se malli me origjinë nga i njëjti shtet dërgues, dhe i njëjti eksportues nga GJTH i janë aprovuar ankesat, i është pranuar vlera e transaksionit, andaj në frymën e aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe faktit që subjekti në procedurë ka prezantuar në fazën e ankimit dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, pasi që ka paraqitur deklaratën eksportuese, faturën e mallit, transferin bankar dhe kontratën e shitblerjes me eksportuesin, në kuptim të nenit 33 të KDA-së subjektit i pranohet vlera e transaksionit.

Provë: Aktgjykimet e Gjykatës Themelore ** i datës 15.06.2017, ***** i datës 14.12.2017.***

Në vështrim nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, vlera e mallrave të importuara do të jetë vlera e transaksionit që do të thotë çmimi realisht i paguar ose që duhet të paguhet për mallrat që shiten për eksport drejtë Kosovës. Nuk është kontestuese se dokumentet në mbështetje të Deklaratës Unike Doganore të cilat kërkohen në vështrim të nenit 123 dhe nenit 92 të Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109)) i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 janë prezantuar në fazën e ankimit dhe janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit.

Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave (Nr.03/L-109), andaj aktvendimi sjellët në pajtim me nenin 33, respektivisht në bazë të vlerës së transaksionit që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.

Dogana e Kosovës pas shqyrtimit të provave dhe dokumentacionit të bashkangjitur lëndës një nga një dhe të gjitha se bashku, aprovon kërkesën e subjektit në procedurë si të bazuar, dhe lejon kthimin e mjeteve të paguara me tepër në emër të taksave doganore, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përveç asaj që është thënë në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, datë: 03/Nëntor/2017

Drejtorit Gjeneral

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Aktvendimi nga një kopje për:

1. Palën në procedurë,
2. Shkresat e lëndës
3. Për arkivin
4. Për Zyren Doganore
5. Për Sektorin e Financave
6. Për Departamentin e thesarit (MEF)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

01.3.2.2/***

X.Y.

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së subjektit në procedurë ***** , me numër fiskal ***** për rishqyrtimin e vendimeve nr.R-*****/24.08.2017 dhe R-*****/24.08.2017 të ZBD Merdare, në vështrim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109) të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 neni 291 paragrafi 3) pika b) si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, sjell këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET - kërkesa e subjektit në procedurë ***** , për rishqyrtimin e vendimeve nr. R-*****/24.08.2017 dhe R-*****/24.08.2017 të ZBD Merdare, si e bazuar.

A r s y e t i m

Zyra e Pranimit Qendror, subjektit në procedurë i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratave Unike Doganore (në tekstin e mëtejme DUD-i) të lartcekur, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme që Dogana e Kosovës disponon.

Provë: Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave.

Subjekti në procedurë brenda afatit ligjor me datë 04.09.2017 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e vendimeve të lartcekura. Subjekti thekson se me rastin e paraqitjes për zhdoganim të mallit të lartcekur edhe pse dokumentacioni përcjellës i mallit ka qenë i tëri origjinal dhe kontratat afatgjate me furnizuesin me sasi të madhe, në mendojmë se është bërë rritja e bazës doganore në mënyrë arbitrare duke mos u bazuar në fakte relevante po ashtu duke anashkaluar metodat e vlerësimit ku në proces kemi të cekur se nuk ka pasur importe të të njëjtit mall apo importues, ku kjo nuk qëndron duke pasur provë DUD-at me nr.R-*****/26.06.2017 dhe R-*****/15.08.2017 nga i njëjti importues dhe eksportues. Subjekti metutje thekson se pasi që oficerët doganor të shiqimit së bashku me Task Forcën kanë bërë shiqimin e mallit tek depo e importuesit dhe kanë konstatuar se malli është çdo gjë konform deklaramit, pro jo diçka me kualitativ që ishte dashur të merret parasysh vlera si dhe nga Zyra e Pranimit Qendror është pranuar çmimi i faturuar i mallit me dokumentet përcjellëse sipas deklaramit, metoda së parë të vlerësimit, është bërë pagesa e taksave doganore, pas 3 ditësh na është bërë rritja e bazës doganore, me ç' rast na është dërguar procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallit në e-mail ku përveç tjerash ceket se nuk kemi mallra të ngjashme brenda periudhës 90 ditë, i cili fakt nuk qëndron, si fakt lëndës i bashkangjesim DUD-in R-*****/26.06.2017 dhe R-*****/15.08.2017 të së njëjtës firmë të zhdoganuar në ZBD Prishtina 3. Subjekti metutje thekson se ne si importues kemi edhe importe të tjera të mallit tjetër dhe nuk kemi pasur problem apo rivlerësime të këtij lloji, ku po ashtu neve si importues na dëmton tregu i brendshëm, pasi që të gjitha llogaritë e mallit i kemi regjistruar dhe bërë shitjet e një pjese të mallit sipas çmimit fillestar, ndërsa tani na kanë lindur probleme tjera. Metutje subjekti thekson se duhet cekur faktin se në kontratën e bashkëpunimit midis palëve janë të cekura edhe çmimet e mallrave të cilat importohen, ku ajo kontratë kuptohet se është bërë për një kontingjent të mallit i cili pritet të realizohet sipas marrëveshjes së sasisë dhe çmimit ku normal si në të gjitha sferat e biznesit, sasia e mallit dhe kushte e përcaktojnë edhe koston e çmimit ku neve në rastin konkret si duket një mendim i pa bazë do të na e vështirëson realizimin e marrëveshjes me furnizuesin.

Lëndës i janë bashkangjitur: Ankesa e subjektit, Deklaratat Unike Doganore të lartcekura, Faturat e mallit, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Kontrata e shitblerjes me eksportuesin, Transferi bankar, Deklaratat Unike Doganore referente, Autorizimi, Mendimi i Sektorit të Vlerës nr.***** të datës 28.10.2016, Faturat e shitjes së brendshme.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesës së subjektit në procedurë dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të palës si dhe pas shqyrtimit të dokumenteve (provave) të bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se kërkesa është e bazuar për arsye se,

Inspektimi Pas Zhdoganimit nuk ka vepruar drejtë kur për Deklaratat Unike Doganore të lartcekura ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë,

pasi që vlera e mallit e deklaruar nga subjekti bazuar në zhdoganimet e mëhershme dhe pas importit kontestues të mallit të njëjtë dhe të ngjashëm nga i njëjti shtet i origjinës dhe dërgues, nga eksportuesi i njëjtë, i njëjti importues dhe importues tjetër, kanë vlerë edhe më të ulët se sa vlera e deklaruar nga subjekti.

Dogana e Kosovës konstaton se Inspektimi Pas Zhdoganimit nuk ka vepruar drejt kur me rastin e rivlerësimit të mallit lëndor kontestues, është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit- nenit 35 të KDA-së, duke u thirrur në mendimin e Sektorit të Vlerës nr.***** të datës 28.10.2016, pasi që siç vërehet në këtë mendim, si referencë për caktimin e vlerës së mallit për një DUD kontestues për të cilin është kërkuar mendimi i vlerës, janë marrë DUD-at R-*****/03.09.2016 dhe R-*****/03.09.2016, që për mallin lëndor kontestues të subjektit ankimor nuk mund të shërbej si referencë, pasi që kemi të bëjmë me përshkrim tjetër të mallit, nuk ka tipare të njëjta me mallin që është rivlerësuar, gjithnjë duke pasur parasysh se nga të dhënat e zhdoganimit të mallit të ngjashëm në një periudhë të afërt kohore, rezulton se vlera e njëjtë e mallit edhe vlera me e ulët është zhdoganuar sipas vlerë së transaksionit.

Provë: Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Mendimi i Sektorit të Vlerës nr. ** të datës 28.10.2016, Zhdoganimet e mallit të njëjtë DUD-at nr.R-*****/26.06.2017, R-*****/15.08.2017, R-*****/22.09.2017.***

Dogana e Kosovës me qëllim të trajtimit objektiv të rastit dhe përcaktimit të vlerës reale të mallit lëndor kontestues, kemi analizuar në sistemin COGNOS dhe ASYCUDA lidhur me zhdoganimet e mëhershme të mallit të njëjtë/ngjashëm, dhe prej analizave të kryera kemi vërejtur se malli i njëjtë është importuar edhe me parë nga i njëjti importues, nga i njëjti shtet i origjinës dhe i njëjti eksportues dhe i është pranuar vlera e transaksionit, po ashtu edhe tjetër importues që ka importuar prej të njëjtit eksportues, të njëjtit shtet të origjinës dhe shtet dërgues ka importuar mallin me çmime edhe më të ulëta se sa vlera e deklaruar nga subjekti, andaj në kuptim të këtyre fakteve konstatojmë se vlera e deklaruar nga subjekti paraqet vlerën reale të transaksionit.

Me qëllim të trajtimit objektiv të lëndës dhe forcimit të bindjes që vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve kemi kërkuar nga subjekti të ofroj dëshmi-fatura mbi shitjen në tregun e Kosovës të mallit të njëjtë nga ana e tyre dhe prej faturave të shitjes së brendshme të ofruara nga subjekti, kemi arritur të konkludojmë se çmimi i shitjes së mallit të njëjtë në tregun e brendshëm nga importuesi e dëshmon se vlera e deklaruar nga subjekti me rastin e importit të mallit lëndor kontestues është vlerë që përkon me çmimin e shitjes në tregun e brendshëm, duke pasur parasysh marzhën e fitimit që është minimale dhe shpenzimet e tjera, andaj konstatojmë se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit, po ashtu faturat e shitjes së brendshme mund t'i nënshtrohen procesit të verifikimit në ATK.

Provë: Fatura mbi shitjen e brendshme të mallit nr./26.08.2017, nr.121/17/****, nr*/26.08.2017, nr.126/****, nr.*/27.08.2017, nr.145/****, nr.*/16.09.2017, nr.155/****, nr.*/11.09.2017, nr.147/17/****, nr.*/30.08.2017, nr.128/17/****.*

Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave(Nr.03/L-109), andaj aktvendimi sjellët në pajtim me nenin 33, respektivisht në bazë të vlerës së transaksionit që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.

Dogana e Kosovës pas shqyrtimit të provave dhe dokumentacionit të bashkangjitur lëndës një nga një dhe të gjitha se bashku, aprovon kërkesën e subjektit në procedurë si të bazuar, duke e anuluar procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të Inspektimit Pas Zhdoganimit, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përveç asaj që është thënë në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, datë: 20/Tetor/2017

Drejtori Gjeneral

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ te Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit te aktvendimit.

Aktvendimi nga një kopje për:

1. Palën ne procedurë,
2. Shkresat e lëndës
3. Për arkivin
4. Për Zyren Doganore
5. Për Inspektimin Pas Zhdoganimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

01.3.2.2/**

X.Y.

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së ***** që e përfaqëson subjektin në procedurë *****, me numër të biznesit *****, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-*****/31.10.2017 të ZD Hani i Elezit, në vështrim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109) të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 neni 291 paragrafi 3) pika d) si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, sjell këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT - kërkesa e subjektit në procedurë *****, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-*****/31.10.2017 të ZD Hani i Elezit, si pjesërisht e bazuar.

II. LEJOHET - kthimi i mjeteve të paguara me tepër, subjektit në procedurë *****, në xhirologarinë rrjedhëse nr.***** të evidentuar pranë **** Bank, dhe atë:

1. **Për Deklaratën Unike Doganore nr.R-*****/31.10.2017 të ZD Hani i Elezit, në emër të:**

Taksës Doganore 10%	= *****€
<u>TVSH 18%</u>	<u>= *****€</u>
Gjithsej	= *****€

A r s y e t i m

Sektori i Pranimit Qendror subjektit në procedurë *****, i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratës Unike Doganore (në tekstin e mëtejme DUD-it) të lartcekur, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së 6-të (gjashtë) të vlerësimit nenit 35, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme Doganës së Kosovës.

Provë: Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave.

Subjekti në procedurë *****, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor me datë 17.11.2017 ka parashtruar ankesë kundër vendimit të lartcekur. Subjekti e atakon vendimin me pretendimin se është bërë shkelje e dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, vërtetimit i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, shkeljes e dispozitave të ligjit për procedurën administrative dhe aplikimit i gabuar i së drejtës materiale. Me rastin e deklarimit për doganim të këtij malli importuesi ka poseduar dhe prezantuar para zyrtarëve doganor të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për ta bërë bindëse vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit, gjithashtu kësaj anese i ka bashkangjitur dokumente të tjera për ta vërtetuar vlerën e mallit si: faturat e mallit, kontratën e shitblerjes së këtij malli, pagesën bankare në emër të mallit, mirëpo këto dokumente nuk janë marrë parasysh nga zyrtarët doganor të cilët kanë kontestuar vlerën e këtij malli dhe e kanë rivlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit, meqë rast është konstatuar se ky mall, duhet të rivlerësohet me një çmim shumë më të lartë se sa vlera reale. Tutje subjekti ankimor thekson se ekziston shkelja e dispozitave të KDA-së të Republikës së Kosovës nga ana e zyrtarëve doganor të ZBD Prishtinë, nga shkak se nuk është zbatuar në mënyrë adekuate dispozita ligjore përkatësisht neni 33 i tij, e cila parasheh se mallrat që importohen në Kosovë obligohen që taksat doganore ti paguajnë në bazë të vlerës së transaksionit, në rastet kur importuesi posedon dokumentet e mallit në bazë të së cilave mund të vërtetohet kjo vlerë. Me tutje subjekti ankimor thekson se ekziston shkelja e dispozitave ligjore të UA 11/2009 për implementimin e KDA-së përkatësisht dispozitave nga kapitulli 1 (nenet: 60-68) pasi që zyrtarët doganor pa dhënë asnjë sqarim dhe pa e bërë verifikimin e tyre nuk bëjnë pranimin e dokumenteve të transaksionit që ne e kemi prezantuar. Gjithashtu subjekti ankimor thekson se ekziston konstatim i gabuar i gjendjes faktike i cili qëndron në mënyrën se si është përcaktuar vlera e këtij malli duke mos i marrë parasysh dokumentet e tij e pastaj duke u thirrur në shënime referente jo adekuate për mallin pa asnjë bazë faktike dhe ligjore përcaktohet një bazë doganore më e madhe me qëllimin e vetëm për marrjen e taksave shtesë. Subjekti thekson se vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike qëndron edhe në përdorimin e referencave nga ana e zyrtarëve doganor me rastin e rivlerësimit. Ata nuk kanë pasur referenca adekuate për këtë lloj malli, nuk janë marrë parasysh kushte e transaksionit krahasues që kanë të bëjnë me sasinë e mallit, cilësinë dhe kushte të tjera që

determinojnë çmimin e mallrave. Subjekti metutje thekson se ekziston edhe shkelja e rregullave të procedurës administrative përkatësisht parimin e ligjshmërisë, për faktin se ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave të importuara, pastaj edhe parimin e objektivitetit dhe të paanësisë pasi që nuk ka shqyrtuar në mënyrë objektive dokumentet shoqëruese të mallit. Subjekti në fund propozon që pas shqyrtimit të argumenteve të prezantuara të sjellët aktvendim përmes së cilit do të aprovohet ankesa si e bazuar, të bëhet pranimit i dokumenteve dhe të lejohet kthimi i mjeteve të paguara me tepër në emër të taksave doganore. Subjekti në fund propozon që të sjellët aktvendim përmes së cilit do të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të lejohet kthimi i mjeteve të paguara me tepër në emër të taksave.

Lëndës i janë bashkangjitur: Kërkesa e subjektit ankimor, Deklarata Unike Doganore, Fatura përcjellëse e mallit, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Transferi bankar, Kontrata e shitblerjes, Transferi bankar, Referenca e Sektorit të Pranimit, Të dhënat e disponueshme – dosja e vlerave, Autorizimi.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesës së subjektit në procedurë, pas shqyrtimit të pretendimeve të palës si dhe shqyrtimit të provave të bashkangjitura në lëndë, ka konstatuar se kërkesa është pjesërisht e bazuar për arsye se;

Spektori i Pranimit Qendror ka vepruar pjesërisht drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim me anë të DUD-at të lartcekur, pasi që vlera e mallit të deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për t'u paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Sa i përket fakteve në të cilën është bazuar Spektori i Pranimit Qendror gjatë vlerësimit të mallit kontestues, Dogana e Kosovës konstaton se nuk ka vepruar drejtë kur ka rivlerësuar mallin, duke u bazuar në zhdoganimet e mëhershme të mallit të ngjashëm nga importet e importuesve të tjerë nga i njëjti shtet i origjinës dhe dërgues, por që përshkrimi i mallit dallon nga malli lëndor kontestues, po ashtu edhe numri tarifor nuk është i njëjtë, përbërja e materialit është e ndryshme, andaj në këtë kuptim vlera e marrë si referencë nuk është e qëndrueshme për mallin e rivlerësuar.

Andaj Dogana e Kosovës me qëllim të shqyrtimit objektiv të çështjes kontestuese ka hulumtuar në sistemin COGNOS dhe ASYCUDA, prej nga është konstatuar se në vitin 2017 ekziston vetëm edhe një import tjetër i mallit të ngjashëm, nga i njëjti shtet eksportues dhe i origjinës, por që edhe ai mall është rivlerësuar me vlerë më të ulët se sa vlera që i është caktuar mallit lëndor kontestues. Po ashtu me qëllim të përcaktimit të vlerës reale të mallit lëndor kemi analizuar edhe të dhëna të tjera të disponueshme, si të dhënat nga dosja e vlerave për mallin e ngjashëm, të dhëna të cilat vendosen nga Spektori i Vlerës (sektor profesional për vlerësimin e mallrave), të cilët përcaktimin e

vlerës së mallit e bëjnë duke u bazuar në të dhënat nga zhdoganimet e rregullta nëpër zyre doganore dhe të dhënat për vlerën e mallit të ngjashëm në treg, andaj është konstatuar se vlera e mallit duhet të caktohet sipas dosjes së vlerave, pasi që përshkrimi i mallit përkon me karakteristikat e mallit lëndor kontestues.

Provë: Të dhënat e disponueshme – dosja e vlerave ID ***.

Nuk është kontestuese se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacion për të provuar se vlera e deklaruar është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme pasi që Dogana e Kosovës disponon me të dhëna të tjera nga ato të deklaruara nga subjekti në procedurë, pra në këtë kuptim Dogana e Kosovës lidhur me mallin lëndor ka bërë analiza të çmimeve duke konkluduar se çmimet e prezantuara nga subjekti nuk mund të pranohen si reale, andaj ka caktuar vlerë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme – të dhënat nga dosja e vlerave për mallin e ngjashëm.

Sa i përket pretendimit të subjektit se me rastin e deklarimit për doganim të këtij malli importuesi ka poseduar dhe prezantuar para zyrtarëve doganor të gjitha dokumentet obligative për deklarimin e mallit dhe të tjera të nevojshme për ta bërë bindëse vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit, gjithashtu kësaj ankese i ka bashkangjitur dokumente të tjera për ta vërtetuar vlerën e mallit si: faturat e mallit, kontratën e shitblerjes së këtij malli, pagesën bankare në emër të mallit, mirëpo këto dokumente nuk janë marrë parasysh nga zyrtarët doganor të cilët kanë kontestuar vlerën e këtij malli dhe e kanë rivlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit, meqë rast është konstatuar se ky mall duhet të rivlerësohet me një çmim shumë më të lartë se sa vlera reale, Dogana e Kosovës konstaton se, edhe pse subjekti ka prezantuar dokumentacion për të tentuar të dëshmojë vlerën e transaksionit, Dogana e Kosovës nuk ka mundur të marrë parasysh dokumentacionin e prezantuar, pasi që Dogana disponon me të dhëna se subjekti ka prezantuar vlerën e mallit dukshëm më të ulët se sa vlera reale e mallit bazuar në të dhënat e disponueshme, andaj në këtë kuptim vlera e mallit caktohet duke u bazuar në dosjen e vlerave – ID ***.

Sa i përket pretendimit të subjektit se ekziston konstatim i gabuar i gjendjes faktike i cili qëndron në mënyrën se si është përcaktuar vlera e këtij malli duke mos i marrë parasysh dokumentet e tij e pastaj duke u thirrur në shënime referente jo adekuate për mallin pa asnjë bazë faktike dhe ligjore përcaktohet një bazë doganore më e madhe me qëllimin e vetëm për marrjen e taksave shtesë, Dogana e Kosovës konstaton se janë pjesërisht të qëndrueshme, pasi që dokumentacioni nuk ka mundur të merret parasysh, pasi që vlera e deklaruar është më e ulët se sa vlera reale e mallit të ngjashëm, por që është evidente që Sektori i Pranimit ka përdorura referenca të gabuara për të caktuar vlerën e mallit, andaj vlera e mallit caktohet bazuar në të dhënat e disponueshme nga dosja e vlerave.

Provë: Të dhënat e disponueshme për mallin e ngjashëm- dosja e vlerave ID.***

Për këtë arsye Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli lëndor nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 paragrafi (1) respektivisht sipas vlerës së transaksionit, andaj aktvendimi sjellët në pajtim me nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme, në këtë kuptim aprovohet kërkesa e subjektit si pjesërisht e bazuar dhe lejohet kthimi i mjeteve të paguara me tepër në emër të taksave doganore, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përveç asaj që është thënë në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, datë: 28/Dhjetor/2017

Drejtori Gjeneral

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Aktvendimi nga një kopje për:

1. Palën në procedurë,
2. Shkresat e lëndës
3. Për arkivin
4. Për Zyren Doganore
5. Për Sektorin e Financave
6. Për Departamentin e thesarit (MEF)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

01.3.2.2/870

B.S.

Dogana e Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së ***** i cili e përfaqëson subjektin në procedurë *****, me numër fiskal *****, për rishqyrtimin e vendimeve nr.R-*****/06.12.2017, R-*****/16.12.2017 të ZBD Prishtinë, në vështrim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 neni 291 paragrafi 3) pika a), si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, sjell këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET - kërkesat e subjektit në procedurë “Bekimi Commerce” – Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve nr.R-*****/06.12.2017, R-*****/16.12.2017 të ZBD Prishtinë, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Sektori i Pranimit Qendror, me datat e cekura si në Deklaratat Unike Doganore (në tekstin e mëtejme DUD-at) të lartcekura, subjektin në procedurë ***** i kanë kontestuar vlerën e deklaruar duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave kanë cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së 6-të të vlerësimit, nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht të dhënave të disponueshme, që në rastin konkret

janë marrë të dhënat nga bursa për këtë lloj të mallit, si dhe janë inkorporuar shpenzimet e transportit në bazën doganore konform UA 06/2015.

Provë: Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallit.

Subjekti në procedurë përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor me datë 22.12.2017 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimeve të lartcekura. Subjekti e atakon vendimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KDA-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, dhe rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit. Në arsyetim subjekti thekson se me rastin e paraqitjes së mallit pranë ZBD Prishtinë me rastin e paraqitjes së mallit doganor për zhdoganim Deklaratës Doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit, të cilat kërkohen si dokumente që duhet të bashkangjiten deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë. Subjekti tutje thekson se Dogana e Kosovës nuk ka arritur të kontestoj asnjë nga dokumentet e bashkangjitura, sepse nga këto dokumente mund të konstatohej se malli doganor është blerë sipas vlerës së faturës, të cilën rrethanë e vërtetojnë urdhërpagesa ndërkombëtare, fatura e shitblerjes për çdo ngarkesë. Subjekti thekson se Dogana nuk ka marrë parasysh dokumentet e bashkangjitura por ka rivlerësuar mallin duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit dhe ky vlerësim është në kundërshtim me nenin 34.1 të KDA-së, kjo për faktin se vlera e mallit mund të rivlerësohet vetëm në rastin kur vlera e tij nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33 – vlerës së transaksionit, se në rastin konkret të gjitha dokumentet e mallit e sidomos transaksionet bankare janë bazë e mjaftueshme për të përcaktuar vlerën e mallit sipas nenit 33 të KDA-së dhe se neni 34, pika b) në këtë rast nuk mund të aplikohet. Subjekti metutje thekson se sipas dispozitave të KDA-së me rastin e përcaktimit të çmimit duhet pasur parasysh dallimet që shfaqen me nivelet komerciale, nivelet sasiore, kualitetin, e të cilat elemente nuk i ka respektuar Dogana e Kosovës kur ka rivlerësuar mallin doganor ashtu si është paraparë në nenin 34, pika b) të KDA-së, ngase ky lloj i mallit ka çmime të ndryshme varësisht nga kualiteti dhe varësisht nga ndryshimet e tij në bursën ndërkombëtare. Subjekti pretendon se në bazë të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike zyra doganore ka aplikuar gabimisht dispozitat materiale dhe e ka detyruar ankuesin të paguajë taksa importuese më të larta sesa taksat reale që duhej të paguante realisht, ka shkelë dispozitat procedurale sepse nuk mund t'i kontestohet çmimi i mallit pa u dëshmuar jovaliditeti i dokumenteve të mallit. Subjekti metutje thekson se rritjen e gabuar të vlerës së mallit gjatë zhdoganimit të mallit sipas DUD-ave kontestues e vërteton edhe fakti se subjekti në procedurë ka importuar të njëjtin mall nga i njëjti eksportues me të njëjtin numër tarifor dhe Dogana nuk e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit dhe se për mallin e deklaruar përmes DUD-it nr.R-*****/19.09.2017 dhe R-*****/19.09.2017 i deklaruar me çmim 1,750.00€ për ton nuk është kontestuar fare edhe se pse edhe DUD-at pasues kanë pasur të njëjtat dokumente sikurse DUD-it të cilit nuk i është kontestuar vlera e transaksionit. Subjekti metutje thekson se vlen të theksohet se fakti që subjekti në procedurë pasi ka pasur të

njëtin problem me rivlerësimin e mallit gjatë procedurës së zhdoganimit me Doganën e Kosovës i ka ndjekur të gjitha hapat ligjore dhe GJTH ka vendosur në favor të subjektit, po ashtu edhe Dogana ka zbatuar aktgjykimin e Gjykatës dhe i ka kthyer subjektit në procedurë mjetet monetare të paguara me tepër gjatë zhdoganimit të mallit të njëjti si edhe në rastin konkret (provë:aktgjykimi i GJTH A.nr.*****). Subjekti propozon që të sjellët aktvendim përmes së cilit të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të lejohet kthimi i mjeteve të paguara me tepër në emër të taksave doganore.

Lëndës i janë bashkangjitur: Kërkesat e subjektit në procedurë, Deklaratat Unike Doganore kontestuese, Faturat e mallit, Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Transferet bankare, Kontrata e shitblerjes, Deklaratat e tranzitit, Zhdoganimet e mëhershme, Dosja e vlerave ID1022, Të dhënat e Reuters për vlerën e mallit në bursë.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesave së subjektit në procedurë dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të palës si dhe pas shqyrtimit të dokumenteve (provave) të bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se kërkesat janë të pa bazuara, për arsye se,

Spektori i Pranimit Qendror kanë vepruar drejtë kur kanë kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për t'u paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Spektori i Pranimit Qendror kanë vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit lëndor kontestues është bazuar në metodën e 6-të të vlerësimit, nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, pasi që këto të dhëna janë vlerësim i cili është bërë duke i shfrytëzuar, referencat të cilat janë marrë nga dosja e vlerave, përkatësisht çmimet e marra nga Reuters si çmime të bursës në kohën e blerjes së mallrave.

Provë: Të dhënat e Sektorit të Vlerës nga bursa "Reuters" për mallin "Rio Minas 15/16 dhe 17/18, Dosja e vlerave ID1022.

Dogana e Kosovës me qëllim të marrjes së një vendimi të drejtë, duke i marrë parasysh edhe pretendimet e subjektit ankimor, ka hulumtuar dhe analizuar në sistemin Cognos dhe ASYCUDA, dhe ka konstatuar se kemi importe tjera nga importues të tjerë për mallin e njëjtë dhe të ngjashëm të zhdoganuar në periudhë të afërt kohore me mallin lëndorë kontestues, me origjinë të njëjtë, me kod tarifor të njëjtë, me emërtim të mallit të njëjtë, pra që kanë të gjitha karakteristikat e njëjta të llojit të mallit dhe që vlera e këtij malli është shumë më e lartë se sa vlera e mallit kontestues dhe vlera nga bursa, andaj edhe vijmë në përfundim se nuk qëndron pretendimi i subjektit ankimor se vlera

e mallit kontestues është vlerë reale, pasi që kemi zhdoganime me mall të njëjtë por me vlerë më të lartë të transaksionit.

Provë: Zhdoganimet e mallit të ngjashëm R-*/03.10.2017, R-****/03.10.2017, R-****/21.10.2017, R-****/11.11.2017, R-****/18.11.2017, R-****/18.11.2017, R-****/23.11.2017, R-****/24.11.2017.***

Nuk është kontestuese se subjekti në procedurë ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në procedurën e administrimit të provave, dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme, pasi që nuk ka ofruar deklaratën eksportuese por vetëm deklaratën e tranzitit, andaj një vlerë e tillë si është deklaruar nga subjekti është e papranueshme për arsye se Dogana disponon me të dhëna që vlera e mallit lëndor kontestues është më e lartë se sa vlera e deklaruar nga subjekti, andaj ka caktuar vlerë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme.

Sa i përket pretendimit të subjektit se me rastin e paraqitjes së mallit pranë ZBD Prishtinë me rastin e paraqitjes së mallit doganor për zhdoganim Deklaratës Doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit, të cilat kërkohen si dokumente që duhet të bashkangjiten deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë. Subjekti tutje thekson se Dogana e Kosovës nuk ka arritur të kontestoj asnjë nga dokumentet e bashkangjitura, sepse nga këto dokumente mund të konstatohej se malli doganor është blerë sipas vlerës së faturës, të cilën rrethanë e vërtetojnë urdhërpagesa ndërkombëtare, fatura e shitblerjes për çdo ngarkesë, Dogana e Kosovës konstaton se janë të paqëndrueshme, pasi që, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit.

Sa i përket pretendimit të subjektit se rritjen e gabuar të vlerës së mallit gjatë zhdoganimit të mallit sipas DUD-ave kontestues e vërteton edhe fakti se, subjekti në procedurë ka importuar të njëjtin mall nga i njëjti eksportues me të njëjtin numër tarifor dhe Dogana nuk e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit dhe se për mallin e deklaruar përmes DUD-it nr.R-*****/19.09.2017 dhe R-*****/19.09.2017 i deklaruar me çmim 1,750.00€ për ton nuk është kontestuar fare edhe se pse edhe DUD-at pasues kanë pasur të njëjtat dokumente sikurse DUD-it të cilit nuk i është kontestuar vlera e transaksionit, Dogana e Kosovës i bënë me dije subjektit, se deri tek rivlerësimi i mallit ka ardhur pasi që Dogana e Kosovës ka ardhur në disponim të të dhënave të cilat nuk i kishte në momentin e zhdoganimit të DUD-ave të potencuar, pra deri në atë kohë Sektori i Vlerës nuk i kishte të dhënat e bursës për këtë lloj të mallit, por Dogana e Kosovës përmes mekanizmave përkatës ka mundësi që edhe pasi që malli të del nga mbikëqyrja doganore konform nenit 82.3 lidhur me nenin 219, paragrafi 3 të KDA-së, të bëj kontrollimin e deklaratave doganore bazuar në rastet kur gjenden të dhëna të reja mbi zhdoganimin e mallrave.

Sa i përket pretendimit të subjektit se sipas dispozitave të KDA-së me rastin e përcaktimit të çmimit duhet pasur parasysh dallimet që shfaqen me nivelet komerciale, nivelet sasiore, kualitetin, e të cilat elemente nuk i ka respektuar Dogana e Kosovës kur ka rivlerësuar mallin doganor ashtu si është paraparë në nenin 34, pika b) të KDA-së, ngase ky lloj i mallit ka çmime të ndryshme varësisht nga kualiteti dhe varësisht nga ndryshimet e tij në bursën ndërkombëtare, Dogana e Kosovës konstaton se janë të paqëndrueshme, pasi që, rivlerësimi i mallit është bërë duke u bazuar në çmimet e bursës, e që çmimi i bursës është çmim i shumicës për të njëjtin lloj të mallit dhe për nivele komerciale më të larta, andaj në rastin konkret Sektori i Pranimit dhe Inspektimit Pas Zhdoganimit, ka vepruar drejt kur ka rivlerësuar mallin duke u bazuar në të dhënat e disponueshme, dosjen e vlerave-çmimet e bursës, po ashtu nëse krahasohen zhdoganimet e mallit të ngjashëm nga importuesi malli i tillë është duke u importuar me vlerë edhe më të lartë se sa vlera e caktuar nga Sektori i Pranimit dhe Sektori i Inspektimit Pas Zhdoganimit.

Provë: Të dhënat e Sektorit të Vlerës nga bursa “Reuters” për mallin “Rio Minas 15/16 dhe 17/18.

Sa i përket pretendimit të subjektit se vlen të theksohet se fakti që subjekti në procedurë pasi ka pasur të njëjtin problem me rivlerësimin e mallit gjatë procedurës së zhdoganimit me Doganën e Kosovës i ka ndjekur të gjitha hapat ligjore dhe GjTH ka vendosur në favor të subjektit, po ashtu edhe Dogana ka zbatuar aktgjykimin e Gjykatës dhe i ka kthyer subjektit në procedurë mjetet monetare të paguara me tepër gjatë zhdoganimit të mallit të njëjti si edhe në rastin konkret, Dogana e Kosovës konstaton se janë të paqëndrueshme, pasi që pavarësisht faktit që subjekti me herët i është aprovuar kërkesa bazuar në të dhënat dhe provat për atë lëndë, duhet pasur parasysh që kemi të bëjmë me mall që është në bursë dhe që çmimi i këtij lloji të mallit lëvizë në bursë, andaj në rastin konkret kemi të dhëna të sakta që vlera e mallit nuk është ajo që është deklaruar nga subjekti, meqenëse çmimi në bursë për këtë lloj të mallit është dukshëm më i lartë se sa ai që është deklaruar nga subjekti.

Për këtë arsye Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesave me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 dhe nenit 34 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109), andaj aktvendimi sjellët në pajtim me nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Në këtë kuptim Dogana e Kosovës konstaton se në rastin konkret nuk mund të veprohet sipas kërkesës së subjektit ankimor, andaj Dogana e Kosovës ka bërë rivlerësimin e provave konform nenit 89 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Dogana e Kosovës pas shqyrtimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, ka ardhur në përfundim se kërkesa e subjektit ankimor është e pa bazuar, andaj kërkesa e subjektit refuzohet si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përveç asaj që është thënë në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, datë: 17/Janar/2018

Drejtori Gjeneral

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Aktvendimi nga një kopje për:

1. Palën në procedurë,
2. Shkresat e lëndës
3. Për arkivin
4. Për Zyren Doganore



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

01.3.2.2/757

B.S.

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës së subjektit në procedurë ***** , me nr.fiskal ***** për rishqyrtimin e vendimit nr.***** të datës 23.10.2017 i Sektorit për Kundërvajtje Doganore, në vështrim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 neni 291 paragrafi 3) pika a), si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, sjell këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET - kërkesa e subjektit në procedurë ***** , të ushtruar ndaj aktvendimit nr.***** të datës 23.10.2017 i Sektorit për Kundërvajtje Doganore, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Procedura e kundërvajtjes ndaj subjektit ***** është iniciuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, me anë të procesverbalit nr. ***** te datës 23.10.2017, për shkak se zyrtarë nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe Shënimit të Brendshëm ***** , kanë kontrolluar importin e subjektit të lartcekur të deklaruar me anë të DUD-it nr.R-*****/dt.11.11.2016 në ZBD Prishtinë dhe kanë verifikuar se mallin “Automjet special për bartjen e makinave“ ka deklaruar në kod tarifor 8705 9080, i cili kod mallin e liron nga taksë e doganës 10%, ndërsa është dashur të deklarohet në kod 8704 2139

00 dhe duhet të paguaj taksat doganore 10%, ku me këtë veprim i është shmangur taksave doganore në vlerë 1,640.20€, pra ka vepruar në këtë mënyrë me qëllim që të paguaj takse doganore në vlerë më të vogël nga ajo realja duke kryer kundërvajtje nga neni 276, pika k) të KDA-së, andaj Sektori për Kundërvajtje Doganore subjektin e ka shpallur përgjegjës dhe e ka dënuar me gjobë në të holla në shumë prej 500.00€.

Provë: Aktvendimi nr.** i datës 23.10.2017 të Sektorit për Kundërvajtje Doganore.***

Subjekti në procedurë ***** brenda afatit ligjor me datë 07.11.2017 ka parashtruar ankesë për rishqyrtimin e aktvendimit të lartcekur. Subjekti ankimor e konteston vendimin për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të ligjeve materiale. Subjekti thekson se organi i shkallës së parë përmes aktvendimit të atakuar në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë ka bërë konstatimin e gjendjes faktike në dëm të ankuesit, kinse me rastin e zhdoganimit të mallit “automjeti special për bartjen e makinave” kinse e paskemi deklaruar në kodin tarifor 8705 9080 e i cili kod e liron nga taksa e doganës 10%, e ndërsa qenka dashur të deklarohet në kod 8704 2139 00 dhe duhet të paguaj taksat doganore 10% dhe se me këtë veprim kinse i jemi shmangur taksave doganore në vlerë prej 1,640.20€. Subjekti metutje thekson se organi i shkallës së parë nuk ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e karakteristikave, ka ardhur deri te një vendim i padrejtë dhe jo i saktë, pasi që automjeti i zhdoganuar është automjet me tipare dhe veçori speciale i cili si i tillë është zhdoganuar. Subjekti metutje thekson se ky kategorizim është i aprovuar nga vet personeli i juaj duke e aplikuar një procedurë standarde për zhdoganimin e atyre automjeteve për tipare dhe karakteristika të tilla, karakteristikë specifike e këtij automjeti special që e bënë special në raport me automjetet e tjera është se i njëjti është special nga fakti se bënë tërheqjen e veturave të avarisë pra është “kamionë për avari e i cili automjet më të drejtë është përfshirë në kodin tarifor 8705 9080 dhe se i njëjti dallohet si për nga pamja ashtu edhe për nga karakteristikat dhe destinimi si automjet-kamion për avari. Subjekti metutje thekson se nga arsyetimi i aktvendimit të atakuar, askund nuk cekën karakteristikat dhe arsyet se pse ky automjet nuk qenka automjet special, por organi i shkallës së parë ka mjaftuar me deklarime paushallë, të pabazuara në fakte dhe prova dhe me deklarim të përgjithshëm kinse në kemi vepruar në këtë mënyrë me qëllim që të paguaj taksë doganore në vlerë më të vogël dhe ky është një konstatim i paarsyetuar në mungesë të bazës dhe arsyeve nuk mund të pranohet si arsyetim i aktvendimit, ngase automjeti i zhdoganuar me kodin tarifor 8705 9080 i ka të gjitha tiparet, veçoritë dhe karakteristikat specifike që e dallojnë nga mjetet e rëndomta transportuese, ngase i njëjti është i destinuar me destinim special për avazin në rrugë. Subjekti propozon që Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve të sjellë aktvendim përmes së cilit do të aprovon ankesën si të bazuar, të anulon aktvendimin kontestues dhe subjekti të lirohet nga pagesa sipas aktvendimit të kontestuar.

Lëndës i janë bashkangjitur: Ankesa nga subjekti në procedurë, Aktvendimi nr.03.1.7-***** i datës 23.10.2017 i Sektorit për Kundërvajtje Doganore, Procesverbali mbi kundërvajtjen doganore, nr. 03.1.7-*****/1 i datës 23.10.2017, Mendimi i Sektorit të Tarifës *****/25.09.2017, Deklarata Unike Doganore kontestuese.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesës së subjektit *****, për rishqyrtim të ushtruar ndaj aktvendimit të Sektorit për Kundërvajtje Doganore, shqyrtoi pretendimet ankimore të palës dhe të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, duke ardhur në përfundim se kërkesa e palës është e pa bazuar për arsye se;

Sektori për Kundërvajtje Doganore ka vepruar drejtë kur subjektin në procedurë e ka shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore dhe e ka dënuar me gjobë në të holla në vlerë prej 500.00€, pasi që subjekti në procedurë është konstatuar se ka bërë deklaram të pasaktë të numrit tarifor të mallit lëndor, që ka rezultuar me shmangie nga pagesa e taksave doganore, bazuar në mendimin e Sektorit të Tarifës (sektor profesional për klasifikimin tarifor të mallrave), andaj duke vepruar në këtë mënyrë subjekti ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 276, pika k) të KDA-së, ku parashihet;

Personi fizik apo juridik, në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5,000.00) deri në dhjetëmijë (10,000.00)€, bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr.04/L-099 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave sipas të cilit për të gjitha shkeljet e parapara në nenin 276 do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëqind deri në 10,000.00€.

Dogana e Kosovës konstaton se deri tek një vendim i tillë për shpalljen e subjektit përgjegjës për kundërvajtje doganore ka ardhur bazuar në mendimin e Sektorit të Tarifës 04.1.2 nr.*****, ku është cekur se klasifikimi tarifor i mallrave në nomenklaturën e mallrave në TARIK përcaktohet sipas rregullave të përgjithshme për interpretim të nomenklaturës së mallrave, siç është publikuar në nomenklaturën e kombinuar të Unionit Evropian, shënimet shtesë të TARIK-ut që përbëhen nga shënimet sqaruese të sistemit të harmonizuar të organizatës botërore të Doganave dhe të shënimeve sqaruese për nomenklaturën e kombinuar të Unionit Evropian. Po ashtu në mendimet për klasifikim tarifor ceket se bazuar në rregullat gjeneralë 1 deri 6 mbi klasifikimin e mallrave për qëllime ligjore klasifikimi tarifor përcaktohet në përputhje me kushtet e krerëve dhe shënimeve të ndonjë seksioni apo kapitulli përkatës me kusht që të tillë krerë ose shënime nuk specifikohen ndryshe.

Sektori i Tarifës në mendimet mbi klasifikimin tarifor ka cekur se: pas shqyrtimit dhe analizimit të lëndës bazuar në dokumentacionin përcjellës të lëndës, fotove të bashkangjitura në lëndë, shënimeve sqaruese për krerët 8704 dhe 8705, Sektori i Tarifës konstaton se në rastin konkret deklarimi në kreun 8705 si mjetet transporti special, nuk janë të duhura pasi që kemi të bëjmë me automjetet për qëllime transporti të cilat nuk kanë të integruar pajisje tjera të posaçme të cilat do të mundësonin kryerjen e funksioneve të tjera përpos atyre të transportit, andaj klasifikimi i duhur i këtyre automjeteve është në numrin tarifor 8704 2139 00. Andaj ky klasifikim bazohet në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK-ut-2015, e në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit XVII, kapitullit 87 dhe të krerëve 8704 dhe 8705, fotografive të dërguara, shpjegimeve plotësuese, informatave të tjera.

Provë: Mendimi mbi klasifikimin tarifor i Sektorit të Tarifës nr.** i datës 25.09.2017.***

Sa i përket pretendimit të subjektit se organi i shkallës së parë nuk ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e karakteristikave, ka ardhur deri te një vendim i padrejtë dhe jo i saktë, pasi që automjeti i zhdoganuar është automjet me tipare dhe veçori speciale i cili si i tillë është zhdoganuar, se ky kategorizim është i aprovuar nga vet personeli i juaj duke e aplikuar një procedurë standarde për zhdoganimin e atyre automjeteve për tipare dhe karakteristika të tilla, karakteristike specifike e këtij automjeti special që e bënë special në raport me automjetet e tjera është se i njëjti është special nga fakti se bënë tërheqjen e veturave të avarisë pra është “kamionë për avari e i cili automjet më të drejtë është përfshirë në kodin tarifor 8705 9080 dhe se i njëjti dallohet si për nga pamja ashtu edhe për nga karakteristikat dhe destinimi si automjet-kamion për avari, Dogana e Kosovës konstaton se janë të paqëndrueshme, pasi që, konstatimi se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë numrin tarifor për mallin lëndor e ka bërë Sektori i Tarifës (sektor profesional për klasifikimin tarifor të mallrave), dhe se pavarësisht faktit që me rastin e zhdoganimit të këtij malli ai është zhdoganuar si është deklaruar, Dogana e Kosovës përmes mekanizmave përkatës ka mundësi që edhe pasi që malli të del nga mbikëqyrja doganore konform nenit 82.3 lidhur me nenin 219, paragrafi 3 të KDA-së, të bëjë kontrollimin e deklaratave doganore bazuar në rastet kur gjenden të dhëna të reja mbi zhdoganimin e mallrave, në këtë rast shkresat dhe mendimet mbi klasifikimin tarifor të mallit i Sektorit të Tarifës, ka të drejtë të bëjë rregullimin e situatës deri në tri vite prapa zhdoganimit të mallit duke obliguar subjektet pagesës së taksave shtesë, andaj në rastin konkret të dhënat mbi deklarimin e pasaktë të numrit tarifor janë proceduar nga Sektori për Kontroll Pas Importuese tek Sektori për Kundërvajtje, prej me të drejtë është konstatuar se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë të numrit tarifor, andaj ka konsumuar kundërvajtjen doganore nga neni 276, pika k) të KDA-së.

Sa i përket pretendimit të subjektit se nga arsyetimi i aktvendimit të atakuar, askund nuk ceken karakteristikat dhe arsyet se pse ky automjet nuk qenka automjet special, por organi i shkallës së parë ka mjaftuar me deklarime paushallë, të pabazuara në fakte dhe

prova dhe me deklaram të përgjithshëm kinse ne kemi vepruar në këtë mënyrë me qëllim që të paguaj taksë doganore në vlerë më të vogël dhe ky është një konstatim i paarsyetuar në mungesë të bazës dhe arsyeve nuk mund të pranohet si arsyetim i aktvendimit, ngase automjeti i zhdoganuar me kodin tarifor 8705 9080 i ka të gjitha tiparet, veçoritë dhe karakteristikat specifike që e dallojnë nga mjetet e rëndomta transportuese, ngase i njëjti është i destinuar me destinim special për avazin në rrugë, Dogana e Kosovës konstaton se janë të paqëndrueshme, pasi që, Sektori i Tarifës është sektor profesional që detyrë ekskluzive e ka klasifikimin tarifor të mallrave, dhe se deri tek një mendim i tillë ka ardhur bazuar në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK-ut-2015, në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit XVII, kapitullit 87 dhe të krerëve 8704 dhe 8705, fotografive të bashkangjitura, shpjegimeve plotësuese, si dhe informatave tjera, përmes së cilave është konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me automjet për qëllime transporti të cilat nuk kanë të integruar pajisje tjera të posaçme të cilat do të mundësonin kryerjen e funksioneve të tjera përpos atyre të transportit, andaj klasifikimi i duhur i këtyre automjeteve është në numrin tarifor 8704 2139 00.

Në këtë kuptim Dogana e Kosovës konstaton se në rastin konkret nuk mund të veprohet sipas kërkesës së subjektit ankimor, andaj Dogana e Kosovës ka bërë vlerësimin e provave konform nenit 89 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj në bazë të arsyeve të lartcekura, dhe pas shqyrtimit të provave një nga një dhe të gjitha së bashku, Dogana e Kosovës refuzon kërkesën e subjektit ankimor si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi aktvendimin e lëshuar nga Sektori për Kundërvajtje Doganore.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe përveç asaj që është thënë në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, datë: 04/Dhjetor/2017

Drejtori Gjeneral

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Aktvendimi nga një kopje për:

1. Palën në procedurë,
2. Shkresat e lëndës
3. Për arkivin
4. Për Sektorin për Kundërvajtje Doganore

Shembulli i 15-të, natyra e çështjes
Tatimet-ATK
Rasti-1

Printuar më: **12-04-2019**

Republika e Kosovës Ministria e Financave Administrata Tatimore e Kosovës		Nr i Dokumentit MFA2C0000000	Data e Afatit të Deklarimit 20-02-2012 Data kur duhet bërë Pagesa 20-02-2012
NJOFTIM PËR RIVLERËSIM			
FIN	Llogaria Tatimore	Periudha Tatimore	Datat e Periudhës së Vlerësimit
600250469	586213	1 2012 Nr i Rivlerësimit: 18000000 Nr i Vlerësimit: 1700000000	Nga: 01-01-2012 Për: 31-01-2012
Për KOMPANIA E SIGURIMEVE "NNN" Adresa: Lloji i Tatimit: TV - TATIMI I VLERËS SË SHTUAR PRISHTINË Komuna: PRISHTINË, KOSOVA			
Qendra Tatimore NJTM		Data e Pranimit: 20-FEB-12	

Përmbledhje e Vlerësimit

Përshkrimi	Dorëzuar/ Adresuar Parapakisht	Vlerësuar
9 Furnizimet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi	,00	,00
10 Furnizimet e trajtuara si eksporte me të drejtë kreditimi	,00	615,03
11 Eksportet	,00	,00
12 Shitjet e tatueshme me normën 16%	339.356,77	492.569,44
13 Debi ne furnizimet e tatueshme 54.297,08 changed to 78.811,11	54.297,08	78.811,11 ,00
14 Nota debitore e lëshuar dhe nota kreditore e pranuar	,00	
15 Debi ne noten debitore te lëshuar dhe te pranuar	,00	,00
16 Fatura e borxhit të keq e pranuar dhe inkasimi i borxhit të keq	,00	,00
17 Debi te borxhit te keq	,00	,00
18 Rregullimet për të rritur TVSH-në për pagesë	,00	,00
19 Debi ne rregullimet e TVSH-se	,00	,00

20	Blerjet që i nënshtrohen ngarkeses së kundërt	20.932,00	29.932,00
21	Debi ne blerjet e ngarkeses se kundert	4.789,12	4.789,12
22	Totali I TVSH-se se llogaritur	59.086,20	83.600,23
	59.086,20 changed to 83.600,23		3.696,30
23	Blerjet dhe importet pa TVSH	33.585,70	
24	Blerjet dhe importet investive pa TVSH	,00	,00
25	Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme	,00	,00
26	Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	,00	,00
27	Importet e tatueshme	,00	,00
28	Kredi ne importet e tatueshme	,00	,00
29	Importet investive të tatueshme	,00	,00
30	Kredi ne imporet investive	,00	,00
31	Blerjet e tatueshme vendore	58.352,62	51.341,43
32	Kredi ne blerjet e tatueshme vendore	9.336,42	8.214,63
	9.336,42 changed to 8.214,63		7.011,19
33	Blerjet investive të tatueshme vendore	,00	
34	Kredi ne blerjet investive te tatueshme vendore	,00	1.121,79
	0,00 changed to 1.121,79		,00
35	Nota debitore e pranuar dhe nota kreditore e lëshuar	,00	
36	Kredi ne noten debitore te pranuar dhe noten kreditore te leshuar	,00	,00
37	Fatura e borxhit të keq e lëshuar dhe pagesa e borxhit të keq	,00	,00
38	Kredi e borxhit te keq te leshuar dhe pagesa e borxhit te keq	,00	,00
39	Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë	,00	,00
40	Kredi ne rregullimet e TVSH-se	,00	,00
41	E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt-	20.932,00	20.932,00
42	Kredi e TVSH ne lidhje me ngarkesen e kundert	789,12	789,12
43	Totali I TVSH-se se zbritshme	125,54	125,54
	14.125,54 changed to 14.125,54		
44	Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	,00	,00
45	Balanca kreditore e mbetur 45 = ((43+44)-22)>0	,00	,00
46	Kërkesa për rimbursim	,00	,00
47	Kreditimi i TVSH-së per muajin pasues 47 =(45-46)	,00	,00
48	TVSH që duhet të paguhet 48 =(22-43-44)>0	44.960,66	69.474,69
	44.960,66 changed to 69.474,69		
	Ndëshkim Dështim Për Të Paguar Me Kohë		2.103,36
	Ndëshkim \$\$Making Supplies Without Being Registered, If Failure To Register Is Due To The Carelessness (25%), Section 32, The Law 03/L-071\$\$		6.128,51
	Interesi:		7.356,07

Pjesa e Bankës

Nënshkrimi dhe Vula	Nr. i Llogarisë: 1000420070000373	Shuma e Tatimit të Paguesit
	Tekst:	
	Data:	

Transakcionet e Posaqme

FSHIJ BORXHIN - Ndëshkimi LIGJI NR.05/L-043-NR.05/L-119: -8.155,97

FSHIJ BORXHIN - Interesi LIGJI NR.05/L-043-NR.05/L-119: -7.261,19

Detyrimi - Ndëshkimi Furnizime pa regj. 25%: 6.128,51

Unë Deklaroj se Faktet e Dhëna Në Këtë Deklaratë Janë të Vërteta

Emri/Mbiemri/Nënshkrimi dhe Vula

(_____)

ERR

Përmbledhje e Pagesës			
	Detyrimi i Obliguar	Pagesa/Kredit i Aplikuar	Shuma obligative
Tatimi	69.474,69	69.474,69	0,00
Ndëshkimi	8.231,87	8.231,87	0,00
Interesi	7.356,07	7.356,07	0,00
Gjithsej Obligime Për Periudhën (Tatimi Ndëshkimet + Interesi):			0,00
Kreditit për Raportim:			0,00
Mbipagesa për periudhën:			0,00

Procedura e Ankesës

Neni 77 i Ligjit Nr. 03/L-222 thotë se tatimpaguesi mund të apeloj cilin do tatim shtesë, ndëshkim, apo interes të bërë nga Administrata Tatimore. Ankesa duhet t'i drejtohet Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore brenda 30 ditëve kalendarike.

Të gjitha ankesat:

- (1) Duhet të dorëzohen me shkrim;
- (2) Duhet të jenë të shoqëruara me fakte specifike, dokumente, dhe informata që përfshijnë:
 - llogari, fatura, librat dhe evidencën siç është specifikuar në Ligj, plus
 - fakte të tjera specifike, dokumente, dhe informata që paraqesin:
- (3) pse vlerësimi i dhënë nuk është korrekt; dhe
- (4) cila duhet të jetë baza korrekte ligjore e tatimit.
- (5) ju lutemi në çdo ankesë të figurojë adresa e saktë dhe numri i telefonit.

Sqarim: Në bazë të paragrafit 8 të Nenit 14 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo dokument i ofruar jashtë afatit të paraparë në paragrafin 7 të këtij Neni nuk do të merret në shqyrtim me rastin e paraqitjes së Ankesës në Departamentin e Ankesave apo në ankesën e mëvonshme të ushtruar nga tatimpaguesi.

Me postë ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVË Zyra Qendrore -
Departamenti i Ankesave Prishtinë

Në dorë Vendosi ankesën në zarf të mbyllur në adresë:

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVË Zyra Qendrore - Departamenti i
Ankesave Prishtinë, të protokolohet në librin e pranimit të ankesave.

Dorëzuar me

Pranoi:

**Për: ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS -
DEPARTAMENTIN E ANKESAVE**

Nga: Subjekti "NN" SHP me NRB 80000000 dhe NF 600000000, me seli në: me seli në rrugën B Mati 1 Prishtinë, me pronar.....,

Bazë të Nenit 77, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, brenda afatit ligjorë paraqet:

A n k e s ë

Kundër njoftim rivlerësimeve të cilat kanë rezultuar nga raporti i kontrollit i datës 31/08/2017 dhe atë për trajtimin e transaksioneve të shërbimeve për sigurime dhe ri sigurime, për vitin 2011 dhe 2012.

Ne si kompani e kundërshton pjesërisht Raportin e kontrollit të datës 31/08/2017, dhe atë të trajtimi i transaksioneve të shërbimeve për sigurime dhe ri sigurime për vitin 2011 dhe 2012 si transaksione të tatueshme, sepse shpjegimi publik nr. 02/2012, ku thirret Inspektori i Kontrollit nuk mund të prodhoj efekte juridike për periudhat retroaktive, kurse nëse i referohemi nenit 28 të Ligjit Nr.03/L-146 këto shërbime kanë qenë të lira dhe nuk mund të trajtohen si transaksione të tatueshme.

Kontrollit nuk ka arrit me vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe si rezultat i kësaj kemi gjendje të gabuar faktike, moszbatimit të Ligjit 03/L-146 nenit 52 dhe nenit 28 pika 1.1., i cili ka hyr në fuqi më 03/02/2010, dhe kemi aplikim retroaktiv sa i përket vendim shpjegues 02/2012 i cili ka hyr në fuqi më 07/03/2012.

Në procedurën e kontrollit të ATK-së, kemi shkelje të dispozitave ligjore me rastin e trajtimit të shërbimeve të sigurime dhe ri sigurimeve si transaksione të tatueshme për vitin 2011 dhe 2012. Duke u bazuar në ligje gjegjësisht nenin 28 të ligjit 03/L-146 ne nuk kemi bërë shkelje ligjore dhe të gjitha faturat e polisave të sigurimeve dhe ri sigurimeve i kemi evidentuar, por padrejtësisht po penalizohemi kinse për mos deklarim të transaksioneve si të tatueshme për të cilën pas dy vite vjen shpjegimi publik.

Vlerat kontestuese e cila kërkojmë që të kthehen në gjendje të mëparshme janë shitjet e periudhës 1 Shtator 2011 deri më 12 Mars 2012 dhe atë në vlerë prej 223,843.79€ ku është ngarkuar TVSh-ja në vlerë prej 39,777.49€.

Andaj, bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë nga DA-ve që pas shqyrtimit të fakteve dhe mbajtjes së seancës të nxjerr:

Andaj, bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë nga DA-ve që pas shqyrtimit të fakteve dhe mbajtjes së seancës dëgjimore të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e subjektit “NN” SHPK me NRB 80000000 si e bazuar.

Prishen njoftim vlerësimet sipas raportit të kontrollit nr. 630/2017 datë 31/08/2017, sa i përket tatimit shtesë për përu dhën 01 Shtator 2011 deri 12 Mars 2012.



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - Departamenti i Ankesave me panelin shqyrtues të kryesuar nga Mevlyde Berisha, Ramadan Ahmeti dhe Xhevdet Neziri anëtarë, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit “NN”, me numër të regjistrimit të biznesit 80000000 dhe numër fiskal 600000000, me seli në rrugën B Mati 1 Prishtinë, me numër protokollit 383/2017, kundër Njoftim Rivlerësimet të kontrollit të lëshuara nga Drejtoria e Tatimpagueseve të Mëdhenj, në seancën dëgjimore të mbajtur me datën 23/10/2017 në prezencë të palëve:..... përfaqësues i autorizuar i subjektit dhe..... Inspektor Tatimor, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit “NN” me NRB 80000000, me numër protokollit 383/2017, kurse Njoftim Rivlerësimet pas kontrollit vërtetohen si të bazuara.

II. Procedura e ankesës nuk ndërprehet sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit Nr. 03 / L-222 për “Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi me datë 31/08/2017 ka pranuar Njoftim Rivlerësimet pas kontrollit dhe procedurën e ankesës, ku brenda afatit të përcaktuar ligjor ka parashtruar ankesë më datë 29/09/2017, në përputhje me nenin 77 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi “Administratën Tatimore dhe Procedurat” dhe nenit 44 paragrafi 7 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 mbi “Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

Veprimtaria e subjektit është ofrimi i shërbimeve të sigurimit; sigurimi i mjeteve motorike sigurimet nga zjarri, sigurimet shëndetësore etj.

Subjekti afarist aktivitetin e tij e zhvillon në ter territorin Kosovës, kurse nga data 01/01/2015 aksionar 100% i aksioneve të “NN” është kompania “.....” me numër regjistrimi 80000001 me adresë rruga Tiranë – Prishtinë.

Kontrolli ka filluar më datë 01/02/2017 ku tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me dorëzimin e formularit AU003 dhe me zhvillimin e intervistës fillestare me datë 03/02/2017.

Objekt i kontrollit ka qenë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) periudhat: 01/2011 – 12/2016, Tatimi i Mbajtur në Burim (WM) periudhat: 02/2011 – 12/2016, Kontributet pensionale (CM) periudhat: 02/2011 – 12/2016, Tatimi i Mbajtur në Burim dhe pagesës së Interesit, të drejtës pronësore, Qirasë dhe Personin jo-rezident (WR) periudhat: 02/2011 – 12/2016 si dhe Tatimi në të Ardhura të Korporatave (CD) për vitin 2011 deri 2015.

Pas analizimit të evidencave kontabël, dokumentacionit të prezantuar nga tatimpaguesi dhe deklarimeve tatimore të bëra nga ana e tatimpaguesit janë paraqitur diferenca të cilat kanë ndikuar në rezultatin e kontrollit.

Në ankesën e datës 29/09/2017, tatimpaguesi e kundërshton pjesërisht Raportin e kontrollit të datës 31/08/2017 dhe atë për trajtimin e transaksioneve të shërbimeve për sigurime dhe ri sigurime për vitin 2011 dhe 2012 si transaksione të tatueshme.

Në ankesë më tej tatimpaguesi potencon se në vlerësimin e kontrollit kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike – moszbatimit të Ligjit 03/L-146 të nenit 52 dhe nenit 28 pika 1.1. qe ka hy në fuqi më 03/02/2010, dhe me veprim retroaktiv me vendim shpjegues 02/2012 i cili hyn në fuqi me 07/03/2012.

Në procedurën e kontrollit të ATK-së, kemi shkelje të dispozitave ligjore me rastin e trajtimit të shërbimeve të sigurime dhe ri sigurimeve si transaksione të tatueshme për vitin 2011 dhe 2012. Duke u bazuar në ligje gjegjësisht nenin 28 të ligjit 03/L-146 ne nuk kemi bërë shkelje ligjore dhe të gjitha faturat e pulisëve të sigurimeve dhe ri sigurimeve i kemi evidentuar, dhe ne nuk mbajmë përgjegjësi dhe njëherit penalizohemi për mos deklarim të transaksioneve si të tatueshme për të cilën pas dy vite vjen shpjegimi publik.

Vlerat kontestuese dhe të cilat kërkojmë qe të kthehen në gjendje të mëparshme janë shitjet e periudhës 1 Shtator 2011 deri më 12 Mars 2012 dhe atë 223,843.79€ ku është ngarkuar TVSh-ja në vlerë prej 39,777.49€.

Bazuar ne të lartcekurat kërkojmë nga Departamenti i Ankesave qe të aprovoj ankesën tonë për kontestin e paraqitur në ankesën me shkrim si të bazuar.

Departamenti i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L – 031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 23/10/2017, në të cilën të pranishëm ishin të gjitha palët e ftuara në mënyrë të rregullt.

Përfaqësuesi i tatimpaguesit ne të drejtën e fjalës theksoj se qëndroj mbrapa ankesës të cilën e kemi paraqitur me shkrim dhe jemi të interesuar të dimë nëse shpjegimi publik nr. 02/2012, mund të prodhoj efekte për periudhë retroaktive, gjegjësisht trajtimi i shërbimeve të sigurimeve dhe ri sigurimeve sipas nenit 28 të Ligjit Nr.03/L-146 dhe

sipas së cilit nen këto shërbime kanë qenë të liruara të trajtohen si transaksione të tatueshme.

Inspektori i kontrollit ne të drejtën e fjalës theksoj se ne jemi bazuar në shpjegimin publik nr. 02/2012 sa i përket trajtimit të këtyre shërbimeve dhe duhet cekur se ne nuk i kemi trajtuar sigurimet e jetës.

Departamenti i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, pas dëgjimit të dy palëve, gjatë seancës dëgjimore dhe pas vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës, vërtetohet, se ankesa është e pa bazuar.

Sipas Departamentit të Ankesave, Inspektori Tatimor transaksionet e shërbimeve të sigurimeve dhe ri sigurimeve i ka vlerësuar bazuar në nenin 28 të Ligjit 03/L-146 për TVSh i sqaruar me Shpjegimin Publik Nr. 02/2012 për Trajtimin e transaksioneve të Sigurimit dhe Ri- sigurimit nga aspekti i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, ku neni 2 i këtij shpjegimi sqaron: Të gjitha transaksionet nga Kompanitë e Sigurimeve dhe Ri-sigurimeve, duke përfshirë shërbimet e lidhura të bëra nga brokerat e sigurimit dhe agjentët e sigurimit, gjatë periudhës kalimtare 01.01.2010 deri më 31.12.2012, trajtohen si furnizime të tatueshme me të drejtën e zbritjes së TVSh-së së zbritshëm.

Gjatë periudhës kalimtare, për furnizimet të cilat kanë të bëjnë me sigurimet dhe ri sigurimet do të zbatohen rregullat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2004 të datës 01 shtator 2004 për zbatimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, bazuar në Rregulloren 2002/17 dhe Ligjin Nr. 03/L-114 për TVSH.

Sa i përket pretendimit të tatimpaguesit se Shpjegimi Publik Nr.02/2012 i publikuar më datë 07/03/2012 nuk mund të ketë efekt retroaktiv për periudhën Shtator 2011 deri Mars 2012, Departamenti i Ankesave vlerëson se vendimet shpjeguese janë mjete për konkretizimin dhe sqarimin e mënyrës së zbatimit në praktikë të legjisllacionit tatimor dhe nuk janë akte përmes të cilave ndryshohen, plotësohen apo krijohen dispozita të reja, edhe efekti i tyre, pavarësisht momentit së kur nxjerrën, ndërlidhet për gjithë periudhën kur dispozita konkrete ligjore që interpretohet ka hyrë në fuqi e deri sa e njëjta dispozitë nuk shfuqizohet.

Andaj, kur bëhet fjalë për vendime shpjeguese publike, nuk bëhet fjalë për efekt para veprues apo prapaveprues të këtyre shpjegimeve publike, por vendimet e tilla shpjeguese publike lidhen me gjithë periudhën sa dispozita konkrete ligjore që interpretohet të jetë në fuqi.

Sipas të dhënave të cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 132 paragrafi 2 i LPA-Nr. 05/L-031.

DEPARTAMENTI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr. 333/2017 datë 27/10/2017

Drejtor i Ankesave

Kryesuesi i panelit shqyrtues

KËSHILLA JURIDIKE:

Bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, tatimpaguesi ka të drejtë që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit të Departamentit të Ankesave, ta kundërshtojë vendimin në Gjykatën Themelore - Prishtinë, Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal.

Vendimi t'iu dorëzohet:

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore



Barra tatimore Patundshmëritë

Komuna	
Emri i zyrës kadastrale	
Adresa	
Baza ligjore	Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore 03/L-222, Neni 33. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2010, Neni 32.

Pronari

Emri i pronarit	
Emri i prindit	
Mbiemri	
Adresa/ numri i shtëpisë, apartamentit	
Numri identifikues	

Të dhënat mbi patundshmëritë

Njësia kadastrale	
Zona kadastrale	
Letra e posedimit	
Parcela	
(Pjesë nga) ndërtesa-apartamenti/	
Të dhëna tjera	

Obligimet tatimore-shuma	10,000.00€
Përcaktuar nga data	

Letër vlerësimi i dërguar te debitori-Data	
--	--

Barra do të jetë në fuqi deri në njoftimin e ardhshëm nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Barra mund të shkarkohet vetëm me certifikatën e nënshkruar dhe të vulosur, që lëshohet nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Barra mund të shkarkohet vetëm nëse debitori i lartpërmendur mund të prezantoj certifikatën e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Njoftimi do të lëshohet në formë të certifikatës e nënshkruar nga Drejtori Rajonal në emër të Administratës Tatimore të Kosovës.

Nënshkrimi dhe vula e Drejtorit Rajonal



Procedurat e ankesës

Neni 33 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-222 thotë se një person mundë të paraqes ankesë lidhur me vendosjen e barrës nëse vlerëson se barra ju ka vendosur gabimisht. Ankesa duhet t'i drejtohet Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore brenda 30 ditëve kalendarike.

Të gjitha ankesat:

- (1) Duhet të dorëzohen me shkrim;
- (2) Duhet të jenë të shoqëruara me fakte specifike, dokumente, dhe informata që përfshijnë:

- llogari, fatura, librat dhe evidencën siç është specifikuar në Ligj, plus
- fakte të tjera specifike, dokumente, dhe informata që paraqesin:

- (3) pse vlerësimi i dhënë nuk është korrekt; dhe
- (4) cila duhet të jetë baza korrekte ligjore e tatimit.
- (5) ju lutemi në çdo ankesë të figurojë adresa e saktë dhe numri i telefonit.

Me postë ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVË Zyra Qendrore -
Departamenti i Ankesave - Prishtinë

Në dorë Vendosni ankesën në zarf të mbyllur në adresë:

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVË Zyra Qendrore - Departamenti i
Ankesave Prishtinë, të protokolohe në librin e pranimit të ankesave.

Dorëzuar me datë...../...../.....

Pranoi:.....

Për: **ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS -
DEPARTAMENTIN E ANKESAVE**

Nga: Subjekti "NN" SHP me NRB 8000000 dhe NF 60000000, me seli në: rr. Luigj Gurakuqi – Pejë, me pronar.....,

Bazë të Nenit 77, paragrafi 2 dhe Neni 33 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, brenda afatit ligjorë paraqet:

A n k e s ë

Kundër Barrës Tatimore të vendosur me datën 10/03/2016, ndaj pasurisë së kompanisë "NN" SHPK, për arsye se:

Lidhur me obligimet tatimore të përcaktuara me kontroll në vlerë prej 10,000.00€ me ndëshkime dhe interes, si rezultat i të cilave ATK ka vendos barrë tatimore në pasurin e kompanisë tonë, ne si kompani brenda afatit ligjor kemi paraqit ankesë/ padë në Gjykatë ndaj njoftim vlerësimeve dhe raportit të kontrollit të datës....., dhe përderisa rasti është në trajtim gjyqësor ATK nuk ka drejt me vendos barrë tatimore në pasurin e kompanisë.

Provë: *Ankesa/ padia e kompanisë ndaj njoftim vlerësimeve e datës.....*

Barra tatimore e vendosur në pasurin e kompanisë tonë, përfshirë edhe bllokimin e llogaris bankare të kompanisë, paraqet pengesa serioze në ushtrimin e aktivitetit tonë afarist, sepse një pjesë të konsiderueshme të pagesave kompania jon i pranon dhe i realizon përmes llogaris bankare, kurse bllokimi i llogaris në mënyrë të kundërligjshme do dëmton shumë kompaninë tonë, dhe njëherit do na pamundëson marrjen e kredisë për te cilën kemi aplikuar si kompani.

Andaj, bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë nga DA-ve që pas shqyrtimit të fakteve dhe mbajtjes së seancës të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e subjektit "NN" SHPK me NRB 8000000 dhe NF 60000000 si e bazuar.

Obligohet Mbledhja e Detyruar që brenda 10 dite ta liroj Barrën Tatimore të vendosur me datën 10/03/2016, ndaj pasurisë së kompanisë "NN" SHPK, në pritje të vendimi nga gjykata lidhur me çështjen e borxhit kontestues.



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - Departamenti i Ankesave në përbërje të panelit shqyrtues: z. Amir Bullatovci, kryesues, znj. Besa Kurti dhe Ramadan Ahmeti, anëtar, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit “NN” SHPK me NRB: 8000000, NF: 60000000, me seli në: rr. Luigj Gurakuqi - Pejë, me numër protokollit 77/2016, e dorëzuar në Administratën Tatimore me datën 16/03/2016, kundër Barrës tatimore të vendosur nga Mbledhja e Detyrueshme e ATK-së - Pejë, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 13/04/2016, në prezencë të palëve: z....., pronar, z. Eduart Gegaj, zyrtar nga Mbledhja e Detyrueshme, z. Rexhep Kuqi, këshilltar tatimor, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazë ankesa me nr. 77/2016 e subjektit “NN”SHPK, kurse Barra Tatimore e vendosur me datën 10/03/2016 vërtetohet si e bazuar.

II. Procedura e ankesës nuk ndërprehet sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit Nr. 03/L-222 për “Administratën Tatimore dhe Procedurat”.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi ka parashtruar ankesë me datë 16/03/2016, në Departamentin e Ankesave, kurse Njofitimin për Barrë i ka pranuar me datë 19/02/2016, në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me Nenin 77.2 të Ligjit 03/L-222 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Tatimore”.

Me ankesë tatimpaguesi ka kundërshtuar vendosjen e barrës tatimore në pasurin e tij dhe llogarinë bankare, si rezultat i asaj se ndaj obligimeve tatimore lidhur me të cilat ATK ka regjistruar barrën tatimore, e të cilat obligime kanë rezultuar me kontroll, ka paraqit ankesë/padi në Gjykatë dhe përderisa rasti është në trajtim gjyqësor ATK nuk ka drejt me vendos barrë tatimore në pasurin e kompanisë dhe as ti bllokoj llogarinë bankare.

Edhe në seancë tatimpaguesi deklaroj se qëndron mbrapa ankesës dhe kërkoj nga DA-ve që ta detyroj ATK-në – Mbledhjen e Detyrueshme që në afatin sa më të shpejt ta tërheq barrën tatimore nga pasuria e kompanisë sepse barra tatimore e vendosur në pasurin e kompanisë, përfshirë edhe bllokimin e llogaris bankare të kompanisë, paraqet pengesa serioze në ushtrimin e aktivitetit tonë afarist, sepse një pjesë të konsiderueshme të pagesave kompania jon i pranon dhe i realizon përmes llogaris bankare, kurse bllokimi i llogaris e dëmton shumë kompaninë ne këtë drejtim dhe

njëherit i pamundëson kompanisë me realizuar kredinë për të cilën ka parashtruar kërkesë në njëerën nga bankat e Kosovës.

Sipas Mbledhjes së Detyrueshme: Subjekti në fjalë ka obligim ndaj ATK-së, i cili obligim tani si rezultat i llogaritjes të interesit kalon vlerën prej 10,000.00€, andaj për këtë arsye ATK ka vendos barrën tatimore në pasurin e subjektit me qëllim të sigurimit të kërkesës – borxhit, bazuar në Nenin 33 të Ligjit mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore 03/L-222, dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2010, Neni 32.

Kurse përfaqësuesi i Mbledhjes së Detyrueshme lidhur me pretendimet e tatimpaguesit se ATK barrën tatimore nuk ka drejt ta vendos përderisa tatimpaguesi ka paraqit ankesë/padi në gjykatë lidhur me obligimet tatimore të vlerësuar nga kontrolli, i konsideron të pa qëndrueshme sepse bazuar në Nenin 33 të Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ATK ka të drejt ta regjistroj barrën tatimore në pasurin e tatimpaguesit përfshirë edhe bllokimin e llogaris bankare vete 10 ditë pasi që tatimpaguesi ka pranuar Njoftim Vlerësimet dhe mbi këtë bazë ligjore kemi regjistruar barrën tatimore dhe kemi bllokuar llogarinë bankare të kompanisë.

Departamenti i Ankesave pasi ka analizuar ankesën e tatimpaguesit, barrës tatimore, pretendimet e palëve në seancë dhe dispozitave ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendime për arsyen se:

Tatimpaguesi me datën 05.02.2016, ka pranuar Njoftim vlerësimet lidhur me rezultatin e kontrollit, e cila kontroll ka rezultuar me tatim shtesë në vlerë prej 10,000.00€ e të cilin tatim tatimpaguesi nuk e ka paguar në afat prej 10 dite ashtu si e obligon Neni 22 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe si rezultat i kësaj Mbledhja e Detyrueshme duke u bazuar në Nenin 33 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-222, ka regjistruar barrën tatimore në pasurin e tatimpaguesit me qëllim të sigurimit të pagesës së borxhit nga tatimpaguesi.

Sa i përket pretendimeve të tatimpaguesit se ka paraqit ankesë në Gjykatë lidhur me obligimet tatimore të përcaktuara me kontroll dhe si rezultat i kësaj ATK nuk ka drejt të vendos barrë tatimore përderisa Gjykata nuk merr vendim përfundimtar, kjo nuk qëndron sepse Neni 33 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-222, i jep të drejt ATK-së të vendos barrë tatimore në pasurin e personit i cili nuk paguan tatimin apo refuzon ta paguaj tatimin pas 10 dite nga momenti kur personi ka pranuar njoftim vlerësimet lidhur me tatimin.

Andaj DA-ve konsideron se Mbledhja e Detyrueshme me të drejt ka vendos barrën tatimore ndaj pasurisë së tatimpaguesit pasi që i njëjti ka dështuar ta paguaj tatimin brenda afatit ligjor të përcaktuar me ligj dhe se paraqitja e ankesës në gjykatë ndaj rezultateve të kontrollit nuk e pengon vendosjen e barrës tatimore, por ankesa e tillë e pezullon të drejtën e ATK-së ta konfiskoj pasurin dhe ta shes në ankand publik ndaj të

cilës është vendosur barra tatimore, deri sa gjykata të vendos lidhur me kontestin tatimor.

Sipas të dhënave të cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 132 paragrafi 2 i LPA-Nr. 05/L-031. Kshillë

DEPARTAMENTI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr. 77/2016 datë 10/05/2016

Drejtor i Ankesave

Kryesuesi i panelit shqyrtues

KËSHILLA JURIDIKE:

Bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, tatimpaguesi ka të drejtë që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të vendimit të Departamentit të Ankesave, ta kundërshtojë vendimin në Gjykatën Themelore - Prishtinë, Departamenti Administrativ - Divizioni Fiskal.

Vendimi t'iu dorëzohet:

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

KONKLUZION

Në këtë udhëzues Administrativ, është e përfshirë në mënyrë teorike e gjithë procedura administrative e cila zhvillohet pranë organit administrativ, duke filluar nga kërkesa e palës apo sipas detyrës zyrtare nga vetë organi administrativ, me të cilën edhe fillon procedura administrative, gjithashtu është e përfshirë edhe procedura deri në marrjen e vendimit përfundimtar. E gjithë kjo procedurë duke u bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjeve të tjera speciale për secilën materie për të cilën edhe flet shembulli, janë paraqitur në mënyrë praktike, të gjitha format e rasteve të cilat mund të zhvillohen në procedurën administrative.

Në këtë udhëzues është paraqitur edhe rrjedha kronologjike e një çështjes, se si duhet vepruar pala por edhe organi administrativ me rastin e fillimit, zhvillimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar lidhur me një çështje administrative pranë organit kompetent administrativ.

Përveç kësaj paraqitje e cila me shumë kujdes është shtjelluar përmes teorisë dhe praktikës të cilën e përcakton edhe LPPA-ja, duket të theksojmë se në procedurën administrative vendoset përveç me VENDIM lidhur me një çështje të palës sipas kërkesës së sajë, shpesh herë organet administrative gabimisht kanë vendosur që palës ti përgjigjen me:

- Njoftim
- Konkluzion apo
- Përgjigje

Të gjitha këto forma të aplikuara nga organet administrative për të vendosur në mënyrë përfundimtare për një kërkesë të palës janë të gabuara, këto mund të përdoren nga organet vetëm për të vendosur për çështje procedurale gjatë zhvillimit të procedurës administrative lidhur me një kërkesë të palës ose edhe në rastet kur informohet opinioni publik i gjërë lidhur me një vendim i cili përfshim më tepër persona e i cili e ka karakterin informues të opinionit publik.

Duhet theksuar edhe një herë se për një kërkesë të palës lidhur me një të drejtë të caktuar, organi administrativ duhet të zhvillojë procedurë duke ju përmbajtur dispozitave të LPPA-së, dhe të merr vendim në shkallë të parë të dytë apo vendim përfundimtar kur ndaj vendimit nuk kemi të drejtë ankese.

Krejt në fund kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative, gjithmonë pala ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh, të iniciojë procedurën e Konfliktit Administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës - Departamenti për Çështje Administrative, konform dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

